



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

T R A N S K R I P T

**I MBLEDHJES PLENARE TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË
KOSOVËS, E MBAJTUR MË 30 DHE 31. JANAR 2014**

**SA PLENARNE SEDNICE SKUPŠTINE REPUBLIKE KOSOVA,
ODRŽANE 30. I 31. JANUARA 2014. GODINE**

**JANAR - JANUAR
2014**

Rendi i ditës

1. Koha për deklarime jashtë rendit të ditës,
2. Koha për pyetje parlamentare,
3. Miratimi i procesverbalit nga seanca e mëparshme,
4. Shqyrtimi i Projektligjit për ratifikimin e Marrëveshjes për statusin e anëtarëve të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë dhe Forcës së Sigurisë së Republikës së Kosovës gjatë qëndrimit të tyre të përkohshëm në territorin e shteteve respektive,
5. Shqyrtimi i Projektligjit për ratifikimin e Marrëveshjes për hua dhe financim ndërmjet KFW Frankfurt Am Main, Republikës së Kosovës dhe Operatorit të Sistemit, Transmisionit dhe Tregut KOSST për përmirësimin e rrjetit të transmisionit,
6. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për Shërbimin Gjeologjik të Kosovës,
7. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për masat antidamping dhe masat kundërbalancuese,
8. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për mbrojtjen nga zhurma,
9. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për Zonën e rrezikuar mjedisore të Obiliqit dhe rreth tij,
10. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për pajisje me armë dhe pajisje përkatëse të sigurisë për institucionet e autorizuara shtetërore për siguri,
11. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për armë,
12. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për Inspektoratin e Doganës dhe Administratës Tatimore të Kosovës,
13. Raporti i punës së Komisionit ad hoc për Reformën Zgjedhore,
14. Propozimi i Grupit Parlamentar të Lëvizjes “Vetëvendosje” për zëvendësimin e anëtarit në Komisionin Parlamentar.

Dnevni red

1. Vreme za deklarisanja izvan dnevnog reda,
2. Vreme za poslanička pitanja,
3. Usvajanje Zapisnika sa prethodne sednice,
4. Razmatranje Nacrta zakona o ratifikaciji Sporazuma o statusu članova Oružanih snaga Republike Albanije i Bezbednosne snage Kosova tokom njihovog privremenog boravka na teritoriji respektivnih država,
5. Razmatranje Nacrta zakona o ratifikaciji Sporazuma za pozajmicu i finansiranje između KFW Frankfurt Am Main, Republike Kosova i Operatora sistema, transmisije i tržišta KOSST za poboljšanje transimisione preže,
6. Prvo razmatranje Nacrta zakona o geološkoj službi Kosova,
7. Prvo razmatranje Nacrta zakona o anti-damping merama i protiv-balansirajućim merama,
8. Prvo razmatranje Nacrta zakona o zaštiti od buke,
9. Prvo razmatranje Nacrta zakona o ugroženoj zoni životne sredine Obilića i njegove okoline,
10. Prvo razmatranje Nacrta zakona o izmeni i dopuni Zakona o opremanju oružjem i odgovarajućom opremom sigurnosti za ovlašćene državne institucije za sigurnost,
11. Prvo razmatranje Nacrta zakona o oružjima,
12. Prvo razmatranje Nacrta zakona o Inspektoratu Carine i Poreske administracije Kosova,
13. Izveštaj o radu Ad hoc komisije za izbornu reformu,
14. Predlog PG Pokreta “Vetëvendosje” za zemenu člana skupštinske komisije.

Mbledhjen e drejtoi kryetari i Kuvendit, z. Jakup Krasniqi.

KRYETARI: Të nderuar deputetë,

Të nderuar ministra,

I hap punimet e mbledhjes plenare të Kuvendit të Republikës së Kosovës, sipas rendit të ditës, të përgatitur nga Kryesia me kryetarët e grupeve parlamentare.

Fillojmë me pikën e parë të rendit të ditës:

1. Koha për deklarime jashtë rendit të ditës

Koha për deklarime jashtë rendit të ditës është e kufizuar në 30 minuta, në emër të grupit 5 minuta, në emër të deputetëve 3 minuta.

Në emër të Grupit Parlamentar, fjalën e ka kërkuar deputeti Ramë Vataj.

RAMË VATAJ: Të nderuar anëtarë të Kabinetit qeveritar!

Të nderuar kolegë deputetë,

Të gjithë jemi dëshmitarë të një gjendjeje të rëndë të jetuar javët e fundit në Universitetin më të vjetër në Publik në Republikën e Kosovës, ndaj së cilës nuk mund të jetë indiferent asnjë qytetar i Kosovës, aq më pak një deputet i Kuvendit të Kosovës.

Kjo gjendje është e rënduar shumë këto ditët e fundit, kur një grup i studentëve e kanë bllokuar hyrjen e Rektoratit të Universitetit të Prishtinës, duke kërkuar dorëheqjen dhe shkarkimin e rektorit, zotit Ibrahim Gashi, me ç'rast Policia është detyruar të reagojë për ta hapur hyrjen e Rektoratit, në mënyrë që të zhvillohet puna normale.

Deri te kjo situatë ka ardhur pas prononcimeve të disa profesorëve, punëtorë të Universitetit të Prishtinës, të cilët kanë dhënë vlerësime rreth avancimit të disa profesorëve, në mesin e tyre edhe të rektorit Gashi në mënyrë të jashtëligjshme, duke botuar publikime në disa revista, sipas tyre, korruptive.

Ne si grup parlamentar e mirëpresim në çdo kohë debatin, i cili ka për qëllim të vetin përmirësimin e cilësisë së një institucioni të arsimit të lartë, aq më tepër kur është fjala edhe për personin udhëheqës në Universitetin e Prishtinës.

Ndoshta deri te kjo gjendje kemi ardhur edhe për shkak të mungesës së një debati të mirëfilltë në kuadër të Universitetit të Prishtinës. Kësaj situate të krijuar i kanë ndihmuar mjaft shumë disa gazetarë dhe portale, të cilat nganjëherë në mënyrë jokompetente dhe të paargumentuar mirë kanë shkaktuar huti në opinionin e gjerë.

Ndërsa, disa prej profesorëve të cituar për botimet e tyre në revistat korruptive kanë dhënë argumente të dëshmuara se në këto revista publikojnë edhe shkencëtarë eminentë dhe se revistat në fjalë nuk mund të quhen korruptive.

Ndërsa është konstatuar se këto revista të cituara e kanë një bord editorial dhe disa prej tyre kanë edhe impakt-faktorë, që është një tregues i qartë se nuk mund të jenë korruptive, apo të parëndësishme.

Këto dhe problemet tjera janë diskutuar edhe në Komisionin Parlamentar për Arsim, me ç'rast është ftuar ministri i Arsimit, zoti Buja, për të diskutuar për gjendjen e krijuar në Universitetin e Prishtinës dhe për veprimet që po bëhen për eliminimin e këtyre problemeve.

Ndërsa, e inkurajojmë Ministrinë e Arsimit, Këshillin Drejtues dhe Senatin e Universitetit të Prishtinës për veprimet e ndërmarra këto dy ditët e fundit për ta sqaruar të vërtetën rreth avancimit të rektorit dhe të disa profesorëve të universitetit dhe për masat që do të shqiptohen në rast të konstatimit të avancimit të pamerituar.

Në bazë të Ligjit për arsimin e lartë në Republikën e Kosovës dhe Statutin e Universitetit të Prishtinës, janë të rregulluara qartë kushtet e pranimit dhe avancimit të stafit akademik, përzgjedhja e organeve të universitetit dhe detyrat e tri autoriteteve kryesore qeverisëse të universitetit: Këshilli Drejtues, rektori dhe Senati.

Ndërsa neni 31 i Statutit të Universitetit të Prishtinës përcakton se në cilat raste përfundon para kohe mandati i rektorit. Në këtë nen askund nuk është shkruar se mandati i rektorit përfundon në rast të protestave të studentëve, apo pakënaqësive të grupeve të ndryshme politike, të cilat për interesa të natyrave të ndryshme shprehin kritika për punën e tij.

Pranimi dhe avancimi i stafit akademik kalon nëpër disa filtra, duke filluar prej departamentit, komisionit recensues, Këshillit të fakultetit, Komisionit të studimeve dhe, në fund, Senatit. Kështu që mendojmë se heqja e titullit të një kandidati, i cili mund të dyshohet për arritje të pamerituar, duhet të kalojë nëpërmjet këtyre filtrave, e assesi nga opinionet e dhëna nga njerëz jokompetentë dhe që nuk janë të fushës së caktuar.

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës jemi për një punë transparente me të gjitha institucionet e arsimit të lartë dhe institucionet tjera shkencore, që të formohen komisione vlerësuese të të gjitha fushave për t'i vlerësuar të gjitha diplomat e doktoratës dhe titujt e fituar, sidomos në kohën e pasluftës dhe mënyrës së pranimit dhe avancimit të profesorëve gjatë karrierës së tyre akademike.

Jemi që të hetohen nëse ka plagjiatura në veprat dhe punimet e tyre, si dhe çdo përfitim i paligjshëm në këtë drejtim të sanksionohet me heqjen e gradës dhe kthimin e të gjitha përfitimeve që i ka arritur nga avancimi, apo pranimi i paligjshëm.

E mirëpresim një debat parlamentar që do të bëhet shumë shpejt në lidhje me shkeljet dhe parregullsitë në të gjitha institucionet e arsimit të lartë dhe të shkencës në Kosovë dhe pa dyshim që Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike do ta japë kontributin e vet të çmuar në këtë drejtim. Faleminderit!

KRYETARI: Deputet, je edhe kryetar i Komisionit për Arsim e tjera, dhe realisht kjo temë e rendit të ditës më së paku i përket kësaj pike të rendit të ditës.

Dhe, unë mendoj që kjo pikë e rendit të ditës është për çështje që s'mund të hyjnë në rend ditës. Kjo çështje ka mundur fare lehtë, me propozimin tuaj, të hyjë në rend dite sot. Dhe, çështjet që i ngrite janë të komisionit që është ngritur atje, e nuk është çështje e Kuvendit.

Vazhdojmë! Në emër të Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike, deputeti Armend Zemaj e ka fjalën.

ARMEND ZEMAJ: Faleminderit, kryetar i Kuvendit!

Të nderuar kolegë deputetë,
Kabinet qeveritar,

Dola sot këtu, në emër të Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Kosovës, të shpreh shqetësimin tonë për mospërbushjen e obligimeve që dalin nga Kuvendi për Qeverinë e Republikës së Kosovës.

Tani është shumë e qartë për mua dhe të gjithë se kjo është Qeveri e premtimeve, Qeveri e cila jo rrallëherë e anashkalon edhe organin mbikëqyrës, siç është Kuvendi i Kosovës, madje deri te mosrespektimi i ligjeve dhe akteve tjera në fuqi. Aspiratat e popullit shqiptar të Kosovës për liri e pavarësi, të ndërtuara me mund dhe sakrificë deri në flijim për jetë, janë kontribut i qytetarëve të vendit tonë për një shtet demokratik, të zhvilluar, të edukuar dhe me arsim cilësor, ashtu siç janë popujt dhe vendet më të zhvilluara demokratike.

E pjesë e kësaj ishin dhe mbeten mësimdhënësit, të cilët punuan dhe u angazhuan që arsimi shqip ta zhvillojë veprimtarinë arsimore në këtë fushë dhe në kushte të rënda edhe në ditët e okupimit të vendit tonë. Njerëzit e dijes, intelektualë dhe veprimtarë, të rreshtuar pas idealit të lirisë dhe pavarësisë, e ndërtuan dhe avancuan arsimin e pavarur shqip me mund dhe sakrificë, duke e dhënë edhe jetën në mbrojtjen e shkollës shqipe.

Shembuj të tillë kemi si Haki Povataj, Halit Geci, prindërit e Uçës dhe deri te akademik Fehmi Agani e shumë të tjerë, në luftën mbinjerëzore të ndërtimit të shtetësisë së Republikës së pavarur të Kosovës.

Mësimdhënësit tanë asnjëherë nuk u shpërblyen ashtu siç duhen me paga, punuan në kushte të vështira, disa edhe në zona të thella. E përballuan rreziqet e okupatorit, e përballuan edhe injorancën dhe mosrespektimin e shtetit të pavarur, por i qëndruan besnik misionit të tyre fisnik të arsimit të brezave në vendin tonë. Sot kjo Qeveri dhe njerëzit e saj, të udhëhequr me logjikën primitive, duke menduar se jeta fillon me ta, madje edhe historia gjenezën e ka nga viti 1998 dhe duhet të rrugëtojë sipas logjikës së tyre, i sfidojnë mësimdhënësit, intelektualët, veprimtarët patriotë dhe të devotshëm, luftën dhe luftëtarët.

Madje, tentohet të veprohet në mënyrë selektive me njerëzit në bazë të interesave individuale, grupore, për përfitime politike dhe partiake.

Të nderuar kolegë deputetë,

Lidhja Demokratike e Kosovës është angazhuar që punëtorët e arsimit shqip të Republikës së Kosovës t'i gëzojnë të drejtat e tyre legjitime, duke marrë parasysh infrastrukturën ligjore, e cila asnjëherë deri më tani nuk e ka rregulluar statutin e tyre pensional, por mbi të gjitha njohjen e kontributit të pamohuar e meritës për ndërtimin e shtetit të Republikës së Kosovës.

Në bazë të kësaj, LDK-ja, duke marrë parasysh se kjo Qeveri nuk kishte vullnet ta rregullojë këtë çështje në bazë të Ligjit me skemën suplementare pensionale, e trajtoi këtë çështje edhe në seancë të veçantë plenare, duke kërkuar ligj të veçantë dhe duke ia dhënë meritat arsimit si sektor i veçantë në ndërtimin e shtetësisë së Kosovës, me qëllim të rregullimit të statusit të mësimdhënësve, personelit udhëheqës e organizativ, e deri te pronarët e shtëpive-shkolla.

E gjithë kjo e bazuar në sakrificën sublime të punës së tyre në vitet 1990-1999 për ta ruajtur autoritetin, integritetin dhe aspektin moral të tyre në shoqëri. Rekomandimet e dala nga seanca plenare, të përkrahura edhe nga Kuvendi, edhe sot e pothuajse një vit nga aprovimi nuk kanë përgjigje as nga Qeveria, as nga Ministria e Arsimit, si dikaster përkatës.

Kjo e tregon jo vetëm neglizhencën e saj, por për ne është më se evidente se tani jemi mësuar se kjo Qeveri, kur është në pyetje kjo kategori tregohet e vëmendshme vetëm në prag të fushatës, apo edhe në fushatë zgjedhore me premtime të llojllojshme.

Andaj, e ftoj Qeverinë e Kosovës që ta sjellë sa më shpejt ligjin në fjalë, të mos e neglizhojë këtë proces të rëndësishëm, madje të mos tentojë që kjo çështje të jetë justifikim për fushatë parazgjedhore, kur arsimtarët dhe profesorët të shërbejnë si mjet manipulimi me kushtet dhe ndjenjat e tyre.

Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës konfirmon se nëse nuk respektohen rekomandimet e dala nga seanca plenare, në afat prej dy javësh, së bashku me ekspertë të kësaj fushe do ta marrin nismën legjislative për hartimin e këtij ligji, i cili është më se i nevojshëm, por më shumë është obligim i shtetit të Kosovës ndaj mësimdhënësve që kontribuan për arsimin shqip dhe që e mbajtën gjallë idenë e ndërtimit të Republikës së Kosovës. Faleminderit!

KRYETARI: Unë dëshiroj t'ju përkujtoj edhe një herë nenin 47, që ka të bëjë me këtë pikë të rendit të ditës. Po e lexoj paragrafin e parë në tërësi:

“Në fillim të mbledhjes, para miratimit të rendit të ditës, pasi ta kenë njoftuar kryetarin e Kuvendit, deputetët, përkatësisht grupet parlamentare, mund të diskutojnë për çështje të ndryshme që i konsiderojnë që s'janë publike, por duhet bërë publike në mbledhjen plenare dhe që s'kanë mundur të hyjnë në rend dite”.

Vazhdojmë! Në emër të “Vetëvendosjes”, fjalën e ka deputeti Albin Kurti.

ALBIN KURTI: Faleminderit, kryetar!

Deputetë të Kuvendit të Kosovës,

Po i afrohem ditës kur do shënohet gjashtëvjetori i shpalljes së pavarësisë së Kosovës.

Mund të themi që pika më e lartë e kësaj pavarësie ishte shpallja. Që prej atëherë nuk pati zhvillim ekonomik e punësim, nuk pati shtrirje të sovranitetit dhe vendosje të integritetit territorial, dhe nuk pati as zvogëlim të korrupsionit e të krimit. Mbi të gjitha, vazhduan edhe negociatat e padrejta me Serbinë, edhe privatizimet e paligjshme.

Prandaj, nëse Republika e parë e Kosovës, pra ajo që u shpall më 2 korrik të vitit 1990, ishte republikë për rezistencë në kushtet e okupimit dhe të aparteidit, republika e 17 shkurtit 2008 doli të jetë republikë për shitje. Po them “republikë për shitje”, sepse ajo përherë ishte dhe vazhdon të jetë, në njërin anë, republikë e negociueshme, kurse, në anën tjetër, republikë e privatizueshme.

Republika e dytë e Kosovës është bërë republikë e pakicës dhe jo republikë e shumicës. Është interesant qysh shumë qeveritarë, por edhe deputetë që i mbështetin edhe negociatat, edhe privatizimet, orvaten ta mbrojnë shtetin e pavarur dhe Republikën e Kosovës prej lëvizjes “Vetëvendosje”. Pra, këta politikanë që bëjnë paqe të turpshme e kompromise të kalbura me Serbinë, këta politikanë që republikën nga një “res publike” e shndërrojnë në një “res private”, e paskan gjetur armikun e pavarësisë, “Vetëvendosjen”.

Përderisa Serbia po forcohet përbrenda Kosovës, përderisa korrupsioni e pabarazia po rriten, këta politikanë të regjimit shtiren se po e mbrojnë pavarësinë duke e sulmuar “Vetëvendosjen” në çdo hap.

Bëhet fjalë për të njëjtit politikanë që betoheshin te Ahtisari dhe paketën e tij e cilësojnë të shenjtë. Tash, pikërisht këta janë të gatshëm për ndryshime kushtetuese, për privilegje e favorizime partikulare sipas përkatësisë etnike. Prej asociacionit të komunave me shumicë serbe, ku do të sundojë partia e çetnikëve nga Beogradi, e deri te amnistia e kriminelëve serbë nga veriu, prej tendencave të vazhdueshme për ulëse të rezervuara edhe për një a dy mandate, e deri te pazaret e paralajmëruara për ‘Trepçën’ e Ujmanin, të gjitha këto projekte kundër republikës e kanë gjetur mbështetjen në këtë Qeveri dhe në këtë Kuvend dhe kritikën parimore e kundërshtimin kategorik vetëm të lëvizjes “Vetëvendosje”.

Deputetë të Kuvendit të Kosovës,

Republika e dytë e Kosovës nuk do të mbijetojë kështu. Ne duhet të kalojmë te një transformim i shtetit tonë nga privatizimi abuziv që fabrikat i shndërroi në qendra tregtare te shteti zhvillimor, që ekonominë e orienton në prodhim. Nga pazaret me Serbinë, që po na e bosnjëzojnë shtetin, te sovraniteti republikan, që e bashkon Mitrovicën dhe na e heq edhe nenin 1.3 të Kushtetutës, që i përket konceptit të Brezhnjevrit për sovranitet të limituar.

Ky transformim do ta shënonte republikën e tretë të Kosovës, republikën e vërtetë. Na duhet, pra, një republikë e re për ta shpëtuar republikën si ide e si vlerë, si politikë aktuale e si realitet shoqëror. Faleminderit!

KRYETARI: Fjalën e ka deputeti dhe kryetari i Grupit të Aleancës Ardian Gjini.

ARDIAN GJINI: Faleminderit, zoti kryetar!

E lexuat mirë nenin, por bëjmë publike qëndrimet dhe mendimet tona në lidhje me temat, të cilat po ndodhin në Kosovë.

Para disa ditësh kemi mësuar që Grupi Parlamentar i LDK-së ka paraqitur një synim për debat parlamentar për çështjen e universitetit, për gjendjen aty, dhe ne si grup kemi prit që do të ndodhë, do të presim edhe sot nëse Grupi Parlamentar i LDK-së e bën atë kërkesë për debat ne do t'i bashkëngjitemi, nëse jo - do ta bëjmë ne. Por, për Universitetin e Prishtinës duhet të ketë debat në Kuvend dhe duhet të jetë urgjent dhe i shpejtë.

Sidoqoftë, unë po ju them disa fjalë se çka po ndiejmë ne që po ndodh. Ajo që po ndodh është pasojë e falsifikimit të dijes në Kosovë, e falsifikimit të diplomave në Kosovë, e doktoraturave false, e situatës në të cilën njerëzit i shërojnë komplekset e veta duke marrë diploma false, në regjion, apo diku tjetër, kudo qoftë. Te ne ndodh që doktorët e shkencave dhe mësimdhënësit nuk dinë shkrim-lexim.

Të nderuar deputetë të Kuvendit të Kosovës,

E di sa e dhimbshme është, e di sa e zorshme është, e di që përkthehet kjo që po them diku, por po ju them duke pasur kujdes të mos i fyej të gjithë, se ka edhe shumë të zotë, ka shkencëtarë dhe intelektualë, por aq shumë është rritur numri i atyre që kanë grada shkencore, superiore, e që nuk dinë të shkruajnë e të lexojnë në gjuhën e vet amtare sa është seriozisht e dhimbshme.

Pushteti e ka shndërruar Universitetin e Prishtinës në mjet pune, por e ka banalizuar si mjet pune. Mjet pune për punësim, mjet pune për të "tharë" vota çuditshëm, mjet pune për të avancuar njerëz të vet në grada shkencore që s'dinë kurrëgjë, e kjo po e shkakton situatën në të cilën ne do t'i vuajmë pasojat edhe për shumë vite për shkak se këta njerëz, është thënë në Kuvendin e Kosovës më përpara, do t'i mësojnë të rinjtë tonë, këta që s'dinë as vetë, do t'i mësojnë këta që shkojnë të zënë diçka, të zënë dije.

Ka anti-intelektualizëm në Universitet, i nderuar kryetar. Është anti-intelektualizëm. Ne e dimë çka janë intelektualët. E dimë edhe ata që nuk pretendojnë të jenë intelektualë. Por, mbajeni mend - në Kosovë ka lindur ky fenomen i anti-intelektualëve, njerëz që nuk e kuptojnë që dija është e vlefshme. Për ta, dija mund të jetë false, nuk është hiç me rëndësi a di a s'di. Duhet arritur qëllimet personale, duke marrë diploma! Domethënë, këta janë njerëz anti-intelektualë, që e fyejnë dijen, e fyejnë shkencën. Në të njëjtën kohë, e fyejnë edhe të ardhmen e Kosovës.

I nderuar, zoti kryetar,

Të nderuar deputetë të Kuvendit të Kosovës,
Nëse rektori Gashi nuk jep dorëheqje, Universiteti i Prishtinës do të shkatërrohet gati përfundimisht. Vetë fakti se po ndodh ky debat, vetë fakti se ka botuar në revista ose në zhurnale akademike, që praktikisht janë false, e bëjnë tepër problematik qëndrimin e rektorit në Universitet. E bën tepër problematik!

Mendoj se hezitimi për të dhënë dorëheqje po e shkatërron Universitetin e Kosovës. Ajo që po jepet si shembull për të rinjtë është që në Kosovë gjithçka arrihet pa pikë mundi, vetëm duke qenë i gjindshëm. Ama, shumë qëllime arrihen duke qenë i gjindshëm dikush, por nuk mund të arrihet titulli i profesorit, nuk mund të arrihet titulli i doktorit të shkencave duke qenë i gjindshëm. Duhet studiuar, duhet djersitur.

Ky është mesazhi që po u jepet të rinjve të Kosovës. Ky është mesazhi që po u jepet njerëzve në Kosovë dhe mendoj se të gjithë ata njerëz që mendojnë se mund të kalojnë nëpër këtë situatë kështoj, 'hajt se ndodhën disa protesta, ndodhi një debat, shuhet debati dhe vazhdojmë më tutje', mendoj se nuk janë duke e kuptuar që e ardhmja e Kosovës është duke u varur në një pe të hollë. Të gjitha të tjerat kanë relevancë më të vogël se sa korruptimi i skajshëm i dijes, fyerja që u bëhet njerëzve që janë me të vërtetë intelektualë. E ata që janë me të vërtetë intelektualë ma merr mendja që duhet të ndihen tepër të fyer sot. Tepër të fyer! Të mos guxojë kurrkush të afrohet aty për shkak se njerëzit i kanë zaptuar temat.

Nuk është vetëm rektori Gashi. E di, ju e dini, është e njohur publikisht që ka doktorë të shkencave, ka dekanë, të cilët kanë bërë publikime false. Kanë shkruar për minerale historianët. Nuk po dua të shkoj më tutje, se nuk po dua t'i personalizoj shumë. Ama duhet edhe një herë t'u thuhet se është jashtëzakonisht problematike. Është edhe më e dhimbshme kur hezitojmë t'i marrin këta hapa, është edhe më e dhimbshme kur në Kuvendin e Kosovës nuk kuptohet se sa me rëndësi është kjo temë.

Për mendimin tim dhe për mendimin tonë është aspekti më i rëndësishëm që e kemi. Gjithkush mund ta ketë një problem të vetin diku, gjithkush mund ta ketë provuar ta zgjidhë një temë në universitet, por kur flasim për totalin - nëse nuk flasim në mënyrë të qartë - ne jemi duke e shkatërruar të ardhmen e Kosovës. Në universitet shkatërrohet e ardhmja e Kosovës, të nderuar deputetë. Nuk shkatërrohet në tema tjera. Dhe, ky Kuvend e ka për obligim të thotë...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Regjia, është në emër të Grupit.

ARDIAN GJINI: Shikoni! Po e përfundoj për të treguar diçka krejt të thjeshtë, që duhet të thuhet këtu: një profesor universiteti, e këtu edhe në mesin tuaj ka që kanë grada reale, të vërteta shkencore e akademike, e di cilat janë zhurnalet akademike. Mund të shikoni, ka sajte të tjera që tregojnë se cilat janë zhurnalet akademike.

Nëse një doktor i shkencave nuk e di cilat janë zhurnalet akademike, ai nuk është doktor i shkencave, se është t'i lexojë më përpara ato. Nëse e di, e prapë ka shkruar fals, atëherë është edhe mashtrues. Domethënë, kemi të bëjmë me sistem, në të cilin dikush edhe nuk di, edhe mashtron. I bën të dyja!

Të nderuar deputetë të Kuvendit të Kosovës,
Nuk kemi si të mos themi sot: 'a t'ia nisim t'i heqim duart ne si politikë dhe t'i themi dikujt boll në Universitetin e Kosovës' se nuk mund politika, nuk mund Qeveria ta ketë mjet të punës për përfitime të veta, jo për përfitim të shkencës. Faleminderit!

KRYETARI: Në emër të Koalicionit për Kosovë të Re, Jeton Svirca e ka kërkuar fjalën.

JETON SVIRCA: Faleminderit, kryetar!

Sot e mora fjalën që ta ngre një shqetësim, në emër të kolegëve deputetë, në emrin tim, për rezolutën, e cila është miratuar në Kuvendin e Kosovës për Medvegjën, Preshevën dhe Bujanocin, dhe ne si deputetë të Kuvendit deri më sot nuk kemi ndonjë raport nga Qeveria se sa ka pasur progres në implementimin e saj.

Ne e dimë që ajo rezolutë është miratuar me 10 pika dhe unë po përsëris se Qeveria e Republikës së Kosovës ka qenë e obliguar që ta hapë një zyrë ndërlidhëse në Gjilan për Preshevën e Bujanocin dhe një zyre tjetër në Prishtinë për qytetarët e Medvegjës, në të cilat do të ndihmohej popullata e këtyre komunave për çështjet e ndryshme.

Gjithashtu, nga kjo rezolutë, Qeveria e Kosovës apo Kosova është obliguar që të ndikojë te faktori ndërkombëtar nëpërmjet kërkesave të ndryshme që të ketë reciprocitet të plotë për shqiptarët e Medvegjës, Preshevës dhe Bujanocit në raport me të drejtat të cilat i kanë serbët që jetojnë në Kosovë.

Gjithashtu, është kërkuar që të ketë lehtësira për pajisje me dokumente personale të Republikës së Kosovës nga shqiptarët e kësaj ane dhe nëse këta nuk kanë dokumente, e shumica e tyre edhe nuk kanë, kanë probleme të ndryshme gjatë jetës së tyre, të cilën e zhvillojnë në Kosovë.

Gjithashtu, Qeveria e Kosovës duhet të apelojë te bashkësia ndërkombëtare që t'i bëjë presion Serbisë të vazhduar që të mos bëjë diskriminim ekonomik të tri komunave shqiptare, sepse popullata në Medvegjë, Preshevë dhe në Bujanoc jeton në kushte shumë të vështira ekonomike.

Gjithashtu, Qeveria e Kosovës ta marrë një iniciativë që ta unifikojë spektrin politik në Medvegjë, Preshevë dhe Bujanoc, sepse si pasojë e mos këtij uniteti po pësojnë banorët, të cilët gradualisht po i lëshojnë vendet e tyre. Bujanoci shumë shpejt mund të bëhet edhe një Medvegjë e dytë.

Pra, ne kërkojmë që faktori politik në Kosovë të ndikojë që të ketë një kohezion të faktorit politik dhe shoqëror shqiptar, i cili do të artikulohet nëpërmjet një platforme të përbashkët të qëndrimeve konkrete, e cila përbën një interes jetik për shqiptarët e

Kosovës Lindore, e sidomos tani para zgjedhjeve të 16 marsit, të cilat do të mbahen në shtetin fqinj.

Gjithashtu, Ministria e Arsimit ta përdorë një strategji për kthimin e kuadrove, të cilat studiojnë në Kosovë, që të kontribuojnë në Medvegjë, Preshevë dhe Bujanoc, sepse është interes yni kombëtar.

Gjithashtu, nuk mund të kaloj pa falënderuar kontributin e Qeverisë, të cilin e ka bërë deri më tani, e sidomos të Ministrisë së Shëndetësisë, e cila i ka pranuar të gjithë specialistët, të cilët kanë konkurruar nga këto tri komuna për të marrë dije dhe për t'u shkolluar në Kosovë, bashkërisht edhe me Ministrinë e Arsimit dhe me ministrinë tjera. Faleminderit!

KRYETARI: Nënkryetari Petar Miletij e ka fjalën.

PETAR MILETIĆ: Poštovani gospodine predsjedniče, Članovi Vlade, Koleginice i kolege poslanici, Govoriću o privođenju gospodina Olivera Ivanovića, i nadam se da ću biti u skladu sa Poslovníkom Skupštine.

Pre svega, želim da kažem da verujem u Sud, da verujem u nepristrasnost Suda, da verujem u nezavisnost Suda, i da kažem da bi i Sud i tužilaštvo, kako u ovom, tako i u svim drugim slučajevima, trebalo da radi bez političkih pritisaka, ali ne samo bez političkih pritisaka, nego i bez medijskih pritisaka.

Svedok sam da zadnjih dana na Prištinskim televizijama se radi ozbiljna kampanja protiv gospodina Olivera Ivanovića i protiv slučaja, koji se vodi u EULEX-sudu. Nažalost, to nije usamljen slučaj, medije rade to vrlo često. Ja sa ove govornice tražim od njih da prestanu sa tom kampanjom, i da ostave Sud da donese odluku onakvu, kako bi pravda bila zadovoljena.

Međutim ovaj slučaj je praćen mnogim nelogičnostima. Prvo, nelogičnost koju bih želio da naglasim jeste da je EULEX pokrenuo istragu zajedno sa kosovskom policijom o ubistvu Dimitrija Janičijevića, koja se desila pre desetak dana. I ja sam se nadao da će ta istraga dovesti do rezultata, međutim EULEX-tužilaštvo je odlučilo da se bavi nečim što je bilo pre 15 godina, što nije nelegitimno i što nije u neskladu sa njihovim mandatom, ali prosto mislio sam da imaju prioritete da rešavaju ono što je sveže, što je lakše da se reši, što se desilo u neposrednoj prošlosti, a ne ono što je bilo pre 15 godina.

Druga nelogičnost koja mi se javlja jeste da je on praktično uhapšen na prevaru. Dakle on se nije krio. On je na poziv da da izjavu, odmah otišao, i dao izjavu. I uvek je bio dostupan svim organima, kako kosovskim, tako i međunarodnim. Podsetiću vas da je Oliver Ivanović bio u dva mandata poslanik ove Skupštine, i ne samo poslanik, nego član i predsedništva. Da je sve vreme dostupan svim, i međunarodnim i domaćim organima, da je javna ličnost, i da kad bi hteo da se sakrije, ne bi mogao. Da ne postoji mogućnost

da može da utiče na svedoke, i nije mi jasna odluka suda da mu se odredi pritvor od 30 dana.

Dalja nelogičnost jeste da se to dešava upravo kada se on kandiduje za gradonačelnika severne Mitrovice. Tačno je da je Sud odvojen od politike, tačno je da je tužilaštvo odvojeno od politike, ali u momentu kada on treba da preda kandidaturu, i u momentu kada treba da vodi kampanju, nakon 14 godina on bude privođen i onemogućen da se kandiduje za gradonačelnika. Naravno, on se kandidovao, ali ukoliko ne bude mogao da vodi kampanju, to će da obesmisli proces izbora u severnoj Mitrovici, koji se ionako odvija sa mnogo problema.

Dakle, bilo bi dobro da ipak prevlada razum u ovom slučaju. Da Oliver Ivanović bude pušten da može da vodi kampanju, pa ako bude i da se brani naravno sa slobode, pa ako bude kriv, kao i svi drugi građani, za ono što je uradio, treba da odgovara. Niko ne treba da bude van zakona, niko ne treba da bude van domašaja pravde. Dakle, pravda za njega, kao i za sve druge građane.

Na kraju, želim da iznesem nešto što ja verujem, a ja verujem da je gospodin Oliver Ivanović, kada je ovaj slučaj u pitanju, potpuno nevin. Hvala!

KRYETARI: Deputetja Aurora Bakalli e ka fjalën, e fundit për sot.

AURORA BAKALLI: Faleminderit, kryetar!

Të nderuar deputetë,

Takimi i janarit në Prizren ndërmjet Qeverisë së Republikës së Shqipërisë dhe asaj të Kosovës ngjalli debate dhe reaksione të ndryshme, të cilat shkonin në dy ekstreme, nga nihilizmi deri në eufori.

Nuk ka dyshim se ky takim e ka rëndësinë e vet, sepse jo vetëm që ishte takimi i parë i dy qeverive të shteteve shqiptare që pashmangshëm bart edhe një simbolikë të rëndësishme politike, por për herë të parë krijohet baza për të kërkuar hapa dhe rezultate konkrete nga bashkëpunimi ndërmjet dy qeverive.

Një ndër këta hapa të rëndësishëm është edhe largimi i barrierave të ndryshme tregtare ndërmjet Shqipërisë dhe Kosovës. Po që se i analizojmë pengesat tregtare të fundit, të cilat lindën ndërmjet dy vendeve tona, si me rastin e çmimit referent për patatet e Kosovës në Shqipëri, pastaj rasti i çimentos nga pala kosovare, ku vendosja e tarifës prej 35% për gjithë botën e preku edhe Shqipërinë, si dhe masat e fundit të paketës fiskale nga Shqipëria, me ç'rast efektohen të gjitha importet e pijeve alkoolike, e në mesin e tyre edhe ato kosovare, si birra e Pejës e të tjera.

Këto barrierat tregtare duhet të na shtyjnë të mendojmë për një formë të veçantë të bashkëpunimit, me të cilën Kosovës dhe Shqipërisë do t'u bëhet e mundur që të mos përfshihen ndërmjet vete me masa të tilla, të cilat në shumicën e rasteve bëhen me të drejtë, për ta mbrojtur tregun dhe produktin vendor, mirëpo padashur dhe pashmangshëm, duke qenë dy shtete të ndara dhe të ndryshme, që prekin edhe njëra-tjetrën.

Një gjë është e ditur se deri më tani ekonomitë tona kanë udhëtuar rrugëtim të ndarë dhe më atë rast nuk është bërë e mundur që këto të zhvillojnë ekonomi komplementare. Si të tillë, do të mund t'u paraprinim zhvillimeve edhe në CEFTA dhe do të mund të evitonim masa, të cilat i përmenda pak më lartë, sepse duke komplementar njëri- tjetrin nuk do ta konkurronim njëri-tjetrin.

Ndër hapat që do të duhej të ndërmerreshin në këtë drejtim janë: unioni doganor, i cili hap rrugë për tregun e përbashkët, si stadi më i lartë i bashkëpunimit. Ne do të duhet koncentruar në bashkëpunim tregtar dhe ekonomik në mes të dy vendeve tona, me qëllim të avancimit real të tregtisë, për aq më tepër, bashkëpunimi tregtar dhe ekonomik do të na bënte faktor ekonomik në rajon dhe si të tillë, edhe në të ardhmen, pas integritetit në BE, do të konsideroheshim më seriozë.

Pra, nga bashkëpunimi ndërmjet qeverive tona presim hapa konkretë dhe praktikë, të cilët jo vetëm që do të na integronin më shumë në mes veti, por edhe do të jenë në dobi të qytetarëve tanë. Faleminderit!

KRYETARI: Këtu edhe përfundon koha e paraparë për këtë pikë të rendit të ditës.

Tani është radha e Qeverisë. Fjalën e ka ministri i Arsimit, zoti Ramë Buja.

MINISTRI RAMË BUJA: I nderuar, zoti kryetar!

Të nderuar deputetë,

I nderuar Kabinet qeveritar,

Unë desha të mos ju marr shumë kohë, por veç t'i them zotit Zemaj, se nuk ka nevojë të merret nisma për hartimin e Ligjit për mbështetjen a privilegjet e arsimtarëve ose mësuesve të viteve '90-'99, për faktin që ai draft-ligj është, ka kaluar në Qeveri, faktikisht ka shkuar në Qeveri dhe është debatuar aty dhe për shkak të kostos së lartë që ka, ka kërkuar Qeveria që të kthehet për t'u ridebatuar tek faktorët dhe aktorët që implikohen në këtë ligj dhe kjo do të procedohet. Kështu që, nuk ka nevojë të bëhet nismë, sepse është e realizuar ajo.

Ndërsa, sa i përket debatit parlamentar, unë jam pro kësaj, gjithsesi pro debatit parlamentar për gjendjen në arsimin kosovar. Jam ftuar nga Komisioni Parlamentar për Arsim dhe unë do të shkoj për të raportuar, gjithsesi. Dhe, natyrisht kjo për ta bërë pikë të rendit të ditës është në dorën dhe në votën tuaj. Faleminderit!

KRYETARI: Fjalën e ka deputeti Armend Zemaj.

ARMEND ZEMAJ: Faleminderit, kryetar!

Zotëri ministër,

Kuvendi i Republikës së Kosovës ka autorizuar Qeverinë që në afat prej 3 muajve të hartojë ligjin në fjalë dhe t'ia sjellë Kuvendit, ndërsa Kuvendi do të vendosë edhe për koston buxhetore në përputhshmëri me kushtet dhe rrethanat të cilat janë në Kosovë.

Është e palogjikshme që afati tremujor të jetë i barabartë me një ose dy vjet të hartimit të një ligji, prandaj ne kërkojmë që ky ligj të vijë në Kuvend, këtu të debatohet dhe atëherë të vendosim bashkërisht edhe me ato privilegje edhe me kushtet, edhe me pensionin bazë, i cili kërkohet tani nga mësimdhënësit, të cilët nuk e kanë të drejtën e pensionimit dhe nuk u njihet kjo periudhë, e cila është periudhë e sakrificës së tyre. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, por koston e ligjit e përcakton Qeveria. Fjalën e ka deputeti Salih Morina.

SALIH MORINA: Faleminderit, kryetar!

Të nderuar kolegë deputetë,

Sa i përket çështjes së debatit që tha ministri, unë do ta kisha njoftuar edhe deputetin Gjini, që tashmë Lidhja Demokratike e Kosovës ka bërë kërkesën për debat në Universitetin e Prishtinës, është protokolluar kërkesa dhe kjo ka mbetur që Kryesia e Kuvendit të vendosë për seancën e radhës apo në ndonjë seancë tjetër. Faleminderit!

KRYETARI: Kërkesa ka ardhur pasi që bërë rendi i ditës, të hënën në Kryesi s'e ka ngritur askush. Në mbledhjen e radhës atë do ta shqyrtojë Kryesia dhe do ta renditë në një seancë për debat.

Nuk kemi të interesuar tjetër për diskutim.

Vazhdojmë me pikën e dytë të rendit të ditës:

2. Koha për pyetje parlamentare

Koha për pyetje parlamentare është një orë. Deputeti nuk mund të bëjë më shumë se dy pyetje parlamentare. Fillojmë.

Deputetja Kadaj-Bujupi pyetje për ministrin Nenad Rashiq.

DONIKA KADAJ-BUJUPI: I nderuar kryetar!

Kolegë deputetë,

Çështja e moszbatimit të Marrëveshjes për sigurime sociale nga Zvicra, në raport me qytetarët e Kosovës.

Po e përshkruaj shumë shkurt, në bazë të Ligjit zviceran për pension të pleqërisë dhe trashëgimtarëve, të drejtë për pensionin e pleqërisë e kanë shtetasit e Zvicrës, të huajt dha ata pa shtetësi. Të huajt pa shtetësi zvicerane kanë të drejtë vetëm atëherë, kur mes vendit nga vjen ka një marrëveshje shoqërore. Kjo marrëveshje e cila ka ekzistuar ndërmjet ish-Jugosllavisë dhe Zvicrës, në fakt është pezulluar nga qeveria e Zvicrës në muajin dhjetor 2009, e cila ka vendosur që marrëveshja për sigurimet sociale, e cila zbatohet për qytetarët e Kosovës të shfuqizohet më 31 mars 2010.

Moszbatimi i Marrëveshjes për sigurime sociale në raport me Kosovën ka rezultuar që shtetasit e Kosovës të mos jenë përfitues të kësaj marrëveshjeje. Nga një prilli 2010,

Kosova konsiderohet si shtet pa Marrëveshje për sigurimin social. Pyetja është: Çka keni ndërmarrë ju si ministri dhe çka ka bërë Qeveria Thaçi për qytetarët e Kosovës, përfitues të pensionit nga Zvicra, që të realizojnë këtë të drejtë elementare?

KRYETARI: Ministër, e ke fjalën.

MINISTAR NENAD RAŠIĆ: Hvala gospodine predsedniče!

Poštovani zamenici premijera,

Ministri,

Dame i gospodo narodni poslanici,

Gospodo Bujupi,

Znam da jedan od vrlo delikatnih izazova bio to sklapanje sporazuma sa Švajcarskom i u ovom slučaju kao što ste i vi rekli, od 01 aprila 2010.godine mi smo imali obaveštenje smo dobili, u kome sa kaže da će biti prekinuto mogućnost isplaćivanja penzija onako na mesečnom nivou, nego će postavljena biti opcija u kojoj ćete moći vi ili neko kao penzioner da dobije u jednoj tranši ceo iznos novca, koji ima kao svoj jedan doprinos koji je dao u Švajcarskoj, da bude prebačen na Kosovo i samim tim da taj neki penzioner može da raspolaže ovim novcem.

Ali naravno mi smo tražili da se obnovi sporazum, koji smo imali sa Švajcarskom zbog toga što je sasvim normalno da bude da svako od građana koji je svoju penziju zaradio u Švajcarsku ima pravo i da nastavi da prima, bez obzira gde on živi.

Na vaše pitanje “šta smo mi preduzeli”, ja moram da kažem pre svega da sam ja lično bio u kontaktu i sa bivšim ambasadorom a i sa sadašnjom ambasadoricom, svakih mesec dana ili dva, gde na naš zahtev da ponovo iniciramo pregovore u vezi sklapanja sporazuma, tražio sam potvrdu, sporazum neki, neku potvrdu. Tako da smo mi u jednom prvom tom delu našeg delovanja uspeali da negde 2.09. imamo jedan sastanak 2.09.2010.godine, znači drugog septembra, da imamo sastanak u Bernu u Švajcarskoj, koji je bio moram da kažem jednog nezvaničnog karaktera, zbog toga što još nismo dobili zeleno svetlo da se vidimo sa visokim zvaničnicima iz Švajcarske, gde taj nam dogovor rezultirao potpisivanjem sporazuma, odnosno ovog protokola, koji je potpisan u Švajcarskoj u februaru 2011. godine. I od tog momenta faktički, tehnički su se stvorili uslovi da mi iniciramo tu jednu, taj jedan razgovor, koji bi trebalo da rezultira sa novim sporazumom, koji treba biti vezan.

Od tog momenta, mi na žalost nismo imali nikakve kontakte, sve do negde sredine prošle godine, gde nam je po prvi put zvanično bilo potvrđeno i gde sam ja bio u poseti sa gospodinom Rajnerom, ministrom za rad i socijalno stvaranje u Švajcarskoj, gde smo 2-gog i 3-eg decembra 2013. godine utvrdili dinamiku i utvrdili spremnost, pogotovo sa političke strane autoriteta Švajcarske, da možemo početi da možemo ući u proces pregovora za stvaranje jednog novog sporazuma.

Kao rezultat toga, kao rezultat našet sastanka u Bernu, došlo je do potvrde čak i zvaničnog tog nivoa...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Deputete, ke pyetje shtesë?

DONIKA KADAJ-BUJUPI: Po. Kisha dashur shumë konkretisht ta di , kur këta njerëz do t'i marrin pensionet dhe si duhen qasur? Nuk po më interesojnë hapat, se sa herë jeni takuar, ku jeni takuar, çka keni folur.

Konkretisht, a është arritur marrëveshje?

Kur qytetarët e Kosovës do të kenë të drejtën elementare të tyre për t'i marrë pensionet e fituara për vite të tëra të punës që kanë bërë në Zvicër? Saktë kur, data, sepse ne po flasim për periudha 2009-2014 janë 5 vjet, këta njerëz kanë nevojë për të ngrenë, për të jetuar, kanë nevojë për ilaçe, do të thotë, janë pensione, për të cilat nuk mundën të presin 100 vjet.

Prandaj, nëse mundeni veç konkretisht të na tregoni saktë, kur kjo marrëveshje do të hyjë në fuqi dhe kur njerëzit do të kenë pensionet e veta?

KRYETARI: Ministër, vazhdo!

MINISTAR NENAD RAŠIĆ: Hvala još jednom!

Ja sam vaš odgovarao konkretno pošto je vaše pitanje bilo: “Šta ste preduzeli da se sporazom veže sa Švajcarskom?”

Zbog toga, ja sam mislio da je to vaše pitanje, ali OK. Kao finale, nisam uspeo da završim malo pre, rekao sam da smo mi imali sporazum usmeni sa ministrom, da će oni do 25 januara nama da pošalju takozvani dokument, koji bi trebalo da bude smernica, šta bi mi takođe trebalo da uradimo da bi bili u skladu sa njihovim zakonskim okvirima.

Tako da mi smo rekli da će biti 25 januara, ali jedna nova informacija da smo mi 23 dobili jedan e-mail u koma oni mole za jedno kraće izvinjenje, da nisu mogli stići do 25 januara da obezbede tih šest tačaka, koje će biti kao preduslovi, da ih nazovem, za vezivanje sporazuma i da su tražili da početkom januara oni to nama dostave. U momentu kad tih šest tačaka budu dostavili nama, ja vam garantujem da će biti zvanične, da ću da ih predstavim bilo u Parlamentu, bilo u ministarstvu, da vam kažem šta se ustvari od nas traži da mi ispunimo.

Još jedan naglasak moram da kažem, da po nezvaničnim informacijama, jedna od stvari od tih šest tačaka, koje će sigurno ... naglašeni ...to je Zakon o penzijama, takođe i Zakon o socijalnom osiguranju, o zdravstvenom osiguranju, izvinjavam se. Zato koristim priliku da zamolim još jednom, da Zakon o penzijama, molim vas ko je u Parlamentu, bude na dnevnom redu i da mi na takav način ispunimo preduslove. Niko pogotovo od evropskih zemalja, neće pregovarati sa nama, ako nismo na istom pravnom nivou. Prema tome, još jednom molim da sve što je u vašoj moći učinite, da Zakon o penzijama bude što pre usvojen. Hvala!

KRYETARI: Deputeti Agim Kuleta, pyetje për zëvendëskryeministrin dhe ministrin e Drejtësisë, zotin Hajredin Kuçi. Zëvendëskryeministri s'është këtu, deputet.

AGIM KULETA: S'ka qenë edhe herën e kaluar, prandaj pyetjen po e bëj.

Në vitin 2000 nga pjesa veriore e Mitrovicës janë dëbuar me dhunë mbi 12 mijë shqiptarë. Që nga ajo kohë ata vazhdojnë të mos mund të kthehen në pronat e tyre. Përkundër faktit që e drejta në pronë, e drejta për qarkullim të lirë dhe shumë të drejta të tjera, që sot përbëjnë standard elementar ndërkombëtar e që janë shkelur në këtë rast, do të duhej të nxitnin faktorin ndërkombëtar si promovues i këtyre të drejtave, e sidomos Qeverinë e vendit tonë.

Lidhur me këtë çështje, jo vetëm që nuk është bërë asgjë, por madje është heshtur tërësisht. Në anën tjetër, në forma më të ndryshme, jeni angazhuar në kthimin e qytetarëve të tjerë jo shqiptarë në pronat e tyre. Pra, kemi të bëjmë me një trajtim selektiv e diskriminues ndaj shqiptarëve. Dhe, këtu më interesonte mendimi i zotit zëvendëskryeministër, jo vetëm për ne, por sidomos për qytetarët e dëbuar, pse po ndodh ky injorim për këtë çështje? Faleminderit!

KRYETARI: Vazhdojmë. Deputeti Afrim Kasolli, pyetje për ministrin Ramë Buja.

AFRIM KASOLLI: Faleminderit, kryetar!

Pyetja është bërë për javën e kaluar, prandaj do ta përsëris prapë. Javën e kaluar opinionioni publik u informua për nënshkrimin e një kontrate ndërmjet Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë dhe kompanisë kroate AJKATE nga Zagrebi, kontratë kjo që parasheh ofrimin e shërbimit SMS Fleksy-S, institucioneve arsimore të Kosovës, apo thënë më ndryshe, prindërit parapaguan për këtë shërbim nga një euro për secilin fëmijë dhe nga shkolla për çdo muaj marrin përmes ueb-shërbimit deri në 10 sms si njoftim për fëmijën e tyre.

Arsyetimi formal për nënshkrimin e kësaj kontrate, thuhet të jetë mundësia që do ta kenë prindërit për të informuar nga shkolla për suksesin e fëmijëve të tyre, si dhe po ashtu kjo formë e komunikimit i shndërron prindërit në pjesëmarrës aktivë në edukimin e fëmijëve të tyre. Mirëpo, nënshkrimi i kësaj kontrate, duke shpërfillur procedurat e rregullta të tenderimit dhe me një kompani, që sipas të dhënave fillestare, duket të jetë fantome, ka ngritur shumë dyshime.

Prandaj, pyetja është: komunikimi ndërmjet shkollës dhe prindërve sot mund të bëhet edhe me forma të tjera alternative dhe jo vetëm në këtë mënyrë, që më shumë po perceptohet si zhvatje e prindërve nga ana e Ministrisë, se sa që ka për qëllim avancimin e komunikimit ndërmjet shkollës dhe prindërve.

Në fund të fundit, pse ky shërbim nuk ofrohet falas ashtu sikurse në shumë vende të tjera të botës, apo pse duhet domosdoshmërisht të ofrohet vetëm nga një kompani e huaj dhe jo nga kompani vendore? Faleminderit!

KRYETARI: Ministër, e ke fjalën.

MINISTRI RAMË BUJA: Faleminderit, i nderuar deputet!

I nderuar kryetar,

I nderuar Kabinet qeveritar, dhe

Deputetë të nderuar,

Faleminderit për pyetjen e bërë, për faktin që javën e kaluar, vërtetë është krijuar një paqartësi ose një konfuzion rreth kësaj çështjeje për faktin që kjo është një marrëveshje që është nënshkruar pas pilotimit që është bërë dy semestrat ose dy gjysmëvjetorë dhe Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me firmën kroate AIKATE nga Zagrebi. Projekti në fjalë ka filluar të implementohet pas marrëveshjes, në prill të vitit 2013.

Pilotimi i këtij projekti është bërë në disa shkolla të komunave: Prishtinë, Ferizaj, Mitrovicë dhe Kaçanik dhe është treguar i suksesshëm, sipas vlerësimit të prindërve, kujdestarëve të klasave dhe drejtorëve të shkollave. Për këtë ekzistojnë raportet. Që nga fillimi i pilotimit ky projekt është shoqëruar me një transparencë maksimale, sepse janë bërë prezantime të shumta në medie të shkruara dhe elektronike, ku për nevojën dhe domosdoshmërinë e projektit kanë dhënë arsyeshmërinë profesionale edhe shumë mësimdhënës, drejtorë të shkollave dhe prindër.

Me këtë marrëveshje pjesë e projektit bëhen vetëm prindërit, të cilët u përgjigjen pozitivisht kërkesës së kompanisë që ofron këtë shërbim ose jo, ndërsa zbatimi i projektit është obligativ vetëm për mësimdhënësit e nxënësve, prindërit e të cilëve u janë përgjigjur pozitivisht kësaj marrëveshjeje.

Nënshkrimi i kësaj marrëveshjeje ka ardhur si nevojë për përmirësimin e komunikimit ndërmjet shkollës dhe prindërve dhe është konsideruar se një formë e tillë mund të ndikojë për hapjen akoma më të madhe të portave, për të komunikuar prindër-nxënës. Dhe, kjo është e tëra.

KRYETARI: Deputet, ke pyetje shtesë?

AFRIM KASOLLI: Faleminderit, kryetar!

Më duhet edhe një herë ta ripërsëris pyetjen. E para, pse nënshkruani kontratë me një kompani të huaj dhe a kanë ekzistuar mundësitë që këto shërbime t'i kryejë një kompani vendore, sepse ne kemi kompani vendore, të cilat munde t'i kryejë? Kush ka vendosur për pilotimin, sepse në fillim ju e keni bërë pilotimin dhe pastaj, pas pilotimit keni kaluar në nënshkrim të marrëveshjes.

Dhe e treta, a ju duket e padrejtë sepse po instaloni njëfarë kulture të përgjegjësisë këtu, ku vetëm ata prindër të cilët kanë mundësi të paguajnë, kanë të drejtë të informohen për fëmijët e tyre në shkolla, ndërsa ata të cilët nuk kanë mundësi të paguajnë, nuk ka problem edhe pse s'informohen për gjendjen e tyre nëpër shkolla.

Pra, në njëfarë mënyre po e komercializoni edhe përgjegjësinë etike. Faleminderit!

KRYETARI: Ministër!

MINISTRI RAMË BUJA: Jo, i nderuar, është halli që këtu është një marrëveshje e zakonshme e nënshkruar. Nuk është hapur tender asnjëherë, sepse s'ka pasur as shumë të caktuar financiare, e as shumë që obligon kënd, ju lutem nuk është çështje që prindërit e kamur po i obligon, s'e obligon asnjë njeri të vetëm. Dhe, këtu tash, nëse kjo është telashe e kësaj çështjeje ose dikush ka humbur në mjegull gjatë rrugës, kjo çështje mund të ndërpritet. Nga kompanitë tona, as s'ka aplikuar kush, as s'ka ofruar kush mundësinë. Ne kemi hapur portën për t'u pilotuar dhe ajo ka treguar suksese dhe në bazë të raportimeve ka pasur suksese. Përndryshe, nëse kjo është defekt, asnjë ngarkesë s'e kanë as ata as ne nëpër debat, kështu që është pa telashe.

KRYETARI: Vazhdojmë. Deputeti Muhamet Mustafa, pyetje për ministrin Fadil Ismajli. Deputet, parashtroje pyetjen.

MUHAMET MUSTAFA: Po, unë e kam lexuar edhe pyetjen në seancën e kaluar, për arsye se kam konsideruar që çështja është shumë urgjente dhe sot e kemi ministrin këtu.

Pyetja ka të bëjë me vonesën në realizimin e rekomandimit të Kuvendit të Kosovës, ne kemi debatuar para nëntë muajsh lidhur me "Trepçën" dhe një nga rekomandimet ka qenë që Qeveria duhet brenda 3 muajve të sjellë Ligjin për "Trepçën".

Kanë kaluar 9 muaj, ne po e dimë që ka disa diskutime, ka disa përgatitje, po situata është ndërlikuar mjaftë kohëve të fundit, për arsye se paralelisht me Ministrinë, po punon edhe AKP-ja e cila po angazhon kompani për ristrukturim apo menaxhim të "Trepçës" apo nuk di çka krejt ka në atë pako. Dhe, unë jam i shqetësuar nga këto veprime paralele, jam i shqetësuar për vonesën e ligjit edhe tash po dëgjoj se do të jetë vetëm një amendament, apo dy apo sa, s'di të Ligjit për ndërmarrjet publike.

Prandaj, lusim ministrin që të na i sqarojë këto çështje. Domethënë, nën 1, pse është vonuar ligji, çfarë ligji po na përgatitni ta sillni në Kuvend dhe 2, çka po ndodh në AKP rreth "Trepçës" dhe cilat do të jenë pasojat e këtyre vendimeve, që po merren në AKP për intencat e juaja që "Trepça" të vihet nën ingerenca të Kuvendit dhe Qeverisë? Faleminderit!

KRYETARI: Ministër, e ke fjalën.

MINISTRI FADIL ISMAJLI: Të nderuar deputetë të Republikës së Kosovës!

I nderuar kryetar,

Të nderuar kolegë ministra,

Zëvendëskryeministra,

Misionet e Kosovës janë në fazën e përgatitjes së bazës së qartë legislative dhe politike sektoriale me qëllim të mbështetjes së zhvillimit të sektorit minerar, që do të mundësojë ristrukturimin e sektorit ekzistues minerar, në të cilin hyn edhe "Trepça".

Kjo do të mundësojë krijimin e perspektivave të reja për shfrytëzimin, përpunimin e resurseve minerale. Valorizimi i resurseve minerale nënkupton vendosjen e resurseve minerale të Kosovës, posaçërisht ato të linjitit dhe të xeheve të plumbit dhe zinkut.

Në objektivin 1.2 hartimi i politikave zhvillimore për sektorin mineral të strategjisë minerare, ndër masat për realizimin e këtij objekti në pikën 1.2.3 parashihet:

Ristrukturimi i sektorit mineral me qëllim të rehabilitimit dhe modernizimit të aseteve ekzistuese për të siguruar shtimin e prodhimit dhe përpunimit të resurseve minerale në vend.

Kujdes i veçantë do t'i kushtohet riorganizimit të "Trepçës" në harmoni me interesat e qytetarëve dhe shtetit të Kosovës. Për këtë qëllim Kuvendi i Republikës së Kosovës ka autorizuar Qeverinë që të nxjerrë Ligjin për "Trepçën" në bazë të këtij rekomandimi.

Zyra Ligjore e Kryeministrit më 30 prill 2013, me numër protokolli 928, ka kërkuar nga Ministria e Zhvillimit Ekonomik që të ndërmerren hapat përkatës për hartimin e Projektligjit për "Trepçën". Sipas Rregullores nr. 09/2011, Ministria e Zhvillimit duke pasur në konsideratë kornizën institucionale dhe ligjore, si dhe duke marrë parasysh se "Trepça" nën administrimin e AKP-së, ka kompleksitet të veçantë, me qëllim të themelimit të kornizës ligjore për rregullimin e ushtrimit të të drejtave pronësore në këtë ndërmarrje, në përputhje me parimet e njohura ndërkombëtare, rrjedhimisht për të realizuar këtë qëllim, ka themeluar grupin punues të ekspertëve për hartimin e Projektligjit për "Trepçën".

Grupi punues përbëhet nga ekspertët e shumë institucioneve, nga Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Ministria e Tregtisë dhe Industrisë, Ministria e Financave, nga Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale, nga vetë AKP-ja, Fakulteti i Gjeoshkencave, Teknologjisë dhe të tjerë, Ministria e Planifikimit Hapësinor e kështu me radhë. Grupi punues i themeluar më 14 gusht nga Ministria e Zhvillimit Ekonomik, pas disa takimeve të mbajtura ka ofruar dy mundësi apo modalitete, si në vijim:

Nën 1, propozim- ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-087 për ndërmarrjet publike; si dhe apo pika 2, hartimi për Projektligjin për "Trepçën".

Megjithatë, grupi punues pas konsultimeve me ekspertë të tjerë si dhe me ekspertë juridikë, mendon se alternativë e parë e cila nënkupton që çështja e Ndërmarrjes "Trepça" të rregullohet përmes ndryshimit dhe plotësimit të Ligjit për ndërmarrjet publike, është më e shkurtër...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Jo, koha është e precizuar në 3 minuta. Deputet, ke pyetje shtesë?

MUHAMET MUSTAFA: Nuk mora një përgjigje. Edhe pse 3 minuta, sigurisht ministri s'pati mundësi t'i lexojë krejt, se për tre minuta s'mund të koncentrohet në pyetje, po na foli për strategjinë e mineraleve. Unë s'kisha pyetje për strategji.

Ajo që mua më intereson, është çka po ndodh dhe a është e koordinuar kjo që po ndodh në AKP me kontraktimin dhe angazhimin e parasë publike për kontraktimin e një firme të huaj, prej 9 firmave, njëherë kanë qenë 40 tash janë 9, për ta menaxhuar dhe ristrukturuar "Trepçën"?

A janë këto aktivitete të dyfishta dhe a janë të koordinuara? Kjo është çështja për mua esenciale.

Dhe 2, a është më mirë ky ligj apo ai ligj, do ta shohim kur të vijë, edhe pse unë jam skeptik se të gjitha çështjet që ne kemi kërkuar të rregullohen me ligj, mund të futen me Ligjin për ndërmarrjet publike. Ndoshta, atje mund të futet që "Trepça" del këtu, por ju lutem, Kuvendi ka kërkuar një ligj të veçantë për "Trepçën", i cili do ta rregullojë "Trepçën" në mënyrë komplekse.

Prandaj, ju lutem nëse mundet ministri shkurt të na përgjigjet në këtë pyetje.

KRYETARI: Ministër, e ke fjalën.

MINISTRI FADIL ISMAJLI: Mirë që ma dhatë rastin të vazhdoj.

Atëherë, sigurisht i keni parë dhe mediet, dje ka kaluar koncept-dokumenti në Qeveri për hartimin e ligjit dhe unë jam i bindur që gjatë muajit shkurt do të jetë këtu në Qeveri, propozimi për aprovim nga Kuvendi.

Pika e dytë, sa i përket AKP-së, Qeveria e kushtimisht as Ministria e Zhvillimit Ekonomik nuk ka kompetenca mbi AKP-në. Përkundër kësaj, unë si ministër i Zhvillimit Ekonomik kam ftuar në bisedë kryesuesin e AKP-së me sugjerim dhe me këshillë që ta ndërpresë atë proces që në fillim, shumë më herët. Pastaj kanë pasuar dy shkresa, njëjtë me kërkesë se nga Kuvendi kemi një kërkesë për ligjin, të cilat përgjigja është kthyer se ata kanë obligim ligjor.

Po ju them këtu para deputetëve, nuk kanë obligim ligjor ta bëjnë këtë që po e bëjnë, sepse në ligj nuk shkruan duhet ta bëjnë, por thuhet mund ta bëjnë. Duke pasur parasysh këtë që jemi duke bërë, ata duhet ta ndërpresin këtë proces.

Dhe, se fundi, më 29 nëntor ju kam drejtuar edhe këtij Parlamenti, respektivisht kryesuesit dhe Kryesisë së Parlamentit, që të shfrytëzojnë autoritetin e tyre, si juve si Kuvend mbi AKP-në dhe ta ndërpresin këtë proces, sepse në këtë moment, derisa jemi duke punuar në ligjin, mendoj se janë dy procese paralele, që nuk e plotësojnë njëra-tjetrën. Prandaj, këtu e keni fjalën ju. Ju falënderoj për këtë.

KRYETARI: Pra, vazhdojmë edhe pse në ligj nuk duhet të jetë “mund”, në ligj duhet të jetë “duhet”. Në rregull, unë po them qysh duhet të jetë ligji.

Deputeti Muhamet Mustafa, pyetje për zëvendëskryeministrin Hajredin Kuçi. Zëvendëskryeministri s’është këtu. Do ta bësh pyetjen? Urdhëro!

MUHAMET MUSTAFA: Mirëpo, ju lutem këtë që tha tash në fund ministri, është dashur ta thotë në fillim dhe të na linte kohë për të diskutuar, është shumë shqetësuese kjo për “Trepçën”, andaj duhet parë çka po ndodh atje, sepse mund të kemi pasoja.

Po ju tërheq vërejtjen shumë serioze.

Sa i përket pyetjes për ministrin Kuçi, unë do ta bëj, sepse është hera e dytë domethënë edhe kërkoj që të botohet edhe pyetja edhe përgjigja, mundësisht në “Bilten”.

Në shtator të 2011-ës, në kuadër të çështjeve jashtë rendit të ditës, kam ngritur çështjen e helmimit të nxënësve të shkollave të mesme në Kosovë, në pranverë të vitit 1990, e cila pat marrë përmasa masive dhe ishte përcjell me pasoja të rënda shëndetësore për mijëra nxënës në shumë komuna të Kosovës.

Shumë ekspertë dhe humanistë, duke përfshirë edhe ata ndërkombëtarë kanë ngrehur dyshime të bazuara se këto ishin helmime të qëllimta të organizuara nga qarqet e fushatës së atëhershme që bënte regjimi serb kundër Kosovës.

Me atë rast i kam dorëzuar ministrit të Drejtësisë dhe zëvendëskryeministrit edhe një publikim të një autori suedez, i cili flet për urgjencën e hetimeve, pasi që shumë dëshmitarë të vlefshëm mund të humbin.

E lus ministrin e Drejtësisë, që të na informoj se çfarë është ndërmarrë lidhur me këtë çështje dhe çfarë është duke punuar institucioni për krime lufte në këtë Ministri dhe cila është çështja e Ministrisë dhe e Qeverisë së Kosovës, për t’i ndryshuar këto ngjarje të dhimbshme në pranverën e vitit 1990? Faleminderit!

KRYETARI: Deputetja Hykmete Bajrami, pyetje për ministrin Fehmi Mujota.

HYKMETE BAJRAMI: Faleminderit, kryetar i Kuvendit!

I nderuar ministër,

Këtë pyetje ua kam drejtuar edhe njëherë vitin e kaluar. Më intereson puna e buxhetit të ndarë, do të thotë, në vitin 2013 kemi pasur 14.3 milionë të ndara për zgjerimin dhe rehabilitimin e rrugës magjistrale Prishtinë – Mitrovicë.

Lus kolegët që të ulen në vend dhe të mbajnë pak qetësi.

Dhe, janë ndarë 9.056 milionë për zgjerimin dhe rehabilitimin e rrugës magjistrale Prishtinë-Pejë.

I nderuar ministër, a mund të na thoni sa për qind e këtyre mjeteve janë shpenzuar për secilin projekt dhe ku kanë shkuar mjetet e pashpenzuara, sepse nga ajo sa kemi parë ne, shanse nuk kanë pasur të gjitha ato mjete të shpenzohen? Faleminderit!

KRYETARI: Ministër, e ke fjalën.

MINISTRI FEHMI MUJOTA: Faleminderit, i nderuar kryetar i Kuvendit!

Të nderuar zëvendëskryeministra,

Ministra,

Të nderuar deputetë,

E nderuara zonja deputete Bajrami,

Me buxhetin për vitin 2013, për projektin zgjerimi dhe rehabilitimi i rrugës magjistrale MD Prishtinë - Mitrovicë, janë ndarë 14 313 768 euro. Pas rirregullimit të buxhetit gjatë muajit janar 2013, procedurë kjo e lejuar ligjore sipas nenit 7 të Ligjit 04/L-165 të Buxhetit të Republikës së Kosovës, për këtë projekt janë paraparë 13 795 414 euro.

Shuma prej 518 354 euro nga ky buxhet është paguar për obligime për segmentet paraprake në këtë rrugë, ndërsa me rishikimin e buxhetit dhe vendimin e Qeverisë, buxheti përfundimtar për këtë projekt në vitin 2013 ka qenë 8 486 412 euro. Nga këto mjete, kontraktuesve në bazë të punëve që kanë realizuar u janë paguar 3 406 970.81 euro ose 40,28% kthyer në përqindje. Pjesa e mjeteve të tjera, në fund të vitit 2013 prej 5 049 442 euro janë mjete të mbetura në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

Në vitin 2014 sipas Ligjit nr. 04/L-233 të buxhetit, në tabelat e buxhetit 3.2 për vazhdimin e punimeve në këtë projekt, janë ndarë 8 milionë e 400 mijë euro, si dhe 11 600 000 euro nga huamarrja ose kredia. Janë gjithsej pra 20 milionë euro, përfshirë kontratat e reja që do të nënshkruhen sivjet për gjatësinë rrugore drejt Mitrovicës dhe mund t'ju siguroj se buxheti për rrugën Prishtinë - Mitrovicë është i siguar dhe është një projekt që do të zgjasë sipas kontratave që do të nënshkruhen, që nënkupton se nuk janë projekte njëvjeçare.

Zgjerimi dhe rehabilitimi i rrugës Prishtinë-Mitrovicë është një fakt i kryer, sa i takon projektimit dhe sa i takon buxhetit, prandaj qytetarët e vendit mund të presin që ky projekt 4 shiritash i rrugës Prishtinë-Mitrovicë, brenda 2 apo 3 vjet, varësisht prej kontratave që nënshkruhen këtë vit, do të jetë i përfunduar.

Ndërsa, për projektin zgjerimi dhe rehabilitimi i rrugës Prishtinë-Pejë, buxheti në vitin 2013 ka qenë 9 056. 038 euro. Me vendim të Qeverisë nga ky projekt janë marrë 1 373 382 euro, ndërsa nga 7 632 706 euro të mbetura janë shpenzuar 5 946 573,20 euro, ose 77,4%. Pjesa e pashpenzuar e mjeteve prej 1 736 133 euro ka mbetur në buxhetin e vendit.

Për vitin 2014, sipas Ligjit të buxhetit nr. 04/L-233 në tabelën e buxhetit 3. ...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Faleminderit! Deputete, ke pyetje shitesë?

HYKMETE BAJRAMI: Faleminderit, kryetar!

Në fakt, jo pyetje, vetëm po e bëj një koment.

Do të thotë, për rrugën Prishtinë-Mitrovicë nga 14,3 milionë euro në janar janë zbritur në 13,7 milionë euro, me rishikim të buxhetit, ky buxhet është zbritur në 8,4 milionë dhe në fund gjatë krejt vitit 2013 janë shpenzuar 3,9 milionë euro. Do të thotë për një projekt të rëndësisë vitale dhe të kësaj madhësie, në fillim të buxhetit ndahen 14 milionë dhe në fund shpenzohen 3,9 milionë. Kjo është mënyra se si ju po arrini që me efikasitet t'i shpenzoni mjetet dhe po na bini shifra, në mënyrë që të duket që kemi projekte të mëdha dhe buxhete të mëdha, dhe në fund, në fakt numrat po tregojnë krejt diçka tjetër.

Ndërsa, për projektin Pejë-Prishtinë, do të thotë janë ndarë 9 milionë euro, në janar kjo shumë ka zbritur në 7,6, në fund çka është shqetësuese, janë shpenzuar, thotë u janë paguar kontraktuesve 5...

(Ndërprerje nga regjia)

MINISTRI FEHMI MUJOTA: Faleminderit, e nderuar deputete!

Unë ju fola me shifra të sakta për planifikimet dhe shpenzimet buxhetore dhe ne ndjehemi shumë mirë që të gjitha punët e kryera deri tash i kemi paguar si Ministri. Dhe, për këtë jemi shembull në rajon, mund të ju them, se nuk kemi borxhe të mbetura për punët e kryera në Kosovë.

Njëkohësisht ne punojmë në shumë projekte kapitale, siç janë rrugët nacionale Prishtinë-Pejë dhe Prishtinë-Mitrovicë, por edhe kemi më tepër se 80 projekte, që realizohen njëkohësisht, prandaj ju e dini si deputete dhe jo vetëm kaq, por edhe si ekonomiste dhe si deputete, që jeni anëtare e Komisionit për Buxhet dhe Financa, që e drejta e bartjes së mjeteve financiare dhe pagesave për projektet në vazhdim është gjithmonë e ruajtur për Qeverinë, për Ministrinë apo për menaxhimin... Sa për informim mund të ju them se në tre vjetët e fundit, Ministria e Infrastrukturës e ka realizuar buxhetin 96% në mesatare. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Vazhdojmë. Deputetja Hykmete Bajrami, pyetje për ministrin Besim Beqaj.

HYKMETE BAJRAMI: Faleminderit, kryetar!

Ministër, çështja është puna e borxhit publik, i cili në shtator të vitit 2013 ka arritur në 458 milionë. Unë i kam një seri pyetjesh, sa është rritur borxhi publik prej vitit 2010, sa është shuma e letrave me vlerë për vitin 2012 dhe 2013 dhe sa janë kamatat vjetore që Qeveria e Kosovës paguan për borxhin publik të marrë nga viti 2011 deri më sot? Faleminderit!

KRYETARI: Ministër, e ke fjalën.

MINISTRI BESIM BEQAJ: Faleminderit, i nderuar kryetar!

Kabinet qeveritar,

Deputetë të nderuar,

E nderuara deputete, Bajrami, sigurisht që ju falënderoj për pyetjen e bërë, sepse gjatë këtyre ditëve kemi pasur shumë komente të ndryshme lidhur me borxhin publik dhe kemi pasur shumë shifra të cilat janë të pasakta.

Dua t'ju informoj juve dhe qytetarët e vendit se në fund të muajit dhjetor 2013 borxhi i përgjithshëm është 475,7 milionë apo 9% nga bruto-produkti vendor. Nga gjithsej ky borxh 323,2 milionë janë apo 68% është borxhi i jashtëm i cili është trashëguar nga ish-Jugosllavia dhe 153 milionë euro, apo 32% është borxh i brendshëm.

Borxhi i jashtëm që ka të bëjë me borxhet e Bankës Botërore të vjetër të cilat janë obligim që shteti duhet t'i paguajë.

Në vitin 2010, borxhi i përgjithshëm ishte 260 milionë apo 6,2% të GDP-së. Dhe nëse e krahasojmë nivelin e borxhit sipas viteve, në vitin 2011 ka pasur një rënie për 2,6%, sepse nuk kemi pasur treg të letrave me vlerë dhe ju e dini që tregu i letrave me vlerë është vlerë për shtetin i cili lëshon dhe ka besim tek institucionet dhe sistemi i tij bankar për t'i absorbuar kërkesat të cilat shteti i lëshon përmes letrave me vlerë, ndërsa në vitin 2011 për shkak të besimit që e kanë treguar edhe institucionet financiare ndërkombëtare, ka një rritje prej 61.6%, ndërsa në vitin 2013 ka rritje për 16.1%.

Në vitin 2012 janë emituar 73 milionë euro letra me vlerë, me maturitet 3 dhe 6 muaj, në vitin 2013 janë emituar 79 milionë euro me maturitet 3, 6 dhe 12 muaj dhe gjithsej siç ju thashë vlера e borxhit të brendshëm është 15 milionë euro.

Kamatat të cilat i paguajmë dhe duhet t'i informoj mirë qytetarët, sepse është manipuluar me shifra mbi 20 milionëshe për pagesa të kamatave, për borxhin e brendshëm mesatarja e kamatës është 1,45% apo në shifra monetare është diku rreth 2 milionë e gjysmë euro në vit që paguan për projekte, ndërsa borxhi i jashtëm është me normë të kamatës 3,8%, që shkon diku rreth 9 milionë euro paguan kamata në raport me borxhin e jashtëm.

Duhet t'ju bëj edhe një krahasim, të nderuar deputetë, të nderuar qytetarë, sepse borxhi i jashtëm është besim i institucioneve financiare që tregojnë në raport me shtetin dhe me stabilitetin e atij vendi. Ne për herë të parë kemi bërë marrëveshje me Bankën Evropiane për Investime, marrëveshje me Bankën Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim dhe borxhi ynë është në 9.1% nga bruto- produkti vendor dhe mund të shohin edhe qytetarët krahasimin me vendet e rajonit.

Kosova borxhin publik e ka 9.1, Shqipëria e ka 66% në raport me bruto-produktin vendor, Maqedonia e ka 31%, Serbia e ka 58%, Mali i Zi e ka 52%, Bosnja e Hercegovina e ka 27% dhe Kroacia e ka....

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Deputete, ke pyetje shtesë?

HYKMETE BAJRAMI: Faleminderit, ministër!

Po, është e vërtetë, ne kemi thënë 20 milionë, por nuk qenka 20 milionë. Në fakt kamata po u paguaka brenda vitit, 11,5 milionë dhe kjo nuk është shumë e vogël kur dihet se për çka merren borxhet dhe mandej marrin borxhe për projekte si rruga, për shembull, Prishtinë-Mitrovicë, të cilat i bartin vit pas viti, sepse nuk jemi në gjendje t'i shpenzojmë.

Pyetja është se ku shpenzohen këto mjete, cilat projekte dhe a janë benefitet, domethënë efektet ekonomike të këtyre mjeteve më të mëdha se kamatat që paguhën brenda vitit?

Dhe, ju lutem shumë të mos na krahasoni me borxhin publik të Shqipërisë, sepse na jemi shtet që 5 vjet e Shqipëria është shtet, ka mund të marrë borxh që 100 vjet. Domethënë, ne vetëm sa kemi hyrë në këtë fazën e hyrjes së borxhit dhe qysh po i shohim trendët, do të thotë janë shumë të mëdha.

E that edhe vet, në vitin 2010 kemi pasur borxhin 260 milionë, tash kemi një borxh prej 475 milionë, nuk është një rritje e vogël...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Ministër, vazhdoje!

MINISTRI BESIM BEQAJ: Faleminderit! E nderuara deputete, edhe një herë dua t'ju them që kur flisni për borxhin publik, kur flisni për emetimin e letrave me vlerë, për destinime, sepse kam parë shumë diskutime të cilat po e them lënë shumë për të dëshiruar në aspektin edhe profesional edhe të analizës së plotë sa i përket borxheve publike, borxhi publik, emetimi i letrave me vlerë bëhet për të financuar deficitin buxhetor i cili jo në asnjë shtet tjetër nuk është 2% sikur që është rregulluar këtu, po ka deficite buxhetore të cilat, më të voglat në rajon janë me 6%, ndërsa ne jemi me 2%.

Pra, nuk mund të thuhet që nuk ka projekte të cilat financohen me deficit, përmes financimit të brendshëm, pra përmes huave të cilat merren përmes letrave me vlerë, bëhen në bazë të projekteve të Qeverisë dhe askund në botë nuk ka projekte konkrete ku thotë që e marrim këtë projekt dhe do ta marrim këtë hua nga letrat me vlerë për ta investuar këtë projekt.

Prandaj, është mirë që kur të flasim për letra me vlerë të kuptohet çka janë letrat me vlerë, të kuptohet tregu i letrave të kapitaleve, të kuptohet besueshmëria e sistemit bankar të Republikës së Kosovës. Ne kemi absorbim të plotë 100% të kërkesave sa herë dalim dhe kjo tregon stabilitet të plotë, përkundër që sistemi bankar ka likuiditet më shumë se sa ka nevojë.

Dhe në ndërkohë, tani jemi duke rritur edhe bazën e mundësive për tregun primar dhe përgatitjet për tregun sekondar, që nënkupton pjekuri të plotë të institucioneve për t'u marrë me tregun financiar.

Pra, këto janë zhvillime moderne, nuk janë zhvillime të ekonomisë së vetë plotësuar, sepse në vetëplotësim nënkuptohet sikurse dikur e ka përdorur edhe para disa ditësh sikur t'i thua dikujt e ke rrogën 300 euro dhe jeto me ato 300 euro, mos merr borxh tjetër, jeto në varfëri, do të thotë edhe kjo është logjika e mendimit për borxhin publik. Ne jemi të interesuar që përmes borxhit publik me kamata të mira t'u mundësojmë projekteve të cilat prej qytetarit krijojnë mirëqenie të plotë të tyre dhe orientim afatgjatë edhe për infrastrukturë edhe për perspektivë tjetër për punësim, por edhe perspektivë për zhvillim ekonomik. Faleminderit!

KRYETARI: Deputeti Daut Haradinaj, pyetje për ministrin Agim Çeku.

DAUT HARADINAJ: Faleminderit, kryetar!

I nderuar Kabinet qeveritar,

Deputetë,

Meqenëse dje Këshilli i Ministrave e debatoi një çështje shumë me rëndësi çështjen e “poçurkave” siç i quajti zëvendëskryeministri dhe mendoj se Mitrovica s'ka problem më serioz se sa “poçurkat”, unë dua ta bëj një pyetje, zoti ministër, jeni kryesues i Komisionit për verifikimin e veteranëve, invalidëve dhe familjeve të dëshmorëve, deri ku ka shkuar puna në këtë komision edhe sa kohë ju duhet që ju ta përfundoni këtë proces?

KRYETARI: E ka fjalën ministri Agim Çeku.

MINISTRI AGIM ÇEKU: I nderuar zoti kryetar!

Kolegë ministra,

I nderuar zoti Haradinaj,

Të nderuar deputetë,

Është e vërtetë se kohëve të fundit janë shtuar kritikrat në llogari të Komisionit për verifikim të veteranëve për neglizhencë, për zvarritje, për mos punë.

Unë e pranoj që ky proces është një proces shumë i vonuar, i kuptoj shqetësimet e veteranëve, por nuk pajtohem me atë se faji për zvarritje të këtij procesi, faji për vonesa është vetëm te Komisioni për verifikim të veteranëve.

Komisioni është formuar në bazë të Ligjit për statusin dhe të drejtat e dëshmorëve, invalidëve dhe veteranëve, pjesëtarëve të UÇK-së, viktimave civile, familjet e tyre, dhe komisioni punon në bazë të këtij ligji.

Ky ligj i definon disa kategori, e definon kategorinë e veteranit... personat qytetarë që janë radhitur si ushtarë me radhët e UÇK-së, kurse e dini që ne kemi punuar që nga dita e parë kur e ka marrë këtë detyrë, janë bërë shumë punë, domethënë është formuar Komisioni, është nxjerr Rregullorja e punës, Sekretaria dhe janë bërë aplikacionet, janë grumbulluar aplikacionet, sistemuar aplikacionet, është krijuar baza e të dhënave dhe në bazë të kësaj baze të dhënave ne kemi vërejtur se shumë aplikantë nuk janë si ushtarë, por thjeshtë janë pjesë, kanë qenë pjesë aktive e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.

Ky ligj të cilit ne i referohemi, edhe pse në titull e ka “statusin dhe të drejtat e pjesëtarëve të UÇK-së” nuk e definon qartë kush janë pjesëtarët e UÇK-së. Edhe në nenet e ndryshme, sot për shembull, veterani dhe pjesëtar i UÇK-së, ky Parlament e ka iniciuar plotësimin e këtij ligji, e di me kërkesën e “Vetëvendosjes” për gratë e dhunuara gjatë luftës. Ne si komision e kemi shfrytëzuar këtë iniciativë të Parlamentit dhe kemi propozuar, i kemi dhënë disa propozime që ky ligj të plotësohet edhe me definicionin e pjesëtarit të UÇK-së, pjesëmarrësit të luftës, të bëhet kategorizimi i këtyre veteranëve të luftës.

Ky ligj është në procedurë dhe neve na nevojitet një bazë ligjore që ta bëjmë verifikimin apo t’ia caktojmë dikujt statusin që i përket, po kjo duhet të jetë në përputhje me ligjin, andaj ky është në duart e juaja dhe ky ligj apeloj te ju që sa më shpejt të vjen në procedurë dhe ne si komision ta kemi bazën ligjore.

Por, ne duke e pritur, duke besuar se kjo do të ndodhë, sepse ligji e parasheh, e kemi filluar procesin e verifikimit, në dy zona - Zona Operative e Shalës, Zona Operative e Karadakut.

Dje, e kemi pasur takimin e fundit të komisionit dhe kemi vendosur që të fillojmë paralelisht me të gjitha zonat operative dhe me Shtabin e Përgjithshëm, njësitë pranë Shtabit të Përgjithshëm. Dhe po i shoh kërkesat për ligj. Ky ligj i cili është në procedurë parlamentare për plotësim, domethënë është krejt diçka tjetër, ia mundëson, e përshpejton punën e komisionit për verifikim, kurse ligji tjetër, Ligji për veteranët që duhet të hartohet...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: A ke pyetje shtesë?

DAUT HARADINAJ: Po kryetar, namin e ka bërë! Domethënë, më 21 nëntor e ke marrë detyrën si kryesues i këtij komisioni dhe prej se jeni bërë kryesues i këtij komisioni, katër takime i ke pasur. Dhe pardje, pasi e ke marrë pyetjen parlamentare, e ke thirrur një komision dhe keni marrë vendim të shkoni në Shqipëri “m’u rrugavë” pak. Mirë bëni, shkoni pak. Ka paralajmërime se veteranët e UÇK-së janë të interesuar për të protestuar dhe mos e bëni si në Kiev të Ukrainës, po ngutuni pak se ju nuk e keni paraparë Ligjin për veteranët e luftës në agjendën e legjislativit të kësaj qeverie për këtë vit, po si e keni menduar ta zgjidhni këtë problem?

KRYETARI: Fjalën e ka ministri Agim Çeku.

MINISTRI AGIM ÇEKU: ...Jo, më shumë kemi mbajtur, dihet ato dhe s’e e kemi mbajtur nën presion këtë takim, po e kemi mbajtur nën presion të punës se unë ndiej përgjegjësi dhe të gjithë anëtarët e komisionit dhe me përgjegjësi të plotë jemi duke e kryer këtë punë dhe do ta kryejmë deri në fund.

Ligji për veteranët është në hartim e sipër dhe javën tjetër do të aprovohet në Qeveri menjëherë do të vjen në Parlament, kështu që edhe ky ligj i veteranëve që kërkohet domethënë ky ligj tjetër, kështu që ne kërkojmë, është diçka tjetër plotësimi i këtij ligji ekzistues, diçka tjetër nxjerrja e ligjit të ri.

Ne po e shohim tendin e këtyre aplikacioneve, diku 45% vërtet janë ushtarë që kanë qenë veteranë luftëtarë, diku 12% janë pjesëtarë të UÇK-së, 6% të plagosur, 3% diku janë dëshmorë të rënë, por afër 30% janë aplikacione që ne i kemi refuzuar që si komisione që deri tash e kanë këqyrë, e kanë parë se nuk ka baza që ai të ketë një status të veteranit. Kështu që besoj se ky trend do të përcillet, ne do ta përshpejtojmë punën, e kemi synim që në pjesën e parë të këtij viti ta përfundojmë si komision. Presim edhe ankesa, ne duhet në kohë ta shqyrtojmë edhe çdo ankesë kështu këto vonesa ju siguroj se nuk janë për shkak të mungesës së vullnetit, mungesës së angazhimit apo për shkak të kësaj apo asaj agjende apo agjende të këtij apo atij, thjesht vonesat janë objektive. Vonesat janë numri i madh i aplikacioneve, mungesa e bazës ligjore, mungesa e dokumentacionit, jo të gjithë komandantët e zinxhirit komandues janë prezent në Kosovë, shumë prej tyre janë jashtë, duhet të vijnë, duhet t'i mbledhim, kështu që ndoshta nuk duket që po punojmë, por komisioni është duke punuar dhe do ta kryejë punën e vet me përgjegjësi dhe me nderë.

KRYETARI: Vazhdojmë. Deputeti Daut Haradinaj, pyetje për ministrin Nenad Rashiq.

DUAT HARADINAJ: Kryetar, kjo pyetje është rreth një ish- deputeti, domethënë i keni marrë të gjitha vendimet e të gjitha niveleve të gjykatave, të sekretariatit të Kuvendit, Gjykatës Themelore, një aktvendim të Gjykatës Kushtetuese. Pse nuk e implementoni, zoti ministër, atë vendim dhe edhe sa kohë ju duhet se kjo kohë veç ka marrë, përkundrazi edhe jeni ndëshkuar nga Gjykata me kompensim material për shkak se nuk e keni fuqizuar vendimin. Dhe pse nuk e fuqizoni këtë vendim? Për deputetin Shkumbin Demalijaj, Armend, komshiun tënd.

KRYETARI: Fjalën e ka ministri Nenad Rashiq.

MINISTAR NENAD RAŠIĆ: Hvala gospodine predsjedniče!

Gospodine Haradinaj, nisam dobio pitanje u pisanjoj formi ali i onako odgovoriću na to.

Kao što znate, slučaj bio da je ovaj opštinski sud - Gjykata themeluese, je na predlog odnosno na aplikaciju gospodina Demalijaja doneta presuda i gospodin Demalijaj osnovano na zakonu o prava ovih poslanika trebalo da bude vraćeno svoje radno mesto gde je pozicija- kryeshefi ili glavni inspektor inspektorata za rad.

Naravno zbog toga što je u tom datom vremenskom periodu i ugovor važeći koji je sad na snazi trenutnog glavnog šefa inspektorata za rad odnosno mi morali da podnesemo žalbu i u ovom slučaju imamo konfliktnu situaciju jer obe strane u stvari imaju prava da budu u ovom slučaju glavni šefovi. Prema tome slučaj je na apelacionom sudu i mi ćemo čekati od njega odluku. uložili smo žalbu kojom treba da nam oni daju da nam razjasne i oni su rekli da će tokom januara da nam dostave njihov odgovor tako da verovatno ako malo kasne verujem da ćemo početkom februara već imati njihove preporuke.

Naravno, Ministarstvo za rad će u svakom slučaju da sprovede te zaključke koje bude sud predložio i mi oko toga nemamo nikakvih problema ali opet kažem desilo se konfliktna jedna situacija u kojoj imate dve osobe, koje imaju faktički pravo na isto mesto. Hvala!

KRYETARI: Deputet, ke pyetje shitesë?

DAUT HARADINAJ: Kryetar, po ashtu ministri i Drejtësisë është ankuar dhe është refuzuar ankesa. Po unë veç po të tregoj ty në një aktvendim të Gjykatës Themelore në Prishtinë, ku thotë: Neni 2, pika 2: “Detyroheni që Gjykatën ta njoftoni me kushte sa më të shpejta me shkrim, më së largu deri me datën 25 9. 2013, në orën 14 për zbatimin e këtij urdhri, ditën dhe orën e caktuar”.

Po të them edhe një herë, është vendim zyrtar. Të gjitha këto i ke këtu, nëse do unë ta bëj një kopje dhe ju mund ta shihni se ju asnjë të drejtë ligjore juridike nuk e keni më tutje, përkundrazi jeni i urdhëruar si ministër ta implementoni vendimin dhe të njëjtën kohë ta kompensoni materialisht për shkak se i keni marrë kohë për mos kthimin e tij në detyrë.

Po flas edhe një herë, domethënë janë shterur të gjitha opsionet juridike nga ekzekutivi. Tani ju të vetmen detyrë e keni implementimin e vendimit dhe nuk është i vetmi rast, ka shumë raste.

Vendimi thotë: duhet ta ktheni në vendin e njëjtë të punës apo të ngjashëm”. E keni saktësisht të përshkruar urdhrin e Gjykatës. Faleminderit!

KRYETARI: Ministër, vazhdoje përgjigjen.

MINISTAR NENAD RAŠIĆ: Hvala još jednom!

Imam svu dokumentaciju, hvala vam puno na vašoj ponudi. Prvo da vam kažem sa one zadnjeg onog akcusa kojeg ste rekli, da u odluci postoji na isto radno mesto ili sličnom, odnosno odgovarajućom tom nivou. Inače gospodin Demalijaj nije prihvatio nijedan, ponavljam nijednu drugu poziciju koja bi bila istog nivoa odnosno odgovarajućeg osim ove. Prema tome mislim da nije bilo malo razumevanja oko nalaženja rešenja, ali okej.

Gospodin Demalijaj ima pravo da insistira na odluci, i ako vidite u odluci tamo vam piše, u roku od 15 dana će prvi odgovorni u ovom slučaju ja biti dužan da plati kaznu od navedeno je tamo u dokumentu. A prošlo je 2 meseca od datuma izvršenja te odluke i to što ja nisam, kažnjen, sve ovo pokazuje da smo mi na više instanci podneli žalbu gde sud jeste uz njihovu saglasnost dao prostora u kome će ovaj slučaj da bude rešen. I ukoliko, opet kažem, u momentu kada budemo imali njihovu odluku, naravno suda, preporuku Ministarstvo za rad, ja lično, ću sprovesti absolutno doslovno kao što bude pisalo u odluci. Hvala!

KRYETARI: Faleminderit! Vazhdojmë. Deputetja Albana Gashi, pyetje për ministrin Nenad Rashiq.

ALBANA GASHI: Faleminderit, zoti kryetar!

Në korrik të vitit 2012, në Parlamentin e Kosovës është miratuar Ligji për personat e verbër. Që nga miratimi i këtij ligji ka pasur vonesa të paarsyeshme që përbën shkelje të ligjit në vazhdimësi nga ana e Ministrisë. Nuk janë nxjerrë aktet nënligjore dhe të gjitha masat tjera të parapara prej afatit prej gjashtë muajsh nga hyrja në fuqi e ligjit, nuk ka filluar të implementohet ligji i paraparë me 1 janar të vitit 2013, kjo si pasojë e mos hartimit të këtyre akteve nënligjore dhe mos planifikimit të kostos buxhetore.

Pas një shikimi të buxhetit, në vitin 2013, janë ndarë mjete shtesë për Ligjin për personat e verbër, mirëpo edhe pas kësaj kompensimi për kategori nuk është bërë.

Përveç këtyre vonesave dhe shkeljeve të ligjit, ju keni qenë kontradiktor dhe i paqartë edhe në deklaratat tuaja gjatë gjithë kësaj periudhe dhe po i përmend disa nga deklaratat e juaja.

Parlamenti kur e ka miratuar ligjin nuk e ka llogaritur koston e tij. Komisioni Mediko-social nuk ka ditur ta bëjë numërimin e saktë të personave të verbër. Këto deklaratat i keni dhënë në dhjetor të vitit të kaluar, pra pasi që është bërë rishikimi i buxhetit.

Deklarata tjetër është, mjetet prej 1,5 milion eurove kanë qenë të dedikuara për pjesën e pensioneve bazike.

Pyetja për juve ministër është: A mund të na e jepni një përgjigje të qartë dhe konkrete se pse këto mjete nuk janë ndarë në vitin 2013?

KRYETARI: Ministër, e ke fjalën.

MINISTAR NENAD RAŠIĆ: Hvala još jednom predsendiče! Inače nikada nisam rekao da komisija nije isvojala tačno aplikante za ovu vrstu beneficija nego sam rekao da nije konačan broj aplikanata i aplikanti nisu verifikovani, jer jedna je stvar aplicirati za nešto a druga je dali vas je medicinska komisija verifikovala kao onog koji ispunjava uslove da bi te benefite dobijao.

Što se tiče razloga zašto nije isplaćeno 2013. godine. Još jednom moram da podsetim da je zakon tad usvojen bez jasne finansijske deklaracije, bez jasne finansijske izračunavanja koliko bi taj utrošak u vezi ovog zakona trebao da bude.

I kao što znate, fiskalna disciplina nalaže da svaki zakon, svaka odluka ima jasno izražen svoj utrošak. U ovom slučaju u Parlamentu je usvojeno bez toga. Pa smo mi bili u obavezi kao onaj koji sprovodi zakon da napravimo komisiju koja će moći da utvrdi koliko će u stvari biti taj iznos koji će koštati Vladu u slučaju implementacije zakona od same 2013. godine. To je jedan razlog.

Drugi razlog je bio to što, ovo može da izgleda posao nije posao zahtevan, ali većina ovih aplikanata i pogotovo onih verifikovanih su deo neke od skema koje mi treba da finansiramo. Da li je to u socijalnoj skemi, da li je to u skemi koja se tiče privremenih penzija, da li je u bilo kojoj skema od onih koji finansiramo, mi sve njih treba da

odstranimo iz jedne, da bi formirali u drugu. Znači zbog tehničkog dela posla, zbog verifikacije komisije, zbog tehničkih objektivnih razloga nismo stigli da do kraja 2013. godine utvrdimo tačan utrošak ovog zakona i zbog toga nije bilo isplaćanja.

Inače, svi aplikanti koji su od 2013. godine bili naravno podneli svoje zahteve, ja sam već juče puta razgovarao sa gospodinom ministrom finansija Bećajom, svi će biti isplaćeni kao što sam i rekao - retroaktivno. Naravno to ne važi za one aplikante koji sad predaju u 2014. godini.

Oni koji budu predali u 2014. godini zbog toga što imamo saznanja da se taj broj aplikata i dalje je konstantan, odnosno povećava, oni će moći da apliciraju samo za ovu godinu. Oni koji su u 2013. godini aplicirali i potvrđeni, verifikovani kao oni koji uspunjavaju uslove za isplatu biće im isplaćeno.

KRYETARI: Deputete, ke pyetje shitesë?

ALBANA GASHI: Faleminderit, kryetar!

Ju prapë e thatë që kur është miratuar ky ligj nuk ka qenë e paraparë edhe kostoja buxhetore, mirëpo po ua sjell edhe një herë në kujtesë, që me rishikim të buxhetit, buxhet i cili ka kaluar më 27 korrik të vitit 2013 është paraparë shuma prej 1.58 milionë euro për këtë kategori të qytetarëve. Ju thatë që disa prej tyre janë përfitues nga skema sociale, gjë që me njëfarë mënyre e sanksionon edhe marrjen e këtij kompensimi ... mirëpo, ministër të gjithë përfituesit nga ky ligj nuk janë përfitues edhe nga skema sociale.

Ky është një problem tjetër që duhet të bëhet amendamentimi i këtij ligji, sepse skemat sociale, në fakt pensionet bazike janë e drejtë e çdo qytetari ose pensioni i moshës, ndërsa kompensimi për efekt verbërie nuk është pension, duhet bërë dallimi, sepse ka persona të cilët kanë lindur të verbër ose me kalimin e viteve kanë fituar këtë mangësi dhe këta nuk mund të....

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Ministër, vazhdo!

MINSITAR NENAD RAŠIĆ: Hvala gospodine predsedniče još jednom!

Kao što sam već napomenuo bio, zbog procesa koji bio tehničke prirode, ono što ste rekli vi da na rebalansu u toku prošle godine, tada još nije bila obaveštavam vas, tad nije bila ni utvrđen ni iznos nego se radio na način koji od prilike bi trebalo da bude taj iznos, ali nije bio. Tada nisu bili stečeni tehničko-pravni uslovi da oni mogu da budu isplaćeni i tada to prebacivanje od 1 milion i po, koji su rekli nije bio na kodu koji je decidovalo utvrdio da je na kodu za slepe osobe. Prema tome, znajući sve ove stvari koje vam još jednom ponavljam ja mogu samo da se obratim onima interesnim grupama u ovom slučaju, svi koji su u toku 2013. godine aplicirali biće apsolutno isplaćeni retroaktivno od dana kada je zakon na snazi, to znači od 1. Januara 2013. godine. Svi oni koji budu od 2014. godine bili aplicirali dobiće odnosno biće im isplaćeno od momenta kada budu njihove aplikacije i njihova verifikacija njihovog statuta bila potvrđena. Hvala puno!

KRYETARI: Faleminderit! Edhe pyetja e fundit për sot, deputetja Albulena Haxhiu, pyetje për ministrin Mahir Jagxhilar.

ALBULENA HAXHIU: Faleminderit, kryetar!

Meqenëse Ligji për pagat e shërbyesve civilë është miratuar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës, në maj të vitit 2010, ky ligj nuk është zbatuar fare që nga hyrja e tij në fuqi e deri më sot. Pas katër vjetëve që është miratuar ky ligj, i cili ka për qëllim të përcaktojë sistemin dhe strukturën e pagave, shtesave dhe kompensimeve të tjera për nëpunësit civilë, sipas përkufizimit të Ligjit për shërbimin civil të Republikës së Kosovës, moszbatimi i tij e ka vazhduar diskriminimin e përgjithshëm në administratën publike.

Ky ligj jo vetëm se do të kishte nivelizuar pagat brenda administratës publike, por po ashtu do të kishte sistemuar vendet e punës sipas specifikave të vendit të punës dhe përgatitjes profesionale të nëpunësve civilë.

Pyetja është se sipas nenit 26 të Ligjit për pagat e nëpunësve civilë, është theksuar se mbikëqyrjen e zbatimit të këtij ligji e bën pra Ministria përgjegjëse e Administratës Publike dhe Ministria e Financave. Cilat janë arsyet që ministritë përgjegjëse deri më tani nuk janë parë që të kenë tentuar që të zbatohet ky ligj? Faleminderit!

KRYETARI: Ministër, e ke fjalën.

MINISTRI MAHIR YAGCILAR: Faleminderit, i nderuar kryetar!

Të nderuar deputetë,

Ministra,

E nderuara zonja Haxhiu,

Ligji për pagat e nëpunësve civilë dhe Rregullorja për klasifikimin e vendeve të punës në Shërbimin civil e gjithashtu edhe Rregullorja për shtesat dhe kompensimet tjera të nëpunësve civilë, Ligji për administratën shtetërore dhe Rregullorja për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës pasqyrojnë një reformë të thellë në Shërbimin civil në lëmin e pagave të nëpunësve civilë dhe organizimin e brendshëm të institucioneve të Republikës së Kosovës.

Çdo ligj i miratuar nga Kuvendi e përcakton edhe një periudhë kohore në të cilën parashihet të hartohen e miratohen aktet nënligjore për zbatimin e ligjit përkatës.

Në këtë kontekst janë miratuar me vonesë Rregullorja për klasifikimin e vendeve të punës dhe Rregullorja për shtesat e kompensimet tjera për nëpunësit civilë. Gjithashtu, Rregullorja për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës për zbatimin e Ligjit për Administratën Shtetërore.

Aktet nënligjore të cekura më lartë janë fundamentale për fillimin e suksesshëm të sistemit të ri të pagave. Pra, këto akte nënligjore kanë determinuar një ristrukturim në të gjitha institucionet. Rregullorja e re për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës të secilit institucion sipas procedurës është dashur të miratohet nga

organi kompetent për komunat, kuvendi i secilës komunë ose për institucionet qeveritare nga Qeveria dhe agjencitë ekzekutive, apo nga bordet e institucioneve të pavarura.

Mandej është dashur të hartohen dhe miratohen të gjitha përshkrimet e vendeve të punës për secilin vend të punës në Shërbimin civil të Kosovës.

Procedurat e miratimit të dokumenteve të lartpërmendura, që është dashur t'i kryejnë të gjitha institucionet e Republikës së Kosovës, kanë zgjatur më tepër se që kanë planifikuar dhe si pasojë kanë shkaktar edhe vonesën e zbatimit të Ligjit për pagat e nëpunësve civilë.

Çështja e zbatimit të ligjit për pagat e nëpunësit civil, konkretisht të Rregullores për klasifikimin e vendeve të punës është diskutuar edhe në takimin e fundit që ka pasur grupi i veçantë për reformën e administratës publike në Bruksel pranë Marrëveshjes së Stabilizimit-Asociimit.

Dhe në konkluzionet e miratuara nga ky takim kemi premtuar se riorganizimi dhe klasifikimi i vendeve të punës bashkë....

(Ndërprerje nga regjia)

(Drejtimin e mbledhjes e merr nënkryetari i Kuvendit, zoti Glauk Konjufca.)

KRYESUESI: Atëherë, zonja Haxhiu, nëse keni pyetje shtesë për ministrin, urdhëroni.

ALBULENA HAXHIU: Faleminderit, kryesues!

Mua po më intereson ta di se cilat janë masat që i keni ndërmarrë ju si Ministri për zbatimin e këtij ligji, pra cilat janë ato masa ose presionin që e keni bërë ndaj institucioneve që janë përgjegjëse për t'i ndërmarrë të gjitha masat, cilat janë ato masa që ju i keni ndërmarrë, çfarë presioni keni bërë konkretisht dhe po më intereson saktë dhe konkretisht ta di se kur është dita edhe viti edhe muaji që ky ligj do të fillojë të zbatohet për shkak se është shqetësuese se si Kuvendi i Republikës së Kosovës, në vitin 2010 miraton Ligjin për shërbyesit ose për pagat e shërbyesve civilë dhe nuk zbatohet nga ju si ministri.

MINISTRI MAHIR YAGCILAR: Faleminderit! Sigurisht masat janë të aprovimit të gjithë akteve nënligjore. Tashmë janë aprovuar të gjitha.

Duhet të aprovojmë të gjitha klasifikimet i cili është sfidë jo vetëm për administratën publike, por çdo institucion, janë pengesa kapacitet njerëzore, kapacitetet buxhetore, sepse Rregulloren për shtesat dhe kompensimet na është dashur afër dy vjet e gjysmë të aprovojmë, sepse ka qenë një diskrepancë ndërmjet ligjit dhe hartimit të Rregullores. Mbasandaj ekziston edhe diskrepanca në ligjet, Ligjin e administratës shtetërore, Ligjin për shërbimin civil dhe Ligjin për pagat e nëpunësve civil. Por besojmë se të gjitha këto sfida tash i kemi tejkaluar, duhet t'i aprovojmë klasifikimet e vendeve të punës për çdo institucion. Tashmë janë dërguar 70%, ne jemi duke menduar, në qoftë se institucionet

nuk i dërgojnë, atëherë me një vendim të Qeverisë t'i jepet përgjegjësia Ministrisë së Administratës Publike të bëjë një klasifikim të përkohshëm që edhe premtimi ndaj Komisionit Evropian ta zbatojë më 1 korrik. Është edhe pjesa e modernizimit të sektorit publik me Bankën Botërore që duhet të përfundohet në muajin e ardhshëm.

Në këtë aspekt do të kemi pjesën teknike të përfunduar, por duhet të përfundohen edhe të gjitha klasifikimet që vërtet fillojmë me zbatimin. Është çështje komplekse, nuk është vetëm veçori e Kosovës. Për shembull në Slloveni, reforma në sistemin e pagave ka zgjat 7 vjet dhe në ndërkohë janë plotësuar dhe ndryshuar ligjet disa herë, ndërsa ne dëshirojmë të fillojmë me zbatimin, me ndryshimin e sistemeve të pagave dhe ndërkohë të planifikojmë edhe plotësim-ndryshimin e ligjit, pra edhe për pagat e nëpunësve publikë, Ligjin e Administratës Shtetërore dhe Ligjin e shërbimit civil, krahas saj të hartojmë edhe Ligjin për pagat në sektorin publik si për arsim, shëndetësi dhe fusha tjera.

KRYESUESI: Konstatohet që koha e përcaktuar për pyetjet parlamentare ka përfunduar.

Kalojmë në pikën e tretë të rendit të ditës:

3. Miratimi i procesverbalit të seancës së mëparshme

Të nderuar deputetë, pyes keni vërejtje në procesverbalin e seancës plenare, të mbajtur më 23 janar 2014.

Nëse nuk ka vërejtje, konstatohet se Kuvendi e miratoi procesverbalin e seancës plenare, të mbajtur më 23 janar 2014.

Kalojmë në pikën e radhës, në pikën e katërt të rendit të ditës:

4. Shqyrtimi i Projektligjit për ratifikimin e Marrëveshjes për statusin e anëtarëve të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë dhe Forcës së Sigurisë së Republikës së Kosovës gjatë qëndrimit të tyre të përkohshëm në territorin e shteteve respektive

Konstatohet që të pranishëm janë 76 deputetë, e ndërkohë po vijnë edhe të tjerë. Unë do të propozoj që nëpërmjet një votimi elektronik ta kuptojmë më saktësisht se sa deputetë janë të pranishëm në sallë, për shkak se për votimin e kësaj pike nevojiten 2/3 e deputetëve, pra 80 deputetë.

Ju kisha lutur që t'i zini vendet tuaja dhe të përgatiteni për votim elektronik për praninë tuaj.

E ftoj regjinë të përgatitet për votim. Le të fillojë votimi!

Konstatohet se kemi numër të mjaftueshëm për të hyrë në këtë votim. Përpara kësaj, ia jap fjalën përfaqësuesit të Qeverisë së Republikës së Kosovës, ministrit të Forcës së Sigurisë së Kosovës, zotit Agim Çeku, si propozues i çështjes.

MINISTRI AGIM ÇEKU: I nderuar kryesues!

Të nderuar deputetë,

Ministria për Forcën e Sigurisë së Kosovës dhe Ministria e Mbrojtjes së Republikës së Shqipërisë, në kuadër të bashkëpunimit ndërshtetëror në fushën e sigurisë dhe të mbrojtjes, me qëllim të realizimit të bashkëpunimit të mirëfilltë dhe të rregullimit të statusit ligjor të forcave të sigurisë kanë arritur në përfundim të përbashkët për lidhjen e Marrëveshjes për statusin e forcave të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë dhe të Forcës së Sigurisë së Kosovës gjatë qëndrimit të tyre të përkohshëm në territorin e shteteve respektive, apo lidhjen e marrëveshjes të njohur si marrëveshja SOFA (Status of Force Agreement).

Duke pasur parasysh se një marrëveshje e tillë hyn në nivelin e marrëveshjeve ndërkombëtare, duke iu referuar nenit 4, paragrafit 2, nenit 5 dhe nenit 7, paragrafi 1 dhe 8 të Ligjit numër 04/L-052 për marrëveshje ndërkombëtare, ne kemi marrë pëlqimin e Ministrisë së Punëve të Jashtme për ta filluar procedurën e lidhjes së kësaj marrëveshjeje më 22.1.2013.

Mandej, Qeveria e Republikës së Kosovës, më 30.1.2013 ka marrë vendim për lidhjen e kësaj marrëveshjeje dhe Presidentja e Republikës së Kosovës më 18.6.2013 e ka autorizuar ministrin e Forcës së Sigurisë për nënshkrimin e kësaj marrëveshjeje.

Andaj, ministri për Forcën e Sigurisë së Kosovës dhe ministri i Mbrojtjes së Republikës së Shqipërisë, më 1 korrik 2013, në ambientet e Kazermës së FSK-së në Prizren kanë nënshkruar marrëveshjen për statusin e Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë dhe Forcës së Sigurisë së Kosovës në territorin përkatës.

Kjo marrëveshje rregullon procedurat e hyrjes, daljes, qëndrimit të përkohshëm dhe statusin e anëtarit të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë dhe anëtarët e FSK-së në territorin e shtetit përkatës, si dhe të personelit civil dhe personave në varësi.

Ky projektligj për ratifikim të kësaj marrëveshjeje obligohet nga dispozitat e Ligjit numër 04/L-052 për marrëveshje ndërkombëtare, respektivisht neni 7, paragrafi një, që u referohet procedurave për dhënien e autorizimit për lidhjen e marrëveshjeve ndërkombëtare të Republikës së Kosovës, që kanë të bëjnë me fushën e përcaktuar si në paragrafin 1 dhe nenin 10 të këtij ligji: territorin, paqen, aleancat, çështjet politike dhe çështjet ushtarake.

Andaj, sot para jush e paraqes Projektligjin për ratifikimin e kësaj marrëveshjeje, e cila është pjesë përbërëse e këtij ligji, shtojca 1, e keni të gjithë, dhe zbatohet ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Republikës së Shqipërisë.

Me qëllim të përmbushjes së obligimeve ligjore që dalin nga Ligji numër 04/L-052 për marrëveshjet ndërkombëtare, si dhe me qëllim të rregullimit të çështjeve të procedurave të hyrjes, daljes, qëndrimit të përkohshëm, statusit të anëtarëve të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë dhe anëtarëve të Forcës së Sigurisë së Kosovës në territorin e shtetit përkatës, si dhe të përbërësve civilë, apo personave në vartësi, Qeveria e

Republikës së Kosovës kërkon shqyrtimin dhe miratimin e këtij projektligji. Faleminderit!

KRYESUESI: E ftoj kryetarin e Komisionit FunkSIONAL, Ahmet Isufin, për arsyetimin e raportit me rekomandime.

AHMET ISUFI: Faleminderit, zoti kryesues!

Komisioni Parlamentar për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrje të Forcës së Sigurisë së Kosovës e ka shqyrtuar Projektligjin për ratifikimin e marrëveshjes për statusin e anëtarëve të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë dhe Forcës së Sigurisë së Republikës së Kosovës gjatë qëndrimit të tyre të përkohshëm në territorin e shteteve respektive.

Duke pasur parasysh se kemi të bëjmë me një ratifikim të marrëveshjes ndërkombëtare, komisioni ka vlerësuar se ky projektligj duhet të kalojë, i cili rregullon marrëdhëniet ndërmjet dy vendeve në aspektin e mbrojtjes dhe po ashtu përmirëson ose rregullon kushtet e qëndrimit të tyre në vendet respektive.

Prandaj, edhe në emër të komisionit, edhe në emër të Grupit Parlamentar të Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, konsideroj se është mirë ta miratojmë këtë projektligj për marrëveshje.

KRYESUESI: Tani është radha e përfaqësuesve të subjekteve politike, nëse duan ta marrin fjalën lidhur me këtë çështje. Nga Partia Demokratike e Kosovës, zoti Fatmir Xhelili e ka fjalën.

FATMIR XHELILI: Faleminderit, kryesues!

Përshëndetje për Kabinetin qeveritar,
Deputetë të nderuar,

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike gjithashtu e përkrah ratifikimin e kësaj marrëveshjeje, e cila ka normëzuar standardet dhe përcaktimet në mënyrë të qarkullimit, të sjelljes, përgjegjësisë dhe obligimeve të shtetit nikoqir për pjesëtarë të forcave të sigurisë të shtetit mysafir dhe obligimet dhe mënyrën e sjelljes dhe përgjegjësisë të pjesëtarëve të sigurisë, që janë me qëndrim të përkohshëm në vendin tjetër, përkatësisht në vendet reciproke dhe reciprociteti ka qenë një prej elementeve bazë të lidhjes së kësaj marrëveshjeje.

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike e përkrah përligjjen e kësaj marrëveshjeje që del si ligj për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë dhe Forcës së Sigurisë së Republikës së Kosovës gjatë qëndrimit të përkohshëm në vendet reciproke. Faleminderit!

KRYESUESI: Nga Lidhja Demokratike e Kosovës, fjalën e ka zonja Vjollca Krasniqi.

VJOLLCA KRASNIQI: Faleminderit, kryesues!

Përshëndetje për ministrat,

Kolegë deputetë,

Edhe Lidhja Demokratike e Kosovës, përkatësisht Grupi Parlamentar i saj e ka shqyrtuar Projektligjin për ratifikimin e marrëveshjes për statusin e anëtarëve të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë dhe Forcës së Sigurisë së Republikës së Kosovës gjatë qëndrimit të tyre të përkohshëm në territorin e shteteve respektive.

Natyrisht që ky bashkëpunim është i mirë për Forcën e Sigurisë së Kosovës në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë si element shumë i rëndësishëm për paqen dhe për stabilitetin në rajon, duke përcaktuar kështu procedurat e hyrjes, daljes, qëndrimit të përkohshëm të forcave në territorin e shteteve përkatëse.

Si Grup Parlamentar i LDK-së do të votojmë për miratimin e këtij projektligji. Mirëpo, më duhet të them që këto dy forca kanë misionë jo të njëjta.

Dje, në Komisionin për Mbikëqyrjen e Sigurisë të MPB dhe FSK-së, e kemi pasur një raport të Forcës së Sigurisë së Kosovës dhe komisioni e ka shqyrtuar raportin e vitit 2013.

Mund të them se të gjithë anëtarët e Komisionit kanë votuar për këtë raport dhe e kanë përgëzuar FSK-në për punën, angazhimin, performancën gjatë vitit që sapo e lamë pas. E përgëzuam edhe për besimin që i është dhënë nga qytetarët e Republikës së Kosovës, si organizmi më i besueshëm.

Mirëpo, të nderuar kolegë, deputetë dhe ministra, në këtë raport kemi pasur, tashmë veç e dimë, por më duhet të them, se sa deminime ka bërë FSK-ja, sa çaktivizime të mjeteve shpërthyes, sa ka ndihmuar në zgjerimin e rrugëve, në ndërtimin e urave, në ndërtimin e shtëpive, në misionë humanitare, shëndetësore e të natyrave të tilla.

Deri kur ministër kjo forcë do t'i punojë këto punë? Ju keni premtuar që do të angazhoheni maksimalisht për ndryshimin e misionit të Forcës së Sigurisë së Kosovës, me ç'gjë kjo marrëveshje do të kishte rëndësi edhe më të madhe. Faleminderit!

KRYESUESI: Nga Lëvizja “Vetëvendosje”, fjalën e ka zotëri Visar Ymeri.

VISAR YMERI: Faleminderit, nënkryetar!

Deputetë të Kuvendit të Republikës së Kosovës,

Edhe Lëvizja “Vetëvendosje”, dua ta them fillimisht, do ta votojë për ratifikimin e marrëveshjes në fjalë.

Mirëpo, natyrisht, konsiderojmë që kjo marrëveshje, edhe pse është e mirë në vetë, nuk është aspak e mjaftueshme për atë se çfarë Kosova ka nevojë, e veçanërisht në bashkëpunimin e Kosovës me Shqipërinë, pra bashkëpunim kombëtar në fushën e sigurisë dhe qëndrojnë ato që i tha deputetja e LDK-së për dallimin fundamental ndërmjet dy forcave, marrëveshjen e të cilave po e ratifikojmë këtu, por edhe me fuqinë që e kanë, e veçanërisht me kapacitetet ligjore që këto dy forca i kanë.

Është e domosdoshme që Kosova së pari ta ketë ushtrinë e vet mbrojtëse dhe për këtë mendoj që do të pajtoheshin të gjithë verbalisht, por nuk është se po i shoh që po veprojnë të gjithë në të njëjtin mënyrë për ta realizuar këtë.

Dhe, çështja tjetër, po aq e rëndësishme për Kosovën, është që ta kemi një marrëveshje të bashkëpunimit në fushën e sigurisë, veçanërisht marrëveshje për mbrojtje të dyanshme ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Republikës së Shqipërisë, e kjo marrëveshje do të ishte ajo që vërtet do t'i plotësonte edhe nevojat, por edhe domosdonë e bashkëpunimit ndërmjet dy shteteve sa i përket kësaj fushe. Faleminderit!

KRYESUESI: Nga Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës, zoti Isufi ka folur më herët. Nga Koalicioni Kosova e Re, fjalën e ka kryetarja e Grupit, Myzejene Selmani.

MYZEJENE SELMANI: Faleminderit, zoti kryesues!

Duke marrë parasysh prezantimin e ministrit të FSK-së në lidhje me Projektligjin i cili e ratifikon marrëveshjen për statusin e anëtarëve të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë dhe Forcës së Sigurisë së Republikës së Kosovës gjatë qëndrimit të tyre të përkohshëm në territoret e shteteve respektive, mund të themi se ratifikimi i një ligji të tillë - ligj i marrëveshjes, Koalicioni për Kosovë të Re do t'i japë përkrahje.

Mirëpo, në fakt, do të ketë punë për të dyja shtetet për çështjen e zbatueshmërisë viza-vijë me NATO-n, kur dihet se ky Projektligj për ratifikimin e marrëveshjes së SOFTA-s ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Kosovës nuk do të ketë kosto gjatë implementimit, mirëpo çështja është se të dyja shtetet do të kenë mundësi që të kenë ndoshta akoma punë derisa të vijë çështja e ratifikimit të kësaj marrëveshjeje.

Koalicioni për Kosovë të Re do t'i japë përkrahje dhe njëkohësisht kërkojmë që ndoshta të jetë prania e 81 deputetëve se ndryshe nuk mund të kalojë kjo marrëveshje. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Nga Grupi Parlamentar SLS nuk ka të paraqitur. Nga Grupi Parlamentar "6+", zoti Rasim Demiri e ka fjalën.

RASIM DEMIRI: Hvala predsedavajući!

I Parlamentarna grupa "6+" razmotrila je zakona o ratifikaciji Sporazuma o statusu članova Oružanih snaga Republike Albanije i Bezbednosne snage Kosova tokom njihovog privremenog boravka na teritoriji respektivnih država. Tako da ćemo svoj doprinos dati u daljem radu i glasaćemo za ovaj Nacrta zakona. Hvala!

KRYESUESI: Nga deputetët, fjalën e ka kërkuar deputetja zonja Alma Lama.

ALMA LAMA: Faleminderit, zoti kryesues!

Në fakt, është një nga gjërat e rralla që do ta përshëndesja nga ato që ka bërë Ministria e FSK-së, pas vërejtjeve të mëdha që kanë pasur më herët në lidhje me ata që punojnë aty.

Pa dyshim që bashkëpunimi në ushtri duket si më i vështiri ndërmjet Shqipërisë dhe Kosovës dhe gjithsesi tejkalimi i këtij ngërçi të deritanishëm mendoj që duhet përshëndetur dhe ky bashkëpunim duhet të shtrihet edhe në fusha të tjera, jo vetëm në ministrinë përkatëse, për të cilën ne po flasim dhe do të ratifikohet kjo marrëveshje, por edhe në të gjitha ministritë e tjera homologe, në mënyrë që bashkëpunimi të rritet dhe të integrohemi më shumë si një komb i vetëm. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Të tjerë të paraqitur nuk ka. Por, në ndërkohë e shohim që shumë deputet kanë lëvizur dhe numri aktual të pranishmëve është vetëm 67. Për votimin e këtyre marrëveshjeve na duhen 80 deputetë, kështu që kërkoj edhe një herë t'i thirrni deputetët në sallë.

Meqë në sallë nuk kemi numër të mjaftueshëm të deputetëve për ta votuar marrëveshjen, atëherë propozoj të kalojmë në pikën e pestë të rendit të ditës:

5. Shqyrtimi i Projektligjit për ratifikimin e Marrëveshjes për hua dhe financim ndërmjet KFW Frankfurt Am Main, Republikës së Kosovës dhe Operatorit të Sistemit, Transmisionit dhe Tregut KOSST për përmirësimin e rrjetit të transmisionit

Komisioni për Buxhet dhe Financa e ka shqyrtuar Projektligjin për ratifikimin e Marrëveshjes dhe Kuvendit ia ka rekomanduar për miratim.

E ftoj përfaqësuesin e Qeverisë, ministrin e Financave, zotëri Besim Beqaj, si propozues të çështjes, që ta marrë fjalën.

MINISTRI BESIM BEQAJ: Faleminderit, shumë i nderuar kryesues!

Të nderuar ministra,

Të nderuar deputetë,

Në kuadër të bashkëpunimit ekonomik ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Gjermanisë, sipas marrëveshjes kornizë të bashkëpunimit, ne për çdo vit, pas negociatave ndërqeveritare, nënshkruajmë protokollet, ku përcaktohen fushat konkrete të bashkëpunimit.

Këtu përfshihen shumë sektorë në zhvillimin ekonomik dhe shoqëror të vendit.

Ministria e Financave ka bërë nënshkrimin e një marrëveshjeje financiare me Bankën Gjermane për Zhvillim, e cila do ta mbështesë investimin në rrjetin e KOSST-it.

Me këtë marrëveshje, Qeveria e Kosovës do të huazojë nga KFW 20,5 milionë euro dhe do të pranojë nga Komisioni Evropian 3 milionë euro kontribut financiar. Më pastaj e tërë shuma do të nënhuazohet te KOSST-i.

Këto mjete janë të dedikuara për modernizimin e nënstacioneve në Prishtinë, Pejë, Ferizaj dhe Deçan. Po ashtu, do të bëhet instalimi i pajisjeve moderne në linjat interkonjektive.

Deri më tani, Ministria e Financave ka nënshkruar me Bankën Gjermane edhe marrëveshje për linjën e transmissioinit me Shqipërinë, vlera e së cilës arrin në 33 milionë euro, 17 milionë janë kredi, ndërsa 16,5 milionë janë grante, e cila po ashtu është nënhuazuar në KOSST.

Ndërmarrja publike KOSST është ndërmarrje, e cila realizon kthim pozitiv, por që ka nevojë për investime në infrastrukturë dhe ka pasur një bashkëpunim të shkëlqyeshëm deri më tani lidhur me bashkëpunimin në formën e huamarrjes nga KFW, investimeve të përbashkëta, qoftë edhe me Komision Evropian.

Ministria e Financave, sipas kërkesave të KOSST-it, ka vendosur që t'i mbështesë investimet e tilla dhe në të ardhmen e afërt, qoftë edhe nëpërmjet Komisionit Evropian, BERZH-it, apo institucioneve tjera financiare.

Pra, e kemi një ndërmarrje, e cila është ndërmarrje publike dhe e cila ka kërkuar nga Ministria e Financave një hua që shkon për ndërmarrjen. Kredia duhet të merret nga shteti nëpërmjet agjentit fiskal, që është Ministria e Financave, dhe ajo kredi do të nënhuazohet te KOSST-i.

Pra, ju bëj thirrje deputetëve që ta miratojmë një marrëveshje të tillë dhe që KOSST-i pastaj të fillojë me investime të parapara, në bashkëpunim me gjermanët, por njëkohësisht këtu është përfshirë dhe granti prej 3 milionë eurosh nga Komisioni Evropian. Faleminderit!

KRYESUESI: Me sa po e shoh, këtu nuk ndodhet kryetarja e Komisionit FunkSIONAL, Safete Hadergjonaj, për arsyetimin e raportit me rekomandime. Por, nëse dëshiron dikush tjetër, në emër të Komisionit, ta marrë fjalën. Zonja Jelena Bontiq e ka fjalën.

JELENA BONTIĆ: Hvala predsedavajući!

Uvaženi članovi Vlade,

Poštovani kolegnici i kolege,

Nacrt zakona o potvrđivanju Sporazuma o pozajmici i finansiranju između KFW Frankfurt Am Main, Vlade Kosova i Operatora sistema, transmisije i tržišta KOSST, ima za cilj finansiranje i poboljšavanje prenosa mreže.

Sporazum je potpisan između Nemačke banke za razvoj KFW Frankfurt Am Main, Vlade Kosova, koja je zastupljena od Ministarstva finansije kao zajmoprimac i Operatera sistema transmisije i tržišta KOSST-a kao agencije za izvršenje projekta.

Na osnovu sporazuma, Nemačka banka za razvoj kao zajmodavac daje sredstva u iznosu od 23 miliona i 500 hiljade evra, koja se sastoje od pozajmice u iznosu od 20 miliona i 500 hiljada evra i finansijskog doprinosa od 3 miliona evra.

Ministarstvo finansije kao zajmoprimac je ovlašćena na osnovu Sporazuma za podzajmodavac koji je pripoen ovom Nacrtu zakona za Operatorom sistema transmisije tržišta kao agencije za izvršenje projekta da snosi u celini finansijski doprinos i zajam

kod ovog operatera koji je obavezan da poštuje uslove i da vrati zajam prema predviđenim rokovima u ovom sporazumu.

Ovaj sporazum ne proizvodi dodatni budžetski implikacije za budžet Kosova, budući da obaveze vraćanja prima Operator sistema, transmisije i tržišta, što je javna kompanija.

Što se tiče finansijskog KOSST-a i uslovima vraćanja, što je u odgovornosti agencije za izvršenje projekta KOSST, zajmoprimac neće isplatiti kamatu za finansijski doprinos, a isplatiće kamate o zajmu. Takođe, zajmoprimac će isplatiti godišnju nepovratnu kamatu angažovanja od 0,25% u iznosima nenadoknađivanje pozajmice. Kamata će se platiti tri meseca nakon stupanja na snagu ovog sporazuma.

Zajmoprimac će isplatiti KFW-u takođe paušalne kamate nepovoljnog menadžiranja od 1% iznosa glavnog duga, što je u iznosu od 155 hiljade evra.

Povratak pozavnicu će se izvršiti u dva dela, uključujući prvi i drugi deo pozajmice.

Što se tiče povratka prvog dela pozajmice, u iznosu od 5 miliona evra, imaćemo jedan sivi period do 20.12.2023. godine, datum kada počinje povratak pozajmice po ratama koja će biti šestomesečna, i brisanje poslednje rate pozajmice je predviđeno izvršiti do 30.12.2023. godine.

Povratak drugog dela pozajmice u iznosu od 15 miliona i 500 hiljada evra će se izvršiti na 19 rata, koja će biti jednake, a prva rata će se izvršiti šest meseci nakon sprovođenja projekta, a ne kasnije od 13 decembra 2016. godine.

Komisija za budžet i finansije je na sednici, održana 22.1.2014. godine, razmotrila i preporučuje Skupštini da usvoji Nacrta zakona o potvrđivanju Sporazuma o pozajmici i finansiranju između KFW Frankfurt Am Main, Vlade Kosova i Operatora sistema, transmisije i tržišta KOSST-a i poboljšavanju prenosne mreže.

U jedno govorim i ispred Poslaničke grupe Samostalne liberalna stranka, mi ćemo takođe ovaj sporazum podržati i glasaćemo za njegovo usvajanje. Hvala!

KRYESUESI: Tash është radha e grupeve parlamentare. Në emër të Partisë Demokratike të Kosovës, zonja Hasime Krasniqi e ka fjalën.

HASIME KRASNIQI: Faleminderit, zoti kryesues!

I nderuar Kabinet qeveritar,

Të nderuar kolegë dhe kolege deputete,

Edhe Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike e ka shqyrtuar dhe analizuar Projektligjin për ratifikimin e marrëveshjes dhe do të jemi pro, duke pasur parasysh rëndësinë që ka realizimi i kësaj huaje për investimet në infrastrukturë për t'i mbështetur nevojat zhvillimore.

Me këtë projektligj kemi të bëjmë me një marrëveshje për nënhuazim, që do të thotë se pagesën e kësteve dhe të interesit do të bëjë ndërmarrja publike KOSST, ndërsa Qeveria e Republikës së Kosovës e ka realizuar këtë marrëveshje për arsye se ndërmarrja publike KOSST nuk ka të drejtë të hyjë dhe të realizojë këso lloj kredie.

Duke pasur parasysh se kjo do të jetë një ndihmesë që do t'i jepet kësaj ndërmarrjeje, e cila edhe në vitet e kaluara, e ka pasur një afarizëm pozitiv në qarkullimin e saj dhe besojmë që kjo hua që do të realizohet do të jetë edhe në interes të kësaj kompanie dhe të zhvillimit të Kosovës, në përgjithësi. Faleminderit!

KRYESUESI: Në emër të Lidhjes Demokratike të Kosovës, zonja Hykmete Bajrami e ka fjalën.

HYKMETE BAJRAMI: Faleminderit, kryesues!
Edhe Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike e përkrah marrëveshjen. Faleminderit!

KRYESUESI: Nga Lëvizja “Vetëvendosje”, zotëri Visar Ymeri e ka fjalën.

VISAR YMERI: Faleminderit, nënkryetar!
Grupi Parlamentar i Lëvizjes “Vetëvendosje” do të votojë për ratifikimin e kësaj marrëveshjeje, sepse e konsiderojmë, në njërën anë, që intervenimet në rrjetin e transmisionit janë domosdoshme dhe shumë të dobishme për ekonominë e Kosovës. Ndërkohë që, në anën tjetër, ekziston një praktikë, të them ashtu, e përfitimeve të mira në bashkëpunimin që Kosova e ka pasur veçanërisht me Bankën Gjermane për Zhvillim dhe me këtë drejtim konsiderojmë që kjo marrëveshje është e kënaqshme në të dyja këto aspekte. Faleminderit!

KRYESUESI: Nga Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës, Xhevdet Neziraj e ka fjalën.

XHEVDET NEZIRAJ: Faleminderit!
I nderuar zoti nënkryetar,
Kolegë deputetë,
Ministra,
Edhe Grupi i Aleancës do ta përkrahë këtë hua, e cila shkon në drejtim të zhvillimit ekonomik, sidomos në lëmin e energjetikës, dhe besoj që në dekadën e ardhshme do të kemi 24 orë rrymë pandërprerë, për arsye se në Pejë kanë filluar reduktimet bukur të mëdha.

Ndoshta me këtë kredi dhe me zhvillim në infrastrukturë të energjetikës do ta kemi këtë sektor shumë më të mirë dhe qytetarët nuk do të ballafaqohen me probleme të rrymës. Faleminderit!

KRYESUESI: Nga Koalicioni Kosova e Re, fjalën e ka shefja e Grupit Parlamentar Koalicioni Kosova e Re, zonja Myzejene Selmani.

MYZEJENE SELMANI: Faleminderit!

I nderuar nënkryetar i Kuvendit,
Përshëndetje për ministrat dhe deputetët,
Duke marrë parasysh përvojën time në dy mandate si deputete e këtij Kuvendi, më vjen mirë që njëri nga ministrat e mandatit të kaluar është këtu.

Ne e patëm ratifikuar edhe një marrëveshje për hua financiare nëpërmjet Bankës së Frankfurtit me Republikën e Shqipërisë dhe atë ditë kur është mbajtur ajo mbledhja ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Qeverisë së Shqipërisë, besoj që ju dy ministrat që jeni këtu të pranishëm i keni dhënë ndoshta sugjerimet tuaja dhe idetë më të mira që huat, në rast se i marrim, për realizimin e projekteve madhore, siç ka qenë linja 400-kilovotëshe me Shqipërinë, dhe ajo ka mbetur peng, nuk kemi nevojë fort për patriotizëm ndërmjet dy shteteve, por kemi nevojë për realizim të projekteve dhe uroj që Qeveria e Kosovës dhe Qeveria e Shqipërisë të shkojnë në projekte konkrete drejt liberalizimit të tregut në bazë të direktivave të BE-së, ngase kemi shumë mangësi.

Ndërsa ky projektligj për ratifikimin e marrëveshjes për hua sot, në lidhje me Operatorin e Sistemit të Transmisionit dhe Tregut KOSST është i mirëseardhur, mirëpo jo që na jep mundësi ne që të kemi furnizim më të mirë me energji elektrike. Është çështja e linjave të larta. Mirëpo, prapëseprapë besoj që pas marrëveshjes teknike ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, KOSST-i vetëm e ka fituar një garë dhe kjo ndoshta jep mundësi që në të ardhmen t'i kthehen të gjitha dëmet që i janë bërë nga transmissioni i Serbisë.

Koalicioni Për Kosovë të Re jep përkrahje dhe shpresojmë që do të realizohen këto ratifikime të marrëveshjeve dhe të mos na ndodhë si në mandatin e kaluar, kur e patëm pasur një ratifikim të këtij lloji, mirëpo në fakt nuk u realizua nga shteti Shqiptarë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Nga Grupi Parlamentar SLS nuk ka të paraqitur. Nga Grupi Parlamentar “6+” nuk ka të paraqitur.

Atëherë kërkoj edhe një herë ta verifikojmë numrin e saktë të deputetëve të pranishëm në sallë. I kemi vetëm 67 deputetë të pranishëm. Nuk ka numër të mjaftueshëm për votimin as të kësaj marrëveshjeje të radhës, kështu që mbetet që për këto dy marrëveshje, të cilat vetëm u shqyrtuan dhe për të cilat pati diskutime, votimi të bëhet, qoftë më vonë, kur ta arrijmë numrin e deputetëve të nevojshëm, qoftë në njërën prej seancave të ardhshme.

Kalojmë në pikën e gjashtë të rendit të ditës:

6. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për Shërbimin Gjeologjik të Kosovës

Projektligji është propozuar nga Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri.

Qeveria e Kosovës, brenda afatit të përcaktuar, e ka paraqitur mendimin lidhur me Projektligjin për Shërbimin Gjeologjik të Kosovës, me të cilin pajtohet për iniciativën e ndërmarrë nga Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri.

Në bazë të nenit 56 të Rregullores së Kuvendit, Komisioni FunkSIONAL e ka shqyrtuar Projektligjin dhe Kuvendit ia ka rekomanduar për miratim në parim.

E ftoj kryetarin e Komisionit, deputetin Zenun Pajaziti, në cilësinë e propozuesit, që para deputetëve të Kuvendit ta paraqesë dhe ta arsyetojë projektligjin.

ZENUN PAJAZITI: Faleminderit, zoti kryesues!

Ministra, kolegë deputetë,

Ky është një projektligj, ashtu siç e tha kryesuesi i seancës, një nismë e Komisionit për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri, një nismë e radhës. Kemi pasur edhe rast tjetër që të bëjmë iniciativa për hartimin e projektligjeve të reja.

Më mbetet t'i falënderoj të gjithë deputetët që janë angazhuar dhe të gjithë ata që kanë mbështetur në hartimin e këtij drafti që e kemi sot këtu, përfshirë edhe Qeverinë, edhe organizatat tjera që na kanë mbështetur, e veçanërisht grupin punues të deputetëve që kanë punuar një kohë rekorde, në mënyrë që ta kemi tash këtë projektligj, një grup punues i kryesuar nga zonja Sala Berisha-Shala.

Mendojmë që projektligji i përmban të gjitha standardet edhe është i bazuar, është punuar deri tash me modelet më të mira. Kosovës i ka munguar një institucion i tillë. Komisioni, pasi e ka konsultuar tashmë edhe Qeverinë, e ka marrë edhe një miratim se janë institucionet relevante, edhe Qeveria, edhe Komisioni për Miniera dhe Minerale. Mendojmë që tashmë në fazën tjetër deputetët, grupet punuese, grupet politike ta japin mbështetjen dhe po ashtu ta bëjmë sa më të mirë, sepse po them edhe një herë - është një ligj krejtësisht i ri, nuk kemi pasur deri më tash që të formohet një institucion i ri.

Jemi dakorduar me të gjitha institucionet dhe besoj që do të na shkojë mirë në finalizim. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Tash e hap debatin për diskutim në parim. Në emër të Partisë Demokratike të Kosovës, fjalën e ka deputetja, zonja Sala Berisha-Shala.

SALA BERISHA-SHALA: Faleminderit, nënkryetar i Kuvendit!

Të nderuar deputetë të Parlamentit të Kosovës,

I nderuar zoti ministër i Zhvillimit Ekonomik,

Kabinet qeveritar,

Ju të pranishëm,

Sot, me miratimin e këtij projektligji, gjeologjia e Kosovës e ka një adresë. Kjo adresë është Shërbimi Gjeologjik i Kosovës.

Janë bërë shumë përpjekje për të ardhur deri këtu. Deri sot pjesërisht ky segment ka funksionuar i shkapërderdhur nëpër institucione të ndryshme, siç është Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale, Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, Ministria e Zhvillimit Ekonomik e tjerë.

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike, edhe nëpërmjet deputetëve të tij dhe si iniciues i kësaj nisme ligjore, e mbështet në parim dhe kontributin e vet do ta japë vazhdimisht gjatë fazës së amendamentimit.

Që në fillim, më lejoni të them që në këtë rast unë si gjeologe ndihem e nderuar nga kolegët e mi deputetë për mbështetjen që ma kanë dhënë me rastin e kësaj nisme ligjore për Shërbimin Gjeologjik të Kosovës, andaj dua t'i falënderoj anëtarët e Komisionit për Zhvillim Ekonomik, Tregti dhe Infrastrukturë që më mbështetën unanimisht me këtë ide për gjeologjinë e Kosovës.

Të nderuar deputetë,

Kosova është e pasur me resurse minerale. Ato presin dorën e institucioneve për valorizim, presin të kthehen në favor të zhvillimit ekonomik. Për të ardhur deri te kjo, duhet fuqizim i institucioneve që merren me hulumtime gjeologjike. Hulumtimet gjeologjike e paraqesin bazën themelore në përcaktimin e rezervave gjeologjike dhe shfrytëzimin racional të resurseve natyrore, të cilat kanë nevojë për rregullim ligjor për t'i mbrojtur interesat e shtetit për një zhvillim të qëndrueshëm.

Studimet gjeologjike në përgjithësi dhe studimet gjeologjike hulumtuese në veçanti si proces u paraprijnë lëmenjve tjerë të industrisë dhe japin mundësi për t'i zgjeruar njohuritë e veprimtarive shkencore aplikative që, në instancë të fundit, ndihmojnë zhvillimin ekonomik të vendit, si dhe kanë ndikim të drejtpërdrejtë socio-ekonomik në shoqëri. Hartimi dhe nxjerrja e këtij ligji për Shërbimin Gjeologjik të Kosovës do ta plotësojë zbrazëtinë ligjore, me çka do të fuqizohet korniza institucionale në përmirësimin e kërkimeve dhe hulumtimeve shkencore-gjeologjike dhe aplikative në përputhje me kërkesat e tanishme dhe perspektivën e ardhshme të shoqërisë.

Nxjerrja dhe aprovimi i Ligjit për Shërbimin Gjeologjik do t'u ofrojë mundësi institucioneve të Republikës së Kosovës dhe partnerëve të shoqërisë, ku përfshihen industria nxjerrëse dhe investitorët privatë për studimin e parametrave të argumentuar gjeo-shkencorë të cilësisë së sigurt për t'i caktuar orientimet e investimeve dhe drejtimet e zhvillimit ekonomik të vendit.

Të nderuar deputetë,

Objekti i veprimtarisë së Shërbimit Gjeologjik të Kosovës do të jetë: studimet gjeologjike sistematike të vendit; studimet gjeofizike e gjeokimike të çdo shkalle; monitorimi sistematik i tërmeteve; vlerësimi i rrezikut sizmik dhe mikro-sizmik të territorit të Kosovës; kërkimi dhe vlerësimi i mineraleve metalore e jometalore, burimeve ujore nëntokësore, burimeve për ujërat e pijshëm dhe industriale; burimeve të ujërave mineral dhe gjeotermal; studimet e hidro-gjeologjike për vlerësimin e zonave akuipere dhe përcaktimin e masave për ruajtjen e rezervave ujore; studimet gjeologjike për gjeomjedisin; studimet gjeologo-inxhinierike; studimet agrogjeologjike dhe erozionin, krijimi i bazës së të dhënave gjeologjike të mineraleve të dobishme, vënia e tyre në dispozicion të organeve të pushtetit qendror dhe lokal dhe subjekteve të tjera të interesuara për investime; përgatitja, publikimi dhe komercializimi i informacioneve gjeologjike.

Kosova aktualisht nuk e ka një shërbim gjeologjik funksional, i cili do ta përmbushë hapësirën e hulumtimeve në gjeologji në tërësi. Më lejoni t'ua përkujtoj se Shërbimi Gjeologjik i Britanisë së Madhe si rezultat i shqyrtimit dhe analizave që ka bërë në vitin 2005 u ka rekomanduar fuqishëm institucioneve të Republikës së Kosovës krijimin e një shërbimi gjeologjik të pavarur dhe transparent të modeluar sipas normave evropiane, duke pasur rolin dhe misionin si në vijim.

Shërbimi Gjeologjik ka mision ta luajë rolin e tërheqjes së investimeve të huaja, të drejtpërdrejta në sektorin e burimeve natyrore të Kosovës, si dhe plotësimin e nevojave të vendit. Kosova e ka një gamë të gjerë të resurseve natyrore, në veçanti atyre minerale me potencial të madh ekonomik dhe mundësitë e zbulimeve të reja, duke i shfrytëzuar teknikat moderne të hulumtimit.

Sidoqoftë, investuesit potencialë kërkojnë një burim të besueshëm të informatave relevante gjeo-shkencore për investim të kapitalit të tyre. Ky burim i informatave bazë të të dhënave është roli kryesor i Shërbimit Gjeologjik, i rekomanduar për tërheqjen e investitorëve.

Të nderuar deputetë,

Aprovimi i Ligjit për Shërbimin Gjeologjik të Kosovës do të ketë ndikim pozitiv afatshkurtër, afatmesëm dhe afatgjatë në zhvillimin e qëndrueshëm të vendit. Themelimi i Shërbimit Gjeologjik do të sjellë rezultate në drejtim të rritjes së koeficientit të hulumtimeve, mundësive të reja të zbulimeve të mineraleve të dobishme, vlerësimin real të rezervave dhe pasurive natyrore konform standardeve botërore evropiane në vlerësimin dhe menaxhimin e qëndrueshëm të resurseve natyrore. Do të ketë përmirësime cilësore më të larta dhe informacione shkencore të besueshme. Informacionet dhe të dhënat e tilla do të sistemohen në kuadër të gjeo-databazës, të cilat do të mundësojnë qasje të shpejtë në procesin e vendimmarrjes.

Produktet shkencore, studimet, projektet, hulumtimet, hartat gjeologjike, monografite e tjera, do të jenë në përdorim të drejtpërdrejtë të organeve të planifikimit, si dhe subjekteve të ndryshme shtetërore administrative e private. Gjeo-shkenca është shkencë multidisiplinare. Zhvillimi i saj kërkon vullnet politik, kërkon dije e përkushtim, në mënyrë që të reflektohen efektet e saj në jetën e qytetarit, jo vetëm nëpërmjet zhvillimit ekonomik e mirëqenie sociale, por edhe në dimensionet tjera, siç është, bie fjala, siguria.

Shërbimi Gjeologjik mbulon edhe gjeo-rreziqet. Më lejoni të sqaroj se gjeo-rreziqet në Kosovë janë të pranishme dhe Kosova shumë herë u është ekspozuar këtyre fenomeneve natyrore, siç janë dridhjet e tokës (jemi dëshmitarë të dridhjes së tokës kohëve të fundit në Vushtrri), rrëshqitjet në akset rrugore, ortekët, rasti i Restelicës, vërshimet, dalja e lumenjve nga shtrati, që të gjitha kanë impakt - ndikim të rëndësishëm në sferën sociale dhe të sigurisë, në sferën ekonomike dhe strategjike.

Pra, ngritja e kapaciteteve të Shërbimit Gjeologjik të Kosovës është kërkesë, është nevojë imediate me karakter nacional. Nëse i marrim praktikën e vendeve, shteteve të zhvilluara, i tërë kapitali i tyre ekonomik është bazuar në fazën fillestare mbi zhvillimin e gjeo-

shkencës dhe shfrytëzimin e tyre. Jam e bindur se Shërbimi Gjeologjik që po themelohet sot do të jetë shtysë dhe katalizator i zhvillimit ekonomik të shtetit.

Prandaj, të nderuar kolegë deputetë, ju ftoj që ta mbështetni në parim dhe ftoj që angazhimin tuaj ta jepni gjatë fazës së amendamentimit të këtij projektligji. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Nga Lidhja Demokratike e Kosovës, deputeti Lutfi Zharku e ka fjalën.

LUTFI ZHARKU: Faleminderit, nënkryetar!

Të nderuar ministra,

Kolegë deputetë,

Edhe LDK-ja në parim e përkrah avancimin institucional të Agjencisë në Shërbimin Gjeologjik të Kosovës, duke marrë parasysh rëndësinë e madhe që kanë burimet tona natyrore për zhvillimin ekonomik të vendit. Duke marrë parasysh që na si deputetë e kemi propozuar këtë projektligj, nuk besoj se është vendi që të hyjmë në detaje të punës sonë, por vetëm ta përkrahim në parim. Faleminderit!

KRYESUESI: Nga Lëvizja “Vetëvendosje”, zotëri Visar Ymeri e ka fjalën.

VISAR YMERI: Faleminderit, nënkryetar!

Edhe Grupi Parlamentar i Lëvizjes “Vetëvendosje” do ta mbështesë në parim këtë projektligj. Është e qartë që me këtë projektligj, pra me themelimin e Shërbimit Gjeologjik të Kosovës po bëhet një lloj përqendrimi i përgjegjësi që ka jetuar, të them ashtu, në dy institucione të ndara. Në njërën anë, pra ka qenë Agjencia Gjeologjike e Kosovës, e cila me këtë ligj i ka detyrat dhe të drejtat e së cilës shfuqizohen me nenin 15, dhe, në anën tjetër, kanë qenë edhe ato dispozitat ligjore të Ligjit për miniera dhe minerale, e kështu me radhë, për krijimin e një instituti, edhe të Institutit Gjeologjik të Kosovës dhe Rregullorja për organizimin e funksionimit të tij, e cila po ashtu shfuqizohet pastaj me nenin pas-rendës, me nenin 16 të ligjit ose të projektligjit për të cilin po flasim, dhe në këtë drejtim konsiderojmë që, meqenëse shërbimi do të jetë pra i rëndësishëm, natyrisht për sektorin minerar, në veçanti të Republikës së Kosovës, do të duhej që t’i ketë edhe disa çështje tjera të definuara, në mënyrë që të jetë sa më gjithëpërfshirës.

Pra, me gjithë faktin që e përkrahim në parim këtë ligj, mendojmë se ka hapësirë për t’u plotësuar dhe për t’u bërë më i mirë dhe këtu do t’i kisha përmendur disa prej atyre çështjeve që do të duhej të përmbledheshin në ligj, si detyrat dhe të drejtat e këtij shërbimi gjeologjik.

Pra, duhet që të sanksionohen kushtet dhe mënyra e realizmit të hulumtimeve gjeologjike të mineraleve dhe të resurseve gjeologjike. Pastaj, hulumtimet fillestare gjeologjike, me qëllim të identifikimit të hapësirave të mundshme me resurse minerale, hulumtimet e detajuara gjeologjike, apo ato aplikative, siç quhen, hulumtimet gjeologjike për planifikim hapësinor dhe urban, klasifikimi i resurseve dhe i rezervave minerale, resurset metalike, jometalike, resurset fosile, ujërat nëntokësore e tjera; licencimi i zonave hulumtuese, kriteret e lëshimit të licencës e tjera; dokumentet gjeologjike, elaborati i

resurseve dhe rezervave minerale, verifikimi dhe aprovimi i raportit vjetor dhe raportit përfundimtar.

Pastaj duhet të sanksionohet edhe kush mund të jetë bartës i hulumtimeve, i mbikëqyrjes, verifikues i hulumtimeve e kështu me radhë; hulumtimet në zonat e mbetura natyrore me hapësirat me rëndësi kulturore, historike, turistike dhe retroaktive, gjë që duhet të figurojnë në ligj; strategjia për zhvillimin afatgjatë të hulumtimeve afatgjate, si dhe planeve dhe programeve me të cilat rregullohet mënyra dhe dinamika e realizimit të strategjisë.

Konsiderojmë që këto çështje do ta plotësonin dhe do ta bënin shumë më funksional, shumë më të mirë, më të dobishëm dhe më të mbikëqyrshëm, të them ashtu, zbatimin e këtij ligji, dhe, në anën tjetër, do ta plotësonin dhe drejtonin për të mirë punën e Shërbimit Gjeologjik të Kosovës. Faleminderit!

KRYESUESI: Nga Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës, fjalën e ka deputeti Ramiz Kelmendi.

RAMIZ KELMENDI: I nderuar kryesues!

Kabinet qeveritar,

Kolegë deputetë,

Edhe Grupi i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës do ta mbështesë në parim këtë projektligj dhe do të marrë pjesë aktive në themelimin e këtij ligji në funksion të zhvillimit ekonomik të Kosovës. Faleminderit!

KRYESUESI: Fjalën e ka kryetarja e Grupit Parlamentar Koalicioni për Kosovë të re, zonja Myzejene Selmani.

MYZEJENE SELMANI: Faleminderit, i nderuar nënkryetar!

Duke marrë parasysh se Projektligji për Shërbimin Gjeologjik të Kosovës ka filluar të punohet në Komisionin Parlamentar për Zhvillim Ekonomik, Koalicioni për Kosovë të Re i ka dhënë përkrahje edhe në fillim komisionit gjatë amendamentimit të këtij draft-projektligji, kështu që ne e përkrahim Projektligjin për Shërbimin Gjeologjik dhe të gjitha të dhënat të tjera, në rast se duhet të plotësohet akoma në amendamentim, ne do të japim përkrahje në Komisionin Parlamentar. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Nga grupi Parlamentar SLS më duket se nuk ka të paraqitur. As nga Grupi parlamentar “6+”. Fjalën e ka deputetja Justina Shiroka-Pula.

JUSTINA SHIROKA-PULA: I nderuar kryesues!

Kabinet qeveritar,

Të nderuar deputetë,

Hartimi i Projektligji për Shërbimin Gjeologjik duhet t'i hapë rrugë zhvillimit të gjithëmbarshtëm ekonomik të vendit, duke krijuar bazë të mirëfilltë ligjore për një konkurrencë të drejtë për të gjithë pjesëmarrësit në këtë fushë.

Hartimi i këtij projektligji ka rëndësi të veçantë, ngase Ligji mbi kërkimet gjeologjike, që e rregullonte këtë çështje, dhe as Ligji i minierave dhe mineraleve nuk e kanë mbuluar në tërësi fushën e shërbimeve dhe hulumtimeve gjeologjike.

Mosrespektimi ligjor i shërbimeve dhe hulumtimeve gjeologjike në territorin e Republikës së Kosovës ka ndikuar drejtpërdrejt dhe është reflektuar në hulumtime dhe shfrytëzimet e pakontrolluara dhe të paplanifikuara të resurseve minerale.

Pra, ky ligj duhet t'i plotësojë zbrazëtitrat ligjore për furnizimin e institucioneve shtetërore për përmirësimin e vazhdueshëm të problematikës kërkimore, hulumtuese dhe aplikative sipas kërkesave të tanishme dhe perspektive të shoqërisë.

Projektligji për Shërbimin Gjeologjik duhet t'i përcaktojë kriteret, procedurat dhe mënyrën e kryerjes së projekteve, studimeve, kushteve të shërbimeve për realizimin e hulumtimeve gjeologjike, testimet laboratorike, ruajtjen dhe aktivimin e dokumentacionit gjeologjik, si dhe mbikëqyrjen e zbatimit. 'Asqui'-të e BE-së nuk e specifikojnë legjislacionin e veçantë për këtë fushë, mirëpo parimet e përgjithshme në fushën gjeologjike dhe aktivitetet në fushën e bashkëpunimit evropian dhe ndërkombëtar mund të gjenden në komisione për menaxhimin e aplikacioneve të informacioneve të gjeo-shkencës.

Prandaj, ky projektligj nuk i cenon parimet themelore të legjislacionit të BE-së. Statusi i preferuar për shërbimet gjeologjike është si shërbim i pavarur publik dhe si i tillë funksionon në regjione dhe më gjerë. Si për shembull: Shërbimi Gjeologjik i Shqipërisë është person juridik publik, buxhetor, organ këshillimor, teknik i shtetit, që me porosi të tij kryen veprimtari gjeologjike në territorin e Republikës së Shqipërisë. Instituti i Gjeologjisë të Kroacisë - të drejtat dhe detyrat bëhen në Ministrinë e Shkencës, Arsimit dhe të Sportit. Instituti Gjeologjik i Malit të Zi është institucion shtetëror në kuadër të Ministrisë së Ekonomisë, e cila merret me hulumtimet gjeologjike.

Instituti Gjeologjik i Rumanisë është institut kombëtar për kërkime dhe zhvillime të gjeologjisë, gjeofizikës, gjeokimisë në kuadër të Ministrisë së Arsimit, autoritetit kombëtar të kërkimit shkencor. Shërbimi Gjeologjik i Finlandës vepron në kuadër të Ministrisë së Ekonomisë dhe të Punësimit. Është shërbim kombëtar për gjeologji. Shërbimi Gjeologjik i Irlandës është agjenci kombëtare për hulumtime gjeologjike. Është në kuadër të Ministrisë të Komunikacionit, Energjisë dhe Burimeve Natyrore. Shërbimi Gjeologjik i Lituanisë vepron në kuadër të Ministrisë së Mjedisit dhe është shërbim nacional.

Prandaj, qëllimi i hartimit të Ligjit për Shërbimin Gjeologjik të Kosovës duhet të ketë ngritje në nivel më të lartë të Shërbimit Gjeologjik të Kosovës, sigurimin e një baze të mirëfilltë ligjore për funksionimin e tij dhe të shërbimeve gjeologjike, duke i implementuar dhe promovuar standardet e pranuar ndërkombëtare.

Ndërkohë do të jap disa komente konkrete rreth këtij ligji. Për shembull, në nenin 10, pika 1.1, kemi hulumtime gjeologjike. Në pikën 1.2 bëhet fjalë për studime gjeologjike.

Në pikën 1.8 kemi krijimi, pasurimi dhe zgjerimi i bazës shtetërore të të dhënave dhe arkivimi, ndërsa në pikën 1.4 thuhet se i siguron kadastrës, minierave dhe GIZ-it të KPMN-së të dhëna të azhuruara, ndërsa në nenin 15, në fakt, flitet që agjencia e gjeologjisë së Kosovës, që është në kuadër të Komisionit të Pavarur të Minierave, kalon në Shërbimin Gjeologjik të Kosovës, që do të thotë se GIZ-i në mënyrë automatike duhet të jetë pjesë e Shërbimit Gjeologjik të Kosovës. Prandaj, nëse japim të dhëna, atëherë Shërbimi Gjeologjik i Kosovës duhet vetëm në mënyrë indirekte apo direkte, me ndonjë kërkesë të posaçme, të begatojë apo t'i ndihmojë Komisionit të Pavarur të Minierave.

Në anën tjetër, në pikën 1.13 parashihet që Shërbimi Gjeologjik e menaxhon laboratorin, krijon analiza profesionale laboratorike të hulumtimit, që do të thotë se pra hulumtimet gjeologjike paraqesin bazë për përcaktimin dhe shfrytëzimin e drejtë të resurseve natyrore, të cilat kanë nevojë për rregullim ligjor për t'i mbrojtur interesat e shtetit në fushën e hulumtimit, ndërsa në nenin 13, pika 2 thuhet: Shërbimi Gjeologjik i Kosovës bashkëpunon ngushtë me Fakultetin e gjeoskencave për përdorimin e laboratorit për qëllime studime, gjë që po më duket pak e logjikshme, se ky shërbim duhet ta ketë laboratorin e vet, e jo të bashkëpunojë me Fakultetin e Gjeoshkencës, kur e dimë se laboratorit i gjeoshkencës ka shumë mangësi dhe ballafaqohet me shumë probleme, si për kah komponentët, si edhe për kah problemet tjera, të cilat menaxhohen atje.

Një çështje tjetër të cilën dëshiroj ta cek është në nenin 16, i cili duhet më mirë të ristrukturohet. Në fillim thuhet: të hyjë në fuqi të këtij ligji, të shfrytëzohen disa nene, ndërsa në fund të këtij paragrafi thuhet se disa prej këtyre neneve janë në kundërshtim me ligjin.

Prandaj, neni 16 duhet të ristrukturohet dhe të jetë pak më i qartë.

Në kuadër të një pike tjetër, që mendoj se duhet të diskutohet, është neni 11, i cili ka të bëjë me muzeun e “Trepçës”, e cila është një begati kombëtare dhe unë mendoj që ndoshta duhet të shqyrtohet, të analizohet që ky muze të mos jetë në kuadër të Shërbimit Gjeologjik, por në kuadër të ministrisë përkatëse, në departamentet për mbrojtjen, ristrukturimin dhe kultivimin e pasurisë shtetërore, apo të çështjeve që kanë të bëjnë direkt me ruajtjen e pasurisë kombëtare, e jo në kuadër të shërbimit për shkak se nevojitet një përkujdesje më e mirë, e jo të përkujdeset një shërbim gjeologjik, i cili merret më shumë me hulumtime dhe studime, e jo me përkujdesjen e këtij muzeu.

Unë në parim mendoj se ky ligj është shumë i rëndësishëm dhe duhet të miratohet, mirëpo në kuadër të takimeve vijuese duhet të rishikohen këto kërkesa, këto komente të cilat i dhashë, dhe të jetë një ligj shumë efikas, i cili do të ndikojë në shfrytëzimin sa më racional dhe më efikas të të gjitha resurseve, të cilat janë në Kosovë. Faleminderit!

KRYESUESI: Atëherë të tjerë të paraqitur nuk ka. Për replikë është paraqitur zonja Sala Berisha-Shala.

SALA BERISHA-SHALA: Faleminderit, nënkryetar!

Nuk kisha dashur t'i them si replikë, por si një plotësim ose qartësim i asaj që e tha deputetja zonja Justina Shiroka-Pula. E falënderoj shumë për angazhimin e saj. Është angazhuar edhe kur ka qenë ministre e Energjisë dhe e Minierave në këtë drejtim. Bashkërisht kemi pasur edhe si ide ta bëjmë një gjë të tillë, por kemi hasur në pengesa të ndryshme, me të cilat nuk dua sot të merrem, me një historik të tillë.

Sa i përket laboratorit, desha një sqarim ta bëj edhe për opinionin, se laboratori është pjesë e Institutit të Gjeologjisë, mirëpo momentalisht në mungesë të hapësirave fizike për ta vendosur diku këtu, ai është i vendosur në Fakultetin e Gjeoshkencave në Mitrovicë. Kështu që është një laborator i fjalës së fundit të teknologjisë në këtë drejtim dhe ideja ka qenë që Shërbimi Gjeologjik i Kosovës, përkatësisht pjesa e laboratorit të jetë në dispozicion të shkencës dhe të dijes dhe studentët ta marrin përvojën, që janë pjesë e Fakultetit të Gjeoshkencave.

Për detaje tjera sigurisht që do të bisedojmë edhe më tutje dhe e ftoj deputeten e nderuar të jetë edhe pjesë e grupit punues. E mora fjalën në cilësinë e kësaj nisme ligjore dhe në cilësinë e kryesueses së grupit punues, që më tutje do të punojë në këtë drejtim. I falënderoj të gjithë ata që e dhanë kontributin e vet sot në këtë debat dhe janë të mirëseardhur me vërejtjet dhe sugjerimet gjatë fazës së amendamentimit. Faleminderit!

KRYESUESI: Të tjerë të paraqitur për diskutim nuk ka, mirëpo problemi është i njëjtë. Në sallë i kemi të pranishëm vetëm 56 deputetë. Kërkoj nga shërbimi kompetent që t'i thërrasë edhe një herë deputetët, meqenëse jemi shumë afër numrit, i cili na nevojitet për të hyrë në votim.

Tani e kemi numrin e nevojshëm prej 61 deputetëve të pranishëm. Kërkoj që t'i zini vendet tuaja.

Në vazhdim kërkohet deklarimi me votim për miratimin në parim të Projektligjit për Shërbimin Gjeologjik të Kosovës. Të pranishëm në sallë janë 61 deputetë. Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim. Votojmë tash!

Problemi është se me votim kanë dalë 58 deputetë të pranishëm, në ndërkohë që numërimi na thotë se janë 61 të pranishëm në sallë. Ju kisha lutur edhe një herë që të gjithë të pranishmit në sallë ta shfrytëzojnë të drejtën e tyre për të votuar. Atëherë shkojmë edhe një herë në votim. Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim. Votojmë tash!

Atëherë konstatoj që ligji në fjalë nuk kalon, por para kësaj propozoj që edhe një herë të votojmë, meqenëse në momentin e fundit ka hyrë edhe zonja Krasniqi. Propozoj që ta bëjmë një votim elektronik për ta konstatuar praninë e saktë në sallë.

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votimin se sa jemi të pranishëm në sallë.

Konstatoj se në sallë janë të pranishëm 62 deputetë. Lus edhe një herë regjinë dhe deputetët të votojmë për projektligjin në fjalë. Votojmë tash!

Konstatohet se me 61 për dhe me 1 votë kundër, Kuvendi e miratoi në parim Projektligjin nr. 04/L-232 për Shërbimin Gjeologjik të Kosovës.

Ngarkohen Komisioni Funkcional dhe komisionet e përhershme që në afatin e paraparë me Rregulloren e Kuvendit ta shqyrtojnë projektligjin dhe Kuvendit t'ia paraqesin raportet me rekomandime.

Tash jemi në pikën e shtatë të rendit të ditës, por ministri për Financa, zoti Beqaj dhe ministri i Zhvillimit Ekonomik, zoti Ismajli, kanë bërë një marrëveshje reciproke me njëri-tjetrin për shkak të angazhimeve të ndryshme që i kanë, që pika e 12-të, në të cilin është përgjegjës zoti Beqaj, të ndryshohet me pikën numër 7, në të cilën është përgjegjës zoti Ismajli, dhe që pika e 12 të trajtohet si pika e 7-të e rendit të ditës. Pra, vetëm t'i ndërrojnë vendet. Këtë nuk mund ta bëj unë, nuk munden ta bëjnë as ministrat, por i takon seancës së Kuvendit që të vendosë. Ata e kanë bërë marrëveshjen, por seancës i takon që të jetë instanca e fundit e vendimmarrjes. Kështu që edhe një herë ju kërkoj që t'i zini vendet tuaja, apo më mirë për ta thjeshtuar procedurën, shkojmë nëpërmjet diskutimit me grupet parlamentare.

Nga Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike, fjalën e ka zoti Shaip Muja.

SHAIP MUJA: Grupi Parlamentar e pranon propozimin e parashtruar nga dy ministrat. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Nga Lidhja Demokratike e Kosovës, zotëri Arben Gashi e ka fjalën.

ARBEN GASHI: Rendi i ditës është i aprovuar dhe po më duket joserioze që në mes të tij ta ndryshojmë. Kështu që ministrat e kanë për detyrë me qenë në Parlament kur i bëjnë propozimet e ligjeve dhe kërkohet prania e tyre. Faleminderit!

KRYESUESI: Nga Lëvizja "Vetëvendosje", zotëri Visar Ymeri e ka fjalën.

VISAR YMERY: Edhe unë konsideroj që veç për çështje procedurale është problem ta ndryshojmë rendin e ditës, sepse jemi në mes të seancës. Pra, rendi i ditës ndryshohet kur e diskutojmë rendin e ditës menjëherë pas diskutimit të procesverbalit. Kjo marrëveshje e ministrave le të jetë marrëveshje e ministrave. Këta mund ta ndryshojnë rendin e ditës të Qeverisë, por jo të Kuvendit.

KRYESUESI: Nga Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës, zonja Donika Kadaj-Bujupi e ka fjalën.

DONIKA KADAJ-BUJUPI: Edhe ne jemi kundër. Edhe kështu asnjëherë nuk po vijnë në seancë. Sot i kanë pikat e veta, le të qëndrojnë deri në fund, siç është rendi i ditës.

KRYESUESI: Nga Koalicioni Kosova e Re, kryetarja e Grupit, Myzejane Selmani e ka fjalën.

MYZEJENE SELMANI: Faleminderit, nënkryetar!

Duke marrë parasysh se ministrat kanë qenë të dytë këtu në fillim të seancës dhe në fillim të seancës është dashur ndoshta edhe në bazë të Rregullores së Kuvendit të ndërrohen këto, ngase është vetëm çështje teknike, nëse janë të pajtim të gjithë, nuk është shumë e rëndë që pika e 12-të të dalë aty, por esenca është që deputetët duhet ta japin mendimin e vet a mund të ndërrohen këto pika të dy ministrave tanë.

KRYESUESI: Problemi ishte që edhe unë për këtë u informova gjatë pikës 6, kështu që menjëherë e bëra propozimin, pas përfundimit të saj. Nga Grupi Parlamentar SLS, fjalën e ka Sasha Milosavljeviq.

SAŠA MILOSAVLJEVIĆ: Hvala predsedavajući!

Naša politička grupa se slaže sa time, da dođe do oizmene dnevnog reda.

KRYESUESI: Grupi “6+”, Albert Kinolli e ka fjalën

ALBERT KINOLLI: Faleminderit, i nderuar kryesues!

Edhe Grupi Parlamentar “6+” e përkrah këtë propozim tuajin që të vijë deri te ndryshimit i pikave të rendit të ditës. Faleminderit!

KRYESUESI: Atëherë, meqë po e shoh se nuk ka konsensus për këtë çështje dhe meqë kemi 61 deputetë të pranishëm në sallë, shkojmë me procesin e votimit lidhur me këtë propozim. Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim. Votojmë tash!

Propozimi është të ndërrohet pika 12 me pikën 7. Problemi është që disa nga deputetët ikën, disa nuk duan ta shfrytëzojnë të drejtën e tyre për votim, kështu që, meqenëse nuk ka kuorum, nuk mund ta realizojmë këtë propozim.

Urdhëro, Arben Gashi e ka fjalën.

ARBEN GASHI: Faleminderit për fjalën e dhënë!

Vetëm desha të sqaroj. Deputetët po e shfrytëzojnë të drejtën e tyre të mosvotimit, sepse deputeti ka të drejtë të votojë, por edhe të mos votojë dhe të ndikojë në vendimmarrjen nëpërmjet mosvotimit. Në këtë rast, disa deputetë nuk votuan për të ndikuar në vendimmarrje, që të mos kalojë ky propozim. Kështu që deputetët me vullnetin e tyre po ndikojnë në këtë vendimmarrje dhe vazhdohet me procedurën, me rendin e aprovuar të ditës. Faleminderit!

KRYESUESI: Natyrisht që kjo është një e drejtë, mirëpo është e zakonshme që deputetët kur janë të pranishëm të votojnë dhe mosvotimin ta manifestojnë ndoshta nëpërmjet lëshimit të seancës, por jo edhe ta zënë vendin e tyre edhe ta hutojnë shërbimin kompetent për deputetët, sa deputetë janë të pranishëm dhe ajo të ketë shpërputhje pastaj me numrin e votave. Por, kjo është çështje tjetër.

Fjalën e ka kërkuar deputetja Ganimete Musliu.

GANIMETE MUSLIU: Faleminderit!

Përshëndetje për të gjithë deputetët,

Vetëm desha sa për sqarim. Ndoshta është që hera e katërt që e hidhni çështje për votim pa kuorum. Nuk patëm kuorum disa herë, deshët ta dërgoni ligjin pa u votuar, edhe pse merrte vota për t'u votuar, ndërsa tash e hidhni prapë një kërkesë të ministrave pa kuorum. Më mirë është ta ndërpritni seancën, të thoni nuk ka kuorum, dhe vazhdojmë pas pauzës, se sa që të bëni teatër, siç po vazhdoni të bëni. Faleminderit!

KRYESUESI: Vetëm një sqarim për deputeten Ganimete Musliu. Këtu është fleta e shërbimit të deputetëve, që na informon se sa deputetë janë të pranishëm në sallë. Ata më informuan që 61 deputetë kanë qenë të pranishëm në sallë gjatë votimit të propozimit të ministrave, kështu që ne nuk kemi bërë asnjë gabim, ma merr mendja. Ne i marrim informatat tona nga shërbimi kompetent i deputetëve, të cilët lajmërojnë se sa deputetë janë të pranishëm në sallë.

Atëherë propozoj që të shkojmë në pauzë deri në orën 14:30.

* * *

Vazhdimi i mbledhjes plenare pas pauzës

Mbledhjen e drejton kryetari i Kuvendit, zoti Jakup Krasniqi.

KRYETARI: Të nderuar deputetë,

Në sallë janë të pranishëm 48 deputetë. Mund të fillojmë me pikën e shtatë të rendit të ditës:

7. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për masat antidamping dhe masat kundërbalancuese

Në bazë të nenit 56 të Rregullores së Kuvendit, Komisioni FunkSIONAL e ka shqyrtuar projektligjin dhe Kuvendit ia ka rekomanduar miratimin e tij në parim.

E ftoj ministrin, zotin Fadil Ismajli, që para deputetëve të Kuvendit ta paraqesë dhe arsyetojë projektligjin. Ministër, e ke fjalën.

MINISTRI FADIL ISMAJLI: Faleminderit, i nderuar kryetar!

Të nderuar deputetë,

Ministra,

Më lejoni që në emër të Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë, si bartëse e Projektligjit për masat antidamping dhe masat kundërbalancuese, të shpalos para jush qëllimin, rëndësinë dhe fushën e rregullimit dhe përmbajtjen e këtij projektligji.

Nëpërmjet këtij projektligji do të përmirësohet rregullativa ligjore në fushën e rregullimit dhe mbrojtjes së tregut të Kosovës.

Me anë të këtij projektligji do të sigurohen masat adekuate për mbrojtjen e industrisë dhe prodhimit vendor në rastet kur dëmtohet dhe pengohet nga praktikat jolojale të tregtisë ndërkombëtare nëpërmjet importeve të dampuara, ose të subvencionuara.

Ky projektligj për herë të parë është harmonizuar me rregulloret e Bashkimit Evropian, me konceptet e legjislacionit të Organizatës Botërore të Tregtisë, në kuptim që ato tani më janë të inkuorporuar në nene të caktuara, duke iu përshtatur nevojave të vendit dhe njëkohësisht duke i siguruar Kosovës bazë të mirë për mbrojtje të tregut të industrisë e huas jolojale.

Në projektligj, në mënyrë specifike është bërë harmonizimi me legjislacionin e Bashkimit Evropian në sferën e tregtimit të shitjeve nën kosto, përlllogaritjes së kostove në përcaktimin e vlerës normale, çmimit të eksportit, krahasimit të vlerës normale me çmimin e eksportit dhe të marzhës së dampingut.

Gjithashtu duhet theksuar se në këtë projektligj janë harmonizuar edhe çështjet që kanë të bëjnë në parimin e përgjithshëm për subvencione, përkufizimin e subvencionit, subvencionet kundërbalancuese, përlllogaritjen e shumës së subvencionit kundërbalancues, përlllogaritjen e përfitimit nga përfituesit, dispozitat e përgjithshme për përlllogaritjen e subvencioneve, metodat e përlllogaritjes së shumës së subvencionit, si dhe përlllogaritja e shumës së subvencionit specifik.

Po ashtu, në këtë projektligj është harmonizuar përkufizimi i dëmit, shqyrtimi i efektit të produkteve dampuara apo të subvencionuara me çmime, vlerësimi kumulativ i dëmit, si dhe kërcënimi i dëmit material ndaj industrisë së Kosovës.

Si risi në këtë projektligj është Komisioni për vlerësimin e detyrimeve të veçanta të importit që tanimë ka vetëm rol këshillues, që do të thotë se tani e tutje si organ hetues dhe vendimmarrës për hetimin e dampingut, subvencionimit, dëmeve të tyre dhe interesit të Kosovës do të jetë departamenti i caktuar në kuadër të Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë.

Pra, projektligji ka siguruar që zhvillimi i hetimeve, metodologjia e zhvillimit të hetimeve, procedura e hetimeve, afatet dhe çështjet tjera janë të rregulluara në përputhje të plotë me legjislacionin evropian për masat antidamping dhe subvencionet.

Projektligji është hartuar në përputhje me procedurat e parapara me Rregulloren numër 09/2011 për punën e Qeverisë së Kosovës dhe është pranuar deklarata financiare nga Ministria e Financave në deklarata e pajtueshmërisë me legjislacionin e Bashkimit Evropian nga Ministria e Integritetit Evropian se projektligji i lartpërmendur është i harmonizuar nga të dyja këto aspekte.

Projektligji i propozuar është ndryshuar mbi 40% dhe i plotëson kushtet për të proceduar si projektligj i ri në përputhje me udhëzimin për standardet e hartimit të akteve juridike.

Me hartimin e këtij projektligji ne synojmë të jemi shembull i mirë dhe në përputhje të plotë me legjislacionin evropian dhe të Organizatës Botërore të Tregtisë për antidamping dhe masa subvencionuese.

Për fund, duhet të them se në këtë ligj është siguruar edhe e drejta e të dëmtuarve eventuale, të cilët mund të paraqesin ankesë në Gjykatën Themelore për çështje administrative të Republikës së Kosovës.

Duke pasur parasysh rëndësinë e këtij projektligji në fushën e ekonomisë dhe me qëllim të përmirësimit të tij të sigurohet zbatimi adekuat i masave antidamping dhe masave kundërbalancuese për mbrojtjen e prodhimit vendor. Ju ftoj që ta shqyrtoni dhe miratoni këtë projektligj në këtë seancë plenare. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, ministër!

Fjalën e ka kryetari i Komisionit Funkcional për Zhvillim, Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti, Industri, deputeti Zenun Pajaziti.

ZENUN PAJAZITI: Faleminderit, zoti kryetar!

Të nderuar ministra,

Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri, në mbledhjen e mbajtur më 16 e ka shqyrtuar në parim Projektligjin për masat antidamping dhe masat kundërbalancuese. Të njëjtin e kemi aprovuar dhe kemi kërkuar që Kuvendi ta miratojë në parim, pasi është në përputhje edhe me Rregulloren e Kuvendit.

Konsiderohet që ky është ndër ligjet e rëndësishme, i cili u del në mbrojtje prodhimeve vendore ose produkteve vendore, vendos masa ose kontroll të caktuar për importe të ndryshme dhe mendoj që është njëri ndër ligjet, të cilat konsiderohen si ligje me benefite për prodhuesit vendorë, ose për ta rregulluar këtë fushë kaq të rëndësishme.

Unë i ftoj gjithë deputetët ta japin kontributin e tyre edhe gjatë trajtimit në fazën e dytë, edhe në fazën vijuese, dhe ju ftoj që ta votoni. Faleminderit!

KRYETARI: Në emër të Grupit të Partisë Demokratike, fjalën e ka deputeti Shaip Muja.

SHAIP MUJA: Faleminderit, zoti kryetar!

Të nderuar ministra, deputetë,

Ky projektligj përcakton rregullat, procedurat, kushtet e përcaktimit dhe të zbatimit të masave antidamping dhe kundërbalancuese, me qëllim të mbrojtjes së industrisë dhe prodhimit vendor, në rastet kur dëmtohet dhe pengohet nga praktikatat jolejale të tregtisë ndërkombëtare nëpërmjet importeve të dampuara, ose të subvencionuara.

Pra, me këtë ligj zbatohet vendosja e masave antidamping dhe e masave kundërbalancuese ndaj një produkti të importuar që përfiton nga një ose më shumë subvencione specifike, të cilat i ka përfituar në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë nga vendi eksportues, përkatësisht autoriteti publik i atij vendi gjatë prodhimit,

eksportimi ose transportimi, kur importi i produktit në fjalë shkakton ose kërcënon t'i shkaktojë dëm industrisë vendore.

Nëpërmjet këtij ligji, Republika e Kosovës e krijon një sistem të mirëfilltë ligjor dhe efikas në përputhje me standardet evropiane dhe ndërkombëtare.

Ky projektligj synon të arrijë përmirësimin e infrastrukturës ligjore që ka të bëjë me rregullimin e fushës ku përcakton rregullat dhe procedurat, kushtet e përcaktimit dhe zbatimit të masave antidamping dhe kundërbalancuese, me qëllim të mbrojtjes së industrisë dhe prodhimit vendor në rastet kur dëmtohet dhe pengohet nga praktikat jolojale e tregtisë ndërkombëtare nëpërmjet importeve të dampuara, ose të subvencionuara.

Ne e kemi një ligj në fuqi për masat antidamping dhe kundërbalancuese, mirëpo projektligji është hartuar me qëllim që të bëhet përafrimi më i gjerë me legjislacionin e Bashkimit Evropian dhe është i harmonizuar me Rregulloren e Bashkimit Evropian numër 1225/2009 për mbrojtjen kundër importeve të dampuara nga vendet joanëtare të komunitetit evropian - Rregullorja e Bashkimit Evropian numër 597/2009 për mbrojtjen kundër produkteve të subvencionuara nga vendet joanëtare të komunitetit evropian.

Andaj, me hyrjen në fuqi të këtij ligji, kjo fushë do të begatohet dhe rregullohet sipas praktikave më të avancuara dhe është i harmonizuar me ligjet tjera në fuqi, gjithnjë duke iu përshtatur rrethanave të Kosovës.

Duhet të cek se zbatimi i projektligjit për masat antidamping dhe masat kundërbalancuese nuk parasheh implikime buxhetore në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike e përkrah në parim këtë projektligj dhe kontributin e tij do ta japë në komisionet parlamentare. Faleminderit!

KRYETARI: Në emër të Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike, deputetja Teuta Sahatqija e ka fjalën.

TEUTA SAHATQIJA: Faleminderit, kryetar!

Në komision e kemi analizuar këtë ligj, por edhe në Grupin Parlamentar kemi diskutuar për projektligjin për masat antidamping dhe masat kundërbalancuese.

Në fakt, ky ligj do ta zëvendësojë Ligjin 03/L-097 të vitit 2010, i cili deri më tani e ka rregulluar këtë lëmi.

Në fakt, mendojmë që ky ligj i ri ka shumë pak ndryshime në krahasim me ligjin, i cili e ka rregulluar deri më tani dhe do të jetë sfidë t'i gjejë ndryshimet, të cilat ekzistojnë në mes të ligjit të vjetër dhe këtij ligji, i cili na është sjellë në Kuvendin e Kosovës.

Por, ndonëse ky ligj e ka për qëllim që të ndikojë në mbrojtjen e prodhimit vendor, gjithashtu dëshiroj ta shfrytëzoj rastin që të them që ekonomia është sektor shumë i

rëndësishëm për shtetin dhe prodhimi vendor e biznesi janë ato që e mbushin buxhetin dhe e sigurojnë mirëqenien e qytetarëve.

Prandaj, biznesi vendor duhet të konsiderohet me prioritet dhe me masa për stimulimin e tij me politikatat e taksave, me programe mbështetëse, të cilat e sigurojnë një ambient të përshtatshëm biznesor.

Por, përveç këtyre masave, të cilat po mungojnë për krijimin e një ambienti biznesor, i cili do ta fuqizonte biznesin dhe prodhimin vendor, ekzistojnë edhe ligje tjera sikur ky ligj, por edhe Ligji për masat mbrojtëse në importe, i cili në vitin 2011 është aprovuar në Kuvendin e Kosovës dhe këto masa e mbrojnë biznesin nga ndikimet, nga produktet që vijnë jashtë shtetit të Kosovës dhe që mund ta dëmtojnë atë.

Masat antidamping e mbrojnë biznesin tonë nga ndikimet e futjes së prodhimeve në Kosovë nga shtetet joeuropiane, të cilat, duke përdorur masa të ndryshme, e rrezikojnë prodhimin tonë kundrejt politikave të padrejta tregtare ndërkombëtare.

Nga Ministria e Financave kemi njoftimin se ky ligj nuk prodhon kosto shtesë dhe se shpenzimet mbulohen nga ndarjet buxhetore të kornizës afatmesme të shpenzimeve, 2013-2015.

Gjithashtu, nga Ministria e Integritetit njoftohet se projektligji në mënyrë të konsiderueshme është në përputhje me parimet e përgjithshme të ‘acquis communautaire’ dhe është përshtatur për nevojat e Kosovës. Dhe, ‘acquis’ që e përkrah zhvillimin e tregtisë globale dhe hapjen e tregjeve për zhvillimin e tregtisë, sipas Rregullores së BE-së 12/25 të vitit 2009.

Është interesant që asnjë nga organizatat që janë konsultuar nuk ka dhënë asnjë koment dhe ishte me të vërtetë për t’u çuditur a s’ka pasur komente, a ka qenë ligji perfekt, apo janë kontaktua vërtet, apo jo, ndonëse lista e organizatave të konsultuara ishte mjaft e madhe.

Gjatë analizës së projektligjit, shihet që këto masa mbrojtëse vendosen pas kryerjes së hetimeve dhe vendosen duke pasur parasysh vlerën nominale të produkteve të importuara, ose të produkteve të ngjashme.

Në listë trajtohet shitja nën kosto, përllogaritjet e kostove në përcaktim të vlerës normale, sikur edhe krahasimi me çmimin e eksportit, duke llogaritur shpenzimet, zbritjet, rabatet, sasinë, transportin, sigurimin, ngarkimin, shkarkimin, paketimin dhe shpenzimet tjera të mundshme, të cilat mund të ndikojnë në koston e produktit të tillë, apo të produkteve të ngjashme me produktin e importuar, që dyshohet që është produkt që prish, që do të thotë është dumping.

Kreu III flet për subvencionet, për kundërbalancim dhe përllogaritjet e ndryshme, ndërsa në IV flitet për përcaktimin e dëmit dhe efektet e importeve të dampuara dhe të subvencionuara.

Në përgjithësi, atë që e thashë në fillim, mendojmë që ky ligj i ri është shumë i ngjashëm me ligjin e kaluar, gjë e cila po vazhdon të vijë prej Ministrisë së Tregtisë, ku ligjet e reja janë gati 'copy paste' të ligjeve të vjetra. Por, mendojmë që në komision do ta shfrytëzojnë këtë ligj në mënyrë që t'i bëjnë përmirësimet e nevojshme dhe ligji t'u përshtatet nevojave dhe kushteve të Kosovës.

Prandaj, si Grup Parlamentar, në parim, e përkrahim me vërejtjet të cilat i dhamë.

KRYETARI: Në emër të Grupit të "Vetëvendosjes", kryetari Visar Ymeri e ka fjalën.

VISAR YMERI: Faleminderit, kryetar!

Deputetë të Kuvendit të Republikës së Kosovës,

Është e saktë ajo që e tha zonja deputete Sahatqija që ligjin që po e trajtojmë tash, që na ka ardhur si ligj i ri prej Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë është në fakt një lloj riprodhimi i ligjit të vjetër, me disa ndryshime.

Dhe në këtë drejtim unë e kisha ngrehur një çështje që ka të bëjë domosdoshmërisht me ligjin, por më shumë me zbatueshmërinë e tij, sepse këtu edhe nga ministri e dëgjova dhe përgjithësisht nga Qeveria e Kosovës thuhet që 'po përkujdesemi që t'i kemi ligjet sa më të mira, në mënyrë që pastaj këto t'i ndihmojnë zhvillimit të prodhimit dhe të tregut të Kosovës, në përgjithësi'.

Mirëpo, secili vit që po na vjen është një lloj përsëritje e një ligji që tashmë e kemi në fuqi dhe para se të hyjmë te diskutimi i ligjit, pyetja ime do të ishte për Qeverinë çfarë u bë deri më tash me ligjin aktual, i cili është në fuqi. Sa herë është përdorur, në çfarë rastesh është përdorur, a ka treguar ndonjë efekt apo jo, sepse natyrisht që ligji, në njërën anë, për masat mbrojtëse, që e kemi në fuqi, e kemi diskutuar dy herë në Kuvend, e pastaj Ligji për masat antidamping, të dyja këto do të duhej të shërbenin shumë më shumë e të përdoreshin shumë më shumë nga prodhimi vendor, në mënyrë që tregu i Kosovës të mbrohet nga një konkurrencë jolejale që na paraqitet veçanërisht nga importi, nga vendet e rajonit, dhe në këtë drejtim konsideroj që deri më tash, me aq sa është publikuar, Ministria e Tregtisë dhe Industrisë, Qeveria e Kosovës, në përgjithësi, nuk është se i ka përdorur këto ligje në gjendjen e tyre, në të cilën janë, për t'i shfrytëzuar raportet për të mirën e prodhimit vendor.

Pra, e vetmja masë mbrojtëse që është përdorur deri tash, që e ka shkaktuar një pompozitet të madh, është ajo që i është shqiptuar sektorit të ndërtimtarisë, më saktësisht importit të çimentos, me kërkesë të "Sharcemit", dhe kjo është një çështje që do ta ngre më vonë edhe për këtë ligj, që ka rëndësi për të se kush e nis hetimin dhe si nis.

Është një gjë e evidente që me secilën rregull të tregtisë ndërkombëtare, qofshin ato të Organizatës Botërore të Tregtisë, por edhe me Marrëveshjen CEFTA, pjesë e së cilës është Kosova, u lejohet vendeve që ta parandalojmë hyrjen pa taksë doganore të artikujve ose prodhimeve, të cilat subvencionohen nëpër vendet e tyre, dhe në këtë drejtim konsideroj që Kosova ka mundur deri më tash në shumë raste të bëjë një mbrojtje shumë më të mirë veçanërisht të prodhimeve bujqësore të vendit në sezonin kur ato prodhohen,

duke e përdorur këtë mekanizëm, i cili është lejuar ndërkombëtarisht. Por nuk e ka përdorur asnjëherë dhe ne e dimë që të gjitha prodhimet, veçanërisht bujqësore, nëpër vendet e rajonit, që importohen edhe në Kosovë, janë prodhime të subvencionuara dhe në këtë drejtim, me subvencionet e tyre, ato pra kanë paraqitur edhe shkelje të rregullës së dampingut. Pra, në njëfarë mënyre janë të shitur në Kosovë nën çmimin që do të duhej ta kishin në një vend ku ato eksportohen për shkak se në Kosovë janë shitur gati edhe nën çmimin që e kanë nëpër vendet, ose nëpër tregjet e brendshme.

Pra, në këtë drejtim, konsideroj që edhe pa këtë ligj fare, Qeveria e Kosovës do të kishte mundur të marrë masa, por veçanërisht duke e pasur parasysh faktin se këtë ligj tashmë, ose një ligj të ngjashëm, e kanë pasur në fuqi dhe nuk e kanë përdorur.

Një gjë që e kam parë këtu në ligj dhe që ma ka tërhequr vëmendjen është se sa u përket masave kundërbalancuese, kur flasim për subvencionimin, te kreu që flet për subvencionimin dhe përcaktimin e lejes së subvencionimit, aty thuhet që masat kundërbalancuese do të ndërmerren vetëm karshi subvencionimit specifik. Pra, jo karshi secilit lloj subvencionimi, dhe kjo mendoj që duhet të përmirësohet, sepse subvencionimi, pavarësisht a i bëhet një ndërmarrjeje të caktuar brenda një shteti prej nga importon Kosova, apo u bëhet të gjitha ndërmarrjeve që e prodhojnë produktin e njëjtë ose të ngjashëm, duhet të kuptojë si subvencion dhe rrjedhimisht kundër tij do të kemi masa kundërbalancuese, në mënyrë që të mos e lejojmë atë që ta zaptojë tregun e Kosovës.

Edhe një çështje e fundit që dua ta ngre për projektligjin që lidhet me mundësinë e prodhuesve për të nisur hetime. Pra, sikur me Ligjin për masat mbrojtëse, edhe me këtë për masat antidamping dhe kundërbalancuese, njihet e drejta e prodhuesve vendorë, qofshin ata persona fizikë apo juridikë, që ta nisin një kërkesë për nisjen e hetimit për një masë të caktuar dhe pastaj ministria bashkë me komisionin e shqyrton këtë çështje.

Mirëpo, kjo në të njëjtën kohë, nga vetë ish-ministrja e Tregtisë, kur kemi diskutuar për Ligjin për masat mbrojtëse, është vlerësuar si një lloj problemi, sepse ka thënë se nuk po mund të nisin si ministri shumë hetime për masat mbrojtëse, meqenëse nuk po kanë kërkesa nga baza, pra nga prodhuesit e Kosovës. Dhe, në këtë drejtim konsideroj që, edhe pse këtu shihet, me ligj thuhet që në raste të veçanta ministria ka të drejtë ta nisë vetë hetimin, pa kërkesë nga poshtë, mendoj që duhet të specifikohet dhe të qartësohet çka janë rrethanat e veçanta, pra cilat janë ato raste të veçanta kur ministria e bën këtë gjë dhe të nxitet ajo, për shkak se e ka kapacitetin shumë më të madh për të hetuar dhe për ta mbikëqyrur tregun që të nxitet që të nisë masa e hetimi 'ex officio' shumë më shumë se sa nga kërkesat që vijnë nga poshtë.

Pra, domosdoshmërisht, duhet që kërkesat nga poshtë të pranohen dhe të trajtohen. Mirëpo, për shumë raste, mund ta kemi një situatë kur prodhuesit vendorë, individualisht ose si grup, mund edhe të mos e kenë mundësinë për ta nisur një kërkesë, duke i pasur parasysh të gjitha ata mekanizmat burokratikë që paraqiten në Qeveri dhe me këtë drejtim të heqim dorë pra nga kjo, nga një kërkesë për hetim. Kjo më shumti është e shprehur natyrisht te prodhuesit bujqësorë, të cilët, edhe ashtu, shumica prej tyre janë shumë të

vegjël dhe në këtë drejtim madje nuk kanë mundësi ta përcjellin çfarë po ndodh në treg, e lëre më që ta nisin një kërkesë për hetim te ministria.

Pra, kjo do të duhej të ishte njëra prej përgjegjësive të ministrisë, e cila do të duhej të përdorej më së shumti, për shkak se ministria i ka të gjitha informatat për ta pasur njëloj pasqyre shumë më të gjithëpërfshirëse statistikore të tregut, në mënyrë që t'i dijë edhe rrjetat në tregjet rajonale për ta vlerësuar nëse një produkt i caktuar, apo një grup produktesh, po na vijnë nga një shtet, apo nga shumë shtete me çmime dampingu në Kosovë, vetëm e vetëm për ta gllabëruar tregun e saj.

Dhe, kjo do të duhej të ishte pra një çështje me të cilën merret ministria më seriozisht, e jo vetëm të presë kërkesa nga poshtë, për shkak se ato mund të mos vijnë asnjëherë. Kaq për tash!

Natyrisht që ne si Grup Parlamentar do ta votojmë në parim këtë ligj dhe do të insistojmë që në amendamentimin e tij të futen edhe ato gjëra që i përmenda dhe shumë ndryshime tjera teknike që nuk i përmenda, në mënyrë që ky ligj të jetë sa më i zbatueshëm.

Mirëpo, më duhet të ngre edhe një çështje për fund, që mendoj që zbatohet pak a shumë si vërejtje, si kritikë ndaj shumicës së ligjeve që vijnë këtu në Kuvendin e Republikës së Kosovës, meqë e kanë përmendur disa herë deputetë të ndryshëm.

Po që se lexohet ky ligj në gjuhën shqipe, në shumë prej neneve të tij, është i pakuptimtë. Pra, nuk ka kurrfarë kuptimi. Ligji qartë është shkruar në gjuhën angleze dhe pastaj është përkthyer në gjuhën shqipe. E gjuha shqipe, që është gjuhë zyrtare, e cila do të jetë gjuha e zbatimit të ligji, është e pakuptimtë dhe kur t'ia heqim këtë shtyllën në anglishte, atëherë ky vërtet bëhet i pazbatueshëm, sepse askush nuk do të mund ta kuptojë vetëm në gjuhën shqipe dhe, rrjedhimisht, bëhet i pavlefshëm.

E kisha lutur edhe një herë Qeverinë, që kur t'i sjellë ligjet në Kuvend, meqenëse nuk po e ka aftësinë t'i shkruajë vetë në gjuhën e tyre amtare, por po duhet t'i përkthejnë nga anglishtja, të paktën kujdes në përkthimin shqip që ta kenë kuptimin e njëjtë, sepse shumë prej gjërave e koncepteve në këtë ligj dhe neneve na është dashur t'i lexojmë në anglisht, që ta marrim vesh se çfarë kanë dashur të thonë në gjuhën shqipe. E kjo mendoj që do të duhej të ishte një praktikë e patolerueshme në institucionet e Kosovës, sepse gjuha, sipas të cilëve punojnë këto institucione, është gjuha shqipe. Faleminderit!

KRYETARI: Në emër të Aleancës, deputeti Ramiz Kelmendi e ka fjalën.

RAMIZ KELMENDI: I nderuar, kryetar!

Kabinet qeveritar,

Kolegë deputetë,

Edhe Grupi i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës ndan mendimin e njëjtë se ky ligj e luan një rol të vetin shumë me rëndësi, sidomos për prodhimtarinë vendore dhe duhet të ndërtohet i tillë, që të jetë në funksion të mbrojtjes së prodhimtarisë vendore, jo vetëm në

atë kur ka kërkesa për antidamping, por në kohën kur fillon sezonaliteti i prodhimeve, për shembull, bujqësore.

Ministria e Tregtisë të jetë vigjilente dhe ta përcjellë në kohën kur kemi prodhime të caktuara, hiperproduksion të prodhimeve të caktuara, të veprojë në mënyrë të automatizuar, e të mos presë që të ketë ankesa.

Ndërsa sa u përket industrive të tjera që janë të organizuara dhe mund t'i parashtrojnë ankesat dhe të ndikojnë në çmimin antidamping, që rrjedhin nga shtetet e regjionit, ajo mund të bëhet me njëfarë kontinuiteti.

Prandaj, Grupi i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës do të jetë shumë aktiv në këtë ligj dhe me ndërtimin e këtij ligji që të jetë në funksion të zhvillimit ekonomik të Kosovës. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Në emër të Grupit Koalicioni për Kosovë të Re, kryetarja Myzejene Selmani e ka fjalën.

MYZEJENE SELMANI: Faleminderit, i nderuar kryetar i Kuvendit!

Faleminderit i nderuar ministër për prezantimin e Projektligjit për masat antidamping dhe kundërbalancuese.

Duke marrë parasysh se edhe në mandatin e kaluar ne e kemi miratuar një projektligj të tillë, esenca e zbatimit të tij nuk ka qenë në ata parametra çfarë ne kemi pritur nga ministria përkatëse në atë kohë kur është miratuar, mirëpo edhe më vonë, me sa po më duket, ata kanë hasur në vështirësi shumë të mëdha gjatë zbatimit të këtij projektligji.

Në rast se e shohim çështjen e këtij projektligji, mund të themi se zbatimi i masave antidamping dhe kundërbalancuese me qëllim të mbrojtjes së industrisë dhe prodhimit vendor, kur dëmtohet nga praktikat jolojale të ekonomisë së tregut ndërkombëtar, atëherë duhet të merren këto masa.

Sa i kemi njerëzit tanë brenda ministrisë të specializuar për këto çështje të masave antidamping dhe masave kundërbalancuese, do të mbetet të shihet në të ardhmen.

Projektligji si i tillë e ka rëndësinë jashtë mase për arsye se edhe atëherë ka qenë i përafruar me legjislacionin e BE-së, ndërsa tash është i zbërthyer me direktivat dhe rregulloret e BE-së.

Kosovës i duhet si projektligj i tillë çfarë është, mirëpo esenca është sa do të kemi staf profesional për zbatimin e këtij ligji pas hyrjes së tij në fuqi.

Koalicioni për Kosovë të Re do t'i japë përkrahje dhe besoj e shpresoj që ministria përkatëse ta ketë një staf shumë të mirë që mund ta zbatojë këtë ligj në përpikëri për zhvillimin ekonomik të Kosovës. Faleminderit!

KRYETARI: Të lajmëruar të tjerë për fjalë nuk ka. Të pranishëm janë 63 deputetë, prania fizike, ndërsa prania elektronike është 92, d.m.th. kartelat janë të vendosura, e po të ishin 92 deputetë ne do t'i ratifikonim dy marrëveshjet që i kemi.

Megjithatë, shkojmë në procedurën e votimit. Lus deputetët dhe regjinë të përgatiten për votim. Votojmë tash! 67 deputetë të pranishëm.

Konstatoj me se 61 vota për, asnjë kundër dhe një abstenim, Kuvendi e miratoi në parim Projektligjin numër 04/L-240 për masat antidamping dhe masat kundërbalancuese.

Ngarkohen Komisioni Funkcional dhe komisionet e përhershme që në afatin e paraparë me Rregulloren e Kuvendit ta shqyrtojnë projektligjin dhe Kuvendit t'ia paraqesin raportin me rekomandime.

Vazhdojmë me pikën e tetë të rendit të ditës:

8. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për mbrojtjen nga zhurma

Në bazë të nenit 56 të Rregullores së Kuvendit, Komisioni Funkcional e ka shqyrtuar projektligjin dhe Kuvendit ia ka rekomanduar miratimin e tij në parim.

E ftoj ministrin e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, zotin Dardan Gashi, që para deputetëve të Kuvendit ta paraqesë dhe arsyetojë projektligjin.

MINISTRI DARDAN GASHI: Faleminderit, zoti kryetar!

Të nderuar deputetë,

Kolegë ministra,

Ky projektligj i referohet zhurmës në mjedis, së cilës i janë ekspozuar njerëzit veçanërisht në zonat e ndërtuara, parqet publike dhe pjesë të tjera të qeta të zonave të qytetit, në zonat e qeta të vendbanimeve në afërsi të shkollave, spitaleve dhe zonave të tjera të ndjeshme ndaj zhurmës.

Projektligji e përcakton ekspozimin ndaj zhurmës në mjedis nëpërmjet përgatitjes së hartave të zhurmës me metodat e vlerësimit, të cilat janë të përbashkëta me shtetet anëtare të BE-së.

Projektligji e obligon Qeverinë, respektivisht komunat, për miratimin e planeve të veprimit, të cilat janë të bazuara në rezultatet e hartës së zhurmës, me qëllim të parandalimit dhe zvogëlimit të nivelit të zhurmës në mjedis, veçanërisht ku ekspozimi ndaj zhurmës mund të shkaktojë pasoja të dëmshme për shëndetin e njeriut dhe për ta ruajtur nivelin e ashtuquajtur të mirë të zhurmës.

Po ashtu, e krijon bazën e vendosjes së masave të komunitetit për zvogëlimin e zhurmës, të cilën e emetojnë burimet e mëdha të zhurmës, veçanërisht automjetet, transporti rrugor, transporti ajror, pajisjet e jashtme të industrisë, makineria e mobileve, hoteleria e tjera.

Projektligji po ashtu përfshin edhe bashkësitë fetare të Republikës së Kosovës, pas konsultimit me të gjitha këto bashkësi në fjalë.

Sipas këtij, projektligji ministria e akt nënligjor i përcakton metodat e llogaritjes, matjes së nivelit të zhurmës dhe përmbajtjen e raportit për llogaritjet e bëra, respektivisht matjen e zhurmës në mjedis, si dhe vlerat kufitare të zhurmës.

Andaj, deputetë të nderuar, duke pasur parasysh rëndësinë e këtij ligji për shëndetin e përgjithshëm, ju ftoj që ta votoni këtë ligj. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, ministër! Radha është e kryetarit të Komisionit për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Planifikim Hapësinor dhe atë e zëvendëson deputetja Sevdije Lama.

SEVDIJE LAMA: Faleminderit, kryetar!

Flas në emër të kryetarit të komisionit.

Komisioni për Bujqësi dhe Mjedis, në bazë të nenit 56, paragrafi 2 të Rregullores së Kuvendit, në mbledhjen e mbajtur më 21 janar 2014, e shqyrtoi në parim Projektligjin për mbrojtjen nga zhurma dhe vendosi që Kuvendit t'ia paraqesë këtë rekomandim: Të miratohet në parim Projektligji për mbrojtjen nga zhurma.

Komisioni, pas shqyrtimit në parim të Projektligjit për mbrojtjen nga zhurma, vlerësoi se projektligji i plotëson kushtet e parapara në nenin 54 të Rregullores së Kuvendit dhe ia rekomandon Kuvendit për miratim në parim. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike, deputeti Ramiz Ladvoci e ka fjalën.

RAMIZ LADVOCI: Faleminderit, kryetar!

Të nderuar ministra,

Të nderuar kolegë deputetë,

Edhe Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës e ka shqyrtuar Projektligjin për mbrojtjen nga zhurma dhe ka vlerësuar se projektligji i ka plotësuar kushtet e parapara për miratim.

Kontributin tonë do ta japim gjatë amendamentimit të projektligjit në komisionet përkatëse nëpër grupet punuese. Ftojme deputetë që ta votojnë në parim. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike, deputetja Afërdita Berisha-Shaqiri e ka fjalën.

AFËRDITA BERISHA SHAQIRI: I nderuar, kryetar!

Ministra,

Të nderuar deputetë,

Të nderuar qytetarë,

Hartimi i Ligjit për mbrojtjen nga zhurma është parë i nevojshëm, pasi ligji ekzistues nuk ka qenë në përputhshmëri me direktivën e Parlamentit Evropian.

Qëllimi i këtij ligji është përcaktimi i kushteve dhe masave për shmangien, parandalimin dhe zvogëlimin e efekteve të dëmshme, duke përfshirë bezdisjen për shkak të ekspozimit ndaj zhurmës në mjedis.

Ky ligj gjithashtu krijon bazën e vendosjes së masave të komunitetit për zvogëlimin e zhurmës, të cilën e emetojnë burimet e mëdha të zhurmës, veçanërisht automjetet e transportit rrugor, hekurudhor dhe infrastruktura e tyre, transporti ajror, pajisjet e jashtme, ato të industrisë dhe makineria mobile.

Me hartimin e këtij projektligji synohet të lehtësohet zbatimi i tij, duke u dhënë një rol më aktiv komunave, me qëllim të krijimit të mekanizmave për monitorimin e zhurmës dhe zbatimin e projektligjit nëpërmjet inspektoratit.

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor merr përsipër implementimin e këtij projektligji me stafin aktual dhe nga buxheti ekzistues, sepse për angazhimin dhe monitorimin ekziston Inspektorati i Ministrisë së Mbrojtjes dhe Planifikimit Hapësinor.

Pra, Projektligji për mbrojtjen nga zhurma nuk ka një kosto shtesë dhe mund të konkludohet se nuk ka implikime buxhetore.

Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës, në parim, e mbështet këtë projektligj dhe kontributin do ta japim gjatë shqyrtimit të tij në komision. Faleminderit!

KRYETARI: Në emër të Grupit “Vetëvendosje”, deputeti Faton Topalli e ka fjalën.

FATON TOPALLI: I nderuar, kryetar!

Të nderuar deputetë të Kuvendit të Kosovës,

Ligji aktual për mbrojtje nga zhurma, i datës 30 mars 2007, përveç që nuk përcakton qartë përgjegjësitë e komunave, indikatorët e zhurmës dhe metodat e vlerësimit, nuk është në përputhshmëri me direktivat 2002/49 të Parlamentit Evropian.

Në këtë kuptim, ligji i propozuar është më i saktë. Ai i përcakton përgjegjësitë e ministrisë dhe të komunave, jep detyra konkrete dhe afate për zbatimin e tyre, përcakton indikatorët e zhurmës dhe metodat e vlerësimit të saj.

Nga studime i direktivave 2002/49 të Parlamentit Evropian lidhur me vlerësimin dhe luftimin e zhurmës në ambient, vlerësojmë që ligji i prezantuar është në përputhshmëri me direktivat.

Edhe shtojcat e ligjit për indikatorët e zhurmës, metodat e vlerësimit të indikatorëve të zhurmës, të indikatorëve të dëmshëm, kërkesat minimale për përgatitjen e hartave strategjike të zhurmës dhe kërkesat minimale për planet e veprimtari janë në përputhshmëri

të plotë me direktivat e Parlamentit Evropian të datës 25 qershor të vitit 2002, madje kësaj radhe edhe një përkthim bukur i saktë i tyre.

Më lejoni që me këtë rast të prezantoj dy vërejtje kryesore:

Neni 12 i Ligjit për mbrojtje nga zhurma, pika 7, thotë: “Përdorimi i pajisjeve elektro-akustike në objektet e regjistruara për shërbime hotelierike që i përdorin ato në hapësira të hapura është i lejuar nga ora 9:00 deri në orën 24:00”, ndërsa neni 15, pika 4 thotë: “Ndalohej kryerja e punëve, respektivisht veprimtarive dhe aktiviteteve, që me zhurmën e krijuar pengon qetësinë dhe pushimin e njerëzve në vende të hapura nga ora 22:00 - 7:00”.

Pra, neni 12, pika 7 dhe neni 15 pika 4 bien ndesh me njëra-tjetrën, kështu komisioni duhet të përcaktohet për kohën e saktë.

Kapitulli VIII - Dispozitat ndëshkuese, në nenin 29, pika 1, përcakton gjobën për shkelje të ligjit, e cila me ligjin e kaluar është përcaktuar prej 500 deri në 10 000 euro, ndërsa me ligjin e ri gjoja është rritur deri në 20 000 euro. Shtrohet pyetja, cila është arsyeja e dyfishimit të gjobës?

Edhe neni 29, pika 1.4 thotë ndëshkohet kush lëshon në treg burime të zhurmës, pra pajisje, interpretimi imi, te të cilat fuqia e zërit i tejkalon vlerat kufitare të përcaktuara.

Nëse bëjmë një analogji me veturat e lëshuara në treg, pra të shitura, që kanë një shpejtësi prej 220 km në orë, ndërsa shpejtësia e lejuar te ne është 130 km në orë, atëherë i bie që çdo veturë e cila shitet, pra e ka shpejtësinë maksimale 220 orë, ai që shet duhet të dënohet. Në këtë kuptim, mendojmë se kjo pjesë e ligjit duhet të ndryshoj, përndryshe ne si Grup Parlamentar jemi që ligji në parim të aprovohet, ndërsa vërejtjet tjera do t'i shtrojmë drejtpërdrejt në komision.

KRYETARI: Në emër të Grupit të Aleancës, fjalën e ka deputetja Time Kadriaj.

TIME KADRIJAJ: Faleminderit, kryetar!

Mirë që është hartuar ligji i ri, sepse ligji aktual nuk ka qenë në përputhshmëri me direktivat e Parlamentit Evropian.

Me ligjin e ri bëhet ndarja e përgjegjësiave të komunave, pra definohej qartë përgjegjësitë e institucioneve dhe të komunave.

Me këtë ligj gjithashtu krijojmë bazën e vendosjes së masave të komunitetit për zvogëlimin e zhurmës, të cilat emetojnë burime të mëdha të zhurmës, veçanërisht automjetet e transportit rrugor, hekurudhor dhe infrastruktura e tyre, transporti ajror, pajisjet e jashtme, ato të industrisë dhe makineria mobile.

Pra, me këtë projektligj synohet të lehtësohet zbatimi i tij, duke u dhënë një rol më aktiv komunave, me qëllim të krijimit të mekanizmave për monitorimin e zhurmës dhe zbatimin e projektligjit nëpërmjet Inspektoratit. Por, shtrohet pyetja: Nëse monitorimi

bëhet nëpërmjet Inspektoratit komunal, vështirë të realizohet ky projektligj, sepse komunat kanë pak inspektorë, por këtë obligim e merr në përgjithësi edhe Inspektorati i Ministrisë së Ambientit, që ta monitorojë këtë ligj.

Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës e ka shqyrtuar këtë projektligj dhe e përkrah, prandaj do ta votojë në parim. Faleminderit!

KRYETARI: Në emër të Grupit të Koalicionit për Kosovë të Re, fjalën e ka deputeti Gëzim Kelmendi.

GËZIM KELMENDI: Faleminderit, i nderuar kryetar!

Të nderuar kolegë deputetë,

Sa i përket këtij projektligji ne jemi që fillimisht ministri i Planifikimit Hapësinor ... do të thotë në fund të debatit, pasi të përfundojë dhe shterret krejt debati nga deputetët, do ta tërheq këtë projektligj, përndryshe ne do të votojmë kundër për faktin se ky projektligj është kundër kushtetues, bie ndesh me nenin 38 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, ngase neni 4 i këtij projektligji, paragrafi 2 e cilëson pajisjet akustike fetare, konkretisht ezanin e xhamiave dhe kambanat e kishave si burim të zhurmës. Pra, do të thotë kjo bie ndesh me nenin 38 të Kushtetutës ku garantohet liria dhe manifestimi publik i fesë, e para.

Dhe e dyta, është shumë fyese dhe ofenduese për të gjithë besimtarët e këtij vendi, pa dallim feje që pikërisht këto thirrje fetare, qoftë ezani ose kambana të cilësohen si burime të zhurmës.

Nëse e shikojmë në parim këtë projektligj duke filluar në tërësi që nga fillimi, nga qëllimi i tij dhe tutje të vazhdojmë nen për nen, do të shohim se është bërë një manipulim në opinionin e gjerë për faktin se shumë kohë thirret në legjislacionin e Bashkimit Evropian.

Ministri i nderuar e di shumë mirë se ka jetuar dhe është edhe shtetas i Austrisë, sa i përket Bashkimit Evropian, e di shumë mirë si janë të drejtat fetare në Austri, por edhe në gjithë Bashkimin Evropian.

Së paku kur ka ardhur në Kosovë dhe ka vendosur të bëhet ministër e ta udhëheq këtë dikaster, është dashur, nëse jo më shumë, të marrë modelin e Austrisë apo vendeve tjera të Bashkimit Evropian, sa i përket respektimit të lirive dhe të drejtave të njeriut dhe lirive fetare në vendin tonë, për faktin se në fillim të këtij projektligji ceket se është bërë konsultimi me gjithë institucionet dhe shoqërinë civile, por nuk është cekur se me ato kyçe, nuk është bërë konsultimi me institucionet fetare, qoftë bashkësisë islame, qoftë asaj krishtere. Kjo është e para.

Dhe e dyta, sa i përket qëndrimeve të tij përballë ndjenjave të besimtarëve në Kosovë e në veçanti besimtarëve islamë, qëndrimet e ministrit Gashi nuk janë të panjohura, qysh nga viti i kaluar ka thënë që do të merret dikasterin i cili është mjaft specifik, Ministrinë e Planifikimit Hapësinor, të udhëheqë dhe të merret me të gjitha ato ndërtime pa leje që ua

kanë zënë frymën mbarë Kosovës në përgjithësi, është marrë me rolin e historianit duke fyer historinë gjashtëqind vjeçare të këtij populli.

Sulmet e tij ndaj identitetit besimtar islam në Kosovë nuk kanë të ndalur, ngase në vitin e kaluar ka pezulluar....

KRYETARI: Deputet, nuk je në temë. Nuk jemi duke folur për ministrin, por për projektligjin.

GËZIM KELMENDI: Mirë, unë në temë po dal. Dhe, kur është ftuar në televizionin publik, në katër sy, në debat ka deklaruar se së shpejti do të vjen projektligji, për këtë projektligj po flas, i cili ka cilësuar se ka të bëjë me ndotjen e ambientit, ezanin e ka quajtur ndotje të ambientit, i nderuar kryetari i Kuvendit e kjo është ajo ku desha ta dal. E ka bërë atë që asnjë ministër nuk e ka bërë pas luftës në Kosovë, ka pezulluar lejen e xhamisë që e ka dhënë komuna vitin e kaluar, sot xhamia ka mbetur me katër mure. E para.

Dhe e dyta, po dal te projektligji. Këtë projektligj, nëse ministri nuk e tërheq mbrapa, kemi të bëjmë me nenin 4, paragrafi 2, ne do ta votojmë kundër për faktin se jemi një vend multietnik dhe multifetar dhe ministër duhet të respektohen ndjenjat fetare të besimtarëve të këtij vendi. Atë çka e ndjeni ju në shpirt mbajeni për veti dhe mos e keqpërdorni pozitën duke i fyer ndjenjat e qytetarëve të këtij vendi.

Unë edhe një herë, në emër të koalicionit, ftoj që ta tërhiqni ligjin mbrapa, përndryshe ne do të votojmë kundër.

KRYETARI: Ministrat nuk i hartojnë, po ata i prezantojmë ligjet.

Në emër të Grupit Parlamentar “6+”, fjalën e ka kryetari Rasim Demiri.

RASIM DEMIRI: Hvala predsedniče!

Poštovani predsedniče,

Poštovani kolege poslanici,

Izrada Nacrta zakona od buke je potreban zato što postojeći zakon nije u skladu sa evropskim Parlamentom.

Sa izradom novog zakona o zaštiti od buke bolje će se sprovoziti ovaj zakon, zato što se vrši podela odgovornosti na više institucija.

Poslanici parlamentarne grupe “6+” razmotrili su ovaj nacrt zakona i mišljenja smo da postoje ozbiljne primedbe sa kojim se ugrožava parvo na izražavanje vjerske slobode.

Kada je reč o izvorima buke u životnoj sredini u članu 4.2 gde kaže se :

Najveći izvori buke u životnoj sredini samatraju se drumski saobraćaj, železnički i vazdušni, uključujući opremu za prevoz i infrastrukturu, industriski uredzaji, radne i

gradjevine mašine, elektro akustična oprema verskih objekata i druga oprema koja se koriste u spoljašnjem prostoru.

Kao što se vidi u ovom pomenutom članu pored realnih izvora koje prouzrokuju buku ubrajaju se i vjerski objekti kao što su Džamije, Crkve, Katedrale i tako dalje.

Poslanici Parlamentarne grupe "6+" neće podržati ovaj nacrt zakona i neće glasati ZA iz razloga zato što se vjerski objekti u ovom nacrtu zakonu ubrajaju kao izvori buke.

Poslanici Parlamentarne grupe "6+" predlažu da se ovaj nacrt zakona vrati ponovo Vladi Kosova na ponovno razmatranje dabi ovaj nacrt zakona koji direktno krši vjersku slobodu bio preformulisano da se iz član 4.2 izbriše reč verski objekti u kome se kaže: Da su najveći izvori buke – elektro akustična oprema vjerskih objekata i druga prema kojima se koriste u spoljašnjem prostoru. Hvala puno.

KRYETARI: Në emër të Grupit Parlamentar të SLS, kryetari Sasha Millosavljeviq e ka fjalën.

SAŠA MILOSAVLJEVIĆ: Hvala predsedniče!

I Parlamentarna grupa Samostalne liberalne stranke razmotrila je zakon o zaštiti od buke i naša Parlamentarna grupa isto smatra da ovaj zakon treba da se vrati na doradu Vladi zbog člana 4.2.

Ukoliko ovaj zakon prođe danas u načelu, mi ćemo uložiti amandman za izmenu člana 4.2. Hvala vam!

KRYETARI: Faleminderit! Fjalën e ka deputeti Xhafer Tahiri.

XHAFER TAHIRI: Faleminderit, zoti kryetar!

I nderuar kryetar,

Të nderuar kolegë deputetë,

Është kënaqësi që për herë të parë t'i drejtohem këtij Parlamenti, meqenëse pak vonë jemi bashkuar, bashkë me kolegët këtu.

Për sa i takon ligjit, mendoj se gjuha e ligjit është një gjuhë mjaft problematike, mënyra se si është hartuar ligji është një gjuhë e cila, do të thotë, shkakton shumë paqartësi.

Në anën tjetër, ligji parasheh dhënie të lejeve mjedisore për emetuesit e zhurmave. Një gjë është dëshmuar në këto vite në Kosovë se lejet në radhë të parë janë shndërruar në pengesë të zhvillimit ekonomik në këtë vend dhe në një pengesë burokratike për biznese të ndryshme që duhet të shëtisin nëpër sportele të ministrive për leje të ndryshme. Dhe rrjedhimisht këto leje janë bërë edhe burim korrupsioni në institucionet të Republikës së Kosovës. Prandaj kjo është një vërejtje parimore për sa i takon ligjit dhe vërejtja tjetër ka të bëjë me kompetencat e komunave për sa i takon zbatimit të këtij ligji.

Unë besoj për aq sa të gjithë ne e dimë kapacitetet e komunave të Kosovës fatkeqësisht sot këto komuna nuk kanë kapacitete për të bërë vlerësime të ndikimit në mjedis të zhurmës.

Përgjithësisht mendoj se ligji është një avancim një raport me ligjin i cili ka qenë deri tash në Republikën e Kosovës, por mendoj se ka hapësirë që gjuha e cila është përdorur në këtë ligj të ndryshohet. Faleminderit!

KRYETARI: Fjalën e ka deputetja Blerta Deliu-Kodra.

BLERTA DELIU-KODRA: Faleminderit, kryetar!

Meqë, do të thotë qysh në fillim, Projektligji për zhurmën u tha që është, do të thotë nuk ka qenë në përputhje me standardet evropiane, ne si komision e kemi trajtuar dhe mund të them se Projektligji për zhurmën ka marrë do të thotë dritën jeshile nga Komisioni për Integritet, për faktin se me përmbushjet që janë bërë brenda ligjit dhe me kompletimet që janë bërë, do të thotë janë arritur standardet evropiane dhe që nuk bien ndesh me këto parime.

Dhe diçka që është për t'u vlerësuar janë pikërisht kompetencat shtesë dhe kompetencat që u jepen komunave brenda këtij projektligji që për mua është jashtëzakonisht i mirë dhe që nuk i sanksionon do të thotë siç u tha më herët zhurmat e kampanave, mirëpo i bën këto të pranishme konform edhe standardeve evropiane të cilat janë të cekura brenda ligjit. Faleminderit!

KRYETARI: Fjalën e ka deputeti Jeton Svirca.

JETON SVIRCA: Faleminderit, kryetar!

Të nderuar ministra,

Kolegë deputetë,

Tani jemi duke e shqyrtuar edhe Projektligjin për zhurmën dhe mund të them se të gjitha ato përmirësime pozitive të cilat janë bërë në ligj më pengon që ta përkrah një nen i cili është për mendimin tim antikushtetues të cilin e potencuan edhe kolegët më herët.

Unë nuk mendoj se duhet të lejohet të kalohet ky ligj në këtë formë të tillë pra siç është, për derisa ministri nuk e tërheq nenin 4.2, i cili thirrjen për lutje e konsideron si burim të zhurmës.

Ne konsiderojmë se kjo është një ofendim shumë i madh dhe nëse ministri apo shteti e ka për synim që të standardizojë, të bëjë unifikim të nivelit të lutjeve, këtë mund ta bëjë përmes bashkëpunimeve me bashkësitë fetare, qoftë bashkësinë islame apo bashkësinë katolike.

Ne jemi kundër pra këtij ligji për deri sa ky nen është pjesë e tij. Ju faleminderit!

Prandaj, një rregull duhet, një angazhim duhet, po ne duhet të jemi shumë të kujdesshëm kur i rregullojmë këto gjëra, sepse është fakt që unë e kam dëgjuar që po zhvillohet një propagandë, domethënë se do të ndalohej ezani. Shumë kohë, e po të lutem, shumë kohë e kam ndie këtë dhe sigurisht ka qenë, është folur se do të nxirret ky ligj për kufizim të zhurmës dhe njerëzit e kanë interpretuar në atë formë.

Çështja e mbrojtjes nga zhurma dhe çështja e një tradite që prek ndjenja të caktuara fetare dhe nacionale janë dy gjëra që nuk duhet të përzihen.

Ne duhet të jemi shumë të kujdesshëm e aq më tepër duhet të flasim me aktorët e interesuar, aktorët e interesuar janë qytetarët është Bashkësia Islame dhe në qoftë se ministri nuk ka shkuar ta bisedojë këtë problem dhe ta gjejë një zgjidhje, sepse unë besoj që edhe Bashkësia Islame është kundër zhurmës. Po edhe Bashkësia Islame edhe ata që kanë ndjenja të fesë islame nuk mund të lënë që ezani të trajtohet si zhurmë, përpos në rastet kur nëpërmes të ezanit dikush dëshiron të bëjë zhurmë të qëllimshme. Në qoftë se dikush e keqpërdorë ezanin të bëjë zhurmë të qëllimshme është diçka tjetër, por tradita e thirrjes së ezanit nuk mund të konsiderohet si zhurmë.

Prandaj, ju lutem zoti ministër, të keni kujdes, mos na krijoni probleme të panevojshme dhe të paqena në këtë shoqëri, se edhe kështu po krijohen probleme, dhe krejt debati i shoqërisë nesër ka për t'u orientuar që u ndalua ezani.

Kjo është shumë problematike. Kurrkush nuk e ka bërë problem shaminë në Kosovë e as nuk ka qenë temë diskutimi derisa është nxjerrë udhëzimi administrativ, i panevojshëm.

Edhe sot, është problemi qysh për ta hequr atë.

KRYETARI: Në temë, në temë!

MUHAMET MUSTAFA: Ju lutem, unë po flas, dhe kush do të flasë, le ta marrë fjalën.

KRYETARI: Pra, fol për ligjin!

MUHAMET MUSTAFA: Prandaj, po i përmbahem ligjit, mos ke gajle, por po tërheq vërejtjen: mos krijoni probleme të panevojshme. Zgjidhni me kujdes këto probleme, mos i përzini zhurmën me traditat dhe ndjenjat e qytetarëve.

KRYETARI: Ju lutem, në temë! Kurrkush në ligj nuk e thotë asnjë fjalë kundër ezanit, po kundër mikrofonave, zhurmës. Prandaj, dalloni çka është zhurma e çka është ezani, se jeni deputetë dhe duhet të jeni në vlerat në të cilat është përpunuar edhe është punuar ligji.

KRYETARI: Fjalën e ka deputetja Ganimete Musliu.

GANIMETE MUSLIU: Faleminderit, i nderuar kryetar!
Të nderuar ministra,

Zëvendëskryeministër,

Kolegë deputetë,

Parimisht e mbështes ligjin dhe është një projektligj shumë i nevojshëm për shtetin tonë dhe gjithashtu dua të mbështes ose thjeshtë dua të përkrah zëra të cilët thërrasin sot që ezani dhe kambanat të hiqen nga emërtimi i klasifikimit si mjete të zhurmës dhe gjithashtu kisha pasur dëshirë që mos të thirremi shumë në standardizime evropiane, sepse u fol shumë këtu më herët, sepse ne e dimë të gjithë nëse je privatisht e zyrtarisht dhe njëri prej neve kemi frekuentuar shtetet dhe kryeqytetet botërore, ose evropiane, dhe gjithkund kudo që kemi shkuar kemi dëgjuar kambanat e kishave ose edhe të xhamive, aty kur kanë qenë evidente dhe nuk janë klasifikuar si zhurmë dhe nuk ka të bëjë me procese ose standardizim evropian.

Kisha dashur t'i sugjeroj ministrit që të gjejë një fjali ose një modus tjetër të emërimit të ezanit dhe të kërkojë ndoshta që kishat dhe xhamit të bëjnë standardizimin me decibelët e ezanit që unë konsideroj që nuk ka fare nevojë të futet në ligj, sepse me një marrëveshje ose me një memorandum bashkëpunimi do të pajtohen edhe kishat edhe përfaqësuesit e kishave edhe të xhamive që të rregullohet me decibel standardizimi i zërit, qoftë i ezanit, qoftë i kambanave.

Unë nuk jam që ky nen të jetë kështu siç është në këtë ligj, prandaj do t'i bashkëngjiten grupit i cili kërkon që të bëjë një riamendamentim ose një amendamentim shtesë për këtë ligj.

Mendoj se qasja e tillë ndaj lirive fetare nganjëherë po na shpie drejt tabuzimit të temave dhe unë në jetën time sa mbaj në mend asnjëherë në Kosovë nuk ka qenë tabu të flasësh për cilëndo fe, pavarësisht qoftë ajo myslimane, krishtere apo diçka tjetër dhe unë konsideroj që në Kosovë toleranca fetare është klasifikuar si vlerë, prandaj lus edhe kolegët deputetë edhe iniciuesit e këtij ligji që të kontribuojnë të gjithë që toleranca fetare edhe më tutje të vlerësohet si vlerë në Republikën e Kosovës. Faleminderit!

KRYETARI: Ministri e ka kërkuar fjalën.

MINISTRI DARDAN GASHI: Faleminderit zoti kryetar!

Të nderuar kolegë të Kabinetit të Qeverisë,

Deputetë të nderuar,

Me rëndësi ndoshta është diçka të potencohet, që u potencua këtu edhe prej profesorit dhe prej tjerëve, bashkëpunimi me bashkësitë fetare, posaçërisht me Bashkësinë Islame prej fillimit deri tash e do të vazhdojmë edhe në të ardhmen të bashkëpunojmë.

Ky nen është përpiluar pas konsultimeve me këto bashkësi dhe jemi dakorduar që kur të vjen radha e përpilimit të udhëzimit administrativ ku potencohen edhe decibelët edhe pjesë tjera, do të draftohet bashkërisht dhe nuk do të hyjë në fuqi pa miratimin e të gjithëve.

Do të thotë, nuk është fjala për ezanin si ndotës, do të thotë, të mjedisit ose të zhurmës, fjala është për mjetet akustike të cilat në disa pjesë me qëllim ose pa qëllim i tejkalojnë të

gjitha suazat e akceptueshme dhe krijojnë shqetësime. Këto kanë ardhur si shqetësime të banorëve, si shqetësime pra të votuesve dhe të banorëve të Republikës së Kosovës.

Prandaj, nuk është fjala ndaj asnjë feje, nuk ka nevojë për asnjë gardian të shpallur të fesë, fjala është se ligji i trajton të gjithë bashkë, është pjesë e Kushtetutës edhe mbrojtja e qytetarëve nga zhurma, pra pjesa e udhëzimit administrativ do ta rregullojë edhe pjesën se me çfarë, ku do të dakrodohemi edhe si shoqëri edhe si bashkësi fetare, që është toleranca për zona urbane për qytetarët e Kosovës. Dhe, po ju lus të mos politizohet, nuk ka nevojë të politizohet, është një ligj shumë i saktë dhe udhëzimi administrativ do të jetë shumë i saktë dhe do t'i respektojë në maksimum ndjenjat fetare, kombëtare dhe qytetare. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Jo, s'ka replikë. Fjalën e ka deputetja Myzejene Selmani.

MYZEJENE SELMANI: Faleminderit, i nderuar kryetar!

Unë desha ndoshta të kyçem me vonesë, për arsye se më duket jo e mirë për ne si deputetë të aludojmë në bashkësitë fetare duke marrë parasysh se Kushtetuta jep mundësinë që të gjitha bashkësitë fetare të cilat jetojnë në Kosovë kanë të drejta të barabarta dhe më shtyri që të lexoj nenin 4 të këtij ligji – burimet e zhurmës në mjedis.

Unë kisha kërkuar që mos të politizojmë me fenë, ndoshta është mundësia më e mirë që Kosova i ka të gjitha identitetet e feve të cilat ekzistojnë në Kosovë, janë begatia më e madhe që e ka Kosova. A do të ketë kisha do të ketë xhami, është shumë pak me rëndësi, me rëndësi është që të gjithë flasim shqip dhe problemi është në rast se dikujt i pengojnë këto, mos të politizohet Kuvendi i Kosovës. Ju kisha lutur në mënyrën më të sinqertë!

Në rast se ministri thotë që kjo s'ka të bëjë me atakimin e thirrjes së ezanit, ministri besoj se ka jetuar në Kosovë dhe e din mjaft mirë kur thirret ezani, në çfarë kohe thirret ezani, ndërsa çështja e kishave kur ato kambana të lëshohen, s'duhet të hyjë në ato ceremoni fetare mirëpo në fakt mos të politizojmë shumë me fenë në Kuvend, ju lutem!

KRYETARI: Fjalën e ka deputeti Enis Kervan.

ENIS KERVAN: Faleminderit, kryetar!

Öncelikle bu Yasa Tasarısının Hükümetten Parlamentoya gelmesini kınıyorum, Hükümtte durdurulmalıydı bu Yasa Tasarısı. Söz konusu bakanlık mahvolan Kosova doğasının ağaçlarının yasa dışı şekilde günden güne mahvolmaya devam ediyor, bunu bi engellesin, ondan sonra ses kirliliği adı altında ezan sesini kısıtlamaya gidecek bu yasa tasarısını Meclise sunsun. Eminim Kosova vatandaşları bugün burada ak ve karayı ayırdetme durumundadırlar. Bugüne kadar ezan sesi kısılmamıştır, ezan sesi Kosovanın zenginliğidir, tabi ki diğer diğer dinlerin de kendi obje ve kendi kurumlarının çerçevesinde bunlara uyum getirmeleri söz konusu olabilir. Fakat ses kirliliği adı altında ezan sesini kısıtlayacak pozitif de ne derseler desinler, hiçbir yere, hiçbir önergeye yokuz, hiçbir yasa tasarısına yokuz. Bu sefer eminim milletin sabrını gerçekten taşıyorsunuz sayan bakan ve eminim millet buna susmayacaktır, susmaması da gerekmektedir. Yüzde 96 İslam dinine mensup olan bir ülkede ezan sesi ses kirliliği Yasa Tasarısına giderse, bu

sadece bu Avrupa hukukuna aykırı değildir, insan hukuklara da aykırıdır. Dediğim gibi bu konuda direteceğizdir, sonuna kadar yasa parlamentoda değil, Hükümete geri iade edilmelidir, sonuna da ne gerekiyorsa tutumumuzu iletmeye hazırız, yeter ki ses kirliliği ile dini değerler bir araba getirilip önümüze sunulmasın.

KRYETARI: Fjalën e ka deputetja Alma Lama.

ALMA LAMA: Faleminderit, zoti kryetar!

Edhe unë i bashkëngjitëm pjesës më të madhe të deputetëve të cilët e vlerësojnë ligjin dhe desha t'ju kujtoj disave që Shekspiri e ka shkruar një komedi me titullin "Shumë zhurmë për asgjë".

Edhe zhurma që po tentohet të krijohet në lidhje me Ligjin ose Projektligjin për zhurmat, është shumë zhurmë për asgjë, në rast se nuk ka ndonjë agjendë tjetër antishqiptare, pas kësaj. Pra," shumë zhurmë për asgjë".

Shteti është neutral ndaj të gjithëve dhe duhet të gjejë atë mesin e artë në mënyrë që t'i akomodojë të gjithë njerëzit brenda tij, jo vetëm një komunitet të caktuar dhe jo vetëm një grup të caktuar, i çfarëdolloji të jetë ai, shteti është ai që përkujdeset për të gjithë, i trajton të gjithë si të barabartë.

Personalisht, për shembull, mua më pengon jashtëzakonisht shumë zhurma e motorëve që lëvizin me shpejtësi, kanë një zhurmë aq çjerrëse dhe të padurueshme. Nuk e di nëse ky projektligj besoj se do të duhej t'i neutralizonte, t'i ndalonte që të qarkullojnë në qytet, zoti ministër, apo jo, është tepër shqetësuese.

Kjo nuk do të thotë që ne duhet, që ne jemi ose unë jam kundër këtij lloj mekanizmi qarkullues, prandaj edhe një herë, mos të bëjmë zhurmë për asgjë. Shteti është faktori neutral, duhet t'i akomodojë të gjithë. Faleminderit!

KRYETARI: Fjalën e ka deputeti Amir Ahmeti.

AMIR AHMETI: Faleminderit, kryetar!

I nderuar kryetar,

Kabinet qeveritar,

Kolegë deputetë,

Qytetarë të Kosovës,

Kosova vërtet ka pasur nevojë për një ligj kundër zhurmës, po për këtë ligj që na e ka sjell ministri Gashi, nuk ka pasur nevojë.

Pra, këtij projektligji i mungon gjuha juridike, ka konfuzitet në këto nene, mes detyrave të komunave dhe të Qeverisë.

Nenet 4, 12, 15 dhe 20 kanë kundërthënie të mëdha njëri me tjetrin dhe si të tillë pra e vlerësova se këtij projektligji i mungon gjuha juridike.

Në vitin 2012, Ministria e Mjedisit, respektivisht Agjencia për Mbrojtjen e Mjedisit i cili ka marrë një detyrë prej Ministrisë së Mjedisit dhe është paguar dhe ka investuar Ministria e Mjedisit për këtë Agjenci për të zbuluar dhe për të bërë një publikim në vitin 2012 se cilat janë burimet e zhurmës.

Sipas raportit të vitit 2012 të Agjencisë për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës, pra Agjencia e Ministrisë së Mjedisit, del me rezultatin se burimet e zhurmës të cilat arrijnë mbi 70 decibelë janë trafiku, industrinë dhe ndërtimet.

Askund raporti i Agjencisë për Mbrojtjen e Mjedisit, Agjenci e Ministrisë suaj – ministër Gashi, nuk i përmend si burim të zhurmës pajisjet akustike të objekteve fetare.

Ministria e juaj, respektivisht ju ministër, po punoni me dy standarde, në njërën anë me pretekstin e konsultimit me komunitetin, vitin e kaluar e keni ndaluar ndërtimin e një xhamie me leje komunale se kinse Bashkësia Islame e Prishtinës nuk është konsultuar me komunitetin edhe përkundër 1300 nënshkrimeve që ka pasur.

Ndërsa, për këtë ligj, që na e keni sjell në Kuvend, nuk jeni konsultuar me komunitetin. Atje e keni ndalë punën e xhamisë për shkak të mos konsultimit kinse me komunitetin, ndërsa këtu ju s'jeni konsultuar.

Kam qenë prezent me një vend kur ju ministër i keni afruar kryetarit – kryeimamit të Bashkësisë Islame të Kosovës, bashkëpunim për këtë ligj, por më vjen mirë që dole për së dyti për të folur dhe po mundoheni ta manipuloni opinionin se jeni konsultuar. Nuk është e vërtetë, ju i keni ftuar zyrtarët e bashkësive fetare dhe ua keni dhënë

KRYETARI: Të lutem, Amir, për ligjin meqë e kemi këtu.

AMIR AHMETI: Për atë jam duke folur, sepse ministri tentoi të manipulojë publikun dhe deputetët se kinse është konsultuar në bashkësitë fetare, nuk është konsultuar, ua ka dorëzuar të njëjtin projektligj që na e ka sjell neve, domethënë para një akti të kryer dhe nuk është e vërtetë. Domethënë ka munguar konsulta me bashkësitë fetare dhe plotësisht pajtohem me deputetin Demiri dhe deputetin Kelmendi që ky ligj të kthehet. Është thjeshtë një rresht i cili duhet të shlyhet nga neni 4, respektivisht pika 2 e këtij neni, sepse është në kundërshtim me të gjithë atë që ato që i thanë edhe kolegët e mi, por është edhe në kundërshtim me raportin e vetë Ministrisë tënde e cila ka dalë me raportim në vitin 2012.

Lus deputetët që të mos e votojnë këtë projektligj pa u bërë ky ndryshim. Ju faleminderit!

KRYETARI: Krejt po silleni rreth një neni. Ju keni të drejtë ta amendamenti ligjin dhe nuk di pse për një nen të kthehet ligji, ku keni parë. Për çka jemi ne këtu për ta amendamentuar ligjin.

Fjalën e ka deputeti Daut Haradinaj.

DAUT HARADINAJ: Kryetar!

Meqenëse ky ligj është në lexim të parë, ne kemi mundësi që gjatë amendamentimit edhe për ndonjë ndryshim në qoftë se biem në dakord në kuadër të Komisionit funksional ta bëjmë.

Po nuk po shihet këtu që në nenin 4 atakohet direkt ndonjë sekt fetar, pavarësisht se po flitet për zhurmën e jashtme, jo për zhurmën e objekteve fetare. Domethënë është e cituar saktësisht zhurma e jashtme.

Por megjithatë, edhe një herë po them, ne kemi mundësi në Komisionin Parlamentar që ta bëjmë amendamentimin gjatë punës që jemi aty bashkë, janë prezent edhe deputetët të cilët janë kundër, vijnë marrin pjesë, të bëjnë ndonjë amendamentim të tyre dhe ne jemi të gatshëm të bashkëpunojmë, edhe pse nuk është kryetari i Komisionit këtu, unë besoj se jemi të gatshëm të punojmë dhe procedojmë këtë ligj. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Dhe, diskutuesi i fundit për këtë është deputeti Fikrim Damka.

FIKRIM DAMKA: Teşekkür ederim sayın başkan, değerli bakanlar ve milletvekiller, Asla bu Yasayı, daha doğrusu yasadaki ezanı siyaselleştirmek amacımız değil. Fakat Yasada ezanın bir ses kirliliğine neden olacak şekliyle belirtilmesi tabi ki siyaselleştirilecektir, tabi ki biz buna karşı çıkacağız. Çünkü hiçbir zaman burada ezan sesi ses kirliliğine neden olmuş değildir. Tam aksine hupur veren bir sestir. O yüzden bizim vereceğimiz öneri çerçevesindeki bu 4.2 maddenin içeriğinde kaynağın camiler veya kliselerin olmadığını belirtmektir. Çünkü bu bir dini yapıdır ve dini çağrıdır. O yüzden bzi yasanın tümüne karşı değiliz, elbetteki seslerin düzenlenmesi, ses kirliliğine neden olacak araç gereşlerin belirtilmesi ve düzenlenmesi gerektiğine inanıyoruz. Ama asla ezan sesinin buna neden olduğuna karşı olacağımızı, ilk defa daha doğrusu bunu irade etmek sitiyoruz. İnanıyorum ki bu hem öneri gereği, hem bakanın geri adım atmasıyla düzelterceğine inanmaktayım.

Teşekkür ederim.

KRYETARI: Nuk ka të lajmëruar për diskutim. Shkojmë në votim.

Lus deputetët dhe regjinë të përgatiten për votim. Të pranishëm janë 66 – 67 deputetë dhe votojmë tash.

Me 38 vota për, 30 kundër miratohet në parim Projektligji numër 04/L-238 për mbrojtjen nga zhurma.

Ngarkohet Komisioni Funksional dhe komisionet e përhershme që në afatin e paraparë me Rregulloren e Kuvendit ta shqyrtojnë Projektligjin dhe Kuvendit t'i paraqesin raportin me amendamente.

Vazhdojmë me pikën e nëntë të rendit të ditës:

9. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për Zonën e rrezikuar mjedisore të Obiliqit dhe rreth tij

Projektligji është propozuar nga deputeti Agim Kuleta dhe grupi i deputetëve nënshkrues.

Qeveria e Kosovës brenda afatit të përcaktuar e ka paraqitur mendimin lidhur me këtë projektligj, me vlerësimin se kjo fushë është e mbuluar me legjislacionin për mjedis si dhe ka rekomanduar që disa nene të rishikohen dhe të harmonizohen me legjislacionin për menaxhimin e financave publike.

Në bazë të nenit 56 të Rregullores së Kuvendit, Komisioni Funkcional ka shqyrtuar Projektligjin dhe Kuvendit i ka rekomanduar për miratim në parim.

Ftoj deputetin Agim Kuleta, në cilësinë e propozuarit që para deputetëve të Kuvendit ta paraqesë dhe arsyetojë projektligjin.

AGIM KULETA: Zoti kryetar i Kuvendit,

Zonja dhe zotërinj deputetë,

Ligji për zonën e rrezikuar mjedisore të Obiliqit dhe rreth tij themelon bazën ligjore për përcaktimin e komunës së Obiliqit dhe rrethinës së saj si zonë me status të veçantë mjedisor, përcakton masat mbrojtëse dhe masat tjera shtesë për përmirësimin e kushteve të jetesës së banorëve të kësaj zone si dhe përcakton mekanizmat për zbatimin e këtyre masave.

Pse ligj i veçantë për Obiliqin?

Obiliqi dhe zona rreth tij, në disa aspekte diferencohet nga zonat e tjera të vendit, si zonë e veçantë, mirëpo, fatkeqësisht, ky diferencim deri më tash përbën vetëm lajm të keq për këtë zonë.

Ajo si pasojë e këtij statusi deri më sot ka njohur vetëm dëme të vazhdueshme me kosto shumë të lartë e me shumë aspekte.

Unë dua t'i numëroj me këtë rast katër karakteristika dalluese të saj:

1. Përbën zonën më të ndotur në tërë territorin e vendit;
2. Përbën burime rreth 98% të energjisë elektrike për tërë vendin;
3. Pasuria nëntokësore që shfrytëzohet për prodhimin e kësaj energjie ndodhet në territorin e kësaj komune dhe rreth saj, dhe
4. Në emër të shfrytëzimit të kësaj pasurie nga ana e operatorit ekonomik, Qeveria e Kosovës çdo vit në emër të tantiemës merr mbi 20 milionë euro.

Pra, është e qartë se burimi kryesor i ndotjes në këtë komunë janë termocentralet, po sikur të mos mjaftonin vetëm dëmet që kësaj zone i shkaktohen nga termocentralet, atje në fshatin Mirash është vendosur edhe Deponia Regionale ku grumbullohen mbeturinat edhe të komunave të tjera për rreth.

Përveç kësaj në Milloshevë është lejuar deponimi, në deponi private, jashtë çdo standardi i një lënde shumë të rrezikshme që transportohet nga “Trepça” e që quhet pirit.

Kjo lëndë paraqet rrezik shumë të lartë dhe shkakton dëme shumë dimensionale duke qenë se gjendet mbi tokë të punueshme, buzë magjistrales dhe në afërsi të vendbanimeve.

Ndërsa, historinë në vete është çështja e moslejimit të kësaj komune për kyçje në rrjetin primar të ngrohjes me avull të termocentraleve. Pra, është absurde që avullin e termocentraleve, të cilat vjellin pluhur e gazra mbi Obiliqin ta shfrytëzojë kryeqyteti e një gjë e tillë të mos lejohet kësaj komune, sidomos kur kemi parasysh faktin që kjo do të ndikonte drejtpërsëdrejti në reduktimin e ndotjes së ajrit, sepse bie që një prej faktorëve kryesorë që numërohen kur është në pyetje ndotja e ajrit, është ngrohja shtëpiake me thëngjill.

Siç po shihet, të nderuar, Obiliqi nuk trajtohet ndryshe veç se si një makinë gjeneruese e të mirave, e mbushur me hi, mbeturina e helme ku aksidentalisht ka qëlluar të jetojnë edhe disa njerëz të cilët për fat të mirë janë “përshtatur” me një mjerim të tillë.

Nuk ka dyshim që në praktikë kemi të bëjmë me një status, situatë të veçantë, nga e cila zona fiton vetëm dëme, e në anën tjetër kemi të bëjmë me një fakt që ky status nuk i njihet ligjërisht, gjë që do të ndikonte në zbutjen e këtij dëmi që i shkaktohet asaj.

Pra, arsyeja kryesore për një ligj të tillë është vetë nevoja e jashtëzakonshme për të, është nevoja për rregullimin juridik të një situate faktike.

Ne mund të themi që kemi ligje që rregullojnë çështjen e mjedisit, por pikërisht trajtimi i njëjtë ligjor i zonave me gjendje radikalisht të ndryshme faktike, është baza e diskriminimit që i bëhet zonës së Obiliqit me rrethinë.

Fakti tjetër, që arsyeton nevojën për një ligj të veçantë është efektiviteti i tij, duke qenë zonë me specifika dalluese prej pjesës tjetër, kërkon edhe trajtim specifik.

Vetëm një ligj, masat dhe zbatimi i të cilit është i fokusuar ekskluzivisht në këtë zonë, mund të japë efekte të nevojshme për të.

Dhe, arsyeja e tretë ka të bëjë me faktin që ky ligj parasheh edhe disa masa të tjera të natyrës sociale e shëndetësore që nuk janë të parapara në ligje apo akte të tjera nënligjore.

Zonja e zotërinj,

Sipas një raporti të Bankës Botërore, ndotja e ajrit llogaritet së është shkaktar i drejtpërdrejtë i 835 vdekjeve, shkaktar i 310 rasteve të bronkitit kronik, shkaktar i 600 shtrirjeve në spital dhe i 11 600 vizitave në emergjencë për çdo vit.

Ndërsa, në një raport të mëhershëm të Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, thuhet se në regionin e Obiliqit, ku ndodhen centralet, ndotja e ambientit është

përgjegjëse për 63% të vdekjeve të fëmijëve dhe 48% të fëmijëve të cilët lindin të vdekur, si pasojë e mjedisit të kontaminuar atje lindin fëmijë me të meta.

Ndërsa, sipas Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare në Obiliq janë mbi 20 raste me kancer në çdo vit që paraqiten për herë të parë. Po sipas kësaj qendre, shumica prej tyre duhet të trajtohen jashtë vendit. Nuk po flas këtu pastaj për rastet e panumërta të sëmundjeve të ndryshme që kanë të bëjnë me sistemin e frymëmarrjes dhe sëmundjeve të tjera që shkaktohen si pasojë e ndotjes.

Pra, pa pasur nevojë për më tepër statistika këto që përmenda janë të mjaftueshme për të konstatuar se gjendja në këtë komunë është alarmante dhe nuk pret, pra kërkon veprim të menjëhershëm. Përveç aspektit shëndetësor, kjo zonë është e dëmtuar gjithashtu edhe në aspektin ekonomik. Përveç pamundësisë së punësimit në termocentrale për shkak të nepotizmit dhe punësimit në bazë të lidhjeve e interesave tjera të ngushta, aty është mohuar edhe mundësia që ekzistencën ta sigurojnë përmes zhvillimit të biznesit rural.

Duke qenë se kemi të bëjmë me një ambient të kontaminuar, produktet që do të mund të prodhoheshin në këtë zonë nga fusha e blegtorisë e bujqësisë konsiderohen kancerogjene dhe si të tilla nuk mund të sigurojnë treg. Shembuj të tillë gjatë debateve që kam zhvilluar me banorët e zonës kam hasur shumë dhe kjo që në fakt është pasojë në vete prodhon edhe një pasojë tjetër, rënien e vazhdueshme të vlerës së pronës së paluajtshme, si të asaj të destinuar për banim, ashtu edhe të asaj që njihet si tokë e punueshme.

Përkundër këtyre fakteve është evidente që Komuna e Obiliqit është një vend, për të cilin ne pjesa tjetër e vendit vazhdimisht jemi kujdesur që ta shfrytëzojmë, por kurrë nuk jemi kujdesur seriozisht ta mbrojmë atë nga pasojat e këtij shfrytëzimi.

Në fakt Obiliqi trajtohet saktësisht ashtu siç trajtohet në raportet ndër njerëzore një skllav, shfrytëzohet nga të gjithë deri në sfilite e nuk kujdeset askush për shëndetin dhe mirëqenien e tij. Prandaj, duke i pasur parasysh këto ky ligj nuk duhet shikuar si privilegjim i kësaj zone apo diskriminim i komunave të tjera, ky ligj është veç një përpjeke për ta zbutur diskriminimin që është i është bërë dhe i bëhet vazhdimisht asaj.

Të nderuar deputetë,

Sipas po të njëjtit raport të Bankës Botërore, kostoja vjetore e degradimit mjedisor në Kosovë llogaritet diku 222 milionë euro. Kjo kosto është ekuivalente me një mesatare prej 5,3% të bruto-produktit vendor dhe rol shumë dominues në këto statistika pa dyshim që luan Obiliqi.

Pra, përkundër faktit që veprimi në mbrojtje të ambientit gjithmonë ka një kosto, nuk duhet kurrë të harrojmë që kostoja e mosveprimit është gjithherë më e lartë. Obiliqi është sinonim i kësaj të vërtete të shëmtuar, Obiliqi ka nevojë të padurueshme për ligj, ka nevojë për këtë ligj që sot e kemi para vetes. Dhe që ky ligj të jetë i tillë çfarë është, pra sa më i përputhshëm me nevojat reale, ne kemi punuar mjaftë gjatë, kemi hulumtuar raporte të ndryshme, jemi konsultuar me ekspertë të fushave të ndryshme, e kemi vizituar

zonën, kemi zhvilluar debate të shumta publike me qytetarë, me shoqërinë civile dhe përfaqësues të institucioneve shtetërore.

Ndërsa sa i përket bazës juridike për këtë ligj në qoftë se kjo do të përbënte brengë për dikë, unë rikujtoj nenin 2, pika 3 të Ligjit mbi vetëqeverisjen lokale i cili përbën bazën ligjore për miratimin e legjislacionit të posaçëm, për t'i dhënë status dhe kompetenca të posaçme, përveç kryeqytetit edhe qyteteve tjera.

Prandaj, konsideroj që ky ligj do ta komplotojë edhe më tej kornizën ligjore të kësaj fushe dhe do t'i forcojë edhe më tutje institucionet kompetente në funksion të përmbushjes së objektivave mjedisore të përcaktuara në bazë të standardeve të parapara në derikativat e Bashkimit Evropian.

Në fund, ju lutem që të tregoni ndjeshmërinë e nevojshme për një situatë të tillë dhe të votoni pozitivisht për këtë projektligj, idetë për pasurimin e mëtutjeshëm të tij nga ana juaj do të jenë të shumë mirëpritura. Faleminderit!

KRYETARI: Nga Qeveria, e do dikush fjalën? Jo. Në emër të Komisionit, fjalën e ka deputeti Rasim Demiri.

RASIM DEMIRI: Hvala, predsedniče!

Komisija za poljoprivredu i sredinu na osnovu člana 56 stava 2 Pravilnika skupštine na sjednici održanoj dana 21.1.2014.godine, razmatrala je u načelu nacrt zakona o ugroženoj zoni životne sredine Obilića i njegove okoline i odlučila da Skupštini predlaže sledeću preporuku.

Da se usvaja u načelu nacrt zakona o ugroženoj zoni životne sredine Obilića i njegove okoline, uz obrazloženje da ovaj nacrt ispunjava uslove iz člana 54 Pravilnika Skupštine i preporučio istu za usvajanje u načelu. Hvala!

KRYETARI: Radha është e grupeve parlamentare. Në emër të Partisë Demokratike, kush e do fjalën? Deputeti Ramiz Lladrovci e ka fjalën.

RAMIZ LLADROVCI: Faleminderit, kryetar!

I nderuar zëvendëskryeministër,
Ministër,

Të nderuar kolegë deputetë,

Edhe Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës e ka shqyrtuar Projektligjin për zonën e rrezikuar mjedisore të Obiliqit dhe rreth tij dhe e ka vlerësuar se projektligji i plotëson kushtet e parapara për miratim në parim.

Kontributin tonë do ta japim në grupet punuese, në komisionet përkatëse. Ftojme deputetët që ta votojnë në parim. Faleminderit!

KRYETARI: Në emër të Lidhjes Demokratike, deputetja Afërdita Berisha-Shaqiri e ka fjalën.

AFËRDITA BERISHA-SHAQIRI: Faleminderit, i nderuar kryetar!

Të nderuar ministra,

Të nderuar deputetë,

Gazeta britanike ‘Guardian’, në nëntor të vitit 2013, ka bërë një artikull të gjatë për Kosovën duke e vlerësuar si vendin më të ndotur në Evropë. Ajo sjell rrëfimin e banorëve të Obiliqit që jetojnë në afërsi të tymtarëve të termocentraleve.

Nuk ka qenë e lehtë që të gjendet balancë në mes të nevojës urgjente të Kosovës për të siguruar energji dhe të efekteve helmuese të linjtit, të burimeve të saj që janë në dispozicion në natyrë. Kosova zë vendin e pestë sa i përket rezervave me linjit nga e cila prodhohet 97% e energjisë. Vlerësohet se nivelet aktuale të konsumit mund të furnizojnë edhe për të paktën për 1500 vjetët e ardhshme.

Komuna e Obiliqit me rrethinë përbën një rast të veçantë nga komunat e tjera, për disa arsye - përbën zonën më të ndotur në Kosovë, burimin e 97% të energjisë elektrike për tërë vendin, pasuria nëntokësore që shfrytëzohet për prodhimin e kësaj energjie ndodhet në territorin pikërisht të kësaj komune. Sa i përket dëmeve mjedisore dhe shëndetit të njeriut kjo komunë është e rrezikuar nga sëmundjet e ndryshme që vijnë nga ndotja e ambientit.

Prandaj, miratimi i këtij ligji është më se i nevojshëm, sidomos për popullatën e kësaj komune, të paktën t’i përfitojë benefitet që mund t’i sjellë miratimi i këtij ligji.

Anëtarët e Komisionit të Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Kosovës e kanë përkrahur iniciativën e deputetit në komision. Në parim e mbështesim këtë projektligj dhe kontributin tonë do ta japim gjatë shqyrtimit dhe amandamentimit të tij në komision. Faleminderit!

KRYETARI: Në emër të Grupit “Vetëvendosje”, deputeti Faton Topalli e ka fjalën.

FATON TOPALLI: I nderuar, kryetar!

Të nderuar deputetë,

Komuna e Obiliqit është një prej komunave të vogla, por me një rëndësi dhe ndikim të veçantë për jetën qytetarëve në gjithë Kosovën, posaçërisht për ekonominë e Kosovës.

Çmimin të cilin e paguajnë qytetarët e Obiliqit, por edhe të Fushë Kosovës dhe të Prishtinës është shumë i lartë. Ndërtimi i termocentraleve ka pasur pasoja të shumta për banorët e zonës, prej kontaminimit të tokës, ujit, ajrit e deri tek problemet e rënda shëndetësore.

Qyteti në mes dy termocentraleve “Kosova A” dhe “Kosova B”, që kundërmon nga era e rëndë dhe lirimi i gazrave të dëmshme për shëndetin, po ndryshon jo vetëm shëndetin, por edhe relievin e komunës përmes brigjeve të krijuara të hirit. Si pasojë e ndotjes së ambientit qytetarët e Komunës së Obiliqit lëngojnë nga sëmundjet e ndryshme, prej atyre të frymëmarrjes e deri tek sëmundjet kanceroze.

Edhe pse Komuna e Obiliqit ka vetëm 21 549 banorë gjatë vitit 2012 në Qendrën Shëndetësore të Obiliqit ka pasur 57 520 vizita mjekësore, që i bie që secili qytetar i Komunës së Obiliqit të ketë qenë së paku dy herë për kontroll mjekësor.

Të dhënat e Qendrës Klinike Universitare të Kosovës gjithashtu tregojnë që nga sëmundjet e organeve të frymëmarrjes në Obiliq, respektivisht niveli i tyre është 50% më i theksuar në këtë komunë se sa në komunat tjera.

Qeveria e Kosovës më 13 mars 2009 ka shpallur 75% të zonës së Obiliqit si zonë me interes të veçantë ekonomik. Në këtë zonë hyjnë edhe zona kadastrale e Fushë-Kosovës, Drenasit dhe Vushtrisë. Shpallja e territorit të Komunës së Obiliqit si zonë me interes të veçantë ekonomik do të duhej të ishte një lajm i mirë për banorët e zonës, por në fakt është e kundërta.

Banorët e Obiliqit edhe pse jetojnë në skaj të një gjiganti ekonomik me interes të veçantë për ekonominë e vendit, përfitojnë pak, për të mos thënë fare nga thesari skaj shtëpive të tyre. Ata nuk kanë pasur asnjë prioritet në fushën e punësimit, madje shpesh mbeten pa rrymë edhe pse rryma për gjithë Kosovën prodhohej para shtëpive të tyre.

Nëse termocentralet në Obiliq i sollën dobi të madhe Kosovës dhe zhvillimit ekonomik të saj, banorëve të zonës u sollën vetëm mjerim, ndotje të ujit, ajrit dhe tokës, shkatërrim të shëndetit dhe tash së fundi edhe problemin e qëndrueshmërisë së vendbanimeve ku jetojnë.

Grupi Parlamentar i Lëvizjes “Vetëvendosje” konsideron që është përgjegjësi e të gjitha institucioneve të Kosovës t’i mbështesin banorët e zonës së Obiliqit, Fushë Kosovës dhe të Prishtinës për ta ruajtur ambientin dhe shëndetin e tyre. Në këtë kuptim Grupi Parlamentar i Lëvizjes “Vetëvendosje” është në parim që ky ligj të aprovohet, problemi i ndotjes së ambientit dhe pasojat e tij për shëndetin godasin më shumë banorët e Obiliqit, por pjesërisht edhe të komunave të tjera, si Fushë-Kosova dhe Prishtina.

Ne do të dëshironim që ligji t’i përcaktojë zonat me status të veçantë në bazë të hartave të ndotjes së ambientit, jo të gjitha territoret e një komune i nënshtrohen njësoj nivelit të ndotjes. Pra, për mendimin tonë bazë për përcaktimin e statusit të veçantë të jetë territori i ndotur dhe jo kufijtë administrativ të komunës.

Teksti i ligjit të shtruar para nesh përcakton Komunën e Obiliqit si palë të vetme për ndërmarrjen e masave kundër burimeve të ndotjes. Komuna e Obiliqit në fakt mund të operojë dhe ndërmarrë masa brenda territorit të vet, por jo edhe në komunat tjera. Përderisa, ndotja përfshin edhe komunat tjera do të duhej që të krijohet një mekanizëm i përbashkët i cili do t’i administronte këto masa në nivel komunal.

Për këtë qëllim pra do të duhej të krijohet një trup i përbashkët. Në fakt ekziston një komision, është paraparë një komision mbikëqyrës qendror e shtetëror, në të cilën marrin pjesë disa ministri dhe përfaqësues të komunave të Obiliqit, Fushë Kosovës dhe

Prishtinës, por ky komision mbikëqyrës ka vetëm karakter mbikëqyrës të implementimit të ligjit, por nuk ka detyra ekzekutive.

KRYETARI: Aleanca, kush e kërkon fjalën? Deputeti Daut Haradinaj e ka fjalën në emër të Aleancës.

DAUT HARADINAJ: Faleminderit, kryetar!

Fillimisht unë e përshëndes deputetin Kuleta dhe jam mbështetës po ashtu i këtij projektligji.

Mendoj se është i një rëndësie të veçantë për këtë komunë e cila të themi në gjuhën popullore :“jeton në ar e s’ka bukë”. Këta jetojnë dhe japin rrymë gjithë Kosovës e vet nuk janë të trajtuar në kategorinë A. Domethënë, ky ligj edhe pse është pak i përgjyqsuar unë mendoj që gjatë punës në komision ne do ta bëjmë amandamentimin e tij dhe mendoj që duhet t’i japim përparësi qytetarëve, të cilët jetojnë në Obiliq dhe rrethinë, po ashtu edhe në Fushë Kosovë, dhe pse jo në pjesë të Drenasit, i cili goditet drejtpërdrejt nga ndotja e dy termocentraleve A dhe B.

Çka kishte pasur një send që është shumë me rëndësi, ky ligj nuk bien ndesh me planet që i ka bërë Ministria e Planifikimit Hapësinor në të kaluarën, përkundrazi ky ligj i ndihmon ato vendime ose ato plane të cilat prej zhvendosjes së qytetarëve nga Hadja e në raste tjera unë mendoj që ky ligj vetëm sa e fuqizon rolin e institucioneve mbi këto pjesë.

Për shembull, ne mund, do të kërkojmë edhe do të insistojmë po ashtu që të futen në ligj, që këta qytetarë, të paktën të kenë rrymë 24 orë, të paktën taksat ose pagesa e rrymës të jetë minimum 25% në zbritje, po ashtu profitet të cilat i përfiton KEK-u duhet të jenë të paktën 25% e kësaj takse të jetë po ashtu në buxhetin e komunës. Po ashtu, investimet ose grandet qeveritare duhet të shkojnë, sidomos tek uji i pijes i cili është një problem jashtëzakonisht i theksuar në këtë pjesë, por ajo që mund ta them edhe që është një send që vlen për t’u përshëndetur është që ky ligj njëherë e përgjithmonë këtyre qytetarëve u bën zgjidhje të përhershme.

Unë edhe njëherë po them ne e mbështesim këtë projektligj dhe kontributin tonë do ta japim në komisionin funksional, pra në Parlament të Kosovës. Faleminderit!

KRYETARI: Në emër të Koalicionit Kosova e Re, deputetja Sevdije Lama e ka fjalën.

SEVDIJE LAMA: Faleminderit, kryetar!

Meqenëse zona e Obiliqit është zona më e ndotur në tërë vendin, të shkaktuar nga ndotësi më i madh i Evropës Juglindore, atëherë kjo zonë duhet të trajtohet si zonë me status të veçantë mjedisor.

Ajo anë është shtypur nga të gjitha anët, si me presion të ajrit, tokës, ujit, por edhe me papunësi. Për këtë Grupi Parlamentar i Koalicionit për Kosovën e Re përkrah miratimin e këtij ligji.

KRYETARI: Faleminderit! Tani është radha e diskutimeve. Fjalën e ka deputeti Bekim Haxhiu.

BEKIM HAXHIU: Faleminderit, i nderuar kryetar!

E përkrah deputetin për nismën, vërtet është një ligj i cili ka pasur nevojë që të trajtohet zona e Obiliqit në mënyrë të veçantë me anë të këtij ligji, mirëpo në formën e propozuar edhe me vetë tekstin e ligjit apostrofohet një pjesë e popullatës, e cila gjithashtu të themi që në mënyrë të barabartë është e rrezikuar nga ndotja, të cilën e shkakton Termocentrali i Obiliqit dhe po flasim për banorët e Komunës së Fushë-Kosovës, të cilët një pjesë e tyre në veçanti ata të cilët janë afër Termocentralit Kosova A dhe ata të cilët janë afër hirit të grumbulluar me vite nga puna e atyre termocentraleve, në veçanti gjatë ditëve të verës dhe ditëve me erë edhe banorët e Komunës së Fushë Kosovës pothuajse edhe pothuajse edhe gjatë tërë vitit janë të barabartë të rrezikuar si banorët e Komunës së Obiliqit.

Bile mund të them që një pjesë e banorëve të Komunës së Obiliqit, ata të cilët apo fshatrave të cilët janë më periferike nga Termocentrali Kosova B dhe A, në veçanti ata të cilët kalojnë magjistralen Mitrovicë-Prishtinë, janë më pak të rrezikuar se sa pjesa e qendrës së qytetit dhe pjesa tjetër e Komunës së Fushë Kosovës.

Mendoj që ligji gjatë trajtimit në mes dy leximeve do të duhej që të plotësohej edhe të jetë Projektligji për zonën e rrezikuar mjedisore të Obiliqit dhe të Fushë Kosovës dhe rrethinave të tyre, në veçanti nga perimetri i rrezikueshmërisë mjedisore, ashtu siç është e përcaktuar në ligj që të bëhet rrezja e parë e rrezikut, pastaj rrezja e dytë dhe në veçanti për arsye se ne dimë që edhe një pjesë e banorëve të kryeqytetit, domethënë kanë pasoja për shkak të ndotjes mjedisore të cilën e shkakton termocentrali në Obiliq.

Po përveç këtyre zonave, ne kemi nevojë që t'i trajtojmë me ligj edhe zonat tjera të rrezikuara në veçanti nga mbetjet industriale edhe zona e Mitrovicës, po gjithsesi edhe zona e Hajvalisë e cila për shkak të mbetjeve minerale të grumbulluara me vite janë të rrezikuara nga ndotjet mjedisore, në veçanti për shkak të një mos izolim të këtyre mbetjeve edhe trajtimit adekuat me vite dhe periudhës së gjatë kohore të grumbulluara ato, ndotjet minerale kanë arritur të depërtojnë thellë në sferën e tokës dhe ambientin ujqor dhe kjo bën që pastaj këto ndotje vërtet të shpërndahen dhe të krijojnë një situatë jo të favorshme ekologjike për Kosovën.

Prandaj, mendoj që ligji duhet të plotësohet. E japim dritën e gjelbër që të kalojë në këtë lexim, e inkurajoj deputetin vërtet që edhe gjatë këtyre dy leximeve të mos fokusohet vetëm në çështjen e trajtimit mjedisor vetëm për Komunën e Obiliqit, mirëpo për afërisht të barabartë janë rrezikuar edhe qytetarët e Komunës së Fushë Kosovës dhe do të duhej të ishin pjesë e këtij ligji të trajtuar njësoj. Faleminderit!

KRYETARI: Fjalën e ka deputetja Ganimete Musliu.

GANIMETE MUSLIU: Faleminderit, kryetar!

Fillimisht më lejoni t'i përgëzoj iniciatorët e këtij ligji, konkretisht deputetin Kuleta, mendoj që është një ligj me të vërtetë i nevojshëm dhe konsideroj që pikërisht me

miratimin e këtij ligji në të vërtetë po e plotësojmë një standard evropian dhe jo veç sa për të thënë.

Ndotja e ajrit në vazhdimësi e Obiliqit dhe zonën përreth po bëhet çdo ditë e më shumë një faktor permanent për rrezikun e shëndetit të qytetarëve të Republikës së Kosovës në atë zonë dhe unë konsideroj si deputete që miratimi i këtij i ligji është një e drejtë themelore e qytetarëve të asaj ane, prandaj unë do ta mbështes këtë ligj dhe besoj që edhe deputetët pa dallim do ta përkrahin dhe do ta votojnë për, sepse mendoj që fundi i fundit e kemi obligim që të mbrojmë shëndetin e qytetarëve tanë dhe të bëjmë që ata të ndihen të dinjitetshëm në vendin tonë. Faleminderit!

KRYETARI: Fjalën e ka deputeti Ali Sadriu.

ALI SADRIU: Faleminderit, i nderuar kryetar!

Të nderuar kolegë,

Dua ta përshëndes kolegun që ka propozuar këtë projektligj, vërtet është një ligj që plotëson një hapësirë dhe shpresoj që në trupa të Kuvendit do të bëjë edhe korrektive adekuate. Pra, qëllimi duhet të jetë ta mbulojmë ose të kërkojmë ta mbulojmë pastërtinë e ambientit, ajo nuk ndahet e thanë disa kolegë me kufij administrativ, sepse ajo ndihet edhe në komunat tjera dhe jam ihtar i asaj që të forcohen standardet dhe të respektohen ato standarde.

Gjatë amandamentimit jam ihtar i asaj që duhet të vendosim edhe sanksione të fuqishme në mosrespektimin e këtyre kritereve. Por, diçka që më habiti dhe më nxiti ta marr fjalën, është qëndrimi i Ministrisë dhe i Qeverisë. Një ligj kaq i rëndësishëm që besoj po e ndaj mendimin e të gjithëve në sallë, i lihet hapësira që këtë ta propozojë një deputet apo një grup deputetësh e jo Qeveria dhe në veçanti qëndrimi i ministrit shumë injorant karshi kësaj teme, hynte dilte, u zgërdhike, tash doli krejt, më bën përshtypje se nuk është marrë përgjegjësi në mënyrë adekuate për përgjegjësitë që i janë ngarkuar.

Atë, po e ngarkuaka më shumë zhurma e ezanit e s'po e ngarkoja tymi i Obiliqit që e helmoi krejt Kosovën. Po kjo është skajshmërisht që mendoj që është koha e fundit që deputetët, por edhe te të tjerët t'ju tregojmë vendin atyre të cilët vërtet nuk i marrin çështjet në standarde të nivelit të përgjegjësisë. Faleminderit!

KRYETARI: Fjalën e ka deputetja Time Kadrijaj.

TIME KADRIJAJ: Faleminderit, kryetar!

Obiliqi dhe qytetet përreth, Fushë Kosova dhe një pjesë e Drenasit janë qytetet më të ndotura të Kosovës.

Qeveria e Kosovës, 75% të territorit të Obiliqit e ka shpallur si zonë me interes të veçantë ekonomik, por cilat janë benefitet e qytetarëve të Obiliqit?

Ne e përshëndesim iniciativën e deputetit Kuleta dhe e përkrahim këtë projektligj. Shumë më herët ne si Aleancë për Ardhmërinë e Kosovës e kemi ngritur këtë shqetësim, sepse

ajo çka po ndodh në Komunën e Obiliqit dhe mostrajtimi adekuat nga Ministria e Ambientit dhe nga Qeveria është një lloj diskriminimi i banorëve të Obiliqit, të cilët çdo ditë po helmohen nga ambienti i papastër dhe shumë i dëmshëm për shëndetin e këtyre qytetarëve.

Me këtë ligj mendohet që të mobilizohen të gjithë mekanizmat përgjegjës dhe kompetentë me qëllim të përmirësimit të kualitetit të jetës së personave të cilët jetojnë në këto treva.

Qeveria dhe ministria e caktuar nuk i kanë përmbushur premtimet e zhvendosjes së popullatës së Hades dhe vendbanimeve të tjera. Një lutje Ministrisë së Shëndetësisë që me seriozitet dhe përkushtim t'i trajtojë rastet që kërkojnë trajtim nga kjo trevë, sepse kemi shifra se në këtë trevë janë rritur dukshëm rastet me sëmundje nga frymëmarrja dhe kanceri.

Trajtimi i pacientëve të tillë ka kosto të lartë buxhetore dhe është e papërballueshme për xhepin e varfër të qytetarëve të Obiliqit.

Ne edhe njëherë e përkrahim këtë projektligj dhe do ta votojmë.

(Drejtimin e mbledhjes e merr nënkryetari i Kuvendit, z. Sabri Hamiti.)

NËNKRYETARI I KUVENDIT, SABRI HAMITI: Faleminderit, zonja deputete!
Fjalën e ka deputetja Aurora Bakalli.

AURORA BAKALLI: Faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar deputetë,

Të gjithë jemi të vetëdijshëm për ndotjen që shkakton Obiliqi, na pengon tymi i këtyre tymtarëve edhe këtu në Prishtinë, por asnjëherë deri më sot nuk është menduar të krijohet diçka e veçantë për banorët që jetojnë aq afër burimit të kësaj ndotje.

Banorët e Obiliqit janë të rrezikuar nga ndotja e vazhdueshme e mjedisit të tyre ndërkohë që vendbanimi i tyre është burimi kryesor i prodhimit të energjisë për tërë vendin.

Banorët e Obiliqit meritojnë të kenë trajtim të veçantë dhe jam shumë e kënaqur që ne sot, si Lëvizje për Bashkim bashkë me një grup përkrahës të deputetëve kemi iniciuar një ligj të veçantë që parasheh beneficione për Obiliqin dhe banorët e tij.

Për të bindur cilindo skeptik, qoftë në mesin e deputetëve apo popullatës, se pse është i domosdoshëm një ligj i tillë si kompensim i vogël, për dëmin e madh unë do të sqaroj pak më gjatë efektin e kësaj ndotje në shëndet, por edhe në mjedis.

Obiliqi me rrethinë janë mjedisi më i ndotur në vend, po e ceki me rrethinë dhe këtë e kemi cekur edhe në ligj, prandaj edhe si përgjigje ndaj disa deputetëve të cilët thanë se me zona administrative është bërë ndarja, ne pikërisht për këtë arsye ligjin e kemi quajtur si Ligj për Obiliqin, zonën mjedisore të rrezikuar të Obiliqit dhe rrethinës së tij. Ndërkohë

që burim i ndotjes në këtë regjion konsiderohen por nuk kufizohen vetëm në mihjen sipërfaqësore të Dardhishtës, Mirashit dhe Bardhit, gropat e mihjes së Fushës së mihjes së re, grumbujt e hirit dhe thëngjillit, termocentrale dhe deponia regjionale e Mirashit.

Mihjet e thëngjillit - Ndotja e ajrit nga mihjet e thëngjillit bëhet kryesisht për shkak të emetimit të grimcave apo partikulave dhe gazrave duke përfshirë këtu metanin, dyoksidin e sulfurit dhe oksidet nitrike, si dhe monoksidin e karbonit.

Niveli i lartë i partikulave në ajër ndikon në rritjen e sëmundjeve të traktit të frymëmarrjes, apo respirator përderisa emetimi i gazrave ndikon në shfaqjen e sëmundjeve respiratore, kardiovaskulare dhe të sistemit nervor.

Termocentralet e thëngjillit - Djegia e thëngjillit për të gjeneruar rrymë elektrike liron në ambient një kombinim të kemikaleve toksike të cilat ndikojnë në organizmin e njeriut, por edhe të kafshëve, pra kanë ndikim negativ edhe në blegtorinë.

Shoqata Amerikane e Mushkërive ka identifikuar 84 ndotës të ndryshëm të ajrit, si dhe materiale radioaktive të liruara nga termocentrale e thëngjillit. Ndotësit e përmendur kërcënojnë sistemet thelbësore të jetës. Emetimi i këtyre substancave mund të përkeqësojë astmën, bronkitin kronik obstruktiv dhe sëmundjet e tjera të mushkërive. Këta ndotës mund të shkaktojnë infarktin e miokardit, insultin, cerebrovaskulare apo pikën në tru, kancerin e mushkërive dhe kanceret e të gjitha organeve tjera.

Ndotësit e termocentraleve të thëngjillit mund të ndikojnë në defektet e lindura të foshnjave dhe vdekjet e parakohshme. Gazrat acidike janë korrozive dhe mund të irritojnë dhe djegin sytë, lëkurën dhe mukozën e frymëmarrjes. Ndikimi i këtyre ndotësve është afatgjatë.

Shoqata Amerikane e Mushkërive raporton se është vështirë të ndërlihet një problem i caktuar shëndetësor me një ndotës të caktuar për shkak të kompleksitetit të përzierjes së ndotësve. Sipas tyre, përzierjet e ndryshme të ndotësve mund të jenë shumë më të rrezikshme se sa secili ndotës veç e veç.

Ndikimi në mjedis, ndotësit e përmendur ndikojnë në degradim të ambientit duke përfshirë këtu shtresimin dhe akumulimin e ndotësve në tokë dhe objekte, si dhe kontaminim i ujërave. Shiu acidik në zonën e termocentraleve që bie në tokë dhe ujë, mund ta ndërrojë PH dhe kështu të ndryshojë përbërjen kimike të atij mjedisi dhe e gjithë kjo të rezultojë në ndryshimin e florës, faunës dhe mikroorganizmave që e popullojnë në atë zonë. Ndotësit e rrezikshëm duke ndotur lumenj dhe përroskat mund të shkaktojnë dëmtim edhe të kulturave bujqësore, pyjeve dhe në këtë mënyrë edhe njerëzve.

Njerëzit që jetojnë më së afërmi burimi të ndotjes historikisht dhe gjithkund e kanë mbajtur barrën e rëndë të këtyre ndotësve të rrezikshëm. Shumica e ndotësve e kanë ndikimin e menjëhershëm në zonën e burimit të ndotjes edhe pse disa prej partikulave mund të udhëtojnë edhe larg. Prandaj, edhe ligji duhet të bëhet për Obiliqin, sepse banorët e kësaj zone janë më të rrezikuarit.

Sa i përket ndikimit në popullatë, efektet shëndetësore të ndotësve mund të përcaktohen vetëm përmes një analize të detajuar të raporteve në mes të emetimit, koncentrimit, eksponimit në njërën anë dhe efektit të ndotësve në anën tjetër, gjë që fatkeqësisht te na mungon, një analizë e tillë e detajuar mungon. Kemi disa të dhëna, të cilat nuk po i përsëris që i tha në fillim deputeti Kuleta, megjithatë këto të dhëna nuk janë gjithëpërfshirëse për shkak të mungesës së analizave dhe hulumtimeve të detajuara, si dhe për shkak të mungesës së sistemit të integruar informativ shëndetësor në vendin tonë.

Nga gjithë kjo që u tha, rrjedh nevoja për të nxjerr një ligj për këtë zonë në mënyrë që të vihem në mbrojtje popullatës së kësaj ane. Prandaj, të nderuar deputetë, ju ftoj që të përkrahni dhe të votoni në parim ligjin që kemi para vetes. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka deputetja Donika Kadaj- Bujupi.

DONIKA KADAJ-BUJUPI: Faleminderit, i nderuar nënkryetar!

Është obligim i shtetit që të ruajë balancën ndërmjet zhvillimit ekonomik dhe ruajtjes së mjedisit.

Qeveria jonë nuk e ka mbërri as të parën, as të dytën, për faktin e thjeshtë se ne nuk kemi ekonomi të zhvilluar edhe pse kemi kaq shumë resurse energjetike ose potencial për të zhvilluar sektorin energjetik në vendin tonë dhe ndërkohë kemi një nivel kaq të lartë të ndotjes së mjedisit. Do të thotë, janë të dyja në një shkallë alarmante.

Ky ligj është shumë i mirëseardhur dhe konsideroj që është një e arritur ose një hap i parë, të cilin e inicioi deputeti, kolegu jonë dhe për të cilin e përshëndes, mirëpo gjatë punës në amandamentim Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës do të fokusohet në tri çështje kryesore.

E para, është trajtimi shëndetësor i veçantë për sëmundjet si pasojë e termocentraleve.

E dyta, është punësimi prioritar i kuadrit të Obiliqit në kushte të barabarta, prioritet duhet t'u jepet njerëzve nga Obiliqit dhe,

E treta, është që taksa ekologjike të kthehet në investime, në projekte gjelbëruese, të cilat sadopak do të lehtësonin gjendjen tepër të rëndë atje. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zonja deputete Kadaj-Bujupi. Fjalën e ka deputeti Xhafer Tahiri.

XHAFER TAHIRI: Faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar anëtarë të Kabinetit qeveritar,

E vlerësoj si një ligj të domosdoshëm dhe jetik për banorët që afektohen nga ndikimi i dëmshëm në mjedis që kanë termocentralet aktuale në Obiliq.

Megjithatë, dua të them që në fillim se jo gjithëherë termocentralet që prodhojnë energji elektrike me qymyr apo me linjit mund të kenë ndikim të dëmshëm në ambient.

Personalisht kam pasur rastin të vizitohet termocentrale të tilla në Gjermani, të cilat prodhojnë deri në 2000 MW energji elektrike në orë dhe të cilat faktikisht efektin në mjedis e kanë jashtëzakonisht të vogël.

Për t'u kthyer te projektligji, mendoj se e vetmja e metë e këtij projektligji është fakti se e kufizon ndikimin në mjedis të këtij ligji vetëm në territorin e Komunës së Obiliqit. Unë mendoj se kjo duhet të ndryshohet në procesin e amendamentimit në mënyrë që njerëzit që afektohen nga ndikimi i dëmshëm në mjedis nga ky ligj praktikisht këtu përfshihen të gjithë ata që në fakt afektohen nga ndikimi i dëmshëm që prodhon Termocentrali Kosova A dhe Kosova B, në mjedis.

Dhe këtë rast dua të rikujtoj një argument në favor të kësaj faktin se dy lumenj, lumi Sitnica dhe lumi Llap janë dy nga lumenjtë më të afektuar, praktikisht nga ndotja si pasojë e Termocentralit Kosova B, sidomos. Këta dy lumenj kalojnë edhe nëpër territorin e Komunës së Vushtrrisë dhe nga këta lumenj shumë bujq të asaj zone ujisin tokat e tyre dhe rrjedhimisht edhe produktet e tyre afektohen nga efektet e dëmshme që i kanë termocentralet.

Prandaj, unë kërkoj që në këtë projektligj të përfshihet sidomos edhe zona e qytetit të Vushtrrisë e cila afektohet nga ndikimi që kanë sidomos lumenjtë Llap dhe Sitnicë në territorin e Komunës së Vushtrrisë si pasojë e ndotjes që këta lumenj e marrin nga termocentralet.

Sigurisht që në procesin e amendamentimit kjo gjë do të adresohet dhe do të përfshihen edhe këto zona në mënyrë që të gjithë qytetarëve, të cilët u dëmtohet shëndeti i tyre si pasojë e helmeve të ndryshme që prodhojnë këto termocentrale, t'u njihen të drejtat e caktuara që i parasheh ky ligj. Faleminderit, shumë!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti deputet! Fjalën e ka deputeti Emin Gërbeshi.

EMIN GËRBESHI: Faleminderit, kryesues!

Ky projektligj është shumë i rëndësishëm edhe për vetë faktin se për herë të parë që nga fillimi i eksploatimit të pasurive të Kastriotit po mendohet që përmes ligjit të përcaktohen beneficionet për banorët vendorë ose po mbrohen ata.

Ky ligj në mënyrë strikte përcakton beneficionet që duhet të kenë banorët, qoftë me përcaktimin si zonë e veçantë, grandet qeveritare, beneficionet shëndetësore, si dhe furnizimin me rrymë elektrike.

Por, mendoj se beneficionet duhet të shkojnë më tej, sepse shfrytëzimi shumë i gjatë i pasurive vendore kalon pasojat të cilat vështirë riparohen. Ka nevojë që në këtë ligj të përcaktohen në mënyrë më të qartë çështjet shëndetësore, grandet qeveritare etj., por të gjitha këto mund të bëhen në leximin e dytë. Prandaj, ligji në tërësi është i pranueshëm dhe duhet të përkrahet pa rezerva. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti deputet! Deputetja Sala Berisha- Shala e ka fjalën.

SALA BERISHA-SHALA: Faleminderit, nënkryetar!

Përsëritje ministër,

Të nderuar kolegë deputetë,

Unë e përçolla me vëmendje debatin që ishte një interesim më i madh se sa në projektligjet tjera në këtë pikë. Së pari e përgëzoj deputetin për nismën ligjore të cilën e ka marrë në këtë drejtim dhe po dua t'ua përkujtoj se nismat ligjore nuk janë e drejtë ekskluzive vetëm e Qeverisë, por dihet me Rregullore të punës së Kuvendit se kush mund të marrë nisma ligjore dhe kur qëllohen ato janë të mirëpritura edhe nga deputetët në Parlament.

Po dua t'ua përkujtuar edhe një çështje tjetër shumë të rëndësishme, se standardet mjedisore janë një ndër kriteret më të vështira për t'u ofruar me Bashkimin Evropian. Prandaj, për Kosovën nuk është edhe shumë e lehtë të gjejë atë balancën, atë mesin mes zhvillimit ekonomik dhe cenimit të ambientit në këtë drejtim.

Kosova më shumë ka probleme me ndotje të trashëguara nga veprimtaria e kaluar e operatorëve minerar dhe industrial siç janë termocentralet, mihjet, kompleksi industrial “Trepça”, Ferronikeli, Sharr Cemi e kështu me radhë që këto pjesë që i përmenda që përfshihen në kufijtë administrativë të komunave tjera përveç Obiliqit, hiq nuk janë më pak të ndotura se sa vetë Obiliqi.

Dhe, unë kam pasur rastin të jem pjesë e një projekti të Bankës Botërore si konsulent vendor që ende vazhdon në trajtimin e ndotjeve të mbetura të KEK-ut, përafërsisht ne e dimë secili se çfarë ndotje kemi në Kosovë që e ka trashëguar Kosova edhe në Obiliq dhe rrethinë, mirëpo vërtet është shumë alarmante të shihen studimet dhe analizat që i ka bërë Banka Botërore. Ajo që unë po dua ta cek se kam pasur rast të punoj edhe në minierat e KEK-ut që nuk është shumë e vështirë, por prodhimet industriale dhe minerare në Obiliq dhe në zonën përreth prekin edhe zonën jashtë kufijve administrativ siç e përmendën disa kolegë deputetë siç është Komuna e Vushtrrisë, Komuna e Drenasit e kështu me radhë.

Ndotjet e trashëguara, pra ndotjet që vazhdojnë t'i bëjë KEK-u dhe termocentrale e ndotin ajrin, ujin dhe tokën.

Prandaj, vërtet neve na duhet ky ligj dhe na duhet një qasje më e veçantë edhe Qeverisë edhe gjithë komunitetit, edhe gjithë të tjerëve dhe gjithë nesh, po dua ta përmend rastin se hiri si ndotës i trashëguar që është në KEK, mendoj që duhet të kthehet në përparësi dhe për mua është e pakuptueshme pse ka pasur oferta që të largohen ato kodra të hirit më përpara dhe nuk ka qenë një gatishmëri e KEK-ut ta bëjë një gjë të tillë, madje mendoj që e ka shndërruar në një pikë biznesi, KEK-u ia shet hirin Sharr Cemit, ia shet “Trepçës”.

Sharr Cemi është një kompani private, por nuk e kuptoj pse i shet “Trepçës” për t'i mbushur zgavrat e minierave hirin unë mendoj që duhet të kthehet tash, të largohen ato deponi të hirit në mënyrë që të përfitojnë të dy palët, edhe banorët e Obiliqit, po në këtë rast edhe minierat e “Trepçës”. Duhet ta ketë këtë çështje parasysh Qeveria, ta rishqyrtojë nëse ka mundësi e kompetencë, këtë biznes të KEK-ut me “Trepçën”. Mandej, duke dëgjuar një i paanshëm këtë debat këtu lidhur me këtë pikë kishte për të thënë, se çka i

duhen Kosovës termocentralet dhe mihjet kur vetëm të këqija po shkaktojnë ky operim dhe kjo veprimtari?

Unë mendoj se një kohë asgjë absolute, gjithçka është relative. Çdo e keqe e ka edhe një të mirë, po, hajde t'i analizojmë që të keqen ta shndërrojmë në të mirë. Unë po dua ta përkujtoj edhe një rast, që nga kjo e keqe ka dalë një e mirë. Për shembull, nga deponitë e sterileve apo djerrinave, zbulesave të qymyrit, që kanë qenë regjionale e janë deponuar në komunën e Drenasit, janë formuar liqenet e Vasilevës, një bukuri e rrallë, në të cilën Banka Botërore gjatë trajtimit të këtyre ndotjeve i ka rekomanduar Qeverisë që kjo zonë të shpallet zonë rekreative. Qeveria e ka shpallur zonë rekreative, po ka mbetur vetëm në letër në atë drejtim.

Dhe, krejt në fund, për të mos u marrë më shumë kohë, edhe njëherë e përgëzoj deputetin dhe e mbështes ligjin, por do të pajtohem me një deputet parafolës, si duket ishte nga komuna e Vushtrisë, që të mos kufizohet ky ligj me trajtimin specifik të qytetarëve që dëmtohen nga ndotja vetëm në komunën e Obiliqit. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Deputeti Jeton Svirca.

JETON SVIRCA: Faleminderit, nënkryetar!

Fillimisht, siç e thanë të gjithë kolegët deputetë, më lejoni që të përgëzoj deputetin Kuleta dhe kontribuues të tjerë që ky ligj të na vijë për shqyrtim neve në Kuvend, i cili është ligj shumë i domosdoshëm, i nevojshëm për qytetarët, sidomos të Obiliqit, po edhe të rrethinës.

Ne jemi koshientë pra se mjafton vetëm një shëtitje e vogël në qytetin e Obiliqit dhe t'i shohësh shtëpitë, kulmet e tyre të ndotura, të mbushura me plotë pluhur, i cili shkakton pra edhe sëmundje kancerogjene, sëmundje të frymëmarrjes, pasoja të cilat i kanë vuajtur qytetarët, banorët e komunës së Obiliqit ku jam edhe vet dëshmitar se shumë familjarë të cilët jetojnë në atë komunë kanë pasur vdekjen si rezultat apo si shkak nga sëmundjet të cilat janë krijuar prej ndotjes së madhe, të cilën e ka bërë fabrika gjigante KEK-u.

Ne e dimë se nga kjo fabrikë kemi përfitime shumë të mëdha materiale për shumë familje të cilat u punojnë anëtarët aty, kemi rrymën elektrike, të cilën e gëzojmë të gjithë ne, kemi një zhvillim ekonomik, mirëpo efektet të cilat vijnë nga ky gjigant janë aq të dëmshme saqë banorët e Obiliqit po i përjetojnë dhe nuk kanë asnjë përfitim, qoftë në aspektin shëndetësor apo në aspekte të tjera.

Është obligim yni që këtyre banorëve t'u japim të drejtat që u takojnë. Ligji duhet të jetë pra shumë specifik dhe shumë qartë të precizohen përfitimet, që do t'i kenë banorët e komunës së Obiliqit po edhe ata të rrethinës, sepse ata meritojnë dhe ne jemi të vetëdijshëm për nivelin e përgjegjësisë që na takon. Dhe për fund, më vjen mirë që vërejtja e deputetit Sadriu bëri që ministri të kthehet në sallë dhe t'i dëgjojë diskutimet e deputetëve. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka kërkuar në emër të Qeverisë, ministri i Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, Dardan Gashi.

MINISTRI DARDAN GASHI: Faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar deputetë,

Qëndrimin e Ministrisë, respektivisht Qeverisë, ua kemi dërguar edhe me shkrim më herët edhe deputetëve, Kuvendit dhe iniciuesve të projektligjit. Parimisht edhe kemi diskutuar shumë herët, shumë më herët edhe me propozues të ligjit dhe e kemi përkrahur në parim.

Çështja është si vijon, shumica e asaj që është prezantuar në projektligj mbulohet me shumë ligje të tjera, që veç janë në fuqi. Problemi qëndron shpesh të pamundësia e financimit të implementimit të kësaj baze ligjore, prandaj mbetet prapë te Kuvendi që të vendosë se a do të jetë në gjendje ta përkrahë financiarisht këtë ligj.

Nëse Kuvendi është në gjendje që këtë ligj ta përcjellë edhe me buxhet të caktuar, Ministria e Mjedisit dhe Qeveria në parim, do të thotë ky është edhe mungon edhe qëndrimi i ministrit të Financave zyrtarisht, mirëpo parimisht unë e di se edhe ministri i Financave i ka shprehur brengat e njëjta, se mungon aspekti financiar për implementimin e këtij ligji. Përndryshe, ligji është mbrojtja mënyrë më specifike e sidomos Obilikut. Është e nevojshme dhe këtë e kemi shprehur shumë shpesh. Po ashtu, një replikë të shkurtë me deputetin Sadriu, nuk është çështja se nuk jemi marrë ne me çështjen e mjedisit dhe siç e dini, jemi marrë në mënyrën më të suksesshme të mundur, që është marrë ndonjë qeveri më herët, duke përfshirë edhe vendosjen e filtrave, duke përfshirë edhe instalimin e teknologjisë për kapjen e hirit para se të dalë në mjedis, pastrimi i tokave të helmuara me dekada, i cili gjithë ato projekte shumëmilionëshe dhe atë pa financimin e drejtpërdrejtë të Qeverisë, mirëpo nxjerrin nga donatorë të ndryshëm.

Prandaj, mendoj se është shumë e pasinqertë që të shfrytëzohet mungesa e shkurtë e një përfaqësuesi të Qeverisë, që të bëhen akuza të tilla. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti ministër! Ali Sadriu replikë.

ALI SADRIU: Zoti ministër,

Atë që ta thash ka qenë pak, karshi asaj çka po e kërkon, sepse vetë tema, vetë efektet dëmtuese në mosmbrojtjen e ambientit nga kjo prizëm, raporti i angazhimit të Qeverisë në raport me këtë temë, është indikator më i mirë që flet për joseriozitetin e juaj.

Këtë ligj thashë nuk është dashur ta sjellë asnjë deputet, asnjë grup, është dashur ju ta sillni, sepse ka qenë detyrë e juaja, se nuk ka ndotës më të madh se kjo. Dhe, qëndrimi yt gjatë kohës së diskutimit ka qenë fyes për deputetët. Të gjithë të kanë parë, nuk nevojë ta komentosh.

KRYESEUSI: Faleminderit! Fjalën e ka kërkuar Shaip Muja.

SHAIP MUJA: Faleminderit, zoti kryesues!

Pa dashur që të replikoj me askënd, unë mendoj që ky ligj edhe nga vetë deputetët, përkrahja që i është bërë nganjëherë të jep përshtypje më shumë që është përkrahje që jep një formalitet të përkrahjes sesa studimin e ligjeve ekzistuese për mbrojtjen e ambientit.

Në këtë legjislaturë ne kemi debatuar disa herë dhe mendoj, unë personalisht kam ngritur edhe pyetje parlamentare për ministrin, por hot-spotet që quhen në Republikën e Kosovës, e njëra ndër hot-spotet e kontaminuara është Obiliqi, sipas të dhënave është Drenasi, janë mbeturinat e “Trepçës” dhe është pjesa e “Sharrcemit” në Kaçanik. Po, mbi të gjitha Kosova është e kontaminuar e tëra për shkak të ngritjes së gazit të sulfurit në masa të patolerueshme, sipas standardeve që lejohen edhe nga Bashkimi Evropian.

Mendoj që Ministria e Ambientit gjatë kësaj legjislature ka ngritur disa kapacitete, mirëpo i mungojnë kapacitetet monitoruese për implementimin e kualitetit të shërbimeve, qoftë të implementimeve të projekteve vendore, por edhe atyre ndërkombëtare të cilat janë në formë të donacioneve.

Në këtë pikë ne mund të diskutojmë shumëçka. Nëse kthehemi tek Obiliqi ky ka qenë një shqetësim i cili është me vite i shtresuar dhe i kalon mbi 50 vjet si kontaminim. Dhe, ky kontaminim është i shpërndarë, qoftë në tokë, në ajër, në lumenj dhe po ashtu në kryeqytetin e Republikës, që kontaminohet direkt duke iu bashkëngjitur edhe këtyre kontaminimeve, që është në keqmenaxhimin që është bërë në komunën e Prishtinës, nga mos pastërtia e rrugëve, nga mospërkujdesja në ndërtim, nga mos drenimi i mirë i ujërave të zeza dhe këta dy faktorë kanë sjell që këto dy komuna që bashkëjetojnë në kufirin juridik që kanë, janë të kontaminuara së bashku. Në këtë pikë unë kam kërkuar dhe kërkoj që ky ligj të aprovohet, mirëpo të ngritën kapacitetet e ministrive, të cilat duhet të jenë afër ligjit. Është Ministria e Shëndetësisë, është Ministria e Ambientit, është Ministria e Minerave e Mineraleve, e Zhvillimit Ekonomik, të cilat do të thotë kërkojnë një trajtim multidisiplinar permanent, por jo vetëm ad hoc dhe të flasim sa për të treguar njëfarë lloj dhembshurie dhe për t’u treguar si të krekosur për çështjen e votave ose fushatës paraelektorale.

Mendoj që është bërë mjaft pas reagimeve që ne i kemi bërë. Menjëherë është reaguar nga Ministria e Ambientit dhe në të tri kompanitë ku janë kontaminues direkt nga prodhimet e veta, që është Obiliqi, Feronikeli dhe Sharr-Cemi, kanë vënë filtra dhe monitorimi i ajrit është në kualitet më të lartë, më të mirë. Mirëpo, janë lënë probleme, me të cilat duhet të merremi edhe me shëndetin e popullatës, edhe me çështjen e kontaminimit të tokës, të cilat kanë një akumulim të metaleve të rënda kontaminuese për shëndetin e popullatës dhe në këtë mënyrë në atë rrethin e mbyllur ekologjik afektojnë direkt edhe në shëndetin e gjithëmbarshtëm të popullit, qysh nga ushqimi i shtazëve dhe nga produkte që prodhohen nga to.

Unë e përkrah në parim këtë ligj, shqetësimet duhet të ngritën edhe nga aspekti profesional shumë shkencor dhe permanent, të kërkohej ndihmë nga donatorë të ndryshëm. Kam vërejtur edhe angazhimin e udhëheqjes së re në komunën e Obiliqit, të cilët janë të angazhuar që këtë pikë ta ngritin në nivel shumë të lartë, që të marrin masa sa më shpejt që të jetë si qytet edhe më i pastër, ndërsa edhe Elektroekonomia e Kosovës në

produktin e saj jetë, që është energjia për neve, mos të jetë dëm në njërin anë dhe në tjetrën dritë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën përfundimtare e merr paraqitësi i këtij projektligji, Agim Kuleta, që ka bërë bashkë me grupin prej 7 deputetësh. Zoti Kuleta, mos e zgjat shumë!

AGIM KULETA: Faleminderit, zoti nënkryetar, do të përpiqem!

Unë, fillimisht, dua t'i falënderoj të gjithë deputetët për mbështetje në parim të këtij projektligji dhe gjithashtu për komentet që i dhanë.

Dua shumë shkurt, tri shqetësime:

E para ka të bëjë me shqetësimin lidhur me kufizimin e zonës. U kuptua sikur është kufizim vetëm territorial dhe vetë ky kuptim tregon që ka nevojë që të precizohet edhe më tepër kjo. Qëllimi nuk ka qenë territorial, do të thotë, në kuptimin vetëm administrativ, Obiliqi si territor. Prandaj, është marrë masa që në nenin 5 është bërë ndarja e zonave dhe është ndarë në dy zona, e para dhe e dyta, në bazë të ndikimit dhe distanca që është paraparë këtu i kalon kufijtë e komunës së Obiliqit.

Mirëpo, do ta mirëpresim në komision çdo vërejtje që do ta precizojë më tepër këtë çështje.

Sa i përket çështjes së financimit që e përmendi ministri, në nenin 18.2 të Ligjit mbi vetëqeverisjen lokale thuhet që autoritetet qendrore në Republikën e Kosovës mund t'u delegojnë kompetenca shtesë komunave, nëse është e nevojshme, në pajtim me ligjin.

Dhe, sa i përket çështjes së financimit të përgjegjësive shtesë të deleguar në komuna, përcaktohet me paragrafin vijues të të njëjtit nen, të të njëjtit ligj. Pra, neni 18.3, i cili thotë: "Kompetencat e deleguara duhet në të gjitha rastet të shoqërohen me financim të nevojshëm, në përputhje me objektivat, standardet dhe kërkesat e përcaktuara nga Qeveria e Republikës së Kosovës"

Dhe, sa i përket asaj që ekzistojnë ligjet tjera, unë mendoj që vetë gjendja në terren tregon që nuk është në përputhje me këto letra të cilat po pretendojmë që i kemi dhe edhe në qoftë se ekzistojnë tregon që janë të pamjaftueshme si të tilla, për të ndryshuar gjendjen atje.

Nevojitet një ligj i veçantë, sepse është një territor i veçantë dhe prandaj trajtimi me një ligj të përgjithshëm i një zone që ka karakteristika të veçanta, mendoj që është diskriminues dhe si i tillë është edhe joefikas. Faleminderit edhe njëherë dhe mirëpres angazhime në komision.

KRYESUESI: Pas fjalës përfundimtare të paraqitësit, edhe nëse ka interesime për, natyrisht që nuk flitet, sepse është fjalë përfundimtare. Kështu që unë e thërras regjinë dhe deputetët. Ju lutem, të bëhemi gati. Janë 67 deputetë në sallë. Kërkohet deklarimi me votim për miratimin në parim të Projektligjit për zonën e rrezikuar mjedisore të Obiliqit dhe rreth tij votojmë tash!

Votimi e jep këtë rezultat: aprovohet në parim ky projektligj me 66 vota për, asnjë kundër dhe një abstenim.

Ngarkohet Komisioni FunkSIONAL dhe komisionet e përhershme, që në afatin e paraparë me Rregulloren e Kuvendit, ta shqyrtojnë projektligjin dhe Kuvendit t'i paraqesin raportet me rekomandime.

Kalojmë në pikën 10 të rendit të ditës:

10. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për pajisje me armë dhe pajisje përkatëse të sigurisë për institucionet e autorizuar shtetërore për siguri

Në bazë të nenit 56 të Rregullores së Kuvendit, Komisioni FunkSIONAL e ka shqyrtuar projektligjin dhe Kuvendit i rekomandon miratimin e tij në parim.

Ftoj ministrin e Punëve të Brendshme, zotin Bajram Rexhepi, që para deputetëve të Kuvendit të paraqesë dhe të arsyetojë projektligjin. Zoti ministër, urdhëro!

MINISTRI BAJRAM REXHEPI: I nderuar kryesues i Kuvendit,
Ministra,

Të nderuar deputetë,

Më lejoni të prezantoj para jush Projektligjin për ndryshim dhe plotësim të Ligjit nr. 03/L-246 për pajisje me armë, municion dhe pajisje përkatëse të sigurisë për institucionet e autorizuar shtetërore për siguri, i sponsorizuar nga Ministria e Punëve të Brendshme.

Ky projektligj është hartuar duke u bazuar në programin legjislativ të Qeverisë së Republikës së Kosovës për vitin 2013 dhe në pajtim të plotë me Rregulloren e punës së Qeverisë nr. 09/2011.

Arsye për hartimin e këtij projektligji janë se me këtë ligj rregullohen përcaktimi i dispozitave ligjore lidhur me pajisjen me armë, municion dhe pajisje përkatëse për siguri dhe për institucionet e autorizuar shtetërore për siguri të Akademisë së Kosovës për Siguri Publike, operatorët e sigurimit në institucionet shtetërore dhe Agjencinë e Kosovës për Forenzikë.

Ky projektligj përbëhet prej 5 neneve të cilat i ndryshojnë dhe i plotësojnë dispozitat përkatëse të ligjit bazik. Hartimi i këtij ligji është në harmoni të plotë me Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe me instrumentet ligjore të cilat janë pjesë e direkte e zbatimit në Republikën e Kosovës si dhe me burimet legjislative të Bashkimit Evropian.

Gjatë hartimit të këtij projektligji janë marrë për bazë procedurat e parapara sipas Rregullores së punës së Qeverisë nr. 09/2011 dhe me këtë projektligj janë pranuar edhe deklaratat për vlerësimin e ndikimit buxhetor nga Ministria e Financave dhe deklarata e

pajtueshmërisë bashkë me opinionin ligjor nga Ministria e Integrimit Evropian, me të cilat vërtetohet pajtueshmëria me ‘acquis communautaire’.

Të nderuar deputetë, duke marrë parasysh rëndësinë e këtij projektligji, nevojën e avancimit të kuadrit ligjor në këtë fushë, si dhe duke marrë parasysh prioritetet e Qeverisë së Republikës së Kosovës, kërkoj nga ju miratimin në parim të këtij projektligji. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti ministër! E nisim debatin për projektligjin në parim. Fjalën i pari e merr kryetari i Komisionit Funkcional për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrjen e Forcës së Sigurisë së Kosovës, zoti Ahmet Isufi.

AHMET ISUFI: Faleminderit, zoti nënkryetar!

Është një projektligj shumë i rëndësishëm dhe meqë kemi të bëjmë me ndryshimin dhe plotësimin e ligjit i cili na është sjell me gjithë mangësitë që i ka vërejtur komisioni, i kemi marrë parasysh dhe në pjesën e amendamentimit që do ta kemi, do t'i kemi vërejtjet tona për ta plotësuar këtë ligj i cili është i domosdoshëm për pajisje me armë për institucionet e sigurisë.

Prandaj, edhe në emër të Grupit Parlamentar e përkrahim në parim duke i pasur vërejtjet parasysh.

KRYESUESI: Faleminderit! Për Grupin Parlamentar të Partisë Demokratike, Ganimete Musliu e ka fjalën.

GANIMETE MUSLIU: Faleminderit, nënkryetar!

Të nderuar ministra,

Të nderuar kolegë dhe ju kolege deputete,

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës e ka shqyrtuar Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 3/L-246 për pajisje me armë, municion dhe pajisje përkatëse të sigurisë për institucionet e autorizuar shtetërore për siguri dhe konsideron që ky plotësim-ndryshim i ligjit është i nevojshëm për funksionimin e mirëfilltë të sigurisë në institucionet e vendit dhe do ta votojmë në parim.

Vërejtjet dhe sugjerimet tona, të cilat do të kontribuojnë që ky ligj të jetë sa më efikas dhe më i zbatueshëm, do t'i japim përmes komisionit përkatës i cili është për Punë të Brendshme e Siguri dhe Mbikëqyrje të FSK-së. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zonja deputete! Për Grupin Parlamentar të LDK-së, flet Vjollca Krasniqi.

VJOLLCA KRASNIQI: Faleminderit, nënkryetar!

Të nderuar ministra,

Kolegë të nderuar, deputetë,

Edhe Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës ka shqyrtuar këtë projektligj, gjegjësisht Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për pajisje me armë,

municion dhe pajisje përkatëse të sigurisë, për institucione të autorizuar shtetërore për siguri.

Kemi një ndryshim dhe plotësim të këtij ligji. Kemi një projektligj jo voluminoz, ka diku vetëm 5 nene në tërësi dhe mendoj që kontributin tonë do ta japim në grupin punues dhe në komisionin përkatës, kështu që do ta votojmë në parim. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zonja deputete! Për Grupin Parlamentar të “Vetëvendosje”-s, deputeti Rexhep Selimi e ka fjalën.

REXHEP SELIMI: Faleminderit, nënkryetar!

Edhe Grupi Parlamentar i Lëvizjes “Vetëvendosje” e ka shqyrtuar dhe trajtuar dhe do t’i japim vlerësimet tona, duke përfshirë këtu edhe kontributin tonë që do ta japim në komision dhe në grupin punues për këtë projektligj.

Por, sidoqoftë, një gjë që kemi vërejtur edhe bashkë me kolegët tjerë në Komisionin për Siguri dhe që ne ndoshta do të duhej që të kishim së paku kontributin e Qeverisë në sqarim për këtë çështje, është se në këtë projektligj, i cili është Projektligj për pajisje me armë dhe municion përkatës për institucionet e autorizuar shtetërore të sigurisë, na Qeveria nuk parashihet edhe FSK-ja si institucion i autorizuar shtetëror për siguri.

Normalisht se e kemi konsultuar gjithë infrastrukturën ligjore të Kosovës, duke përfshirë edhe Kushtetutën, pra edhe në Kushtetutë Forca e Sigurisë së Kosovës është një institucion i sigurisë së Kosovës edhe në Ligjin për FSK-në e kemi konsultuar dhe, po ashtu, edhe me ligjet tjera. Duke i parë të gjitha këto trajtime, çfarë i bëhen FSK-së, duke parë edhe në Ligjin për FSK-në, e cila në këtë rast thirret në pakon e Ahtisarit, nga e cila pako do të duhej që të dilnim, pas 5 vjetëve të miratimit të asaj pakoje, pra në shikimin e kësaj pakoje që ka ndodhur, është dashur të ndodh në qershor të vitit të kaluar, akoma Qeveria e Kosovës edhe me këto dy projektligj, po them dy, për shkak se edhe ligji pasues e trajton përafërsisht të njëjtën çështje të së njëjtës natyrë, Qeveria e Kosovës nuk e ka paraparë FSK-në si institucion i autorizuar shtetëror i sigurisë në Kosovë.

Në grupin punues do ta kemi një ndër çështjet, nëse jo kryesore, ndonjë ndër çështjet në trajtimin e kësaj çështjeje dhe mendoj që do të duhej që, së paku tash e së paku pesë vjet pas planit të Ahtisaarit, Forca e Sigurisë së Kosovës do të duhej të ishte e trajtuar ashtu siç është e trajtuar në Kushtetutë, por edhe përtej saj si institucion i autorizuar i sigurisë në Kosovë.

Kështu që mendoj që përfshirja e FSK-së në këtë ligj do të jetë pothuajse e domosdoshme. Presim, ndoshta përveç sqarimit edhe kontributin e hartuesve të këtij projektligji dhe mendoj që tashmë është koha që të jetë e përfshirë, për shkak se edhe në projektligjin pasues, pas kësaj pike do ta kemi edhe ne trajtimin tonë. Në të njëjtën mënyrë është trajtuar, në këtë rast është përjashtuar në këtë rast Forca e Sigurisë së Kosovës, si forcë e autorizuar e sigurisë.

Përveç kësaj, në tërësi projektligjin e kemi trajtuar dhe do ta mbështesim në parim, duke qenë aktiv dhe të kujdesshëm në atë që çfarë do të amendamentojmë për të miratuar edhe në leximin e dytë. Faleminderit!

KRYESUESI: Myzejene Selmani, shefe e grupit të Koalicionit për Kosovë të Re.

MYZEJENE SELMANI: Faleminderit, i nderuar nënkryetar i Kuvendit!

Duke marrë parasysh se ministri në shqyrtim të Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për pajisjet me armë dhe pajisjet përkatëse të sigurisë për institucionet e autorizuara shtetërore për siguri edhe vetë sqaroi që është bërë një plotësim dhe ndryshim i këtij projektligji, Koalicioni për Kosovë të Re do të japë përkrahje në Komisionin Parlamentar. Faleminderit!

(Drejtimin e mbledhjes e merr kryetari i Kuvendit, zoti Jakup Krasniqi.)

KRYETARI: Grupe të tjera të paraqitura s'ka. Fjalën e ka deputetja Sala Berisha-Shala.

SALA BERISHA-SHALA: Faleminderit, kryetar!

Unë e kam lexuar këtë plotësim-ndryshim të këtij projektligji, por desha një sqarim ndoshta nga Qeveria rreth nenit 1, ku flitet për institucionet shtetërore të sigurisë.

Unë e kuptoj që në këtë ndryshim-plotësim të projektligjit është fjala për ato institucione, që duhet të pajisen me armë, mirëpo dëshiroj ta di se përveç këtyre institucioneve që duhet të pajisen me armë, a ka institucione të tjera që e kanë këtë epitë si institucione të sigurisë? Në qoftë se po, do të kërkoja falje, që s'e di, në qoftë se jo, do ta kisha dhënë një propozim, që në kuadër të institucioneve të sigurisë të hyjë edhe Shërbimi Gjeologjik i Kosovës, përkatësisht Departamenti i Sizmikes.

Më lejoni ta bëj një arsyeshmëri pse përse duhet kështu. Mbase shumëkush do të habitej me lidhshmërinë në mes të sigurisë dhe gjeologjisë, siguria e jetës është detyrë parësore e çdo qeverie ndaj qytetarëve të saj.

Pikërisht për këtë njeriu e krijoi shtetin, me qëllim për të pasur të sigurt në kuadër të rregullave të qarta që pranohen e zbatohen nga të gjithë. Thënë më ndryshe e më thjeshtë, të kesh një jetë të sigurt, do të thotë të ecësh sigurt, të udhëtosh sigurt, të pushosh sigurt. Në kuptimin e përgjithshëm, në konceptimin e masave qytetare, organet përgjegjëse për siguri në një shtet janë policia dhe ushtria dhe disa organe që janë përmendur këtu në këtë ligj. Mirëpo, përtej rreziqeve të asaj natyre që shkaktohen nga njerëzit e mbinjerëzit, ka mjaftë rreziqe të tjera, që rrinë fshehur e shpërthejnë papritmas, me pasoja të rënda, që ndodhin e shkaktojnë dëme sa hap e mbyll sytë.

Rreziqeve të kësaj natyre nuk i del dot as policia as ushtria më e fortë e botës. Shembuj që e vërtetojnë këtë kemi mjaftë. Jemi dëshmitarë të asaj që ndodhi edhe në Kosovë, që s'është rast përjashtimor nga krejt bota, kemi pasur rast të dridhjeve, tërmete në Vushtrri, mandej rrëshqitjet në Restelicë, kur është dashur të angazhohen të gjitha

mekanizmat e sigurisë këtu që janë, Forca e Sigurisë së Kosovës, edhe Policia, e kështu me radhë.

Mendoj që roli i gjeologjisë dhe gjeologut këtu është i pashmangshëm. Gjeologu në njëfarë forme është psikolog i tokës, një parashikues i mënyrës se si ajo mund të veprojë në të ardhmen, duke analizuar dhe studiuar veptrimarinë e tokës në të kaluarën.

Kështu që, kisha propozua si term të futet edhe si institucion i sigurisë edhe Departamenti i Sizmikes, që funksionon në kuadër të zhvillimit ekonomik, natyrisht por jo për t'u pajisur me armë.

KRYETARI: Ministri Bajram Rexhepi e ka fjalën.

MINISTRI BAJRAM REXHEPI: Unë desha, të nderuar deputetë, vetëm një sqarim që u ngrit një çështje e një rëndësie të veçantë, çështja e furnizimit me armë nga FSK-ja. Ata e kanë furnizimin ndaras, furnizohen dhe nuk i nënshtrohen kësaj. Pra, Ministria e Punëve të Brendshme është si koordinatore dhe bën listën nacionale të furnizimit me armë për agjencitë e zbatimit të ligjit, si për policinë, për gardianët, për Akademinë e Sigurisë Publike në Vushtrri. Tash Inspektorati Policor edhe Administrata Tatimore, pra janë këto agjenci të zbatimit të ligjit, të cilat e bëjnë listën nacionale dhe Ministria e Punëve të Brendshme është koordinator, ndërsa FSK-ja e ka furnizimin ndaras dhe nuk i nënshtrohet kësaj.

Ndërsa, sa i përket propozimit këtu është çështja e furnizimit me armë, ndërsa çështja e gjeologjisë dhe katastrofat natyrore shkojnë nëpër ligje të tjera, por jo në këtë ligj, unë nuk e shoh se si mund të futet në këtë...

KRYETARI: Faleminderit! Fjalën e ka deputeti Rexhep Selimi.

REXHEP SELIMI: Dakord, unë po shoh që nuk është paraparë që përmes këtij projektligji të furnizohet edhe FSK-ja. Pra, pikërisht ky është problemi, pse nuk është paraparë me të njëjtin ligj të furnizohet ose të shihet se cila është mënyra e pajisjes me armatime edhe për FSK-në. Të mos harrojmë, FSK-ja ka armë. Ato pak armë që i ka, ka armë.

Dhe, nuk e di që diku në infrastrukturën ligjore të Kosovës, ka një ligj tjetër i cili e zëvendëson këtë ligjin përkatës, për të cilin ne po flasim.

Furnizim kanë edhe institucionet tjera të sigurisë që i parasheh ky projektligj, siç është Policia, Shërbimi Korrektues dhe institucionet tjera të sigurisë. Shqetësimi im ishte ky se pse nuk trajtohet nga Qeveria e Kosovës edhe FSK-ja si institucion i autorizuar për sigurinë shtetërore në këtë vend. Po, ky është shqetësimi, pastaj, mbi këtë shqetësim unë ngre edhe pse nuk është paraparë. Sikur të kishte një ligj tjetër të veçantë, i cili do të merrej me furnizimin me pajisje dhe armatime për FSK-në, ne do të ishim dakord, por te përkufizimet në ligjin pasues do ta shihni që Qeveria e Kosovës te përkufizimet, ku

thuhet që institucionet e autorizuarra shtetërore të sigurisë janë këto e këto, nuk përmendet FSK-ja.

Prandaj, shqetësimi im ishte ose ngritja e pyetjes është: a e konsideron Qeveria e Kosovës edhe FSK-në si institucion i autorizuar për siguri në Kosovë?

KRYETARI: Dua t'ju tregoj se seanca vazhdon dhe për deputetët përgjegjësi më kryesore se seanca nuk ka. Urdhëro, edhe nëse do një sqarim, ministër Rexhepi.

MINISTRI BAJRAM REXHEPI: Ne sigurisht që e konsiderojmë si institucion i sigurisë. Edhe një herë po them, Ministria e Punëve të Brendshme është ombrellë e këtyre agjencive të zbatimit të ligjit.

Tash po them parimisht, nëse edhe furnizimi i FSK-së dhe Ushtrisë së ardhshme bie nën këtë listë, ajo kishte për të rënë njëloj denigrimi, ndoshta për ata, pra ata kanë kanalin krejt tjetër. Dhe, në këtë ligj është shumë e qartë që thuhet se FSK-ja e ka furnizimin vetjak, ata i bëjnë të gjitha procedurat vetë dhe nuk i nënshtrohen këtij ligji për furnizim.

KRYETARI: Të pranishëm janë 60 deputetë. Regjia, ju lutem i bjerini ziles që të vijmë deputetët për votim.

I kemi edhe dy ligje për debat, e lëmë nesër për votim. Edhe pastaj nesër i kemi edhe dy votime që kërkojnë së paku 80 deputetë për, kështu që kisha kërkuar nga shefat e kryetarët grupeve parlamentare, që të bisedojnë me deputetët e tyre, që të vijmë nesër në orën 10:00, në vazhdim të seancës.

Tani kemi edhe dy ligje që duhet t'i mbyllim sot, në mënyrë që nesër të kemi më pak punë, sepse është e premtë. A jeni dakord?

Të gjithë i kemi disa ftesa, por nuk po shkojmë, se puna jonë këtu është më e para, se sa ajo që kemi të shkojmë për ta pirë nga një gotë lëng apo ujë.

Të pranishëm i kemi 63 deputetë. Lus deputetët dhe regjinë të përgatiten për votim. Votojmë tash!

Edhe një herë, se nuk e kemi votimin. Lus deputetët le të votojnë nëse duan për, kundër, apo le të abstenojnë, por votoni! Votojmë tash!

Me 61 votë për, 1 kundër, Kuvendi e miratoi në parim Projektligjin nr. 04/L-222 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-246 për pajisje me armë dhe pajisje përkatëse të sigurisë për institucionet e autorizuarra shtetërore për siguri.

Ngarkohen Komisioni FunkSIONAL dhe komisionet e përhershme, që në afatin e paraparë me Rregulloren e Kuvendit, ta shqyrtojnë projektligjin dhe Kuvendit t'ia paraqesin raportin me amendamente.

11. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për armë

Në bazë të nenit 56 të Rregullores së Kuvendit, Komisioni Funkcional e ka shqyrtuar projektligjin dhe Kuvendit i ka rekomanduar miratimin e tij në parim.

Ftoj ministrin e Punëve të Brendshme, zotin Bajram Rexhepi, që para deputetëve të Kuvendit të paraqesë dhe arsyetojë projektligjin. Ministër, e ke fjalën.

MINISTRI BAJRAM REXHEPI: I nderuar kryetar i Kuvendit,
Të nderuar ministra,
Të nderuar deputetë,
Më lejoni të prezantoj para jush Projektligjin për armë, i sponsorizuar nga Ministria e Punëve të Brendshme.

Projektligji për armë është hartuar duke u bazuar në programin legjislativ të Qeverisë së Republikës së Kosovës, për vitin 2013 dhe në pajtim të plotë me Rregulloren e punës së Qeverisë nr. 09/2011.

Arsye për hartimin e këtij projektligji është se me këtë ligj rregullohen çështjet që kanë të bëjnë me armë, si dhe përcaktohen kushtet për blerjen, posedimin, armëmbajtjen, ruajtjen, prodhimin, çaktivizimin, riparimin, tregtimin, importimin, shitjen, transportimin dhe gjurmimin e armëve dhe municionit për personat fizikë dhe juridikë brenda territorit të Republikës së Kosovës, si dhe eksportimin nga Republika e Kosovës.

Projektligji për armë përbëhet prej gjithsej 76 neneve, duke filluar nga dispozitat e përgjithshme, dispozitat shpjeguese, si dhe dispozitat kalimtare dhe përfundimtare. Hartimi i këtij ligji është në harmoni të plotë me Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe me instrumentet ligjore, të cilat janë pjesë direkte e zbatimit në Republikën e Kosovës, si dhe me burimet legjislative të Bashkimit Evropian.

Gjatë hartimit të këtij projektligji janë marrë për bazë procedurat e parapara, sipas Rregullores së punës së Qeverisë nr. 09/2011 dhe për këtë projektligj janë pranuar edhe deklaratat për vlerësimin e ndikimit buxhetor nga Ministria e Financave dhe opinioni ligjor të përputhshmërisë me legjislacionin e Bashkimit Evropian nga Ministria e Integriteteve Evropiane, me të cilat vërtetohet pajtueshmëria me ‘acquis communautaire’.

Të nderuar deputetë, duke marrë parasysh rëndësinë e këtij projektligji, nevojën e avancimit të kuadrit ligjor në fushën specifike të sigurisë, që adreson kontrollin dhe mbikëqyrjen e armëve, harmonizimin e mëtutjeshëm të këtij kuadri ligjor, me Rregullore të Bashkimit Evropian, si dhe duke marrë parasysh prioritetet e Qeverisë së Republikës së Kosovës, kërkoj nga ju miratimin në parim të këtij projektligji. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, ministër! Në emër të Komisionit, fjalën e ka deputeti Rexhep Selimi.

REXHEP SELIMI: Faleminderit, kryetar!

Komisioni në mbledhjen e mbajtur më 21 janar të këtij viti, pra 2014, e ka shqyrtuar këtë ligj dhe i rekomandon Kuvendit të Kosovës që të miratohet në parim, pra Projektligjit me numër 04/L-241, pra Ligji për armë.

I rekomandohet Kuvendit të Republikës së Kosovës që ta kalojë këtë projektligj në parim, pra tashti më lejoni edhe në emër të Grupi Parlamentar ta përfundoj, nëse më lejohet, vlerësimin tonë.

Edhe Grupi Parlamentar i Lëvizjes “Vetëvendosje” e ka trajtuar dhe shqyrtuar këtë ligj. Edhe ne mendojmë që ky ligj e plotëson një hapësirë ligjore, por një zbrazëti ligjore shumë të nevojshme, po ashtu edhe të ndjeshme për specifikat dhe rrethanat në Kosovë. Pra, është shumë i domosdoshëm dhe shumë i nevojshëm si ligj të jetë dhe ta plotësojë këtë hapësirë, e cila ka ekzistuar deri më tani në Kosovë, ose ka qenë e plotësuar pjesërisht.

Por, më lejoni vetëm edhe një herë të lexoj diçka nga projektligji i propozuar. Ky projektligj në përgjithësi i trajton aspektet teknike shumë të nevojshme dhe është një projektligj voluminoz, por më lejoni në lidhje me krejt natyrën e punës të këtyre dy ligjeve, por dhe ligjit paraprak dhe tani, të lexoj vetëm një nen, ose është vetëm një paragraf nga neni 2 i përkufizimeve, që ta plotësoj vetveten atë çka thashë më herët. Te përkufizimet, neni 2, pra 1.1 thuhet: “Institucionet e autorizuar shtetërore të sigurisë përfshijnë Policinë e Kosovës, Inspektoratin Policor të Kosovës, Agjencinë e Kosovës për Inteligjencë, Akademinë e Kosovës për Siguri, Shërbimin Korrektues, Doganat e Kosovës, Agjencinë Pyjore të Kosovës, Agjencinë e Kosovës për Forenzikë dhe operatorët e sigurimit në institucione shtetërore, si dhe në institucionet tjera të autorizura, të cilat mund të krijohen me ligj të veçantë”.

Dhe, unë jam shumë dakord që në këtë ligj, ose institucionet të cilat janë nën domenin e Ministrisë të Punëve të Brendshme, Ministria e Punëve të Brendshme e ka hartuar këtë projektligj për t’i trajtuar ato institucione që i ka nën domenin e vet.

Por, unë nuk po e ngre çështjen pse nëpërmjet Ministrisë së Mbrojtjes nuk furnizohet me armë edhe FSK-ja, por te përkufizimet, aty ku thuhet “institucionet e autorizuar shtetërore të sigurisë në Kosovë janë...”, edhe përmenden këto e këto, nuk përmendet FSK-ja. Pra, nuk them unë pse ne nuk e furnizojmë FSK-në si Ministri e Punëve të Brendshme, por pse është përjashtuar FSK si institucion i autorizuar i sigurimit. Kjo është çështja. Pra, si e trajton FSK-në Qeveria e Kosovës, institucion i autorizuar i sigurisë, apo jo? Këtu del që FSK-ja për Qeverinë e Kosovës nuk është ende institucion i autorizuar i sigurisë në Kosovë.

Në përgjithësi, pra, në tërësi, ne e mbështetim në parim këtë projektligj. Do të votojmë për, duke dhënë kontributin tonë gjatë amendamentimit të këtij ligji.

KRYETARI: Në emër të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike, deputeti Fatmir Xhelili e ka kërkuar fjalën.

FATMIR XHELILI: Faleminderit, kryetar!

Përshëndetje për ministrat,

Deputetë të nderuar,

Edhe Grupi i Partisë Demokratike e ka lexuar me vëmendje ligjin. Është një ligj bukur voluminoz, ligj që ka sqaruar shumë gjëra dhe i ka normuar gjërat në drejtim të përdorimit, tregtimit, licencimit, pajisjes, importit, eksportit të armëve, ndreqjes, rregullimit të tyre dhe kategorizimit të armëve. Ka edhe disa gjëra, në të cilat faktikisht ka bërë kufizime të shumta në drejtim të armëmbajtjes...

KRYETARI: Ata që shkojnë tash, mund ta humbin mëditjen. Mos thoni se nuk e keni ditur!

(Reagime në sallë)

FATMIR XHELILI: ...Ky ligj në njëfarë mënyre i ka favorizuar bukur shumë kompanitë, të cilat merren me tregtinë e armëve dhe i ka vënë në pozitë të disfavorshme edhe sportistët, gjahtarët, koleksionuesit e tjerë, për arsyet e normimeve të shpeshta të kohëzgjatjes të lejes së bartjes së armës, apo të mbajtjes së armës, gjë që është shumë e kushtueshme për vazhdimin e saj, mirëpo kontributin tonë do ta japim në Komisionin për Mbikëqyrjen e Forcës së Sigurisë dhe për Siguri. Gjithsesi është ligj që duhet të kalojë në parim.

KRYETARI: Në emër të Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike, deputetja Vjollca Krasniqi e ka fjalën.

VJOLLCA KRASNIQI: Faleminderit, kryetar!

Të nderuar ministra,

Të nderuar deputetë,

Edhe ne si Grup Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës e kemi shqyrtuar Projektligjin për armë dhe ministri referoi rreth asaj se çka rregullon ky projektligj. Për të mos u përsëritur, ne do ta votojmë në parim. Dune thënë që ky projektligj e ka një kosto shtesë buxhetore, diku afro 30 000 euro, të cilat nuk janë të parapara ame kornizën afatmesme të shpenzimeve 2014-2016, por sigurisht ju si ministri do ta mbulonit këtë pjesë shtesë të kësaj kostoje.

I kemi disa vërejtje edhe esenciale, mirëpo nuk do t'i them sot. Ato do t'i bëjmë të ditura në komision dhe në grupin punues, i cili është themeluar në kuadër të komisionit.

Por, do të doja që të them, ministër, me tërë këtë projektligj bukur voluminoz, diku afro 70 nene, mbi 32 herë është përmendur 'organi kompetent', dhe jo çdoherë organi kompetent në këtë projektligj është i njëjti. Nëse dikush do të dojë ta lexojë këtë projektligj, edhe do të marrë një leje për armë, atij do t'i duhej të shfletojë shumë ligje tjera për të ardhur deri te ai organi kompetent. Prandaj, unë mendoj që në vend të 'organit kompetent' të shkruhet emërtimi i saktë i organit kompetent, sepse përndryshe, jo vetëm për persona që nuk kanë të bëjnë me ligje, por edhe për ne si deputetë, apo edhe për njerëz brenda ministrisë suaj, është pak problematike që të dihet se cili organ kompetent e

lëshon këtë leje, apo cili e ka këtë apo atë detyrë, apo atë mandat. Përndryshe, ne do ta votojmë.

KRYETARI: Në emër të Grupit Parlamentar të Aleancës, deputeti Ahmet Isufi e ka fjalën.

AHMET ISUFI: Faleminderit, zoti kryetar!

Grupi Parlamentar i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës e përkrah në parim Projektligjin e paraqitur dhe kontributin tonë do ta japim në komision. Faleminderit!

KRYETARI: Në emër të Grupit Parlamentar të Koalicionit për Kosovë të Re, kryetarja Myzejene Selmani e ka fjalën.

MYZEJENE SELMANI: Faleminderit, i nderuar kryetar i Kuvendit!

Edhe Koalicioni për Kosovë të Re i jep përkrahje Projektligjit për amët. Faleminderit!

KRYETARI: Deputeti Shaip Muja e ka fjalën.

SHAIP MUJA: Faleminderit, kryetar!

Unë jam munduar ta kuptoj këtë ligj, mirëpo me gjithë disa vërejtje, të cilat do t'i paraqes me shkrim, në nenin 18 kam vërejtje, në nenin 19, në nenin 22, në nenin 23, në nenin 31, në nenin 42, dhe në nenin 51, me propozimet, të cilat do t'i paraqes, edhe si formë amendamentesh ndoshta do të jetë një ligj, i cili do ta japë kuptimin më të mirë të këtij ligji, i cili është i nevojshëm të miratohet sa më shpejt.

Po ashtu edhe një vërejtje tjetër, të cilën e kam vërejtur për prodhuesit që mendohet të ketë në Republikën e Kosovës, e që jam dakord që Republika e Kosovës të ketë prodhues, ku paraqitet koha e licencimit, thuhet për 5 vjet, unë jam kundërshtar i licencave me vite. Nëse dikush e merr një licencë, ajo është e përhjetshme dhe nëse nuk i plotëson kushtet gjatë monitorimit, inspektimeve e të gjithave, i merret licenca, por jo t'i limitohet licenca, sepse në këtë mënyrë ne po e favorizojmë, jo vetëm për këtë pikë, por edhe për pikat tjera në një burokraci, e cila i jep mundësi edhe abuzimit. Faleminderit!

(Pjesë e diskutimit, e dorëzuar me shkrim)

Neni 18 - Pika 1.1 të plotësohet për të përfshirë punëtorët e KPS që sigurojnë objektet e rëndësisë së veçantë.

Propozoj: 1.1. punëtori i certifikuar dhe i kontraktuar të personi juridik i licencuar në fushën e sigurisë së personave, sigurimin e parave dhe gjërave tjera me vlerë, që të mbajë armë zjarri të kategorisë B, si dhe punëtori i certifikuar dhe i kontraktuar të personi juridik i licencuar në fushën e sigurisë së objekteve të rëndësisë së veçantë, që të mbajë armë zjarri të kategorisë C, gjatë orarit të punës në vendin e punës siç është përcaktuar në nenin 19 të këtij ligji;

Neni 19 - Pika 1. të plotësohet për të përfshirë punëtorët e KPS që sigurojnë objektet e rëndësisë së veçantë.

Propozoj: 1. Personat juridikë që posedojnë armë zjarri në bazë të lejes për posedim të armës së zjarrit duhet t'i japin armën e zjarrit për përdorim vetëm punëtorit të certifikuar, siç është përcaktuar në paragrafin 1 nën paragrafi 1.1 të nenit 18 të këtij ligji e që kanë kontratë pune me atë person juridik dhe që kryejnë punën e sigurisë ndaj personave ose për bartjen parave dhe sendeve të tjera me vlerë, apo punojnë në sigurimin e objekteve të rëndësisë së veçantë, si dhe plotësojnë kushtet e cekura në nenin 7 të këtij ligji.

Neni 22. Leja për armë gjuetie ose shenjëtarie

Propozoj: Pikat 2. dhe 3. të hiqen, në mënyrë që të lejohet qarkullimi i lirë i personave dhe të mos pengohet pa arsye zhvillimi i gjuetisë dhe shenjëtarisë.

Neni 23. Leja për armët e kategorisë D

Pika 2. Është e domosdoshme, për të përfshirë punëtorët e shërbimit privat të sigurisë, të cilët mbajnë pajisjet personale mbrojtëse në vendin e tyre të punës. Prandaj, kjo pikë duhet të plotësohet:

Propozoj: (të shtohet fjalia në fund): Personat fizikë, të punësuar te kompanitë e shërbimit privat të sigurisë, mund t'i bartin armët e kategorisë D4 (armët e ftohta profesionale), në vendin e punës sipas legjislacionit përkatës.

Neni 31. Leja për armë të kategorisë D për personat juridikë

Meqenëse në kategorinë D janë përfshirë edhe pajisjet mbrojtëse të punëtorëve të sigurisë private, në pikën 2. të shtohet teksti:

Propozoj: Kompanitë e shërbimit privat të sigurisë mund të bartin armët e kategorisë D4 (armët e ftohta profesionale), në vendin e punës sipas legjislacionit përkatës.

Neni 42 - Obligimi për të siguruar armën, pjesën e armës dhe municionin

Në kategorizimin e armëve, në pikën C8 të versionit të grupit të punës, parashihet adaptuesi, që nënkupton pajisjen, e cila mundëson ndërrimin e tipit të tytës dhe/apo kalibrin.

Të gjitha armët e gjuetisë mundësojnë ndërrimin e tytës, përkatësisht vendosjen e tytës me gjatësi të ndryshme, në mënyrë që t'i përshtatet qëllimit (sezoni) të gjuetisë. Duke pasur parasysh se gjatësia e tytës përcakton edhe kategorinë, së cilës i takon arma, atëherë pika 12 e këtij neni 42 bie ndesh me nenin 2 (përkufizimet) dhe nenin 4 (kategoritë).

Përveç kësaj, janë mbi 30 000 armë gjuetie të regjistruara në Kosovë (me leje), të cilat kanë magazinën që mban më tepër se dy fishekë. Këto armë janë të regjistruara në një kategori të caktuar sipas rregulloreve të UNMIK-ut. Sipas këtij paragrafi, të gjitha këto armë do të mbeten jashtë ligjit, sepse ligji e ndalon rregullimin e tyre.

Gjithashtu, askund në botë nuk prodhohen armë me vjaska (karabina) me magazinë vetëm për 2 fishekë. Sipas këtij paragrafi, këto armë nuk mund të importohen, pasi edhe adaptimi i magazinës do të përbënte vepër penale.

Megjithatë, duhet të qëndrojë pjesa tjetër e paragrafit që ndalon shndërrimin e armës jovekjeprurëse në armë vdekjeprurëse.

Propozoj: (të fshihen fjalët “nga një kategori në tjetrën):

12. Ndalohet ndryshimi i armëve, gjegjësisht shndërrimi i armës jo vdekjeprurëse në armë vdekjeprurëse.

Neni 45 - Shitja e armëve, pjesëve të armëve dhe municionit
Aktualisht, ligji nuk parasheh mundësinë që kompanitë e licencuara për tregti me armë (shitje me pakicë) të mund të blejnë nga një kompani tjetër e licencuar, në Kosovë, përpos për nevoja të veta.

Për blerje të armës, pjesëve të armës dhe municionit, kërkohet pëlqimi i veçantë. Si rrjedhojë, nëse një kompani dëshiron të blejë 100 armë nga një kompani kosovare e licencuar për tregti me armë, blerësi duhet t'i plotësojë 100 kërkesa për blerje, të cilat duhet t'i shqyrtojë organi kompetent (DSP) dhe të lëshojë 100 pëlqime.

Pastaj, në DSP do të arrijnë 100 raporte të shitjes nga kompania shitëse. Pastaj, kompania blerëse duhet ato t'i regjistrojë si armë të vetat dhe në DSP arrijnë edhe 100 raporte të shitjes nga stacioni policor ku gjendet kompania blerëse.

Kompania blerëse duhet të bëjë prapë kërkesën pranë DSP-së që ato armë t'i çregjistrojë dhe t'i nxjerrë në treg për shitje dhe DSP duhet të shqyrtojë edhe 100 kërkesa tjera.

Propozoj: Para pikës 2 duhet të shtohet pikë e re:

Kompania e licencuar për tregti me armë, pjesë të armëve dhe municionit mund të blejë armë, pjesë të armëve dhe municionit në tregun e brendshëm, me leje për tregti.

Neni 51. Licenca për riparim të armës

Propozoj: Të shtohet një pikë shtesë:

10. Personat juridikë nga paragrafi 1 i këtij neni mund të importojnë pjesë të imta të armëve pa leje importi, nëse kjo nuk kërkohet nga prodhuesi apo nga autoritete në vendin e prejardhjes.

Në këtë mënyrë do të thjeshtohet mirëmbajtja dhe riparimi i armëve. Këto pjesë nuk janë pjesë kryesore të armëve dhe nuk shkaktojnë kurrfarë rreziku për sigurinë, e as nuk i ndryshojnë të dhënat balistike e forenzike të armës.

(Shaip Muja, d.v.)

KRYETARI: Kanë mundur të prodhojnë “Amortizatorët” dhe “Zastava” e Pejës, por nuk janë më. Fjalën e ka deputeti Bekim Haxhiu.

BEKIM HAXHIU: Faleminderit, kryetar!

Është e nevojshme që kjo sferë të rregullohet përfundimisht me ligj dhe gjithsesi ky rregullim me ligj do të ishte mirë që t'u krijonte lehtësira edhe atyre të cilët përdorin armë

për qëllime sportive, çoftë edhe për gjueti, mirëpo jo aty ku pësohet në formën e atillë që vërtet të krijohen barriera dhe vështirësi të gjithë ata që e kanë këtë fushë si rekreacion.

Vërejtja ime është te rieksperti, domethënë propozoj te pika 1.52, rieksperti nënkupton aplikimin e formalitetet e eksportit për mallra që më parë janë importuar në Kosovë me lejen e autoriteteve përkatëse të vendit të prejardhjes.

Gjithsesi, vërejtja ime tjetër është te pika 1.6, leja për lëvizjen me armë. Meqenëse ministria e lëshon lejen për gjueti dhe shenjëtari për personat, të cilët janë të verifikuar dhe e posedojnë armën e gjuetisë apo shenjëtari, me të dhënat të cilat janë të përfshira në lejen e gjuetisë - shenjëtari, atëherë është e pakuptimtë që lëvizja nga adresa e vendbanimit deri në vendin e gjuetisë apo shenjëtarisë brenda territorit të Kosovës të bëhet me leje të veçantë, nëse këta posedojnë leje për to. Kështu praktikisht përjashtohet kuptimi i gjuetisë apo i shenjëtarisë si sport dhe argëtim, sepse askush nuk mund të parashohë kur do të ketë mundësi të dalë për gjueti apo ta vizitojë poligonin e civil-qitjes.

Propozoj që ky përkufizim të hiqet nga ky nen dhe të hiqet në tërë ligjin si kërkesë ligjore, përkatësisht të hiqen pikat 2 dhe 3 të nenit 22.

Gjithashtu, vërejtja ime është edhe te armët e ftohta dhe propozoj që armët e ftohta të ndaluara nënkuptojnë vegla, si: boksi metalik, thika balistike, veç vegël që shkrep me të në formë të thikës nëpërmjet mekanizmit të sustës, apo me ndonjë mekanizëm të ngjashëm, por që i përjashton armët me hark apo të tillë, thika 'katramë' apo vegla me teh të fshehur, apo çfarëdo lloj vegle tjetër, me teh, me gjemba, me maje, apo çfarëdo forme tjetër, që për qëllim kryesor ka shkaktimin e lëndimeve trupore. Ndalohet prodhimi, tregtimi apo posedimi i këtyre veglave.

Gjithashtu, kam edhe disa vërejtje tjera në këtë pikë, domethënë që pika 2.21 b; 1.21 c; 1.21 d; 1.21 e dhe 1.32, dhe gjithashtu te kjo fushë, te pika 1.31, gjithashtu në nenin 4, te kategorizimi kam vërejtje dhe propozoj që te kategoria armë, 'armët luftarake dhe municioni i tyre', armët që janë të dizajnuara apo që kanë për qëllim përdorimin nga institucionet shtetërore të sigurisë, të ndaluara për civilët, dhe në pikën 1.1.10. Këto vërejtje tjera, për të mos e marrë kohën e çmuar tuajën dhe për shkak që jemi në fund të seancës, do t'i dorëzoj në formë të shkruar të gjitha këto vërejtje, me qëllim që komisioni përkatës parlamentar, i cili do t'i marrë në shqyrtim këto dhe do t'i amendamentojë gjatë trajtimit të ligjit. Faleminderit!

(Pjesë e diskutimit, e dorëzuar me shkrim)

1. Rieksperti nënkupton veprimtarinë tregtare, duke përfshirë ndërmjetësimin, me ç'rast armët, pjesët e armëve dhe/apo municioni, që janë importuar në Kosovë mund të eksportohen në një vend të tretë, me leje të autoriteteve në vendin e prejardhjes. Me rastin e marrjes së lejes së eksportit, secili shtet parasheh edhe mundësinë e riekspertit, nëse për këtë merret pëlqimi i tyre paraprak. Deri tani, rieksperti ka qenë shprehimisht i ndaluar.

Propozoj (pas pikës 1.52): Rieksporti nënkupton aplikimin e formaliteteve të eksportit, për mallrat që më parë janë importuar në Kosovë me lejen e autoriteteve përkatëse të vendit të prejardhjes.

1.6 Leja për lëvizje me armë - Meqenëse Ministria lëshon lejen për gjueti dhe shenjëtari, për personat të cilët janë të verifikuar dhe posedojnë armën e gjuetisë apo shenjëtarisë, me të dhënat të cilat janë të përfshira në lejen për gjueti/shenjëtari, atëherë është e pakuptimtë që lëvizja nga adresa e vendbanimit deri në vendin e gjuetisë/shenjëtarisë, brenda territorit të Kosovës, të bëhet me leje të veçantë.

Kështu, praktikisht përjashtohet kuptimi i gjuetisë/shenjëtarisë si sport dhe argëtim. Sepse, askush nuk mund të parashohë kur do të ketë mundësi të dalë për gjueti, apo ta vizitojë poligonin civil të qitjes.

Propozoj: Që ky përkufizim të hiqet nga ky nen dhe të hiqet në tërë ligjin si kërkesë ligjore, përkatësisht të hiqen pikat 2. dhe 3. të nenit 22.

1.21 Armë e ftohtë - Sipas këtij definicioni, MPB duhet të lajmërohet për gjithçka që posedojmë në shtëpi (thikat e kuzhinës, shkopinjët e bejsbollit, sëpata, kosa, drapri, kaçavidat, mashat,...). Prandaj, definicioni të saktësohet si vijon:

Propozoj: 1.21a Armët e ftohta të ndaluara: Nënkupton veglat si “boksi metalik”, “thika balistike” (vegël që shkrepe tehe në formë të thikës nëpërmjet mekanizmit të sustës, apo ndonjë mekanizmi të ngjashëm, por që i përjashton armët me hark, apo tetivë), “thika-katramë”, veglat me teh të fshehur, apo çfarëdo lloj vegle tjetër, me teh, me gjemba, me majë, apo çfarëdo forme tjetër, që për qëllim kryesor ka shkaktimin e lëndimeve trupore. Ndalohet prodhimi, tregtimi, apo posedimi i këtyre veglave.

1.21b Armët e ftohta për të cilat nuk nevojitet leje: Nënkupton cilindo mjet, që kanë qëllim tjetër kryesor, por të cilat mund të përdoren për sulm apo për shkaktim të lëndimeve trupore, duke përdorur forcë fizike nga sulmuesi, në rastet kur ato mbahen në tubime publike, në objekte publike apo në vende të ngjashme (thikat e kuzhinës; kaçavidat; veglat të ndryshme shtëpiake, apo profesionale, etj). Këto vegla nuk lejohen të mbahen në tubime publike, në objekte publike, apo në vende të ngjashme.

1.21c Armët e ftohta për të cilat lëshohet leje: Nënkupton cilindo mjet me teh, apo majë, i cili përdoret në gjueti, apo në rastet tjera të qëndrimit në natyrë, e që nuk është përfshirë në pikën 1.21a, apo pikën 1.21b. Ky definicion përfshin, por nuk kufizohet me brisqet me teh më të gjatë se 12,5 cm, thikat me dy tehe, thikat me teh me gjemba, thikat me teh më të gjatë se 30 cm etj. Këto vegla lejohen të mbahen gjatë gjuetisë, apo rasteve tjera të qëndrimit në natyrë, por nuk lejohet të mbahen në tubime publike, në objekte publike, apo në vende të ngjashme.

1.21d Armët e ftohta profesionale: Nënkupton pajisjet profesionale, të cilat përdoren nga punëtorët e kompanive private të sigurisë, ose nga institucionet shtetërore të sigurisë. Kjo kategori përfshin, por nuk kufizohet me shufrat e gomës, shufrat metalike (ASP), tonfa,

prangat metalike etj. Këto pajisje lejohet të mbahen vetëm nga punëtorët e kompanive private të sigurisë, si dhe nga institucionet shtetërore të sigurisë.

1.21e Organi kompetent do të nxjerrë udhëzim administrativ për ta rregulluar çështjen e armëve të ftohta

1.32 Pjesët kryesore të armës së zjarrit. Tek prodhuesit, si dhe tek shtetet me “traditë” më të gjatë ligjore në këtë fushë, korniza dhe pjesët që janë në të (anglisht: “receiver”) nënkupton pjesën kryesore të armës, ndërsa tyta është “material shpenzues”, sikur motori i automjetit. Kjo për shkak se tyta harxhohet, apo dëmtohet gjatë shkrepjes së fishekëve dhe duhet të ndërrohet. Asnjë prodhues i armëve nuk i shënjon tytat, nëse prodhohen për shitje veçmas. Përfshirja e tytës së armës në këtë përkufizim, praktikisht e bën të pamundur importin e tytave për riparim, sepse, më tutje në ligj, parashihet që pjesët kryesore të armës, duhet të kenë numrin serik.

Propozoj: Përderisa pjesët e armës, duke përfshirë tytën, janë të përshkruara në paragrafin 1.31. ky paragraf (1.32) të fshihet. Në vend të tij, të futet paragrafi “Pjesët e imëta të armës”, i cili është i shënuar në fillim.

Neni 4 (Kategorizimi) - Për nevoja të sigurisë së njerëzve, kategorizimi duhet të marrë parasysh kalibrin, shpejtësinë e rimbushjes (mekanizmin e veprimit) dhe largësinë e veprimit. Ndarja e armëve në: me vjaska dhe pa vjaska përfshin të gjitha këto elemente. Nënndarja e armëve me vjaska në ato me ndezje anësore dhe ndezje qendrore thekson edhe më tepër elementin e sigurisë.

Kufizimi i sasisë së municionit që mund të mbajë arma së bashku me magazinën (gjithsej 3 për armët e gjuetisë, dhe gjithsej 5 për armët e sportit), e bënë të panevojshëm futjen e këtij elementi në nënkategori.

Gjithashtu, duhet të ndryshojnë titujt e kategorive, në mënyrë që të jenë më të kuptueshëm.

Propozoj: Kategoria A: Armët luftarake dhe municioni i tyre (armët që janë dizajnuar, apo që kanë për qëllim përdorimin nga institucionet shtetërore të sigurisë, të ndaluara për civilët).

Në pikën 1.1.10 armë me gaz dhe municioni i saj (A10); është e domosdoshme të sqarohet se është fjala për armët për përdorim të agjentëve kimik (pika 1.17 e nenit 2.), e jo për armët pneumatike (pika 1.16 e nenit 2.).

Propozoj: 1.1.10 Armë për përdorim të agjentëve kimikë dhe municioni i saj.

Kategoria A12 ndalon për tregun civil tazerat (elektroshok), të cilët nuk janë fare të rrezikshëm, ndërsa u lejon njerëzve të posedojnë armë zjarri, që jo vetëm qëllimisht, por edhe aksidentalisht mund të marrin jetën e njeriut. Ekzistojnë një mori modelesh të këtyre “armëve” të cilat mund të veprojnë vetëm në afërsi trupore (pra, duke e mbajtur

atë në dorë), e që mund të përdoren për vetëmbrojtje (sidomos nga femrat). Edhe nëse kjo pajisje bie në duar të sulmuesit, ajo nuk paraqet rrezik për pronarin, sepse nuk mund ta shkaktojë vdekjen.

Në anën tjetër, nëse arma e zjarrit, e cila mbahet për vetëmbrojtje, bie në duar të sulmuesit, mund të jetë rrezik për vetë pronarin e saj. Duke e kufizuar këtë paragraf vetëm për një tip të këtyre armëve (atyre që shkrepin elektroda deri në 5 metra), atëherë, sidomos femrave, u mundësohet që t'i mbajnë këto “armë” në vend të pistoletave.

Propozoj: 1.1.12 Paralizues elektrik me elektroda, të cilat mund të shkrepin nga arma, por që mbeten të lidhura me tela.

Kategoria A17 është futur në ligjin tonë për shkak se Agjencia e Forenzikës nuk ka pasur mundësi t'i identifikojë predhat e shkrepura nga Glock. Mirëpo, edhe Glock prodhon tytë të cilat pavarësisht se janë poligonale, megjithatë lënë shenja në predhën e shkrepur. Kështu siç është, ky paragraf e përjashton mundësinë e shitjes së modeleve të armëve, të cilat janë më të njohura në botë dhe më cilësore (Glock, Steyr etj.).

Propozoj: 1.1.17 Armët e zjarrit me tytë poligonale, të cilat kur shkrepin nuk krijojnë gjurmë në predhën e fishekut.

Kategorizimi i armëve në kategoritë B dhe C është i ndërlikuar dhe i pakuptimtë. Një nënkategori është ndarë sipas një elementi (me vjaska/pa vjaska), një tjetër sipas gjatësisë së tytës, një tjetër sipas mekanizmit të qitjes, një tjetër sipas sasisë së municionit në magazinë. Në praktikë, kjo e bën shumë të vështirë përcaktimin e kategorisë në rastin konkret. P.sh. një pushkë me vjaska përsëritëse, që së bashku me magazinën mund të marrin gjithsej 3 fishekë, nuk mund të përcaktohet në asnjërën kategori, me saktësi, por duhet vepruar me hamendje dhe me “përjashtim”.

Prandaj, kategorizimi i armëve të bëhet në tërësi ndryshe (siç janë shembuj nga shumë ligje të ngjashme të vendeve tjera).

Propozoj: 1.2 Kategoria B: Armët mbrojtëse dhe municioni i tyre (armët për të cilat kërkohet leje e veçantë).

1.2.1 Armët e shkurtra të zjarrit, gjysmautomatike, apo përsëritëse, me ndezje qendrore (B1)

1.2.2 Armët e shkurta të zjarrit, gjysmautomatike, apo përsëritëse, me ndezje anësore (B2)

1.2.3 Armë e gjatë e zjarrit, gjysmautomatike, apo përsëritëse, me vjaska dhe ndezje qendrore (B3)

1.2.4 Armë e gjatë e zjarrit, gjysmautomatike, apo përsëritëse, me vjaska dhe ndezje anësore (B4)

1.2.5 Municioni dhe pjesët e municionit (gëzhoja, kapsolla, gëzhoja me kapsollë, predha) për armët e kësaj kategorie. (B5)

1.2.6 Paralizues elektrik, me elektroda që nuk mund të shkrepin

1.2.7 Armët e gjata të zjarrit, të kësaj kategorie, nuk lejohet të mbajnë më tepër se 3 fishekë, së bashku me magazinën

Armët ajrore, të fuqisë më të madhe se 7,5J dhe kalibrit më të madh se 4,5mm, duhet të lejohen me kushte më të lehta. Pra, të kalojnë nga kategoria B, në kategorinë C. Ndërsa armët ajrore me fuqi më të vogël se 7,5J dhe të kalibrit më të vogël se 4,5mm, duhet të hiqen nga kategoria C. Pra, duhet të lejohen vetëm me njoftim (regjistrim), e jo me kushte të njëjta sikur armët e gjuetisë.

Përndryshe, pamundësohet zhvillimi i sportit të shenjëtarisë sportive dhe Kosova po shndërrohet në përjashtim nga e tërë bota e zhvilluar.

Gjithashtu, pajisjet mbrojtëse personale që tregtohen në tregun civil (kompanitë e sigurimit fizik, si dhe qytetarët për nevoja të veta (nga një copë), duhet të përfshihen në këtë kategori

Propozoj: 1.3 Kategoria C: Armët e gjuetisë, dhe municioni i tyre, për të cilat kërkohet leje e veçantë.

1.3.1 Armë e gjatë e zjarrit, gjysmautomatike, apo përsëritëse, pa vjaska (C1)

1.3.2 Armë me mbushje përmes tytës (kobure) (C2)

1.3.3 Armë me vjaska, për një qitje (teke) (C3)

1.3.4 Armët pneumatike, me energji mbi 7,5J dhe me kalibër mbi 4,5mm. (C4)

1.3.5 Municioni dhe pjesët e municionit (gëzhoja, kapsolla, gëzhoja me kapsollë, predha) për armët e kësaj kategorie. (C5)

1.3.6 Pajisjet mbrojtëse personale (helmetat balistike, jelekët antiplumb, pajisjet dhe artikuj të ngjashëm). (C6)

1.3.7 Pajisjet për kontroll të personave (shufrat e të gjitha llojeve, prangat e metalit për duar). Këto pajisje lejohet të mbahen vetëm nga punëtorët e kompanive private të sigurisë, si dhe nga institucionet shtetërore të sigurisë. (C7)

1.3.8 Paralizues elektrikë, me elektroda që nuk mund të shkrepen. (C8)

1.3.9 Armët e kësaj kategorie nuk lejohet të mbajnë më tepër se 3 fishekë, së bashku me magazinën.

Kategoria D, aktualisht, nuk përfshin një varg të llojeve të armëve, që përmenden tek përkufizimet, e pastaj mbeten të patrajtuara.

Gazi lotsjellës në bazë natyrore (OC sprej) për dallim prej llojeve artificiale (CS, CR, CN, etj), nuk është i rrezikshëm dhe është i lejuar në shumë shtete (SHBA, Kanada, Amerika e Jugut (të gjitha shtetet), Afrika e Jugut, Austria, Bullgaria, Kroacia, Çekia, Estonia, Finlanda, Franca, Gjermania, Hungaria, Italia, Polonia, Rumania, Sllovakia, Sllovenia, Spanja, Zvicra, Ukraina, Izraeli, India, Kina, Japonia, Malajzia, Filipinet, Australia, Taivani, Korea e Jugut, etj.). Lejimi i këtyre sprejave do të zvogëlonte për mbajtje të armës së zjarrit.

Armët pneumatike me energji dhe kalibër të vogël (deri 7,5J dhe deri 4,5mm) tregtohen lirisht në mbarë botën. Gjithashtu, këto armë janë armë sportive. Përfshirja e tyre në kategorinë B dhe C pamundëson zhvillimin e sportit të shenjëtarisë sportive. Kjo nga fakti se ndonëse Ligji për armë lejon të rinjtë mbi moshën 16-vjeçare që të përdorin armët sportive, ky ligj nuk u lejon atyre të posedojnë armë të tilla, që është parakusht për masivizimin e këtij sporti dhe arritjen e rezultateve për gara. Prandaj, është e domosdoshme që armët nga kategoria 1.6.1 deri 1.6.3 më sipër duhet të lejohen për posedim nga mosha 16 vjeç.

Propozoj: 1.4 Kategoria D: Armët sportive dhe municioni i tyre dhe armët e ftohta, për të cilat pronari bën njoftim në polici:

1.4.1 Armë pneumatike, me energji deri në 7,5J dhe me kalibër deri në 4,5mm. (D1)

1.4.2 Armë me gaz, që shkrepin predha sferike (airgun/airsoft), apo mbushje me ngjyrë (paintball), apo mbushje tjetër. (D2)

1.4.3 Armë me hark, tojë, apo tetivë. (D3)

1.4.4 Armë e specializuar, që përdoret nën ujë, që shkrep në kontakt të drejtpërdrejt me cakun (powerhead). (D4)

1.4.5 Armë e specializuar, për sinjalizim me zë, apo me dritë. (D5)

1.4.6 Armë që shkrepin fishekë qorr, por që tyta e tyre nuk lejon shkrepjen e fishekëve të vërtetë. (D6)

1.4.7 Armët koleksionuese dhe dekorative (duke përfshirë armët e paaftësuar, armët antike, si dhe riprodhimet/replikat e armëve historike) (D7)

1.4.8 Spreji në bazë të produkteve natyrore (OC sprej). (D8)

1.4.9 Municioni dhe pjesët e municionit (sferat, diabollat, gëzhoja, kapsolla, gëzhoja me kapsollë, predha) për armët e kësaj kategorie. (D9)

1.4.10 Cilido mjet me teh, apo majë, i cili përdoret në gjueti, apo në rastet tjera të qëndrimit në natyrë, e që nuk është përfshirë në kategoritë e mëparshme. Kjo kategori përfshin, por nuk kufizohet me brisqet me teh më të gjatë se 12,5 cm, thikat me dy tehe, thikat me teh me gjemba, thikat me teh më të gjatë se 30 cm, etj. (D10)

1.4.11 Veglat nga pika 1.6.10 lejohen të mbahen gjatë gjuetisë, apo rasteve tjera të qëndrimit në natyrë, por nuk lejohet të mbahen në tubime publike, në objekte publike apo në vende të ngjashme.

(Bekim Haxhiu, d.v.)

KRYETARI: Fjalën e ka deputeti Ramiz Lladrovci.

RAMIZ LLADROVCI: Faleminderit, kryetar!

Të nderuar ministra,

Të nderuar kolegë deputetë,

Projektligji për armët e ka një rëndësi të veçantë dhe është i domosdoshëm. Unë do t'i numëroj vetëm nenet ku kam vërejtje dhe propozimet e mia do t'i dorëzoj me shkrim dhe në formë elektronike që ta lehtësoj edhe punën e komisionit, edhe të grupeve punuese.

Fillimisht dua të them se ligji ka mangësi në gjuhë, sepse nuk është hartuar në gjuhën shqipe, por teksti bazë është versioni anglisht, ndërsa versioni shqip është i përkthyer,

pastaj prapë është kthyer në anglisht, e kështu me radhë. Kjo vërehet tek neni 2, përkufizimet.

Versioni i vjetër i ligjit në anglisht është i radhitur sipas alfabetit, ndërsa versioni shqip nuk është, kurse tani asnjë version nuk ka radhitje alfabetike. Propozoj që versioni shqip të radhitet siç duhet, ndërsa versionet tjera të përshtaten. Pra, tani po i lexoj vetëm nenet ku kam vërejtje dhe propozimet do t'i dorëzoj me shkrim. Neni 1, 2, 3, 4, 5, 7, 8, 12, 13, 14 dhe neni 18. Faleminderit!

(Pjesë e diskutimit, e dorëzuar me shkrim)

Neni 1: Me këtë rishikim, ligji e rregullon edhe eksportin dhe riekportin e armëve, ndërsa nuk janë përfshirë në këtë nen.

Propozoj: Pas fjalës 'importimin', të futen fjalët 'eksportimin' dhe 'rieksportimin'.

Neni 2: Definicionet që mungojnë:

- Kategorizimi i armëve varet edhe nga lloji i tytës (me vjaska, pa vjaska), ndërsa askund nuk është sqaruar ky përkufizim.

Propozoj: Armë zjarri me vjaska: Nënkupton armët e zjarrit, tyta e të cilave përshkohet me lugje në formë të spirales, nga foleja deri në dalje të tytës, me qëllim për t'i dhënë shpejtësi dhe drejtim/saktësi predhës së shkrepur.

Armë zjarri pa vjaska: Nënkupton armët e zjarrit, tyta e të cilave është e lëmuar.

- Aktualisht, edhe për pjesët e imta të armës (sustat, bulonat, shënjestrat mekanike etj.) për të cilat nuk kërkohet leje eksporti në vendin e prejardhjes, te ne kërkohet leje importi. Kjo praktikisht e pamundëson riparimin dhe servisimin e armëve, edhe pse këto pjesë nuk kanë kurrfarë ndikimi në vetitë balistike apo forenzike të armës, e as nuk ndryshojnë kategorinë, apo saktësinë e armës. Prandaj, në këtë nen duhet të futen si përkufizim, ndërsa më vonë të përjashtohen nga procedurat e kontrollit të importit. Gjatë përshkrimit të procedurës së importit dhe kontrollit të sqarohet se kompanitë e licencuara për riparim të armëve nuk kanë nevojë ta ndjekin procedurën e importit, nëse kjo nuk kërkohet në vendin e prejardhjes, por duhet të mbajnë evidencë të qartë të importit dhe ndërrimit të pjesëve të imta.

Propozoj: Pjesë e imët e armës së zjarrit: nënkupton elementët e tjerë të armës së zjarrit, përveç pjesëve kryesore.

Neni 5 - Pasi është shtuar përkufizimi për pjesët e imëta të armës në nenin 2, këtu të shtohet një paragraf i veçantë

Propozoj: 2. Pjesët e imëta të armës mund të ndërrohen pa pëlqim të kompania e licencuar për riparim të armëve. Kompania e licencuar për riparim të armëve do të mbajë evidencë për pjesët e ndërruara sipas udhëzimeve administrative të lëshuara nga organi kompetent.

Neni 7 - Me qëllim që armët pneumatike t'u lejohen të rinjve, pika 1.1 të plotësohet:

Propozoj: 1.1 të ketë mbushur moshën njëzetënjë (21) vjeç, përkatësisht gjashtëmbëdhjetë (16) vjeç për armët e kategorisë 1.4.1 deri 1.4.3

Neni 8 - Sipas këtij neni, punëtorët e Kompanive Private të Sigurimit (KPS) do të kenë një karikator plotë dhe dy rezervë (50 fishekë). Në rast të ballafaqimit me ndonjë kundërshtarë, nuk do të jenë në gjendje as të kërkojnë mbështetje, sepse nuk kanë me çka. Përveç kësaj, pasi të kenë pasur ndonjë situatë të tillë, edhe nëse nuk kanë shpenzuar tërë municionin, ata nuk do të jenë në gjendje të dalin në detyrë, sepse do të duhet të presin që personi juridik (KPS) të aplikojë për blerjen tjetër, dhe të presin mbledhjen e komisionit pranë organit kompetent.

Qendrat e trajnimit do të kenë mundësi të ushtrjnë vetëm 2-4 qytetarë civilë, dhe pastaj do të duhet të mbyllen dhe të presin mbledhjen e komisionit. Në anën tjetër, do të jetë e pamundur të ushtrjnë punëtorët e KPS, sepse për një vijues nga kjo kategori shpenzohen mbi 500 fishekë.

Prandaj, kjo pikë të ndryshohet.

Propozoj: Personave juridikë që janë të regjistruar për ushtrimin e veprimtarisë së sigurisë së personave, sigurimin e parave dhe sendeve të tjera me vlerë dhe gjërave tjera të vlefshme gjatë transportimit, si dhe personave juridikë që japin trajnime, ose janë të regjistruar si shoqata të shenjëtariisë ose gjuetisë. Organi kompetent do ta japë pëlqimin për blerje të shumëfishtë me municion, me afat të vlefshmërisë deri në një (1) vit dhe për sasi të përcaktuara të municionit në pajtim me mundësitë për vendosjen dhe shfrytëzimin e municionit. Ky pëlqim do të lëshohet për armët e lejuara për posedim.

Neni 12. Provimi profesional - Aktualisht, MPB-ja ka problem në rregullimin e trajnimit të punëtorëve të kompanive të sigurisë private. Sepse, ligji për armë thirret në ligjin për sigurinë private, kurse ligji për sigurinë private thirret në ligjin për armë. Pra, krijohet një rreth vicioz që e lë çështjen të parregulluar. Prandaj, të shtohet një paragraf i ri, 3a.

Propozoj: 3.a Aftësimi praktik për mënyrën e përdorimit të armës të kategorisë B, C, D, të punëtorëve të Kompanive Private të Sigurimit, si dhe personave fizikë bëhet nga personi juridik i licencuar sipas Ligjit për shërbimet private të sigurisë. Personi juridik i licencuar duhet t'ia lëshojë certifikatën personit fizik pas përfundimit të suksesshëm të aftësimit praktik.

Paragrafi 7 të përshtatet.

Propozoj: 7. Organi kompetent me akt nënligjor do ta përcaktojë llojin dhe modalitetet e aftësimit teorik dhe praktik, si dhe verifikimin e kualifikimit të instruktorëve të punësuar te personat juridikë që do të licencohen për ofrim të aftësimit, si dhe të personave fizikë dhe punëtorëve të Kompanive Private të Sigurimit, që vijojnë aftësimin praktik dhe teorik, sipas paragrafit 3 dhe 3a.

Neni 13 - Ligji për sigurinë private, aktualisht parasheh vetëm dy kategori të punëtorëve të sigurimit, që mundë të mbajnë armë

- Për transport të parave të gatshme
- Mbrojtje të afërt (truproje)

Mirëpo, ky ligj, në të ardhmen, do të duhet të plotësohet për të përfshirë edhe sigurimin e objekteve të rëndësisë së veçantë. Këtu përfshihen objektet e infrastrukturës kritike nacionale (p.sh. Penda e Batllavës, objektet e Elektrolizës në KEK, Banka Qendrore e Kosovës, Aeroporti, depot e armëve, municionit dhe eksplozivit etj.).

Pika 2.7 e këtij neni i lejon Aeroportit blerjen e armëve. Ndonëse kjo pikë nuk sqaron çfarë armë dhe për çfarë qëllimi, këto armë parashihet të blihen për shfarysjen e kafshëve të dëmshme nga hapësira e aeroportit. Pra, jo për nevoja të sigurisë.

Është e domosdoshme që këto hapësira dhe objekte ta kenë nivelin e duhur të sigurisë. Meqenëse këto hapësira duhet të sigurohen nga KPS, kjo nënkupton edhe ndryshimin e Ligjit për shërbimet private të sigurisë. Prandaj, ky paragraf thirret në këtë ligj.

Këto objekte, deri në hyrjen në fuqi të rregullores së UNMIK-ut 2000/33 (në vitin 2001) janë ruajtur nga rojtarët e armatosur me pushkë gjuetie. Duke pasur parasysh këtë, pika 2.4 të përshtatet:

Propozoj: 2.4. kompanitë që ofrojnë siguri në fushën e sigurisë personale dhe ato në fushën e transportit të parave dhe mallrave me vlerë, si dhe në fushën e sigurimit të objekteve me rëndësi të veçantë, në përputhje me Ligjin për shërbimet private të sigurisë;

Neni 14 - Pika 4. e këtij neni duhet të plotësohet në përputhje me plotësimin në nenin 13, pika 2.4 për të përfshirë armët të cilat u lejohen punëtorëve të KPS, në sigurim të objekteve të rëndësisë së veçantë:

Propozoj: (të shtohet në pikën 4): Për sigurim të objekteve të rëndësisë së veçantë, posedimi i armës saktësohet nga organi kompetent, me vendim të veçantë nga organi kompetent, në varësi nga rëndësia dhe rrezikshmëria e objektit të siguruar.

Ligji për armë nuk e rregullon çështjen e pajisjeve mbrojtëse për punëtorët e sigurimit privat, ndërsa Ligji për sigurinë private thirret në Ligjin për armë. Pra, edhe këtu ekziston një vakum ligjor. Për këtë arsye, dhe duke pasur parasysh plotësimin e kategorisë D të armëve, të shtohet një pikë e re, para pikës 5. Në këtë mënyrë do të rregullohet edhe importi dhe tregtimi i pajisjeve personale të sigurisë për punëtorët e shërbimit privat të sigurisë.

Propozoj: Personi juridik, i licencuar sipas Ligjit për shërbimet private të sigurisë mund të posedojë armë të ftohta të kategorisë 1.5 për punëtorët të cilët janë të licencuar nga organi kompetent dhe në përputhje me Ligjin për shërbimet private të sigurisë.

(Ramiz Lladrovci, d.v.)

KRYETARI: Nuk kemi të lajmëruar të tjerë për fjalë. Në sallë janë 63 deputetë. Lus deputetët dhe regjinë të përgatiten për votim. Votojmë tash!

Edhe një herë votimi! Me ngritje dore, a? Mirë, edhe një herë votojmë.

Lus deputetët dhe regjinë të përgatiten për votim. Votojmë tash!

Konstatohet se me 60 vota për, 1 kundër, 1 abstenim, Kuvendi e miratoi në parim Projektligjin numër 04/L-241 për armë.

Ngarkohen Komisioni Funkcional dhe komisionet e përhershme që në afatin e paraparë me Rregulloren e Kuvendit ta shqyrtojnë projektligjin dhe Kuvendit t'ia paraqesin raportin me amendamente.

Vazhdojmë me pikën e dymbëdhjetë të rendit të ditës:

12. Shqyrtimi në parim i Projektligjit për Inspektoratin e Doganës dhe Administratës Tatimore të Kosovës

Në bazë të nenit 56 të Rregullores së Kuvendit, Komisioni Funkcional e ka shqyrtuar projektligjin dhe Kuvendit ia ka rekomanduar miratimin e tij në parim.

E ftoj ministrin e Financave, zotin Besim Beqaj, që para deputetëve të Kuvendit ta paraqesë dhe arsyetojë projektligjin. Ministër, e ke fjalën.

MINISTRI BESIM BEQAJ: Faleminderit, i nderuar kryetar!

Të nderuar deputetë,

Me qëllim të ngritjes së cilësisë së inspektimit dhe kontrollit të veprimtarisë së Doganave të Kosovës dhe Administratës Tatimore të Kosovës, Ministria e Financave në vitin e kaluar e ka hartuar Projektligjin për Inspektoratin e Doganës dhe të ATK-së.

Ky projektligj e përcakton fushëveprimin dhe parimet e këtij inspektorati, rregullon statusin e tij, e përcakton rolin e Ministrisë së Financave në raport me Inspektoratin, e rregullon mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të inspektoratit, duke e rregulluar pozitën e drejtorit të përgjithshëm, të personelit, aspektet hetimore e tjerë.

Në aspektin hetimor, ky projektligj i përcakton kompetencat hetimore dhe inspektuese të Inspektoratit të Doganës të Kosovës dhe të Administratës Tatimore të Kosovës, si dhe procedurat që duhet të respektohen gjatë zhvillimit të hetimeve dhe të inspektimeve.

Vlen të theksohet se gjatë hartimit të këtij projektligji, Ministria e Financave i ka analizuar praktikat më të mira evropiane dhe rajonale, por njëkohësisht edhe ato në brendi të vendit.

Në kontestin e objektivave nëpërmjet themelimit të këtij inspektorati, Ministria e Financave synon parandalimin dhe ndjekjen e shkeljeve ligjore eventuale që mund të ndodhin në këto dy institucione, duke i trajtuar të gjitha dyshimet për shkeljet disiplinore dhe penale, kështu që konform shqyrtimeve analitike të bëra nga Ministria e Financave,

ky projektligj në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe tërthorazi do të ndihmojë në rritjen e të hyrave në Doganën e Kosovës dhe në Administratën Tatimore të Kosovës, në rritjen e performansës së Doganave të Kosovës dhe të Administratës, në zbatim të ligjit, në luftim të ekonomisë joformale, në luftimin e konfliktit të interesit, në rritjen e sigurisë juridike për bizneset, në rritjen e nivelit të transparencës dhe në luftimin e të gjitha formave tjera të korrupsionit dhe dukurive tjera.

Si rrjedhojë, i gjithë fushëveprimi i këtij inspektorati do t'i shërbejë zhvillimit ekonomik dhe fuqizimit të sundimit të ligjit, që janë dy nga katër shtyllat kryesore ku bazohet programi i Qeverisë së Republikës së Kosovës 2011-2014, e ku janë përcaktuar edhe prioritetet e Qeverisë së Republikës së Kosovës.

Prandaj, të nderuar deputetë, duke parë rëndësinë e këtij projektligji, ju ftoj që ta votoni në parim dhe në ndërkohë, nëse ka propozime, ta përmirësojmë edhe më tutje. Faleminderit!

KRYETARI: Në emër të komisionit, fjalën e ka kërkuar deputetja Jelena Bontiq.

JELENA BONTIĆ: Hvala predsedavajući!

Poštovani ministri,

Uvažene kolegice i kolege,

Nacrt zakona broj 04-L-243 o Inspektoratu carina i poreskoj administraciji Kosova, glavni cilj ima osnivanje inspektorata carina i poreske administracije Kosova u okviru Ministarstva finansija.

Nacrt zakona utvrđuje i istražne i inspeksijske nadležnosti Inspektorata carina Kosova i Poreske administracije Kosova, kao i procedure koje treba poštovati tokom vođenja istrage i inspekcije.

Nacrt zakona o Inspektoratu carina i Poreske administracije utvrđuje delokrug rada i načela ovog inspektorata, uređuje njegov status i utvrđuje ulogu Ministarstva finansije u odnosu sa inspektoratom. Takođe, ovaj nacrt zakona uređuje način organizovanja i funkcionisanja ovog inspektorata uređujući poziciju generalnog dsirektora, kao i osoblja.

Ivšrna analitička razmatranja od Ministarstva finansija su dokazana da ovaj nacrt zakona na neophodan i poseban način će uticati u povećanju prihoda u carinama Kosova i u Poreskoj administraciji Kosova, suzbijanju neformalne ekonomije, suzbijanju konflikata interesa, povećanju performanci Carine Kosova i Poreske administracije u sprovođenju zakona, povećanju pravne sigurnosti za biznese, povećanje nivoa transparentnosti i suzbijanju svih oblika korupcije.

Komisija za budžet i financije, na sednici održanoj 22. 01.2014. godine, razmatrao Nacrta zakona o inspektoratu carina i Poreskoj admistraciji Kosova, i ocenila da nacrt zakona ispunjava predviđene formalno-pravne neophodne uslove Poslovnika Skupštine, što znači da nacrt zakona sadrži objašnjavajuće memorandum e za ciljeve koji imaju za težnju da realizuju ovaj zakon i usklađivanje sa važećim zakonodavstvom. Takođe nacrt zakona

sadrži i finansijsku deklaraciju o budžetskim implikacijama, što se procenjuje da će nacrt zakona proizvesti dodatni budžetni kosto u vrednosti od 60 hiljada euro, čiji iznos će biti snošljiv za budžet Kosova.

Nacrt zakona sadrži i deklaraciju o približavanju i usklađivanju sa zakonodavstvom Evropske unije, prema tome može se zaključiti da odredbe nacrt zakona ne povređuju opšta načela zakonodavstva Evropske unije i kao takav nije u suprotnosti sa osnovnim načelima AKVA Evropske unije. S toga, nacrt zakona kao takav ispunjava uslove za usvajanje na prvo čitanje i Komisija preporučuje Skupštini da ga usvoji u načelu, i sve primedbe i preporuke koje će proizaći u vezi ovog nacrt zakona pažljivo će se razmotriti od komisije tokom njegovog amandamentiranja. Hvala!

KRYETARI: Në emër të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike, deputetja Valbona Dibra e ka fjalën.

VALBONA DIBRA: Faleminderit, i nderuar kryetar!

I nderuari ministër,

Të nderuar kolegë deputetë,

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës e ka shqyrtuar Projektligjin për Inspektoratin e Doganës së Kosovës dhe Administratës Tatimore të Kosovës. Ky projektligj ka për qëllim themelimin e Inspektoratit të Doganës të Kosovës dhe Administratës Tatimore të Kosovës si një institucion i pavarur në kuadër të Ministrisë të Financave.

Objekt i veprimtarisë të Inspektoratit të Doganës dhe Administratës Tatimore të Kosovës është parandalimi, zbulimi, dokumentimi dhe hetimi i shkeljeve të mundshme, të kryera nga zyrtarët e Doganës së Kosovës dhe Administratës të Kosovës, pa dallim grade dhe pozite gjatë ushtrimit të detyrës.

Pra, Inspektorati Doganës së Kosovës dhe Administratës Tatimore të Kosovës është organ qendror i Administratës në kuadër të Ministrisë të Financave, i pavarur nga Dogana e Kosovës dhe Administrata Tatimore e Kosovës.

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës, themelimin e këtij inspektorati e konsideron shumë të rëndësishëm dhe ne si grup do të votojmë për themelimin e tij. Faleminderit!

KRYETARI: Në emër të Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike, deputeti Muhamet Mustafa e ka fjalën.

MUHAMET MUSTAFA: I nderuar kryetar i Kuvendit të Kosovës!

I nderuar ministër,

Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike i mbështet të gjitha aktivitetet dhe orientimet të cilat kanë për orientim rritjen e të ardhurave në Buxhetin e Kosovës, evitimin e shkeljeve dhe në këtë drejtim duket se edhe krijimi i këtij inspektorati që paraqet një institucion të ri dhe unifikimi i aktiviteteve të inspektoratit dhe kontrollit të dy institucioneve kyçe të

mbledhjes të ardhurave për Buxhetin e Kosovës mund të jetë i dobishëm dhe efektiv, andaj edhe ne e mbështesim këtë projektligj.

Përqendrimi i këtij inspektorati do të jetë në deliktet dhe shkeljet që po përbëjnë vepra penale, për çka kompetente janë që hetimet t'i zhvillojnë edhe Policia e Kosovës, edhe Prokuroria e Kosovës.

Duket se në tekstin e ligjit ka disa probleme lidhur me koordinimin ndërmjet këtyre institucioneve. Nëse do të krijohej një konflikt ndërmjet këtyre tri institucioneve, ky projektligj nuk do t'i arrinte objektivat e tij. Prandaj, në tekstin e mëtejshëm duhet të evitohen të gjitha ato që mund ta pengojnë që edhe Prokuroria, edhe Policia, pavarësisht prej këtij organi, duhet t'i bëjnë hetimet e veta për veprat penale, sepse këtu, në disa vende, theksohet se në qoftë se dikush bënë hetime penale për shkelje të ligjit, edhe të Doganave, edhe të Administratës Tatimore, atëherë duhet t'i bartë te ky institucion.

Kjo do të ishte problematike, sepse në vend që të krijojmë një komplementaritet, ne do të pengojmë, prandaj të mos harrojmë që ky organ do të jetë nën ndikimin e drejtpërdrejtë të ministrit dhe të ministrisë. Kështu që shpeshherë mund të vijë edhe deri te konflikt i interesit, edhe deri te përzierja e kompetencave, edhe deri te rrezikimi i pavarësisë.

Prandaj, në leximin e dytë duhet të qartësohen këto raporte ndërmjet këtyre tri institucioneve, në mënyrë që asnjëra të mos e pengojnë tjetrën dhe të krijohet në efikasitet në punën e tyre. Faleminderit!

KRYETARI: Në emër të Grupit Parlamentar “Vetëvendosje”, deputetja Albana Fetoshi.

ALBANA FETOSHI: Faleminderit, kryetar!

Edhe ne si Grup Parlamentar i Lëvizjes “Vetëvendosje” e mbështetim themelimin e Inspektoratit për Doganën dhe Administratës së Kosovës, mirëpo i kemi disa vërejtje në nenet e këtij ligji, por besojmë që do ta japim kontributin tonë në Komisionin Funkcional që t' i përmirësojmë ato. Vërejtjet tona kanë të bëjnë kryesisht me atë se si në këto nene, kryeministri dhe ministri i Financave kanë kompetenca më shumë sesa duhet në këtë ligj për shkak se në një nen aty thuhet që në qoftë se ka shkelje, edhe vërehet që ka shkelje nga drejtori i Doganës, po ashtu edhe nga drejtori i Administratës Tatimore, atëherë kryeministri e autorizon Inspektoratin e Doganës dhe Administratës Tatimore që të kryejë punë.

Unë mendoj që Inspektorati i Doganës dhe i Administratës Tatimore duhet ta kenë një autonomi më të madhe dhe në rastet kur vërehen shkeljet t'i marrë vetë përsipër që të bëjë hetimin, e jo të presë që të autorizojë kryeministri për kryerjen e punës. Mendoj se për këtë arsye edhe themelohet ky inspektorat.

Po ashtu është në rregull dhe është e kuptueshme që ky inspektorat t'i raportojë Ministrisë të Financave, mirëpo konsiderojmë edhe një herë që ky inspektorat ta ketë një autonomi më të madhe në kryerjen e punëve që do t'i bëjë.

Gjithashtu, një vërejtje tjetër e kemi edhe në nenin 16, i cili nen u ndalon punonjësve të Inspektoratit të Administratës Tatimore dhe Doganës që ta ushtrojnë të drejtën e grevës. Ne e kemi të qartë që disa institucione që janë të ndjeshme, si Dogana, apo Policia, e kanë të ndaluar për shkak të ndjeshmërisë së tyre dhe mënyrën se si funksionojnë të drejtën e grevës, mirëpo mendoj se kjo duhet të rregullohet në një mënyrë tjetër. Domethënë punonjësit e kanë të ndaluar në mënyrë rreptësisht grevën, mirëpo të kenë të drejtë në greva të pjesshme, apo diçka të tillë, për shkak se ky është një mekanizëm, me të cilin punëtorët kanë mundësi t'i mbrojnë të drejtat e tyre, nëse ato u cenohen. Pra, greva është mjeti i fundit që punëtorët do ta përdornin kur t'i kanë shterur të gjitha mundësitë e tjera për t'i mbrojtur të drejtat e tyre.

Prandaj, këto janë disa vërejtje sa i përket ligjit në fjalë. Mendojmë se kontributin tonë për t'i përmirësuar këto do ta japim në Komisionin Funksional. Faleminderit!

KRYETARI: Në emër të Aleancës, deputeti Xhevdet Neziraj e ka fjalën.

XHEVDET NEZIRAJ: Faleminderit, i nderuar zoti kryetar!

Ministër,

Kolegë deputetë

Edhe grupi i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës do ta përkrahë në parim Projektligjin për Inspektoratin e Doganës dhe Administratës Tatimore. Mendojmë se ky inspektorat do të bëjë më tepër në luftimin e ekonomisë joformale, luftimin e konfliktit të interesit, por do të bëjë edhe ngritjen e performansës së Administratës Tatimore dhe të Doganës, do të thotë dy institucioneve shumë të rëndësishme që rritin të hyrat buxhetore në Buxhetin e Kosovës për arsye se si Dogana, si Administrata Tatimore e kanë një përqindje shumë të madhe të të hyrave buxhetore.

Prandaj, me këtë inspektorat shpresohet se do të ngrihet performansa më e madhe edhe e Doganës, edhe e Administratës Tatimore, por duhet të eliminohen disa mangësi. Atë që e ceku edhe profesor Mustafa, që të mos ketë shumë mekanizma dhe t'i lënë njëra-tjetrës se cila do ta luftojë këtë dobësi. Prandaj, Grupi i Aleancës e përkrah çdo iniciativë, aty ku luftohet ekonomia joformale, aty ku ka transparencë dhe ku ka rritje të të hyrave buxhetore.

Prandaj, në parim e përkrahim dhe kontributin tonë do ta japim edhe në Komisionin Funksional, edhe në komisionet e përhershme, në të cilat do të kalojë ky projektligj. Faleminderit!

KRYETARI: Në emër të Koalicionit për Kosovë të Re, deputetja Sevdije Lama e ka fjalën.

SEVDIJE LAMA: Faleminderit, kryetar!

Grupi parlamentar i Koalicionit për Kosovën e Re e përkrah Projektligjin për Inspektoratin e Doganës dhe Administratës Tatimore. Kontributin tonë do ta japim në komision.

KRYETARI: Fjalën e ka deputetja Justina Shiroka-Pula.

JUSTINA SHIROKA-PULA: Faleminderit, kryetar!

Unë e përshëndes këtë iniciativë të formimit të Inspektoratit Doganor dhe të ATK-së, që është shumë me rëndësi për efikasitetin dhe për eliminimin e çështjeve dhe kontrabandës, e cila po ndodh, mirëpo në kuadër të këtij ligji unë do të bazohem vetëm në disa nene dhe disa vërejtje, apo konsulta më mirë.

Në nenin 1 thuhet “ky ligj ka për qëllim”. Nuk ka nevojë të thuhet “ka për qëllim”, por në fakt, ky ligj themelon inspektorate, jo ka për qëllim, se nënkuptohet ligji. Do me thënë është thjesht vërejtje gjuhësore. Në shumë nene flitet, diku janë zyrtare, diku janë stafi, duhet të koordinohet, se a kemi të bëjmë me stafin, a kemi të bëjmë me zyrtarët e inspektoratit.

Në disa nene flitet për njëfarë disproporcioni të përgjegjësive ndërmjet Inspektoratit, gjykatave dhe Policisë. Duhet të koordinohet se kush i merr, cilat janë ato përgjegjësi. Për shembull, në nenin 9 thuhet se drejtori i Inspektoratit bashkëpunon me ministrin dhe i ofron atij informata dhe raporte të nevojshme. Jo vetëm kur ka nevojë ministri t’i marrë informatat dhe raportet e nevojshme, por unë mendoj që ky inspektorat duhet të raportojë hollësisht një herë në vit për të gjitha sfidat dhe problem të cilat janë dhe, në anën tjetër, mendoj që këtij inspektorati duhet t’i japim më shumë autoritet dhe një pavarësi, autonomi më të madhe se atë, e cila parashikohet me këtë ligj.

Përndryshe, e përkrah dhe unë mendoj se ky ligj është shumë i nevojshëm dhe dushet të miratohet, ashtu siç është paraparë.

KRYETARI: Kërkoj që deputetët nuk janë në sallë, e që janë këtu, le të kthehen në sallë për votim. Votimi do të jetë dëshmi për mëditjet e sotme. Fjalën e ka deputeti Lutfi Zharku.

LUTFI ZHARKU: Faleminderit, kryetar!

I nderuar ministër,

Kolegë deputetë,

Po shpreh disa rezerva të mia në lidhje me ligjin. Po shihet që kemi, por është mirë që kemi konceptione të ndryshme. E para, unë besoj se nuk ka pasur nevojë për themelimin e një agjencie të tillë, duke marrë parasysh se çështjet e hetimit shumë më mirë do të mund të kryheshin nëpërmjet njësive apo departamenteve të ndryshme që organizohen në kuadër të ATK-së, apo në kuadër të Doganave. Unë besoj se ajo punë është duke u kryer deri më sot, kështu që nuk e shoh të arsyeshme të themelohet një inspektorat mbi këto institucione të veçanta.

E dyta, rezerva ime ka të bëjë me atë që, si arsye tjetër, se gjatë projektligjit shihet që ka disa probleme të themi në definimin, apo ndarjen e përpiktë të punëve, ato që i përmendi edhe profesor Muhamet Mustafa sa i përket Prokurorisë dhe kompetencave që i ka Inspektorati. Është e paqartë ku është vija ndarëse ndërmjet Prokurorisë dhe ku është vija

ku fillon Inspektorati. Cilat janë ato punë, të cilat duhet kryer, ato konfliktet e interesit, cili e fillon punën i pari, nëse e ka filluar ai ku mbaron ky tjetri, e tjera.

Çështje tjetër që është me rëndësi për t'u cekur është se prapë e kemi një paqartësi ndërmjet hetimit dhe inspektimit. Projektligji nuk e definon së paku si duhet, po besoj, inspektimin. Unë inspektimin e kuptoj si procedurë për kontrollin e zbatimit të ligjit, kurse në realitet inspektimi, sipas projektligjit, ka të bëjë me kontroll mbi kryerjen e detyrave për ta siguruar arritjen e qëllimeve, llogaridhënies, efektiviteti dhe efikasiteti, që nuk janë çështje të inspektoratit, por janë thjesht çështje të kontrollit, performansës nga udhëheqësit e institucioneve të ndryshme. Kështu që hetimi dhe inspektimi kanë përshtypjen se janë përzier në këtë projektligj.

Çështje tjetër është llogaridhënia e drejtorit te ministri. Plotësisht po pajtohem nëse është në rregull, i raporton ministrit, por nuk po mund të them të pajtohem që drejtori të mos i zbulojë informatat ministrit. Nuk di si mund t'i raportojë drejtori i Inspektoratit këtij ministri nëse ai nuk i jap kurrfarë informate. Kështu që llogaridhënia në këtë aspekt duhet të drejtohet. Nuk mund drejtori të raportojë te ministri, e të mos e zbulojë asnjë informatë.

Punët sekondare të inspektorëve, nëse kemi inspektorë, besoj se në të gjitha organet e shtetit, të gjithë shërbyesit civilë nuk duhet të kenë punë sekondare, posaçërisht te rastet e zyrtarëve me autorizime që janë të mëdha dhe janë mbi ato që i kanë shërbyesit civilë, pavarësisht se këta zyrtarë nuk janë shërbyes civilë, por do të duhej të ndalohej çdo punë sekondare. Jo punë sekondare që është në kundërshtim me apo që është konflikt interesi, por çdo punë sekondare duhet të jetë e ndaluar për këta zyrtarë.

Dhe, çështja e fundit, inspektorati paraqitet të themi në raste të caktuara edhe si organ mbi Prokurorinë. Është rasti, të them, nëse Prokuroria i pushon hetimet për një punë të caktuar, thotë inspektorati prapë e vazhdon, ia dërgon dokumentacionin ATK-së, apo Doganave për procedurë disiplinore. Çka ka procedurë disiplinore, nëse dikush është shpallur i pafajshëm? Them i që janë çështje që do të duhej ndoshta në Komisionin FunkSIONAL të shqyrtohen edhe një herë. Faleminderit!

KRYETARI: Nuk ka të tjerë të paraqitur për diskutim. Të pranishëm janë 67 deputetë. Lus deputetët dhe regjinë të përgatiten për votim. Votojmë tash!

Konstatoj se me 61 vota për, 2 kundër dhe 2 abstenime, Kuvendi e miratoi Projektligjin nr. 04/L-243 për Inspektoratin e Doganës dhe Administratës Tatimore të Kosovës.

Ngarkohen Komisioni FunkSIONAL dhe komisionet e përhershme që në afatin e paraparë me Rregulloren e Kuvendit ta shqyrtojnë projektligjin dhe Kuvendit t'ia paraqesë raportin me rekomandime.

Kërkoj nga Administrata që ta kenë parasysh për mëditje votimin e fundit.

Mirupafshim nesër, në orën 10:00!

* * *

E premte, 31 janar 2014

Vazhdimi i mbledhjes plenare, të filluar më 30 janar

Mbledhjen e drejton kryetari i Kuvendit, zoti Jakup Krasniqi

KRYETARI: Të nderuar deputetë,

Vazhdojmë seancën!

Para se t'ia fillojmë seancës, dëshiroj t'jua lexoj nenin 40 të Ligjit për deputetët. I ka tri paragrafë dhe ju kisha lutur që t'i dëgjoni me vëmendje.

“Deputeti është i detyruar të marrë pjesë në seancë plenare dhe në mbledhjet e organeve ndihmëse të Kuvendit, në të cilin ai është anëtar.”

Paragrafi 2: “Organe ndihmëse të Kuvendit nga paragrafi i parë i këtij neni janë të gjitha organet e përhershme ose ad hoc, që formohen me vendim të Kuvendit.”

Dhe, paragrafi i tretë, që disa deputetë dhe deputete duhet ta kenë parasysh: “Deputeti që nuk mund të marrë pjesë në seancën e Kuvendit ose në mbledhjen e organeve ndihmëse të Kuvendit, në të cilat ai është anëtar, duhet ta njoftojë me kohë kryetarin e Kuvendit, përkatësisht kryetarin, zëvendëskryetarin e atij organi ndihmës, duke prezantuar dhe arsyen për mungesën e tij”.

Kjo vlen për deputetët që po ikin dhe s'po lajmërohen.

Po lexoj pjesë nga vendimi i Gjykatës Kushtetuese, që janë obligative.

Neni 141, vendimi i Gjykatës Kushtetuese ose pika 141, unë s'po e lexoj në tërësi, po e lexoj atë që duhet ta dini ju, që do të thotë se deputeti konsiderohet, dëgjojeni mirë këtë, që do të thotë se “deputeti konsiderohet se është duke marrë pjesë në seancë vetëm nëse ai, ajo i plotëson të gjitha obligimet e lartpërmendura, që nënkupton hedhjen e votës, qoftë për, qoftë kundër, qoftë abstenim.”

Edhe një herë po them, Administrata ka për obligim për mëditjet e djeshme, votimin e fundit.

Vazhdojmë punimet e seancës plenare të Kuvendit të Republikës së Kosovës, të filluar më 30 janar 2014.

Sipas kartelave të pranishëm janë 67 deputetë, sipas pranisë fizike 65, do të thotë mund të fillojmë.

Pasi nuk kemi kuorum për pikën e katërt dhe të pestë, që duhet të jenë më shumë se 80 deputetë, i lëmë për më vonë dhe fillojmë pikën e 13-të,

13. Raporti i punës së Komisionit ad hoc për Reformë Zgjedhore

Deputeti Haki Demolli, kryetar i Komisionit ad hoc për Reformë Zgjedhore e ka njoftuar Kryesinë e Kuvendit lidhur me punën e komisionit që ai e ka udhëhequr.

Kryesia e Kuvendit, në mbledhjen e mbajtur më 27 janar 2014, ka kërkuar nga ky komision, që të përgatitë një raport të detajuar të punës për reformën zgjedhore dhe Kuvendit t’ia paraqesë rekomandimin lidhur me këtë çështje.

Komisioni ad hoc për Reformë Zgjedhore e ka proceduar raportin përmbledhës për punën e tij, edhe pse pas edhe i ka kaluar afati. Ftoj kryetarin e Komisionit ad hoc për Reformën Zgjedhore, zotin Haki Demolli që të paraqesë dhe arsyetojë raportin e Komisionit ad hoc për reformë zgjedhore.

HAKI DEMOLLI: I nderuar kryetar i Kuvendit të Kosovës,

Të nderuar deputetë të Kuvendit,

Kryesia e Kuvendit të Kosovës duke pasur parasysh faktin se kohëve të fundit është riaktivizuar iniciativa për përfundimin e reformës zgjedhore, respektivisht për përfundimin dhe aprovimin e draftligjit të ri për zgjedhjet në Kosovë e mbi bazën e shkresës së dërguar ditë më parë nga ana ime, ka caktuar këtë pikë të rendit të ditës, për të debatuar për raportin e punës së Komisionit ad hoc për Reformë Zgjedhore.

Si ish-kryetar i këtij komisioni dua të theksoj se nuk i shmangem raportimit dhe debatit për punën e komisionit. Por, duke pasur në konsideratë aktualitetin e problemit të Ligjit për zgjedhjet, mendoj se fillimisht është mirë që materiali i punës t’i procedohet Komisionit për Legjislacion e më pastaj të debatohet për raport të punës.

Vlerësoj se me një veprim të tillë Kuvendi do të ndihmonte përshpejtimin e aprovimit të Ligjit për zgjedhjet. Pra, duke shfrytëzuar materialet dhe punën e Komisionit ad hoc për Reformë Zgjedhore do të krijonim infrastrukturë ligjore më të avancuar, se sa ajo që është në fuqi dhe kështu do të përgatiteshim më mirë në aspektin normativ për zgjedhjet e radhës në Kosovë.

Nuk duhet harruar se aprovimi i Ligjit të ri për zgjedhjet është kërkesë jo vetëm e subjekteve politike dhe qytetarëve të Kosovës, por është edhe kërkesë decitive e faktorit dhe institucioneve relevante ndërkombëtare, të cilat kanë theksuar një kërkesë të tillë edhe në rezolutat dhe dokumentet tjera ndërkombëtare të hartuara për gjendjen dhe zhvillimet politike në Kosovë.

Për këto dhe arsye të tjera të rëndësishme, javën e kaluar iu kam drejtuar Kryesisë së Kuvendit të Kosovës me një shkresë, të cilës ia kam bashkëngjitur edhe draft-ligjin për zgjedhjet, i cili për shkaqe objektive nuk është kompletuar dhe përfunduar në tërësi nga Komisioni ad hoc.

Në kohën kur administrata e Kuvendit e ka bërë publike rendin e ditës së kësaj seance, unë kam qenë jashtë Kosovës, andaj kam kërkuar nga zyrtarët e komisionit që ta

kontaktojnë zotin Halit Krasniqi, i cili ka qenë nënkryetar i komisionit, në mënyrë që të përpilojë shkresën për këtë pikë të rendit të ditës. Zoti Krasniqi së bashku me administratën e komisionit e ka përgatitur raportin, i cili përmban disa rekomandime.

Vlerësoj se kjo shkresë duhet të përpunohet dhe plotësohet edhe me materiale të tjera, në mënyrë që të marrë formën e raportit të punës, për të cilin do të debatohej në Kuvend. Po ashtu kam vërejtje edhe lidhur me rekomandimet që përmban ky raport e posaçërisht me rekomandimin e parë, sepse personalisht nuk përkrah propozimin që Komisionit ad hoc t'i vazhdohet mandati, por si më të pranueshëm e konsideroj propozimin sipas të cilit draftligji për zgjedhjet i Komisionit ad hoc t'i procedohet Komisionit për Legjislacion.

Dy janë arsyet për propozimin e tillë.

Arsyeja e parë është se katër prej anëtarëve të Komisionit ad hoc, përfshirë edhe kryetarin dhe nënkryetarin, në të njëjtën kohë janë edhe anëtarë të Komisionit për Legjislacion dhe arsyeja e dytë është se Komisionit ad hoc mund t'i vazhdohet mandati edhe për një afat të caktuar kohor, kurse Komisioni për Legjislacion do të ishte i pakufizuar në aspektin kohor që do të jetë një garanci se komisioni do të mund të punojë pa qenë nën presionin e kohës.

Pikërisht për këto dy arsye dhe arsye të tjera të patheksuara, kërkoj nga ky vend që pas përfundimit të diskutimeve lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, të votojë dhe të vendosë që materiali i Komisionit ad hoc për reformë zgjedhore, si dhe kompetenca për draftimin e Ligjit për zgjedhjet të barten tek Komisioni për Legjislacion i Kuvendit të Kosovës. Faleminderit!

KRYETARI: Ju e dëgjuat kryetarin e Komisionit ad hoc, edhe pse Komisioni ad hoc kur është formuar i ka pasur dhe çdo komision ad hoc, kohën e kufizuar në gjashtë muaj, komisionit i është dhënë një afat edhe për tre muaj dhe nuk ka raportuar në Kuvend. Tani komisioni në fakt nuk e ka legjitimitetin, por megjithatë kemi një material bruto, material pune që i është dorëzuar deputetëve dhe sot, n mendoj që varet nga vullneti juaj, por ne duhet të debatojmë për këtë material.

Dhe, po shkojmë sipas rendit të grupeve parlamentare. Në emër të Partisë Demokratike, kush e do fjalën? Deputeti Arsim Bajrami e ka fjalën.

ARSIM BAJRAMI: I nderuar kryetar i Kuvendit!

Të nderuar kolegë deputetë,

Grupi parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës mbështet debatin lidhur me raportin e grupit ad hoc dhe i gëzohet hapjes së debatit për reformën zgjedhore në Kuvendin e Kosovës.

Partia Demokratike e Kosovës është e interesuar që sa më shpejt të përfundojë procesi i reformës zgjedhore, procesi i amendamentimit të Ligjit për zgjedhje dhe angazhohet për ndërtimin sa më të shpejtë të konsensusit gjithë partiak për dimensionet e ndryshimit të këtij ligji. Ne insistojmë që sa më shpejt të finalizohet procesi i amendamentimit të këtij ligji. Kërkojmë nga liderët e partive politike, që të konkludojnë qëndrimet e veta politike,

në mënyrë që tani Komisionit të Ligjeve t'i mundësohet sa më shpejt të përfundojë procesin e reformës zgjedhore.

Partia Demokratike e Kosovës është jetësisht e interesuar që procesi zgjedhor drejt zgjedhjeve parlamentare të shkojë në mënyrë të rregullt, pa improvizime dhe të ndërmerren të gjitha veprimet përgatitore që janë të nevojshme që ky proces të finalizohet me sukses. Ne vlerësojmë që improvizimi i zgjedhjeve apo debatet për zgjedhje të jashtëzakonshme apo të parakohshme, nuk e ndihmojnë procesin normal të përgatitjes për zgjedhje dhe angazhohemi që ky debat të jetë konstruktiv dhe partitë politike të merren vesh për dy segmente kryesore të procesit zgjedhor:

E para, për dimensionin e reformës zgjedhore, duke përfshirë edhe sistemin zgjedhor dhe aspektet logjistike të procesit të suksesshëm zgjedhor, por njëkohësisht edhe të merren vesh për kohën më të përshtatshme kur Kosova mund të shkojë në zgjedhjet parlamentare, sepse për neve është jetik që ky proces mos të improvizohet, sepse mbajtja me sukses e këtyre zgjedhjeve parlamentare ka një domethënie të madhe për Kosovën, do të ndërtojë një imazh për Kosovën, do të tregojë se ne dimë të mbajmë zgjedhje të mira parlamentare dhe ne kemi obligim ta vazhdojmë trendin e mirë që e kemi fituar me zgjedhje lokale.

Ne kërkojmë që deri në kohën kur do të mbahen zgjedhjet të plotësohen tri kushte kryesore.

E para, të arrihet konsensusi në Parlament dhe në nivelin e liderëve rreth reformës zgjedhore dhe ky konsensus të jetë sa më i madh. Ne si një mazhorancë do të jemi të hapur për ndërtimin e këtij konsensusi dhe do t'i prijmë ndërtimit të këtij konsensusi dhe insistojmë që në mënyrë të pashtyeshme gjatë muajit shkurt të finalizohet Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për zgjedhje nacionale.

Gjithashtu, kërkojmë që të ketë kohë të mjaftueshme që partitë politike të adoptohen me këtë ligj zgjedhor edhe pse nuk është një dispozitë kushtetuese që e përcakton këtë, është një standard elektorale evropian, por dhe një standard i Venecias që korniza ligjore duhet të jetë e përfunduar gjashtë muaj para se të shkohet në zgjedhje.

Dhe, momentumin e tretë, kërkojmë që të gjitha organet kushtetuese, institucionet kushtetuese ato që menaxhojnë procesin zgjedhor, Komisioni Qendror Zgjedhor, por dhe institucionet tjera, të jenë të përgatitura për monitorimin e rregullsisë së këtij procesi zgjedhor.

Së fundmi, shikuar nga aspekti i Kosovës dhe i perspektivës evropiane të Kosovës, më me rëndësi është që zgjedhjet të jenë të rregullta, se sa ngutia që nganjëherë të shprehet edhe në media, ngutia për të mbajtur zgjedhje të papërgatitura sepse ne nuk guxojmë të krijojmë një ambient ku Kosova nuk është tërësisht e përgatitur për zgjedhje.

Kështu që ky debat tani që është nganjëherë medial dhe i sforcuar, duhet të kalojë në një kontekst real, është mirë që Parlamenti tani po kyçet, por të kemi parasysh që reforma

zgjedhore dhe Ligji zgjedhor do të thosha është një kontratë elektorale dhe ne insistojmë që të gjitha partitë politike edhe ato parlamentare dhe ato jashtë parlamentare të kyçen dhe të arrijnë minimumin e konsensusit.

Po shihet se nuk do të ketë konsensus për të gjitha momentet, në mënyrë që Parlamentit t'i mundësohet ta luajë rolin e vet kushtetues që ka. Nuk kemi nevojë tani që nga dëshirat individuale të një apo të tjetrës parti, ne të improvizojmë zgjedhje dhe pastaj të kërkojmë arsyetim se përse zgjedhjet s'kanë qenë të mira. Ne duhet të përmirësojmë edhe imazhin e zgjedhjeve të kaluara, duhet të riparojmë pak dhe të forcojmë kapacitetin e shtetit tonë, që dimë të mbajmë zgjedhje, të prodhojmë zgjedhje të mira dhe të prodhojmë institucione demokratike dhe kjo kërkon që debati të mbahet në një atmosferë të qetë.

Partia Demokratike do të jetë konstruktive, do t'i prijë këtij procesi të konsensusit dhe ne kërkojmë marrëveshje me opozitën, ne kërkojmë që opozita të definojë një qëndrim të përbashkët, në mënyrë që bashkë me mazhorancën të akordojmë kohën më të përshtatshme për zgjedhjet, sepse edhe ashtu-kështu ne kemi hyrë në vitin e katërt të mandatit tonë, të legjislaturës tonë, ku kërkesat për zgjedhje të jashtëzakonshme dhe zgjedhje të parakohshme nuk janë tipike për demokracitë parlamentare, sepse këto bëhen më herët jo në vitin elektorale, por ne nuk do ta pengojmë asnjë konsensus për cilindo moment politik, për të cilin ndërtohet konsensusi për të mbajtur zgjedhje.

Ajo çfarë do të kundërshtojmë si parti shumicë që jemi dhe si parti mazhoritare, improvizimin e zgjedhjeve. Ne duam që zgjedhjet të mbahen në kohën kur Kosova është plotësisht e përgatitur, kur të gjitha institucionet janë të përgatitura për të monitoruar procesin e zgjedhjeve të lira.

Andaj ne kërkojmë që tani raporti i punës së këtij komisioni, i cili komision ka qenë fatkeqësisht peng i mos ndërtimit të konsensusit politik dhe nuk mund të fajësohet komisioni pse s'e ka kryer punën, por mendoj se të gjitha partitë politike pak kanë kalkuluar me qëndrimet e veta politike dhe në një mënyrë edhe e kanë blerë kohën derisa të ndërtohen këto qëndrime politike.

Ne përkrahim kalimin e punës së këtij komisioni te Komisioni i Ligjeve dhe angazhohemi që brenda Komisionit të Ligjeve të bëhet një punë profesionale, por njëkohësisht edhe të ndërtohet konsensusi politik, i cili do të mundësojë pastaj që edhe në Parlament më lehtë ta ndërtojmë këtë konsensus politik. Në momentin kur Komisioni i Ligjeve e përfundon punën, atëherë afatet kushtetuese të procedimit të ligjeve janë përcaktuar me Rregulloren e punës, janë të përcaktuara me Kushtetutën e Kosovës dhe definitivisht reforma zgjedhore tani po merr edhe formën institucionale, sepse po vjen te organi ligjvënës, te Parlamenti.

Dhe, ne shpresojmë që liderët do të kenë një rol konstruktiv, do ta ndihmojnë Komisionin e Ligjeve, do të harmonizojnë tri-katër pozicione që kanë, sepse siç po shihet deri më tani nuk bëhet fjalë për një reformë substanciale zgjedhore, por më tepër bëhet fjalë për disa përsosje të ligjit aktual dhe ne kërkojmë që rreth këtyre aspekteve teknike dhe logjistike të zgjedhjeve të ndërtohet konsensusi, në mënyrë që ne ta përfundojmë miratimin e këtij

ligji dhe t'ua lëmë kohën e mjaftueshme partive politike që të përshtaten, por njëkohësisht edhe KQZ-së, gjykatave, Prokurorisë dhe organeve të tjera, që të bëjnë të gjitha përgatitjet shtetërore, që zgjedhjet të kalojnë në një trend të mirë, çfarë e kemi pasur zgjedhje lokale dhe definitivisht Kosova ta plotësojë edhe këtë standard të munguar, standardin e zgjedhjeve me integritet evropian dhe me këtë të dëshmojmë kapacitetet tona për t'u bërë pjesë e Bashkimit Evropian. Faleminderit!

KRYETARI: Në emër të Lidhjes Demokratike, kryetari i Grupit, Ismet Beqiri. Ismet, keni parasysh në prillin e vitit 2011 është formuar komisioni.

ISMET BEQIRI: Zoti kryetar, duke pasur parasysh këtë që po e thoni, edhe po e filloj fjalën time.

Zoti kryetar,

Të nderuar kolegë deputetë,

Duke mos dashur ta zgjas shumë, vetëm t'ju them këtë që Lidhja Demokratike e Kosovës ka qenë dhe mbetet fuqishëm në reformën zgjedhore, në kuptimin e përkrahjes dhe kontributit të saj që kjo reformë të bëhet.

Në këtë rast, në këtë kontekst edhe të plotësohet, gjegjësisht të nxirret Projektligji i ri për zgjedhjet. Jemi që ky raport i bërë nga Komisioni ad hoc, ky brumë, ky material t'i drejtohet, gjegjësisht t'i dërgohet me vendim të Kuvendit, gjegjësisht të seancës Komisionit për Legjislacion, i cili pastaj do të hartojë në kohën sa më të shkurtër të mundshme, duke besuar thellë që do të jenë efikas, në mënyrë që kjo të bëhet sa më shpejt duke mos u dëmtuar sigurisht, edhe synimi i cili ka qenë që në fillim i bërjes së reformës zgjedhore, për aq sa kushtimisht ka edhe pajtueshmëri dhe në fund vendos vota.

Ajo që LDK-ja ka pasur të thotë, në një mënyrë e ka thënë në Komisionin ad hoc, i ka dhënë propozimet e saja, por në qoftë se ende duhet diçka plotësuar e harmonizuar, këtë do ta bëjë nëpërmes përfaqësuesve tanë që i kemi në Komisionin për Legjislacion, sikurse që e dimë që të gjithë që të gjitha partitë politike i kanë pasur përfaqësuesit në komisionin e gjertanishëm ad hoc dhe kanë dhënë kontributin e tyre.

Jemi që kjo punë të përfundohet sa më shpejt që është e mundur, gjithmonë duke mos dëmtuar edhe kualitetin, por po ashtu nuk mund të mbetemi peng të kësaj çështjeje në mënyrë që të arsyetohemi se s'po bëhet reforma dhe zgjedhjet po varen nga kjo reformë zgjedhore.

Shkurt, Lidhja Demokratike e Kosovës përkrah punën e bërë të komisionit dhe jemi që me vendim të seancës ky material t'i dërgohet Komisionit për Legjislacion, në mënyrë që të procedohet sa më shpejt dhe ta përmbyllim edhe këtë çështje. Faleminderit!

KRYETARI: Në emër të Grupit të "Vetëvendosjes", deputetja Albulena Haxhiu e ka fjalën.

ALBULENA HAXHIU: Faleminderit, kryetar!

E para, raporti që u është shpërndarë deputetëve, përveç që nuk është i detajuar ashtu siç ka kërkuar Kryesia e Kuvendit, për më tepër ky raport nuk reflekton opinionin e Komisionit për ndryshimin e Ligjit të zgjedhjeve, mirëpo të deputetit Halit Krasniqi.

Pra pjesa hyrëse e këtij raporti dhe përfundimi, ku parashihen rekomandimet, është e PDK-së dhe për këtë kërkojmë nga kryetari i Kuvendit që t'i marrë të gjitha masat administrative ndaj kësaj mënyre të manipulimit me akte kaq të rëndësishme të punës së Kuvendit.

Pra, ky raport përmban të pavërteta dhe ky është manipulim eklatant për të cilën deputeti Haliti do të duhej të mbante përgjegjësi morale dhe politike. Pas disa shtrëngime duarsh ndërmjet Thaçit, Mustafës e Pacollit, në këtë vend, po në këtë Kuvend, më 22 prill të vitit 2011 me shumë pompozitet u votua marrëveshja antikushtetuese dhe jashtë institucionale që parashihte zgjedhjen e presidentit nga qytetarët dhe ndarjen e Kosovës në më shumë zona zgjedhore.

Por ajo marrëveshje doli të ishte asgjë më shumë se sa një lojë e ultë politike dhe tallje e radhës me qytetarët e Republikës së Kosovës, pra ishte asgjë më shumë se sa zgjedhja e presidentit nga zarfi dhe zgjatja e jetës së kësaj Qeveria të dal nga vota e vjedhur.

Pra, po të mos ishte ajo marrëveshje rrjedhimisht nuk do ta kishim as Qeverinë Thaçi 2, pra kjo Qeveri po qëndron në këmbë, duke iu falënderuar opozitës.

Përmbajtja e asaj marrëveshje ishte treguesi më i mirë që flitej për pazare politike dhe mbulim të krimit se sa për reflektim politik të atyre që kishin shkelur me të dy këmbët jo vetëm ligjin, por edhe vullnetin e qytetarëve në zgjedhjet e vitit 2010.

Nuk kam si mos ta përmend edhe njëherë faktin që vota e vjedhur solli njerëz që sot po qëndrojnë në pozita të larta të Qeverisë dhe deputetë që qëndrojnë në ulëset e këtij Kuvendi, ku disa prej tyre ishin pjesë të Komisionit për Reformë Zgjedhore e të cilët na serviren spektakle duke degraduar debatin përgjatë tërë procesit. E dëshmitar për këtë është opinionin publik, mediet, pjesëtarët e shoqërisë civile që i kanë përjetuar të gjitha këto që unë sot vetëm po i ri përsëris.

Lëvizja “Vetëvendosje” me gjithë faktin e kësaj mendësie të mbrapshtë, ishte subjekti i vetëm serioz gjatë tërë këtij procesi që nga fillimi e deri në përfundimin e tij. Qëndrimet tona çdo herë kanë qenë të analizuara dhe konsistente dhe jemi të vetmit që kemi dorëzuar me shkrim, me arsyetimet konkrete secilin prej propozimeve që kemi dhënë, goftë për sistemin zgjedhor, goftë për administrimin e zgjedhjeve.

Reforma zgjedhore në aktualitetin tonë, në rrethanat tona do të duhej të nënkuptonte që vota e qytetarit, vullneti i tij shprehet lirshëm që prej momentit kur ai qytetar fillojnë të krijojnë opinion të caktuar për një program ose për një subjekt politik dhe për të vazhduar me hedhjen e votës së tij dhe për të përfunduar me numërimin e drejt dhe të saktë të votës së tij.

Pra, kjo do të duhej të ishte brenga jonë si përfaqësues të qytetarëve të Republikës së Kosovës dhe jo se a po i konvenojnë Hashim Thaçit listat e mbyllura për t'i ruajtur deputetët apo a po i konvenojnë LDK-së 26 zona apo a po i konvenojnë Hashimit vendet e rezervuara për pazare të tij, pra kjo nuk do të duhej të ishte brenga jonë?

Ndërsa sot unë po ua përsëris edhe njëherë qëndrimet tona sa i përket reformës zgjedhore edhe pse këto kanë qenë publike qysh në shtatorin e vitit 2011. Ne jemi për një zonë zgjedhore dhe lista të hapura e që mundësojnë votimin preferencial, pra ku përveç subjektit politik votuesit të kenë mundësi t'i zgjedhin pesë kandidatë brenda listës. Ne jemi që pragu zgjedhor të jetë 7.5 për koalicionet, pesë për subjektet politike dhe 2.5 për kandidatët e pavarur.

Ne jemi për një balancë të KQZ-së ku 50% përbëhet nga pozita dhe 50% nga opozita. Ne jemi që lista e votuesve të jetë e pastruar nga personat e vdekur dhe nga personat tjerë që nuk janë shtetas të Republikës së Kosovës dhe të përcaktohen qartë përgjegjësitë e institucioneve të drejta dhe detyrimet e qytetarëve në raport me listën e votuesve.

Identifikimi i votuesve të bëhet duke aplikuar teknologjinë informative përmes identifikimit biometrik, numërimi i votave të bëhet në qendrat komunale të numërimit dhe jo në vendvotime duke aplikuar kështu kamerat dhe skanerët. Dokumentet e vlefshme dhe të pranueshme për votim të jenë vetëm dokumentet e Republikës së Kosovës, pasaporta, letërnjoftimi dhe patentë shoferi, mërgatës t'i sigurohet e drejta e votimit të drejtpërdrejtë në përfaqësi dhe ambasada të Republikës së Kosovës, për të cilën çështje do të flasë edhe deputeti Faton Topalli më gjerësisht.

Menaxherët e qendrave të votimit dhe stafi ndihmës i këtyre qendrave të zgjidhen me konkurs dhe t'u përcaktohen detyrat dhe përgjegjësitë me dispozita ligjore, të qartësohen procedurat dhe përgjegjësitë për secilën pjesë të secilit proces të administrimit të zgjedhjeve, si dhe të përcaktohen sanksione penale ndaj çdo lloji të shkeljes e cila e rrezikon integritetin e zgjedhjeve. Dhe fushata zgjedhore të mbetet 30 ditë. Ne kemi alternativ qeverisëse me tri shtylla dhe 20 kapituj, për të cilën na nevojiten 30 ditë për ta rishfaqur anekënd Kosovës, të tjerët ndoshta edhe nuk kanë këso problemesh.

Dhe, në fund jemi kundër vazhdimit të ulëseve të rezervuara për serbët. Pra, asnjëra nga këto nuk është marrë parasysh dhe unë them me plot bindje se sigurisht që kjo një ditë do të arrihet, por jo në asnjë mënyrë derisa kjo kastë politike të jetë në pushtet dhe jo derisa subjekte opozitare që i shkojnë pas partisë në pushtet për t'ia siguruar mbijetesën politike. Prandaj, edhe jemi për rrëzimin e kësaj Qeverie, pasi që çdo ditë e Qeverisë Thaçi në pushtet është një ditë më pak për qytetarët dhe vendin.

KRYETARI: Replikë, Ismet Beqiri e ka fjalën.

ISMET BEQIRI: Së pari, zoti kryetar, mendoj që zonja Haxhiu ka thënë disa të pavërteta. Këto që i përsëriti ose i tha si qëndrime është e drejtë e saj e "Vetëvendosjes", por edhe Lidhja Demokratike i ka thënë vazhdimisht qëndrimet e saja edhe sa i përket zonës ose zonave, është e vërtetë kemi kërkuar më tepër, por s'është arritur edhe s'ka pasur

përkrahje. Po ashtu, edhe për disa çështje se kush kënd e përkrah për të mbijetuar, unë mendoj që tema është për reformë zgjedhore e të mos na mbaj këtu ders politik se po i tregoj se shumë gjëra që i ka thënë nuk qëndrojnë.

Po ia them veç një element, e fundit për shembull thirren shpeshherë në kursim e tjera, ne e kemi propozuar fushata të jetë dy javë, 15 ditë për dallim pra meqenëse këta i lypin 30 që është po ashtu e drejtë e tyre. Ne nuk kemi pothuajse gati asnjë dallim për sa i përket pragut e të gjitha këto që u thanë, sepse i kemi thënë edhe të parët kemi kërkuar të jetë 50-50 për të qenë edhe përbërja e KQZ-së 7.5% për koalicionë, mos t'i përsëris, 5% për parti, 2 ose 2.5% për kandidatët etj., etj. unë nuk desha t'u marrë kohë, sepse Komisioni për Legjislacion do t'i i thotë këto punë.

Por, jam kundër asaj që të tentojnë t'i baltosin të tjerët. Ne i dimë zhvillimet, ne nuk dëshirojmë as unë s'dëshiroj ta shfrytëzoj foltoren tash për marketing politik. Prandaj, qëndrimet tona kanë qenë dhe mbeten qëndrime të qarta, kur t'i bëjnë numrat edhe ndoshta do t'i bëjmë numrat, e rrëzojmë edhe ne Qeverinë, por jo veç kur ka qejf dikush, sepse sot në rend dite reforma zgjedhore, nuk është momenti mendoj që të dalim me fjalë të mëdha aq më tepër ne mendoj që opozitës nuk i takon ndërmjet veti të merret sikur që po e praktikon këtë rast zonja Haxhiu. Ne kundërshtarë politikë e kemi ...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Faleminderit! Në emër të Aleancës, kryetari i Grupit, Ardian Gjini e ka fjalën.

ARDIAN GJINI: Faleminderit, zoti kryetar!

Të nderuar deputetë të Kuvendit të Kosovës,

Nëse dëgjon dikush debatin në Kuvend të Kosovës edhe i dëgjon të gjithë njerëzit çka flasin, dikush thotë: “jemi jetikisht të interesuar që të ndodh kjo”, gjithkush e ka vullnetin tepër të mirë edhe kur e dimë ashtu siç tha në fillim kryetari i Kuvendit, që na ka marrë një vit e gjysmë ose më shumë edhe s'kemi mbërri t'i bëjmë reformat, pra diçka nuk është në rregull këtu.

Të gjithë jemi për reformë, të gjithë e duam reformën, por diçka s'ka bërë , pra është njëfarë problemi në krejt në këtë materie. Mendoj se atë që e dëgjuam më përpara si qëndrim i një subjekti politik, ne e dimë që është arritur si pajtueshmëri, u tha pak më përpara, në Komisionin ad hoc Aleanca e ka deleguar nënkryetarin e partisë dhe ne mendojmë se në politikë, në demokraci nëse do t'i japësh peshë një subjekti atëherë delegon njerëz seniorë dhe kështu jepet serioziteti jo vetëm duke folur.

Dhe, çështje tjetër që është tepër interesant e që po dua ta ndaj me ju është qysh unë e kuptoj demokracinë parlamentare dhe konsensusin në demokraci parlamentare. Të gjithë kemi interesa, politika është interes ata që thonë nuk është, rrejnë. Është interes politike, përpos që është motiv, përpos që është ideologji edhe interes grupor, interes i strukturave politike është. Dhe, nëse është ashtu në demokraci parlamentare nuk mund të dalë një subjekt politik edhe të thotë: “qysh po themi na është mirë, e qysh po thoni ju të gjithë

është keq” edhe ejani ta ndërtojmë konsensusin qysh po themi ne. Nuk shkojnë këto sende kështu, nuk janë në rregull. Në demokraci parlamentare A-ja e demokracisë është që harmonizohen disa interesa në gjithë botën edhe në vendet më demokratike, në vendet ku dikush pretendon se e mban monopolin mbi të drejtën ose e mban monopolin mbi idenë më të mirë për vendin janë pak më ndryshe nuk janë kështu si janë.

Sidoqoftë, për ta shkurtuar krejt këtë punë, mendoj se sot nuk kemi nevojë të bëjmë debat të tepërt, mendoj që ka një pajtueshmëri që materia e cila eksiton nga Komisioni ad hoc t’i delegohet ose t’i dorëzohet Komisionit për Legjislacion dhe që Komisioni për Legjislacion një kohë sa më të shkurtë që të jetë e mundshme, një afat sa më të shkurtë të mundshëm ta kryejë këtë punë dhe këto fjalë që po i themi se jemi jetikisht të interesuar reforma të ndodhë me të vërtetë, ta bëjmë me të vërtetë. Faleminderit!

KRYETARI: Në emër të Grupit Koalicioni për Kosovë të Re, kryetarja Myzejene Selmani e ka fjalën.

MYZEJENE SELMANI: Faleminderit, i nderuar kryetar i Kuvendit!
Përshëndetje për të gjithë deputetët,

Sot në këtë seancë apo në këtë debat mund të diskutojmë ndoshta në mënyrë pak më të shkurtuar për çështjen e punës së Komisionit ad hoc, të cilin material të gjithë deputetët e kanë para veti. Në rast se duan të flasin për reformën zgjedhore, atëherë mund të themi se duhet të flasin liderët e partive politike për një konsensus ndërpartiak që sa më shpejtë të përfundojë kjo reformë zgjedhore apo sa më shpejtë të përfundojë ky ligj i zgjedhje, ku sipas të gjitha gjasave dihet se Komisionit ad hoc i ka kaluar mandati dhe kompetencat për përfundimin e këtij ligji apo draftligji duhet të kalojnë tek Komisioni për Legjislacion.

Procesi zgjedhor sipas Koalicionit për Kosovë të Re duhet të jetë proces i përgatitur në mënyrë të rregullt dhe çështja e mbajtjes së zgjedhjeve në formë të rregullt dhe në formë më të përshtatshme të zgjedhjeve të nivelit nacional apo zgjedhjeve parlamentare, do të jetë një imazh i mirë për Kosovën dhe për miqtë tanë që janë duke na përcjell në procese nëpër të cilat po kalon Kosova.

Si Koalicion për Kosovë të Re japim përkrahje reformës zgjedhore dhe besojmë që në kohën më të shkurtër të mundur të përfundojë kjo reformë zgjedhore. Ju faleminderit!

KRYETARI: Në emër të Grupit SLS, fjalën e ka kërkuar deputetja Jasmina Zhivković.

JASMINA ŽIVKOVIĆ: Zahvaljujem predsedniče!

Najpre da pozdravim sve kolege i politička partija i poslanička grupa samostalno liberalne stranske jeste za izborne reforme, jeste za nastavak izbornih reformi i smatra da je to vrlo neophodno za Kosovsko društvo i za dalji politički proces u kosovskom društvu.

Samostalna liberalna stranka jeste učestvovala u radu ad hoc komisije vezane za izborne reforme. Ono što prvo moram da kažem da materijal koji je prebačen kolegama poslanicima je blago rečeno katastrofalan. Takođe nije odgovornost samo na ad hoc komisiji vezana za ovaj materijal, jer su velike nepravilnosti u samom prevodu koji ne dovodi samo do jezičkih problema nego i do suštinskih problema, koji se odnose na izborne reforme. Sa tim problemom je upoznata na samom početku i ad hoc komisija.

Sledeća stvar koju moram da napomenem jeste da vrlo važna pitanja koja su vezana sa izborne reforme nisu uopšte raspravljena u ad hoc komisiji. O tim pitanjima samostalna liberalna stranka i predstavnici srpske zajednice su pismeno obavestavali komisiju i iznosili stavove vezana za ta pitanja.

Tu se pre svega odnosi rezervisanost za garantovana mesta izborne zone liste i ostale bitne stvari, suštinske vezane za izbornu reformu.

Razlog zašto nije raspravljeno na komisiji o tim pitanjima i zašto odluka nije donešene, jeste zato što politički lideri većinskih zajednica nisu bili spremni da otvoreno iznesu stavove povodom tih pitanja.

Ono što ja moram da napomenem jeste da kao predstavnici manjinskih zajednica na Kosovu bez kojih se izborna reforma ne može završiti i kao deo političkog života na Kosovu predlažem zapravo zahtevam, da se vrlo ozbiljno u obzir uzmu predlozi koji dolaze od strane manjinskih zajednica vezanih za izbornu reformu.

S obzirom da ad hoc komisija nije završila proces koji je trebalo da bude vezan za izbornu reformu, poslanička grupa samostalne liberalne stranke se slaže da zakonodavna komisija preuzme materijal i preuzme odgovornost da završi izmene vezane za izborni proces i da tek onda taj materijal bude prebačen poslanicima u ovoj Skupštini. Zahvaljujem se!

KRYETARI: Në emër të Grupit Parlamentar “6+”, fjalën e ka kryetarja e Grupit, Myfera Shiniq.

MYFERA SHINIK: Faleminderit, kryetar!

Sayın başkan teşekkür ederim. Bugün meclis oturumunda seçim reform komisyonu raporu görüşülmektedir. Şimdiye kadar konuşulanların dışında görülen odur ki komisyonun sunmuş olduğu raporda, eksiklikler çok. Bunun nedeni de siyasi bir anlaşmanın olmamasıdır. Siyasi parti liderleri, seçim yasası konusunda anlaşarak, ya seçim reform komiyonunu yeniden toparlayarak, görev vererek vermeli, ya da yasama komisyonuna göndererek, yasama komisyonu tartıştıktan sonra bu yasa tasarısını meclise göndermesi gerekmektedir.

“6+” Parlamenter Grubu olarak, değişikliklerden yanadır. Değişikliklerin olması, tabi ki önemli, yalnız bu değişikliklerin yapılmasında, toplulukları ilgilendiren değişikliklerden,

topluluk temsilcileri taleplerinin dikkate ALINMASI, Kosova demokrasisi açısından önemli olduğuna inanmaktayız.

Teşekkür ederim!

KRYETARI: Faleminderit!

Po kërkoj që deputetët që janë prapa duke pirë kafe, le të hyjnë në sallë në mënyrë që të votojmë për dy pikat e mbetura se më duket që kemi numrin e mjaftueshëm për të hyrë në procedurë të votimit, pikës 4 dhe pikës 5.

Gjithnjë po them mendoj që është edhe mirëkuptimi juaj, se ju jeni ata që votoni jo unë. Unë po kam respekt për votën tuaj.

Atëherë, po më dukët që ju e dini që duhen 80 vota për të kaluar këto dy marrëveshje.

Atëherë, do të thotë votojmë për pikën 4. 81 deputetë janë të pranishëm, por më parë ishin 90 edhe pse kemi 93 kartela të vendosura. Tani janë 81 nuk e di sa mund të shkojmë me 81? Varet prej juve nëse votoni krejt, mund të shkojnë.

Hajt të votojmë njëherë për prezencën. Regjia përgatitu se na po shkojmë për prezencë, fillimisht. Votojmë tash për prezencë.

76 është prania, 84 janë brenda. Prania fizike është 88. Edhe njëherë po shkojmë prezencën elektronike. Përqendrohuni për të votuar. Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim, votojmë tash.

Mirë, 87 edhe pse prania është 90 deputetë.

Do të thotë, e votojmë Projektligjin për ratifikimin e Marrëveshjes për statusin e anëtarëve të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë dhe Forcës së Sigurisë së Republikës së Kosovës gjatë qëndrimit të tyre të përkohshëm në territorin e shteteve respektive.

Lus deputetët dhe regjinë të përgatiten për votim. Votojmë tash!

Me 87 vota për, asnjë kundër, 2 abstenime, Kuvendi e miratoi Ligjin nr. 04/L-248 për ratifikimin e Marrëveshjes për statusin e anëtarëve të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë dhe Forcës së Sigurisë së Republikës së Kosovës, gjatë qëndrimit të tyre të përkohshëm në territorin e shteteve respektive.

Tani votojmë për pikën e pestë, votimi i Projektligjit për ratifikimin e Marrëveshjes për hua dhe financim ndërmjet KFW Frankfurt Am Main, Republikës së Kosovës dhe Operatorit të sistemit, transmissioinit dhe Tregut KOSST për përmirësimin e rrjetit të transmissioinit.

Lus deputetët dhe regjinë të përgatiten për votim. Votojmë tash!

Konstatohet se me 89 vota për, asnjë kundër, 1 abstencion, Kuvendi miratoi Ligjin nr. 04 /L-239 për ratifikim të Marrëveshjes për hua dhe financimin ndërmjet KFW, Republikës së Kosovës dhe Operatorit të sistemit, transmissioinit të tregut KOST, për përmirësimin e rrjetit të transmissioinit.

Faleminderit për vëmendjen në votim. Vazhdojmë me debatin. Fjalën e ka nënkryetari i Kuvendit, Sabri Hamiti.

SABRI HAMITI: Faleminderit, zoti kryetar i Kuvendit!

Kolegë të nderuar,

Ne sot pikën e rendit të ditës e kemi për një raport të Komisionit ad hoc për reformën zgjedhore, por menjëherë duhet të thuhet që nga deklaratimet e shefave të grupeve parlamentare u pa që ky raport po lihet anash, domethënë është i pavlefshëm. Në formën si është te ne nuk vlen gjë, për shkak se u mohuan tri kërkesat e fundit të tij që janë esenciale, ranë, u tha që nuk janë votuar dhe e dyta si raport i tillë çfarë është ai është me një teknikalitet që nuk bën të bisedojë Kuvendi në këtë përbërje për të, është i pavlefshëm mendoj unë.

Sido që të jetë po hapet tema që është e rëndësishme dhe unë e lash anash atë raport se me të vërtetë nuk ka asgjë për të cilën duhet të bisedohet, as nuk janë idetë, as në mënyrën qysh janë ballafaquar, as ku është mbërri, raporti nuk i ka këto elemente. Problemi është që ne të bisedojmë për reformën zgjedhore, e cila nuk është prodhuar në fillim si vullnet dhe domosdo e përfaqësuesve të qytetarëve, por është prodhuar prej një ngushtice të funksionimit të institucioneve të Kosovës. Ju e dini pse. Për shkak se ka dalë një qeverisje me legjitimitet të cunuar, sepse zgjedhjet nuk kanë qenë fer, demokratike dhe të lira, sepse ka pasur edhe vjedhje dhe, e dyta, sepse, duke qenë si të tilla mezi e kanë prodhuar një Qeveri, por s'kanë mund ta prodhojnë një kryetar të Kosovës legjitim, dhe kriza është bërë për dy muaj. 'Pesë para dymbëdhjetëve', kur mbaronte kjo, ashiqare janë motivuar edhe deputetët, edhe krejt të tjerët, që s'u konvenon të shkojnë në zgjedhje të reja dhe ka ndodhur kjo. Po ju përkujtoj se njerëzit po i harrojnë gjërat, po kujtojnë që prej se kanë lindur, edhe në këtë legjislacion, s'kanë bërë gjë, veç kanë menduar për reformë zgjedhore. Nuk është e vërtetë. Ky ka qenë detyrim i kohës, i orëve, i ditëve.

Dhe, e kemi një memorandum të marrëveshjes ndërmjet zotërinjve Pacolli, Isa Mustafa dhe Hashim Thaçi, që ka ndodhur më 6 prill 2011, i cili në pikën e parë thotë:

1. Ne, udhëheqjet e AKR-së, LDK-së dhe PDK-së nominojmë - lexojeni mirë - pra këta tret - e nominojnë Atifete Jahjagën si kandidate tonën për presidente të Republikës së Kosovës dhe shprehin përkrahjen e plotë të partive tona respektive për kandidaturën e saj. "Jemi të përkushtuar ta vëmë interesin e vendit mbi tonin". Pikë! Të gjitha pikat tjera janë variacione të kësaj.

Kjo pikë që tre liderë të tri partive e nominojnë për presidente Atifete Jahjagën, me emër e me mbiemër, e kanë nënshkruar më 6 prill 2011, nën firmat e tyre shkruan "Dëshmuar nga Kristofer Dell". Unë do të thosha kreator, krijuar nga Dell. Jepjani autorësinë! Pse ia marrin? Kjo është e vërteta. Tash i thonë të gjithë. Atëherë s'e kanë thënë, po është. Dhe,

kjo është mjeshtri e madhe, se ai thotë ‘kam dëshmuar’, veç ju kam parë çfarë po bëni. E që janë bërë a pesë ditë bisedime, këto nuk ekzistojnë, por deputetët duhet ta dinë, se i kanë pasojat.

Po, kjo është një marrëveshje. Në të hyrë në Kuvendin e Kosovës, që ndodh një ditë më vonë, shpejtësia është e dritës, atëherë ky nënshkrim bëhet dokument institucional i Kuvendit. Mos është faj ose meritë e këtyre? Është faj ose meritë e Kuvendit. Dhe, tash këtë marrëveshje në Kuvend e kemi bërë ne. Ata që kanë votuar e kanë bërë dokument, rezolutë e cila është obligative për Kuvendin. Është obligative dhe e ka prodhuar nenin e parë të kësaj rezolute, që është një ditë më vonë. Thotë: “Kuvendi i Republikës së Kosovës shpreh përkrahjen e tij për memorandumin e marrëveshjes së tre liderëve, Pacolli, Mustafa, Thaçi”, të arritur më 6 prill 2011, dhe “mbështet plotësisht zotimet e përmbajtura në të”.

Çka i bie kjo? Kjo i bie, të gjitha pikat tjera janë faktikisht të njëjta, është e përshkruar, veç e përkthyer në shqip faktikisht, sepse është e përshkruar, nuk ka asgjë të re, merren obligimet që të bëhen dy komisione, në mënyrë që, meqë ata e dinin që atëherë nuk ndezte fort të zgjidhet një president në atë formë, edhe thanë ‘jo tjera herë’, për të mos u krijuar krizat institucionale të asaj natyre, zgjidhja është presidenti prej popullit. Prandaj, bëhet komision për ndërrimet e Kushtetutës, se i tillë nuk mund të zgjidhej me Kushtetutën në fuqi dhe bëhej një komision për Kushtetutë dhe një për reformë zgjedhore, sepse nuk bëhej ajo.

Ata thoshin të gjithë atëherë që kjo do të krijojë probleme gjithmonë, prandaj zgjidhja është prej popullit, prandaj duhet komisioni për Kushtetutë, sa di unë zotëriun Bajramin e kemi këtu. Nëse nuk është kështu, lirisht më repliko, thuaj ‘nuk është’. Dhe një komision për reformë zgjedhore. Këto dy komisione kanë qenë komisione binjake, çka do që kanë menduar, tjetri është Demolli, ajo ka qenë lojë. Njëri e ka pasur mandatin nja tre muaj më shumë se tjetri, por kjo nuk thotë gjë.

Për të kënaqur pak a shumë gjendjen shumë të pakëndshme post zgjedhore dhe institucionale, ka shkuar njëfarë deklarimi i një tipi të marrëveshjes, që kinse të gjithë i qetëson, që kjo Qeveri nuk do të duhej, meqë ka ndodhur çfarë ka ndodhur, e çka ndodhi, nuk duhet më shumë se 18 muaj t’i ketë qeverisje, por duhet të shkuar, rregullohen krejt këto punë dhe shkohet në zgjedhje të reja. Kjo është historia, por kjo edhe dokumentohet. Kësaj s’mund t’i ikim ne, se është rezolutë, dhe pse s’ka ndodhur kjo? Pse komisionet s’e kanë kryer punën? Faj ka Kuvendi, jo veç komisionet, sepse Kuvendi ka bërë rezolutë. Kuvendi s’e ka kryer punën.

Në kuptimin institucional, në kuptimin faktik, faj ka Qeveria. Ku e kemi?! A e sheh që mendon që do të shkojë gjithë ashtu. S’ka nevojë të jetë! Domethënë ‘tërt’ veshi s’i bën! Mendon - këta prapë do të votojnë çka do të bëjmë ne - i bie shqip.

Pra, mendoni pak për këto punë! Përgjegjësia është juaja. Prapë nesër, nëse e votoni, është juaja. Njeriu të jep ide, ti nëse i bën votë, edhe Presidentja që është nominuar prej tyre, është juaja, ju jeni përfaqësues të Kosovës, sepse i keni dhënë në një votim 80 vota.

As Ibrahim Rugova kurrë mbi 62 vota në këtë Kuvend s'i ka marrë! 80 ia keni dhënë! Është juaja!

Tash, shkojmë tutje. Çka, ku jemi tash? Çka po duhen tash? Kemi thënë 'reformë'. Kushtetuta s'do të ndërrohet, u krye. Domethënë, ne veprojmë në kuadrin e Ligjit për zgjedhjet. Tash shtyhen partitë. 'jo ne i kemi bërë propozimet'. Kurrëgjë s'keni bërë. Unë i drejtohem tash "Vetëvendosjes" - krejt çka lexoi zonja, ekziston në ligjin ekzistues. Pra, ju jeni kundër reformës zgjedhore! Ju jeni që të mbetet ai që është. Një njësi zgjedhore - është kushtetuese, lista të hapura - është kushtetuese, s'kemi prekur gjë, 2,5 për kandidatët individualë, është pesë partitë, ka qenë të votohen pesë veta. Krejt çka është, është 50:50 komisioni. Ok-ej, unë vetë individualisht e kam kërkuar, por edhe ajo pa e ndërruar Kushtetutën nuk bën, edhe ajo bie. Pra, të bëhemi konkretë, ta dimë çka po bëjmë.

Tash po i bie që ky komision, çka ka punua, njëfarë dosje është, unë edhe në Kryesi ju kam lutur - 'ju lutem këtë dosje mos ia dorëzon komisioni se është joserioze. Le të zbrësë në Kuvend, nëse këtë detyrë ia jep komisionit, ai vetvetiu bëhet komision për draftim, dhe le të bëhet. Është punë jona qysh merremi vesh.

Çështja është çfarë do të bëjë ky? *(Ma jep edhe pak kohë, se po dua ta çoj idenë deri në fund.)*

KRYETARI: Regjia, ia zgjat fjalën nënkryetarit Sabri Hamiti.

SABRI HAMITIT: Po përpiqem, po disa gjëra duhet të thuhet këtu dhe të mbeten. Tash nuk do të ketë reformë në kuptimin, nëse reforma i bie diçka esenciale që ndërrohet. Do të ketë precizime, zotime për numërim të votave më mirë, të mos vidhen, prapë me ligj nuk ndalet, por ndalet me vullnet dhe me organizim. Si do që të jetë, le të rumbullakohen këto, po përtej kësaj s'do të ketë me këtë që vendosim ne sot, se s'ka mundësi.

Është shumë mirë, se jemi katër që kanë qenë. Po ajo mua nuk po më inkurajon shumë, mu pse jeni katër, sepse nuk di çfarë prodhoni, domethënë ju vazhdoni si ka qenë dhe, e dyta, asnjëri ju të komisionit nuk e keni pasur edhe gjithë atë fuqinë të thoni 'idetë po i çojmë tutje, përtej pëshpëritjeve, ndaljeve ose grahjeve të shefave politikë'.

Ata edhe tash mund ta ndalin procesin. Nëse vazhdon teknologjia, se ju s'po e thoni ju, ju kanë ndalur ata. Kur kanë hyrë ata në lojë, ju s'keni bërë më gjë. Ditën e mirë!

KRYETARI: Fjalën e ka deputeti Halit Krasniqi.

HALIT KRASNIQI: Faleminderit, kryetar!

Të nderuar deputetë të Parlamentit të Kosovës,
Nuk mund të mos ndalem pak në gjithë këtë ekspozitë të parafolësit tonë të respektuar, i cili, pavarësisht që shumëkush nuk ka ditur t'i lexojë letrat që i ka shkruar ai, pavarësisht asaj që nuk kanë mundur t'i vlerësojnë të gjitha ato që i kanë lexuar nga parafolësi im,

unë edhe në qelitë e burgjeve jam frymëzuar nga “Letërnjoftimi”, jam frymëzuar nga “Kutia e zezë”, që ma përshkruante gjeografinë e atdheut, tragjedinë që e imagjinonte që mund të ishte. Por, natyrisht...

KRYETARI: Halit, të lutem, në temë!

HALIT KRASNIQI: .. tërë kohën thoshte se do të ketë... për t’i rrëfyer këtij vendi dhe atyre që mbeten gjallë se çfarë ka ndodhur. Tani, do të kthehem në temë.

Është bërë debat i gjerë për reformën. Ajo që duhet ta nënvizoj që në fillim - reforma është aspiratë e këtij vendit, është dëshirë e elektoratit, është domosdoshmëri për këtë proces politik nëpër të cilin po kalojmë tani.

Këtë konstatim e kanë bërë disa liderë politikë, e ka pasur ankesa pse ka qenë ajo përbërje. Por, atë takim dhe atë përbërje e ka imponuar një situatë politike, një ngërç i momentit dhe është gjetur një formulë jashtëzakonisht shpëtimtare, e pranueshme për partitë politike dhe e votuar në këtë Kuvend.

Ne si Komision i reformës nuk jemi produkt, prodhim i një marrëveshjeje politike. Jemi prodhim i një vendimi të Kuvendit legjitim dhe një vendimi legjitim, të përkrahur nga gjitha subjektet politike në këtë Kuvend.

Dhe, tani, në punën që kemi nisur, e kemi nisur për shumë entuziazëm dhe shumë përkushtim. Natyrisht që këtë entuziazëm dhe këtë përkushtim e kanë hendikepuar disa paraqitje të ngurta të subjekteve politike, që zoti Ardian Gjini i sintetizoi jashtëzakonisht mirë dhe e nxori një konkludim të saktë.

Konsensusi nuk arrihet vetëm si dua unë si parti politike, dhe hendikepimi ka qenë shumë i ashpër për ne i dy subjekteve. Hendikepimi shumë dogmatik që ka ardhur nga pozita e ngurtë e “Vetëvendosjes” dhe e SLS-së, të cilët i kanë pasur qëndrimet e njëjta dhe ne kemi pasur shumë vështirë t’i tejkalojmë. Konsensusi i partive tjera politike është ndeshur në këto dy qëndrime të ngurta dhe natyrisht që ne kemi arritur deri aty sa quhet kapitull politik.

Pjesën administrative logjistike dhe të gjitha ato çështje tjera që ngërthehen në Ligjin për reformë zgjedhore kemi arritur t’i përmbledhim bashkërisht. Partia Demokratike e Kosovës me qëndrim të njëjtë, Lidhja Demokratike e Kosovës me qëndrim të njëjtë, Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës me qëndrim të njëjtë dhe AKR-ja me qëndrim të njëjtë dhe koalicioni i tyre.

Kështu që, pjesa më e madhe e frontit të partive politike kemi pasur konsensus, por nuk kemi arritur ta marrim edhe pëlqimin e dy grupeve tjera.

Kështu, kemi shkuar në një debat natyrisht të pjekur, të nivelit me tolerancë për ta dëgjuar edhe mendimin e kundërt, dhe kemi përmbledhur 90% të ligjit me ndryshime dhe

plotësime për reformë zgjedhore. Natyrisht, mandati im ka qenë nga më të ndjeshmit - reforma nënkuptonte shkurtimin e mandatit të Qeverisë së PDK-së dhe koalicionit.

Unë nuk kisha të drejtë të jem flamurtar për t'ia shkurtuar mandatin e Qeverisë së Partisë Demokratike dhe të koalicionit. Natyrisht edhe vullnetin nuk e kisha, por këtë vullnet e kam vërejtur edhe te kryetari i Kuvendit që ka pasur dëshirë ta vazhdojë mandatin të jetë kryetar i Kuvendit, edhe te nënkryetarët e Kuvendit, edhe te ju deputetë të nderuar. Te të gjithë kam vërejtur dëshirën që të vazhdojë mandati.

Kështu që, këtë Kuvend e ka terrorizuar një zhargon, një slogan i një deputeti që i ka veç 2 000 vota, për vjedhje të votave, për vjedhjet industriale e tjera e tjera. Të gjithë jemi pajtuar që e kemi kaluar një proces të votimit të lënduar me keqpërdorime, por ato keqpërdorime për t'i konstatuar ka qenë kompetent Gjyqësori dhe natyrisht që janë organizuar edhe procese gjyqësore për të gjithë ata që kanë vjedhur dhe manipuluar vota.

Por, unë nuk mund të them tash që ka pasur edhe vjedhje industriale. Ka pasur vjedhje në vendet e caktuara, në vendvotime të caktuara, dhe këto i ka konstatuar organi kompetent. Nuk jam unë, zhargoni politik mund të tolerohet në intervista, në televizion, në publik, por nuk tolerohet këtu në këtë Kuvend. Këtu duhet të flasim me fakte, jo pastaj për të debatuar dhe për të nxitur debat të panevojshëm, ajo që është e rëndësishme për këtë moment.

Reforma duhet të përfundojë. O ky komision, ai komision, po Komision legjitim i këtij Kuvendi, dhe kjo është kërkesë e elektoratit, është vullneti i këtij Kuvendi, i shumicës së këtyre deputetëve dhe është kërkesë e partnerëve tanë ndërkombëtarë, sidomos i qendrave relevante, të cilat po vendosin në gjithë planetin për fatin e tij. Dhe, ne nuk guxojmë ta injorojmë zërin që vjen te reforma. Nuk është zë i lagjeve, i vendlindjeve tona. Nuk është zë i asnjë lagjeje të kryeqytetit. Është zë i qendrave të vendosjes për fatin e këtij planeti. Prandaj, edhe për fatin e këtij vendi, pse jo?

Reforma është kërkesë e Bashkimit Evropian. Madje, në listën e kërkesave që i kemi nga Raporti i Progresit për MSA-në, kërkesa e parë është të përfundojë reforma zgjedhore. Kush guxon ta injorojë? Cili është ai deputet? Cili është ai politika, që do ta injorojë këtë kërkesë kaq të rëndësishme nga një institucion kaq relevant?

Dhe, dy gjëra, përveç kësaj, edhe e dyta duhet të respektohet.

Zgjedhjet duhet të organizohen pas reformës. Ne mund të bëjmë një formulë politike, ne mund të bëjmë maskara politike, ne mund të bëjmë një marrëveshje politike nga liderë legjitimë që të shkojmë në zgjedhje edhe pa reformë, por na shtrojnë në këtë Kuvend eurodeputetët, na shtrojnë edhe nga selia e Brukselit, na shtrojnë edhe miqtë tanë të ambasadave respektive: “Ju mund të bëni zgjedhje edhe pa reformë, por rezultatet e këtyre e këtyre zgjedhjeve do të kontestohen, nuk do të njihen”.

Edhe në procesin politik të cilin synon Kosova të integrimëve euroatlantike është një qëndrim shumë i rëndësishëm. Është një vërejtje jashtëzakonisht. Është një ngrehje jo e

një veshi, por është ngrehje për të dy veshët. Kush merr vesh, kush është i ndërgjegjshëm dhe kush është i përgjegjshëm në këto angazhime që ka marrë sot dhe që ju fton për këto detyra tani.

Zgjedhjet duhet të bëhen, por me reformë. Reforma duhet të përfundojë doemos dhe pas reformës duhet të keni durim të prisni, të përgatiteni, ta shtrëngoni rripin, t'i riparoni repartet partiake. Gjashtë muaj ditë keni afat. Edhe institucionet kushtetuese ta përgatisin procesin që të shkojë në mirëvajtje dhe kjo mirëvajtje të jetë legjitime dhe institucionale. Krejt këto janë të nevojshme - koha dhe aspekti ligjor.

Aspekti ligjor tash kalon ta marrë performansën edhe të marrë formën, fizionominë e tij në Komisionin e Legjislacionit. Aty janë të pranishëm të gjitha partitë parlamentare, aty është vullneti i këtij populli të përfaqësuar nëpërmjet njerëzve kompetentë. Këtu duhet patjetër një tolerancë e domosdoshme. Kjo vlen për subjektin shumë simpatik "Vetëvendosje", që nuk duhet të ngulë këmbë të kërkojë vetëm qëndrimet e veta që të vijjnë në shprehje dhe të gjithë ne t'i përshtatemi këtij qëndrimi të tyre. I respektoj të gjitha qëndrimet e tyre, sidomos dekorin e tyre kuq e zi. Por, vendimet nuk duhet të jenë bardh e zi, as edhe kuq e zi. Duhet të jenë kolorit ylberi i të gjitha subjekteve politike që aderojnë në këtë Kuvend dhe që janë të pranishme në atë komision.

Prandaj, nëse të gjithë jemi në nivel të detyrave, nëse vërtet të gjithë e duam këtë vend, nëse të gjithë duam t'i kryejmë detyrat që nga ka ngarkuar elektorati ynë, duhet të ulemi, dhe me cilindo komision, tash po vendosim në Komision për Legjislacion. Ta rumbullakojmë gjithë nevojën e plotësim-ndryshimit të Ligjit për zgjedhje të përgjithshme në Republikën e Kosovës dhe aty të përmbledhet vullneti me tolerancë dhe mirëkuptim i të gjitha subjekteve politike që janë në interes ato vendime dhe ato qëndrime të këtij vendi dhe që sigurojnë zgjedhje...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Replikë, nënkryetari Sabri Hamiti.

SABRI HAMITI: Faleminderit, zoti kryetar!

Replikë dhe pyetje, bashkë.

Unë i kuptoj njerëzit që lexojnë hartime të bukura, ose flasin prej momenti në moment, por dua të bëhem konkret. Prapë një letër në dorë.

Zotëriu që foli para meje, në një dokument që na e ka nënshkruar, është dokument zyrtar, që e kemi ne si raport të komisionit, pika një, nënshkruar për Haki Demollin, nga folësi para meje, thotë: "T'i vazhdohet mandati për një kohë të caktuar Komisionit ad hoc për reformë zgjedhore". Tash po thotë t'i kalohet komisionit tjetër. Çka bëhet? Të jemi të qartë, çfarë po themi.

Prandaj, unë thashë, kjo si materie, si rekomandim, pas deklarimeve të kryetarëve të grupeve, është 'nyl', s'ekziston, se po hiqet dorë. Në emër të komisionit vijnë tjera rekomandime. Thuhet s'vyejnë, thotë edhe nënshkruesi. Kjo është çështja, të bëhemi të

qartë! Është punë tjetër çka po thonë ta zëmë këtu e tutje. Çka po vendosim, është punë tjetër. Por, tash për tash, kjo është kështu. Faleminderit!

KRYETARI: Visar Ymeri e ka fjalën.

VISAR YMERI: Faleminderit, kryetar!

Është e qartë që raporti i punës së komisionit për reformën zgjedhore që na është dorëzuar, pas kërkesës së Kryesisë, është në shpërputhje të plotë, jo vetëm në atë që është diskutuar në Kryesinë e Kuvendit të Republikës së Kosovës, por dorën në zemër është në shpërputhje edhe me një logjikë shumë të thjeshtë të raportimit të një komisioni, i cili është vlerësuar si njëri prej komisioneve ndoshta më të rëndësishme të kësaj legjislature, edhe për shkak të votave që i ka marrë në Kuvend, edhe për shkak të pompozitetit të emërimit të tij, pra Komisioni për reformën zgjedhore.

Edhe tash këtu e kemi një problem, i cili u përmend nga deputetja Albulena Haxhiu, por për të cilën pastaj nuk e morën shumë afër zemrës deputetët çuditërisht, por unë e kisha konsideruar që deputetët të tjerë do të brengoseshin me këtë, si të them, njëloj falsifikimi të këtij qëndrimi të komisionit, i cili na ka ardhur si qëndrim i tij në raport, e prej të cilit automatikisht hoqën dorë të gjitha grupet parlamentare, përfshirë këtu nënshkruesin e raportit.

Pra, çka po i raportohet këtu Kuvendit nga ky komision? A do të na tregojë komisioni se çka ka punuar? Sepse ky raport, tashmë e vlerësuan të gjithë, në mënyrë të drejtpërdrejtë apo indirekt, që është raport i pavlefshëm, si përmbajtje po flas. Mirëpo, këtu pajtohem me nënkryetarin - ky është raport zyrtar, megjithatë, sepse vjen në emër të komisionit, nënshkruar nga nënkryetari i komisionit, e kemi emrin e kryetarit të komisionit, aty pastaj thuhet për kryetarin, domethënë nënshkruan zoti Halit Krasniqi.

Pra, kush po e jep këtë raport? Kush e ka dorëzuar këtë raport në Kuvend? A është komisioni, a është kryetari në bashkëpunim me nënkryetarin, a është vetëm nënkryetari? Ne duhet ta dimë këtë si deputetë, sepse është një komision që është mandata nga ky Kuvend dhe këta deputetë të Kuvendit duhet ta dinë çfarë ka bërë ky komision.

Çështja tjetër pastaj është te përmbajtja, me të cilën unë mendoj që duhet të merremi, sepse këtu ideja ka qenë pak a shumë të diskutohet puna e deritashme e komisionit dhe pastaj në bazë të këtij diskutimi të vendoset çfarë do të bëjmë tutje, apo jo? Përfshirë këtu edhe qëndrimet e grupeve politike, të partive politike për reformën zgjedhore, ose për atë që po quhet sistem zgjedhor në Kosovë, sepse jo domosdoshmërisht kur flasim për sistemin zgjedhor duhet të flasim vetëm në vija të reformimit të tij.

Mbase ka grupe politike që pajtohen që me gjendjen në të cilën ndoshta është i mirë, përveç disa përmirësimeve në administrim të zgjedhjeve, po ky është qëndrim politik dhe nuk mund të thoni që ju nuk keni asnjë qëndrim, siç u tha këtu për "Vetëvendosjen", sepse ju po doni ta mbani të njëjtë. ky është qëndrim politik pra. Është qëndrim i qartë politik i argumentuar, që e kemi pasur vetëm në krahasuar me të tjerët, që kurrë nuk kanë pasur një qëndrim të qartë, të argumentuar dhe të dorëzuar në formë të shkruar në

komision, por ka pasur lëvizshmëri të madhe të grupeve të tjera, herë për zona, herë për më shumë zona, herë për më pak zona, herë për lista të mbyllura, herë për lista të hapura, herë për pesë të votuar, herë për dhjetë të votuar, herë për një të votuar, e kështu me radhë. Këto nuk janë qëndrime, pra.

Secili grup politik duhet, mendoj unë, ta shfrytëzojë të drejtën e vet që ta ketë qëndrimin e qartë, i cili mund të jetë për ta ndryshuar sistemin zgjedhor, ta argumentojë atë, ose mund të jetë për ta mbajtur siç është dhe ta argumentojë atë. Po këtu në komision fatkeqësisht nuk e kemi parë një gjë të tillë.

Po i kthehem raportit. Këtu asgjë nuk përmendet, përveç disa informatave teknike të numrit të takimeve, të vizitave nëpër komuna të ndryshme të Kosovës, dhe pastaj të anëtarëve të grupit, e kështu me radhë, që janë të domosdoshme, por absolutisht të pamjaftueshme për një raport të Komisionit ad hoc. Pra, këto janë të domosdoshme, natyrisht, duhet t'i tregohet dhe ky aspekti teknik i sasisë së takimeve, intensitetit të tyre, e kështu me radhë, por çka është më me rëndësi - debati që është zhvilluar në Komisionin ad hoc për reformën zgjedhore, duke i përfshirë këtu edhe qëndrimet e grupeve të ndryshme, ose edhe të deputetëve individualisht, duhet të reflektohen në këtë debat pastaj në Kuvendin e Republikës së Kosovës.

Kjo ka qenë ka qenë pritshmëria jonë, të paktën, që ne do të dëgjojmë nga komisioni - të na thuhet që 'i kemi diskutuar këto gjëra, e kemi arritur njëlloj konkluze për disa gjëra, kjo është arsyeshmëria pse ne mendojmë që është më mirë të ndryshohet Ligji zgjedhor në këto pika që ne i kemi propozuar të ndryshohen'. Këto janë çështje që nuk kanë arritur të diskutohen për shkak të pengesave të ndryshme. Prej nga kanë ardhur pengesat, a kanë qenë pengesat e liderëve politikë drejtpërdrejt, a ka qenë ndërhyrje institucionale e Kuvendit, a kanë qenë ndërhyrje jashtinstitucionale të ambasadave dhe të grupeve tjera, e kështu me radhë.

Pra, ky ka qenë dashur të jetë raporti, që ne ta dimë se çfarë është bërë me reformën zgjedhore, ndërkohë që asnjë prej këtyre nuk përmenden në raport. Ky raport është një lloj antiraporti për shkak se raporton për ta fshehur atë që duhet raportuar. Është e kundërta e raportit.

Pra, i tërë debati që ka ndodhur në këtë kohë sa po flasim për reformën zgjedhore, është një debat i cili në njëfarë mënyre e shpërfaq të them ashtu një qëndrim që e kanë shumica e subjekteve politike në Kosovë për sistemin zgjedhor, në përgjithësi. Pra, mënyra se si është vendosur së pari që ta nisim një reformë zgjedhore, në një takim të tre prej të udhëheqësve të partive politike në Kosovë, të cilët e kanë nënshkruar me ambasadorin amerikan një marrëveshje, tregon qartë se çfarë qëndrimi kanë këta persona që e kanë nënshkruar marrëveshjen për sistemin zgjedhor.

Pra, këta mendojnë se këta e pronësojnë sistemin zgjedhor dhe përgjithësisht këtu mendohet që partitë politike e pronësojnë sistemin zgjedhor, por nuk është sistemi zgjedhor një hapësirë ku qytetari flet politikisht, por po duan ta mbajë sistemin zgjedhor në një hapësirë ku këta mund financiarisht t'i blejnë qytetarët, për shkak se kjo është

pronësia. Është ftesë për qytetarin, 'ejani në sistemin tonë zgjedhor, ne ju tregojmë se si bëhet ai për interesat tona dhe ju e keni rolin aty të një spektatori ose të një pjesëmarrësi', të them ashtu, në një teatër modern interaktiv, ku qytetari si spektator e merr edhe rolin e aktorit për një moment shumë të shkurtër kohor.

Pra, këtu po flasim edhe për pronësinë mbi sistemin zgjedhor. Epërsia mbi sistemin zgjedhor duhet të jetë e qytetarëve, sepse sistemi zgjedhor në demokracinë parlamentare është ajo pjesë e politikës që ia mundëson qytetarit të flasë politikisht, prapë po e përsëris, gjë që nuk ka ndodhur në vitin 2010, të gjithë e dimë, për shkak të manipulimit të këtij sistemi zgjedhor që është bërë nga po të njëjtit njerëz që mendojnë që e pronësojnë këtë sistem zgjedhor.

E sa për seriozitetin, të them ashtu, të subjekteve të ndryshme që kanë marrë pjesë në këtë që u quajt të reformës zgjedhore, unë mendoj se shpërfaqja më e mirë e nivelit të diskutimit është ajo që e tha zotëri Krasniqi më herët. Pra, mënyra se si ky foli për reformën zgjedhore, jo vetëm tash këtu në Kuvend, por që e kemi parë edhe në emisione, mendoj se tregon se sa seriozë ka qenë, në fakt, në këtë rast, Partia Demokratike e Kosovës në këtë diskutim për sistemin zgjedhor dhe çfarë forme do duhej ta kishte ai. Dhe, për këtë, unë, pasi e dëgjova edhe një herë zotin Krasniqi që ka qenë nënkryetar i komisionit, në fakt, edhe e kuptova pse e kemi këtë raport të tillë çfarë e kemi. Natyrisht, nuk mund ta presësh më të mirë.

Për fund, është e domosdoshme që sistemi zgjedhor, zgjedhjet, në përgjithësi, të jenë të pamanipulueshme, mirëpo problemin që e kemi pasur në vitin 2010, edhe në vitet pararendëse me vjedhjen e votës, me vjedhjen industriale të votës në vitin 2010, nuk ka qenë domosdoshmërisht e lidhur me sistemin zgjedhor, me formën e tij, por as me ligjin zgjedhor, por ka qenë drejtpërdrejt ndërhyrja e partive politike për ta manipuluar votën dhe, në anën tjetër, moskokëçarja e institucionit, e aparatit shtetëror të gjyqësisë dhe policisë për ta parandaluar këtë vjedhje. Ky është problemi.

Pra, t'i themi të gjitha qartë. Ne pastaj në njëfarë mënyre e kemi sulmuar Ligjin zgjedhor, thuajse Ligji zgjedhor ka thënë se votat duhet të vidhen domosdoshmërisht. Natyrisht se nuk e ka thënë këtë Ligji zgjedhor. Këtë e kanë bërë individët e caktuar, pjesëtarët e subjekteve politike, me direktiva nga lart nga Kryesia, të cilët është dashur të identifikohen, është dashur të ndiqen dhe të hetohen nga Prokuroria dhe është dashur të ndëshkohen për atë hajni të votës. Dhe, kështu parandalohet hajnia e votës. Nuk ka asnjë ligj në Kosovë në Kosovë që thotë se bën të vidhet. Atë e bëjnë njerëzit përkundër ligjit, pra hajnia bëhet duke e shkelur ligjin, gjë që ka ndodhur në vitin 2010.

Ne që në vitin 2011, më 12 shtator të vitit 2011, publikisht kemi kërkuar dorëheqjen kësaj Qeverie. Pra, pasi i kemi identifikuar politikat e kësaj Qeverie si shumë të dëmshme për Kosovën, kemi ardhur në konkluzionin që Kosova do të shpëtonte po të mos e kishte këtë Qeveri në pushtet. Pastaj, më 4 dhjetor të vitit 2011, e kemi bërë publik dhe i kemi ftuar të gjitha subjektet politike, por edhe deputetët që të bëhen pjesë e një mocioni të mosbesimit për këtë Qeveri dhe pastaj, më 25 maj të vitit 2013, u kemi propozuar dy partive opozitare, në takime të përbashkëta, me Lidhjen Demokratike të Kosovës dhe me

Aleancën për Ardhmërinë e Kosovës, që ta krijojmë së bashku një bllok opozitar, i cili synim do ta kishte rrëzimin e Qeverisë dhe shkaktimin e zgjedhjeve.

Jemi nisur nga fakti që po qe se edhe këto parti konsiderojnë që problem në Kosovë është qeverisja e Hashim Thaçit me ministrat e tij, atëherë kemi konsideruar që natyrisht do të kishte qenë në përputhje me këtë qëndrim tonin që të angazhohemi që ta rrëzojmë këtë Qeveri. Pra, ta rrëzojmë problemin, apo jo? Dhe, i qëndrojmë prapë besnikë kësaj ideje dhe kësaj kërkesë tonës, e cila natyrisht ka mundur shumë lehtë të shndërrohet në kërkesë të përbashkët. Pra, nuk kemi ne, si të them ashtu, ne lloj manie që ta mbajnë pronësinë mbi këtë proces.

KRYETARI: Në temë, se realisht ke dalë pak prej teme!

VISAR YMERI... çështja është kështu: mendojmë që ndryshimi për të cilin po flasim nuk mund të bëhet në marrëveshje me atë që e ka shkaktuar problemin. Me këtë po u drejtohen dy partive opozitare. Ndryshimi bëhet vetëm nëse opozita bëhet bashkë për ta hequr problemin.

Pra, nëse e konsiderojmë këtë Qeveri, ose politikat e saj si problem për Kosovën, si një e keqe që po i ndodh Kosovës, atëherë angazhimi për ta rrëzuar këtë Qeveri është angazhim për ndryshim. Marrëveshja me të nuk mund të jetë kurrë angazhim për ndryshim. Faleminderit!

(Drejtimin e mbledhjes e merr nënkryetari i Kuvendit, z. Sabri Hamiti.)

KRYESUESI: Fjalën e ka kryetari i Kuvendit, Jakup Krasniqi.

JAKUP KRASNIQI: Të nderuar deputetë!

Do të përpiqem vërtet të flas shkurt, por të jemi i saktë. Unë konsideroj që Komisioni ad hoc parlamentar nuk e ka kryer detyrën e vet siç e ka marrë nga Kuvendi i Republikës së Kosovës. Dhe, jo vetëm që nuk e ka kryer detyrën e vet, por nuk i ka identifikuar problemet që është dashur t'i identifikojë dhe t'i raportojë Kuvendit.

Kjo punë e këtij komisioni siç ka ardhur, në fakt, nuk do të thotë kurrëgjë. U tha edhe nga të tjerët. Dhe, tash është çështja e Kuvendit se ku e adreson. Por edhe të adresohet në Kuvend, me lëndën që është aty, përsëri nuk është bërë reforma zgjedhore. Komisioni paraprakisht do duhej t'i identifikonte se në cilat drejtime do ta bënte reformën zgjedhore dhe këtë nuk e ka bërë.

Ne dëgjuam edhe një propozim më konkret nga përfaqësuesja e pranishme në këtë komision, e Grupit "Vetëvendosje", por në fakt ajo është - mbetet ligji në fuqi. Ka qenë edhe një detyrë tjetër që është dashur ta saktësojë komisioni - cili ka qenë burimi i defektit të zgjedhjeve të kaluara? Ne nuk mund ta fajësojmë vetëm një parti apo një subjekt politik, por dihet se ne e kemi parë edhe në zgjedhjet e fundit. Zgjedhësi ynë nuk mund të bëjë shumë vota, edhe pse ka pasur të votojë për parti dhe për kandidatin dhe

diku 100 000 vota - fletëvotime janë shpallur të pavlefshme. Kjo tregon se për qytetarin tonë është i ndërlikuar votimi në shumë vende.

Po i lëmë këto krejt. Partitë politike në ditën e zgjedhjeve kanë mundësi t'i ruajnë votat e tyre nëse i zgjedhin komisionarët e mirë. Shtrohet pyetja: deputetët brenda listës si do t'i mbrojnë vorbat e tyre, nëse, për shembull, unë dua të flas për vete, se kam folur mjaft për këtë sistem, tash dua ta marr shembull veten, nëse unë kam xhepin e fryrë dhe i blej komisionarët, i blej votat pa m'i dhënë qytetarët dhe bëhem deputet, kush ta mbrojë votën e deputetit në zgjedhje? Këtë çështje është dashur ta shtrojë me vëmendje Komisioni ad hoc, i formuar për reformën zgjedhore.

Në fakt, vënia e emrit të kandidatit në listë nuk ka mundësi ta mbrojë votën e vet. Prandaj, komisioni është dashur të merret me këtë çështje: si ta mbrojë votën e kandidatit? Dhe, kjo formë dhe ky ligj që është, a mund ta mbrojë votën e kandidatit?

Shikoni, unë po them që ligji në vetvete, edhe ai ekzistuesi, nuk ka qenë i keq, dhe nuk është problemi te ligji. Problemi është te ata që janë të pandërgjegjshëm dhe me qëllim, edhe të organizuar, duan ta keqpërdorin votën e qytetarëve. Këtu nuk është e mbrojtur as vota që e merr kandidati dhe nuk është mbrojtur as vota që e jep qytetari. Unë mendoj që detyra e komisionit është dashur ta thotë si të mbrohet vota e qytetarit dhe si të mbrojë pastaj kandidati votën që e merr nga qytetari.

Ne e kemi problem dhe duhet ta themi dhe nuk do të zgjatëm shumë. Ne kemi problem në funksionimin të institucioneve të shtetit. Ne, sipas Kushtetutës, kur është arritur marrëveshja, Kosova e ka pasur Presidentin në detyrë siç ia jep Kushtetuta, dhe unë po them - partitë politike, sa herë që duhet të marrin vendime të përbashkëta dhe të formësojnë konsensus, duhet ta kenë adresë Presidentin e shtetit, se ai e përfaqëson vendin edhe brenda, edhe jashtë. Por, as atëherë, e as sot, pas katër vjetëve, bisedimet nuk janë duke u zhvilluar në institucionet e Republikës së Kosovës.

Unë dëshiroj që kjo reformë të përmbyllet në Kuvend, por nuk besoj që ky Kuvend ka kapacitet ta bëjë reformën në afatin e duhur dhe në afatin që i duhet Kosovës. Kur them kapacitet, nuk e ka vullnetin politik, se u tha këtu, se edhe mua më ka pëlqyer të jem kryetar i Kuvendit, dhe anëtari që foli e di shumë mirë që unë kam qenë i gatshëm dhe atë gatishmëri e kemi pasur deri në fund për të shkuar në zgjedhjet e jashtëzakonshme, por të mos prodhoheshin këto institucione që janë prodhuar, dhe kjo dihet. Gjithçka ka qenë konkrete dhe e njohur për opinionin.

Nëse dikush nuk ka pasur besim që kthehet përsëri në këtë sallë, nuk është problem imi. Prandaj, atë që e kemi, ajo që është jona, të mos ia themi tjetrit, të mos bëhemi si dhelpra. Iu kishte djegur bishti dhe thoshte 'u kallë dynjaja'. Jo, pse është djegur bishti i dhelprës, nuk është djegur dynjaja.

Prandaj, unë dëshiroj, edhe një herë po them, që Kuvendi si institucion ta kryejë detyrën dhe përgjegjësinë e vet, por vërtet duhet të jetë vullneti i deputetëve, duhet të jetë vullneti i shumicës së deputetëve, edhe në këtë Kuvend, edhe në komisionet parlamentare. Më

vjen keq, por deri sot nuk e kemi parë këtë vullnet. Nëse prej sot ky vullnet tregohet nga ne, unë jam i bindur që reforma zgjedhore do të përfundojë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zotëri kryetar! Fjalën e merr deputetja Donika Kadaj-Bujupi.

DONIKA KADAJ-BUJUPI: Faleminderit, i nderuar nënkryetar!

Mendoj se të gjithë e dimë që arsyeja për fillimin e kësaj reforme, në fakt, ka ardhur si pasojë... *(Ndërhyrje: Arben, po flet ti, a unë?! Ende nuk të ka ardhur rendi, të lutem mos më pengo!)* Arsyeja për reformë ka ardhur si pasojë e moszbatimit të ligjit, e jo si pasojë e ligjit të keq, siç nganjëherë kemi pretenduar ta themi.

Megjithatë, ka ardhur si propozim, ka filluar të ndodhë, ndoshta për ta tërhequr vëmendjen prej problemit kyç që ka qenë moszbatimi i Ligjit dhe moszbatimi i vullnetit politik për të dalë, bazuar me ligj si institucione me të cilat, në fakt është dashur të kryhen zgjedhjet, me ligjin i cili ka qenë në fuqi. Por, megjithatë, mendoj se të gjithë këtu e dimë sot se ku fle lepuri. Nuk bëhet fjalë për pengesa, të cilat kanë ndodhur për shkak të mungesës së vullnetit të komisionit ose të deputetëve të caktuar, por bëhet fjalë për një bllokim të këtij procesi, i cili vjen si pasojë e mungesës së guximit dhe vullnetit politik të dy liderëve të partive më të mëdha. Do të thotë, është fakt se dy liderët e partive më të mëdha e kanë bllokuar reformën zgjedhore dhe kjo po ndodh në 3 vjetët e fundit.

Arsyet ata i dinë, por pasojat tregojnë edhe një herë që na mungon një vetëdije shtetndërtuese. Përndryshe s'kishim pritur 3 vjet, ta gjuajmë topin herë te një komision e herë te tjetri për një punë, e cila është puro përgjegjësi e liderëve.

Ne sot mund të flasim çfarë ka bërë ose nuk ka bërë komisioni. Sigurisht se ka shumë për të diskutuar dhe debatuar, por reforma në esencë nuk bëhet nga komisioni. Reforma ose vendimi për një reformë thelbësore merret nga liderët politikë, të cilët nuk e kanë pasur gatishmërinë.

Po dua të theksoj që Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës qysh në fillim të këtij procesi, duke e dërguar nënkryetarin e parë, e ka dërguar edhe vendimin, ose propozimin e marrë në kuadër të partisë për reformë. Dhe, ai vendim e ka paraqitur një reformë, ose ka qenë një vendim për reformë, i cili nuk është përkrahur, sepse të tjerët nuk e kanë pasur as vullnetin, as guximin, e as nuk e kanë marrë asnjë veprim për ta zhbllokuar këtë proces.

Prandaj, të flasim shqip dhe ta adresojmë problemin aty ku duhet.

Sa i përket raportit, mendoj se ne i kemi disa çështje teknike që janë esenciale, por që prapë nuk janë reformë. Për shembull, pastrimi i listave. Po dua ta marr një shembull. Në komunën në të cilën kam garuar herën e fundit, në statistika, në entin statistikor rezultojnë të regjistruar 30 000 qytetarë, sipas regjistrimi të fundit. Ndërkaq, në listën e KQZ-së kanë qenë 58 000 votues. Do të thotë, kemi një shpërputhje për mbi 20 000 qytetarë, të cilët ose janë, ose s'janë, ose janë votues, ose s'janë, sepse dy institucione zyrtare në të njëjtën ditë në ueb-faqet e tyre dhe në listat zgjedhore japin dy informata, të cilat garojnë me një numër mbi 20 000 qytetarë.

Mendoj se kjo është punë e Ministrisë së Punëve të Brendshme, e cila po neglizhohet, është punë e KQZ-së dhe është punë e këtij Kuvendi që të luftojë që të paktën para këtyre zgjedhjeve t'i kemi të pastuara ato lista, nëse jo krejt, të paktën deri në një pikë ku nuk mund të ndodhë manipulimi, të cilin e kemi parë në vitin 2010.

Pjesa tjetër ose vendimet e mëdha dihet kujt i takojnë dhe dihet kush po i bllokun.

KRYESUESI: Faleminderit! Ismet Beqiri, replikë!

ISMET BEQIRI: Zoti, nënkryetar!

Unë ju kisha lutur, se po mundohem t'i kuptoj disa deputetë që tash po tentojnë të bëjnë marketing elektoral, por ju kisha lutur - rendi i ditës është shumë i qartë.

Po ia rikujtoj deputetes së nderuar që në të gjitha këto biseda për reformë zgjedhore merr pjesë edhe lideri, zoti Haradinaj. Dhe, ne e çmojmë kontributin e tij.

Por, mos u mundo tash t'u hedhësh qytetarëve pluhur syve, duke e shfajësuar dikë, e duke e fajësuar dikë. Prandaj, të bëhemi korrektë. Takimet mbahen në Kuvendin e Kosovës. Këto takime janë mbajtur për ta debllouar, për të bërë përpjekje për të ecur reforma tutje.

Prandaj, mos bëni gjëra të tilla, sepse këto nuk pinë ujë. Ju mendoni, ndoshta, por nuk pinë ujë te qytetarët, edhe të krijoni njëfarë favorizimi, nëse mund të thuhet.

Ajo që për ne si LDK është në interes, e besoj edhe të gjithë tjerët, është ta përfundojmë këtë punë dhe nga ky komision të shkohet në komisionin tjetër, në komisionin që të gjithë i kanë pasur përfaqësuesit. Prandaj, t'i lëmë marketingjet politike, sepse nuk është tema për këtë punë, e kur të vijë fushatat, i bëjmë. Pra, nuk është korrekte të sillemi kështu, kush kujt më tepër po ia hedh, nëse mund të thuhet, akuza. Nuk është korrekte, absolutisht.

Prandaj, është rendi i ditës. Shikoni numrat, a kanë qenë dhe a janë sot për ta rrëzuar Qeverinë? Lërinë këto, se i dimë. Merrni e kalkuloni, sa numra i ka deputetë...

KRYESUESI: : Ismet, tash nuk je duke bërë replikë. Përmbylle!

ISMET BEQIRI: OK! Po e përmbyll! Pra, të mos dalin jashtë rendit të ditës.

KRYESUESI: Faleminderit!

DONIKA KADAJ-BUJUPI: Faleminderit!

Edhe një herë, po e ritheksoj: zoti Haradinaj, ashtu sikur në të gjitha proceset, ka qenë shumë i saktë me vendimet e tij për ecje përpara të reformës zgjedhore. Janë dy liderët, edhe një herë po e ritheksoj, të partive më të mëdha ata të cilët e bllokujnë. Ju po kërkoni ta hidhni topin nëpër komisione për t'i ikur përgjegjësisë, për të dalë prej bllokadës në të cilën dy partitë e mëdha e kanë futur Kosovën me këtë proces.

KRYESUESI: Faleminderit! Por, më nuk do ta merrni fjalën as për replikë për t'i lavdëruar liderët, se unë e di që ju e teproni duke i lavdëruar të gjithë. Fjalën e ka Lirije Kajtazi.

LIRIJE KAJTAZI: Faleminderit, i nderuar nënkryetar!

Të nderuar kolegë deputetë,

Komisioni që ka derivuar nga marrëveshja, e cila ka dashur ta shërojë një proces të lënduar zgjedhor, normalisht që i është dashur një kohë për të kaluar në një mënyrë që ndoshta manipuluesit ta harrojnë pak zanatin dhe kjo kohë ka kaluar, jemi këtu ku jemi, dhe ky komision sot e prezantoi punën e vet. E pa edhe vetë të arsyeshme se është e mjaftueshme që Komisioni Parlamentar për Legjislacion do të kishte mundur të bënte punë dhe natyrisht që çështja duhet të kthehet këtu dhe aq më tepër nuk ka pas bile nevojë të bëhen dy komisione - edhe komisioni për reformë zgjedhore dhe komisioni për reformë kushtetuese.

Prandaj, ne po e shohim se tash ndoshta për ta shëruar procesin është dashur të kalojë një kohë. Është interesante nëse juve ju ka rënë në sy një çështje, e cila është në raport - sfidë komisioni e evidenton takimin me liderë.

Mendoj se ky është një fakt i cili flet shumë. Gatishmëria për të ecur më tutje vërehet që nuk ka qenë e mjaftueshme dhe një çështje që flet për joseriozitetin e qasjes në këtë problematikë është kjo. Sipas të dhënave të Agjencisë për Statistika të Kosovës, regjistrimi i vitit 2011, Kosova i ka pasur 1 739 825 banorë. Rritja për një vit, për 2012, sipas indeksit ka shkuar në 1 815 606 banorë, ndërsa votues sipas Agjencisë për Regjistrim Civil në Ministrinë e Punëve të Brendshme janë 1 750 272 dhe sipas Agjencisë së Statistikave për çdo vit moshën 18 vjeç e mbushin 35 000 të rinj.

Mendoj se krejt këto shifra flasin për një gjë. Ne, ose është dashur ta shohim se regjistrimi i vitit 2011 ka qenë joserioz dhe të mos pranohet që numri i banorëve të Kosovës është ai që është deklaruar, ose nuk është dashur të pranohet numri i votuesve në këtë shifër, dhe krejt këto bien në përgjegjësinë tonë.

Edhe ky komision, edhe Agjencia e Statistikave i jep llogari këtij Kuvendi. Prandaj, unë mendoj se është mirë të bëhemi seriozë, t'i shohim problemet aty ku janë.

Më lejoni ta përmbyll me një thënie të Zhan Zhak Rusosë, e cila thotë: Asnjëherë mos iu friko ligjit, por gjykatësit bën t'i frikohesh.

KRYESUESI: Fjalën e ka Suzan Novobërdaliu. Meqë s'kemi biseduar për kohë, unë ju tregoj se janë edhe 13 veta, e kohën menaxhoheni si të doni. Në daçi shkoni deri në minutën e 10-të.

SUZAN NOVOBËRDALIU: Faleminderit, nënkryetar!

Të nderuar deputetë,

E nderuara zëvendëskryeministre,

Siç e dimë të gjithë, po diskutojmë për raportin e Komisionit për reformën zgjedhore për periudhën e filluar prej 22 prillit. Do të thotë, përafërsisht në muajin tjetër do t'i kemi 3 vjet prej formimit të këtij komisioni.

Pse u formua ky komision të gjithë e dimë - pasojë e vjedhjeve të votave në zgjedhjet e fundit parlamentare të vitit 2010.

Si zgjidhje e këtij problemi - vjedhjes - u parapa formimi i komisionit për ndryshimin e ligjit. Ligji, sipas meje, nuk është edhe i keq, aq avaz të ngrihet - ligji, ligji, ligji! Është problemi të mbrojtja e votës së qytetarëve, se në fund të fundit edhe me këtë ligj kishim mundur t'i organizojmë edhe zgjedhjet e ardhshme.

Pra, avaz 3 vjet, reforma zgjedhore, reforma zgjedhore, dhe të mendojë dikush që s'e dinë përmbajtjen çfarë reformash do të ndodhin në këtë ligj.

Çka thotë raporti të sfidat e komisionit? Thotë se ka hasur në vështirësi rreth sistemit zgjedhor, zonave zgjedhore, listave, pragut zgjedhor dhe ndarjes së ulëseve në Kuvend. Gjërat që mund t'i themi sipas njohurive që i kemi, pastaj nga takimet e liderëve, që të gjithë faktikisht janë pajtuar me ligjin ekzistues zgjedhor.

Zonat zgjedhore, sa e di unë, një zonë, listat sa e di unë në atë demokratike të hapura, që edhe janë në ligjin ekzistues, pragu zgjedhor ndoshta diçka është dashur të ndryshohet dhe ndarja e ulëseve në Kuvend, që të gjithë e dimë - është Pakoja e Ahtisarit, e kemi Kushtetutën, e cila i definon shumë qartë ulëset në Kuvend.

Objektivat e komisionit, thotë sistemi zgjedhor transparent, sistemi zgjedhor i thjeshtë, sistemi zgjedhor pa keqpërdorime, gjë që në shtetet tjera as që diskutohet. Paramendoni si shtet qysh u dukemi shteteve tjera. Në shtetet tjera votohet me telefon. Aq i madh është besimi. E ne diskutojmë për diçka që duhet të nënkuptohet. Kjo rrjedh si pasojë e zgjedhjeve të manipuluar.

Pra, për mua, këtu ka shumë pak vend që të ndryshojë ky ligj, jo aq sa është bërë e madhe tash e 3 vjet të flitet për këtë çështje.

Krejt për fund, për mua është shumë interesant që pikërisht partia në pushtet është ajo e cila bën përpjekje për zgjedhjet e parakohshme, edhe pse mandatin e ka deri në shkurt të vitit 2014. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka deputeti Bekim Haxhiu.

BEKIM HAXHIU: Faleminderit, i nderuar nënkryetar!

Të nderuar kolegë deputetë,

Vërtet këtë material kemi pritur ta trajtojmë me kohë për arsye se data e skadimit të afatit, apo edhe vetë komisioni ka paraparë që mbledhjen e fundit e ka mbajtur më 29.8.2012 dhe ne kemi pritur të gjithë që ky komision vërtet ta kryejë punën ashtu brenda mandatit, të cilin ia ka dhënë Kuvendi.

Dobësitë e theksuara të procesit zgjedhor në Kosovë janë si rezultat i administrimit të dobët të zgjedhjeve dhe ndërhyrjes në sistemin zgjedhor. Prandaj, kur flitet për reformën zgjedhore i gjithë opinioni pret një rregullim të sistemit zgjedhor, ku mundësia e manipulimit nuk do të ekzistojë dhe ku procesi zgjedhor u garanton qytetarëve që vota e tyre nuk do të jetë e manipuluar dhe sistemi zgjedhor do ta garantojë vullnetin qytetar, ku deputetët e zgjedhur në Kuvendin e Kosovës janë deputetë të zgjedhur drejtpërdrejt nga qytetarët dhe kjo pastaj e bën më efikas edhe punën e deputetëve, e ngre nivelin e llogaridhënies së deputetëve ndaj zgjedhësve.

Nëse do të vendosej që sistemi zgjedhor të jetë zonal, atëherë llogaridhënia do të ishte edhe më e madhe dhe më e drejtpërdrejtë ndërmjet zgjedhësve dhe deputetëve. Mundësia që iu dha votuesve në Kosovë për të zgjedhur pesë kandidat nga listat e partive, i ka përparësitë e saj sa i përket përfaqësimit politik.

Me reformën e sistemit zgjedhor ne duhet ta zvogëlojmë, apo thënë shkurt ta eliminojmë tendencën për manipulim të vullnetit qytetar dhe kjo do të duhej të jetë sfida kryesore e reformës zgjedhore dhe kështu me këtë mospunë të komisionit zgjedhor nuk do të mund të arrijmë atje.

Debati i deritanishëm publik sa i përket reformës zgjedhore ka dëshmuar që qytetarët dëshirojnë që vota e tyre të mos manipulohet dhe kërkojnë llogaridhënie nga të zgjedhurit e tyre. Dhe, për këtë ata e kërkojnë mundësinë që brenda listave të partive politike të kenë mundësi për të zgjedhur dhe listat të jenë të hapura.

Karakteristikë tjetër që duhet t'i karakterizojë dhe që të jetë pjesë bartëse e reformës zgjedhore duhet të jetë edhe transparenca. Transparenca është ajo e cila do ta eliminonte mundësinë e manipulimit të zgjedhjeve gjatë zgjedhjeve dhe t'i eliminonte të gjitha dyshimet sa i përket manipulimit të tyre.

Komisionit të krijuar nga ne i ka skaduar mandati dhe më pastaj u tha që ia kemi vazhduar mandatin edhe për 3 muaj. Ky Kuvend ka pritur që Komisioni ad hoc brenda mandatit të tij ta sillte këtë material që tani ka ardhur në Kuvend, mirëpo komisioni nuk e ka bërë një punë të tillë.

Materiali i dorëzuar tani një vit e gjysmë pas skadimit të afatit apo të mandatit është material jovalid. Prandaj, edhe nuk vlen të shqyrtohet në këtë seancë.

Delegimi i përgjegjësive nga komisioni te liderët ka dëshmuar se ky komision nuk ka qenë në nivelin e detyrës dhe kot anëtarët e komisionit e fajësojnë njëri-tjetrin në tërësi. Komisioni nuk ka arritur ta kryejë punën brenda mandatit të caktuar nga Kuvendi dhe para përfundimit të mandatit komisioni është dashur që këtë material të na e dërgojë në kuti postare dhe pastaj ta marrim në shqyrtim. Këtë nuk e ka bërë atëherë dhe tani e ka sjellë një draft pas skadimit të mandatit që vërtet s'ia vlen të shqyrtohet.

Tani ne po e shqyrtojmë një material nga një komision që nuk ka mandat, andaj fillimisht mendoj që Kuvendi do të duhej ta caktonte një mandat të ri, ose të votonte për një

komision të ri, për arsye se ky nuk e ka kryer punën dhe pastaj materiali, i cili do të prodhohej nga ai komision të shqyrtohej në Kuvend, sepse nëse ky material tani i dërgohet Komisionit për Legjislacion, ai nuk mund ta marrë në shqyrtim një material i cili është prodhuar nga një komision tanimë inekzistues, ose pa mandat.

Të nderuar kolegë,

Ne po dëshirojmë ta vendosim një sistem zgjedhor kredibil, ndërsa qysh në nismë po bëjmë shkelje ligjore e kushtetuese dhe shkelje të Rregullores dhe shkelje të vetë ligjit zgjedhor, për të cilin e kemi autorizuar komisionin që ta bëjë.

Dihet procedura për hartimin e ligjeve, dihet procedura për plotësim-ndryshimin e ligjeve dhe është ‘non sens’, që nga një komision, i cili nuk e ka kryer punën, ky material t’i delegohet një komisioni tjetër. Prandaj, së pari, ne duhet të vendosim që kujt do t’ia besojmë reformën zgjedhore, a do të vendosim që reforma zgjedhore të jetë e thellë, apo ajo të jetë vetëm një reformë zgjedhore sipërfaqësore, dhe a do të vendosim që ajo të jetë vetëm një reformë kozmetike. Kjo i mbetet në dorë Kuvendit se si do të vendosë. Pastaj, kur materiali të na vijë në Kuvend, ne do të vendosim, se për transparencën e zgjedhjeve do të vendosim a do të dëshirojmë t’i kemi komisionet e votimeve dhe komisionet e numërimeve të ndara, a do kemi komisione komunale të votimit dhe komisione komunale të numërimit të votave, a do të bëhet numërimi i votave në formë transparente, apo do të zvarritet sikur në zgjedhjet e fundit që numërimi i votave në qendra të numërimit të votave të zgjasë mbi një muaj dhe edhe ata të cilët kanë kandiduar në zgjedhje, edhe ata të cilët kanë zgjedhur, do të presin me muaj të tërë për të ditur se kandidatët e preferuar të tyre a kanë kaluar në zgjedhje, por edhe vetë kandidatët ta marrin vesh rezultatin e zgjedhjeve.

Nëse e delegojmë këtë përgjegjësi nëpër qendrat komunale të numërimit, atëherë mundësia e numërimit të votave dhe përfundimi i procesit zgjedhor do të ishte shumë i shpejtë, mirëpo kjo do të mbetet në përgjegjësi të vetë komisionit dhe të këtij Kuvendi për formën se si do të vendosim ta bëjmë reformën zgjedhore.

Dhe, krejt në fund, të nderuar kolegë deputetë, kërkoj që vërtet reformën zgjedhore ta bëjmë të thellë, të jetë në të vërtetë një reformë zgjedhore ashtu siç e kërkojnë qytetarët e Republikës së Kosovës dhe për mua mbeten ‘non sens’ edhe vetë mëditjet e paguara për Komisionin ad hoc dhe mendoj se ato mëditje do të duhej t’i shlyhen këtij komisioni për arsye se nuk e ka kryer punën e vet dhe është ‘non sens’ të paguhet dikush, i cili s’ka punuar asgjë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Unë kërkoj vëmendje, deputetë të nderuar, para se të vazhdojmë. Ne po zhvillojmë debat, dhe normalisht unë do t’ua jep fjalën të gjithë atyre që janë paraqitur.

Megjithatë, unë po jua tërheq vëmendjen se kur bëhet mocion i secilit, të gjithë kanë bërë mocion, edhe këta që po diskutojnë, edhe shefat e grupeve parlamentare, atëherë zakonisht s’bëhet debat për mocion.

Unë tash po ju propozoj, në bazë të asaj që kanë deklaruar shefat e grupeve, çfarë mund të jetë vendimi që sot e marrim ne.

Bazuar në deklarimet e shefave të grupeve parlamentare dhe të diskutuesve në debatin e Kuvendit të Republikës së Kosovës, më 31.01.20124, Kuvendi i Republikës së Kosovës, nxjerr këtë:

V E N D I M

Puna rreth reformës zgjedhore i kalon Komisionit për Legjislacion të Kuvendit të Republikës së Kosovës, si Komision Funkcional.

Komisionit Legjislativ i dorëzohet i gjithë materiali punues i ish-Komisionit ad hoc për reformën zgjedhore për ta draftuar ligjin për zgjedhjet.

Pra, a e paraqet ky formulim mocionin të cilin e keni theksuar ju të gjithë?

(Ndërhyrje)

Po me dy pika, unë besoj që është.

(Ndërhyrje)

Tash duhet parë sa jemi brenda këtu. Thirri deputetët, le të hyjnë brenda. Nëse janë këtu, e nëse s'janë s'i kemi!

(Ndërhyrje)

Nëse nuk janë, vazhdojmë, por ne u morëm vesh faktikisht për formulimin, e të shohim sa do të bëhemi, se po hyjnë.

(Ndërprerje e shkurtër)

Qetësohuni ju atje! Uluni për një moment! Pushoni pak!

Në sallë janë 64 deputetë. Unë ju thërras të bëheni gati e ta votojmë propozimin që e dhashë dhe që e pranuat. E ftoj regjinë dhe deputetët të bëhen gati për votim. Votojmë tash!

(Ndërhyrje, V. Ymeri: Desha vetëm ta arsyetoj vendimin, se i kam disa pyetje.)

Shikoni, ju jeni kaq sa jeni këtu. Se po thonë fizikisht... Fizikisht po, por a jeni të plotë?

Shiko, Visar! Ky e ka mandatin si çdo komision funksional që e trajton një ligj në lexim të parë, në lexim të dytë. Periudhat i dendëson, qysh punon. Ne nuk mund të vëmë afat

këtu, por është komision funksional. Ka lexim të parë, ka lexim të dytë, sikur të gjitha draftimet.

(Ndërhyrje)

Po, bën Visar!

(Drejtimin e mbledhjes e merr kryetari i Kuvendit, z. Jakup Krasniqi.)

KRYETARI: Urdhëro, Visar! Regjia, fjalën deputetit Visar Ymeri!

VISAR YMERI: Faleminderit, kryetar!

Unë e kërkoja fjalën për t'i qartësuar disa gjëra, që konsideroj se duhet sqaruar. Jam dakord me vendimin e propozuar që doli këtu nga debati për t'iu bartur tash puna Komisionit për Legjislacion.

Mirëpo, duhet ta qartësojmë ne, mendoj unë, që së pari a po ia dorëzojmë ligjin me ndryshimet e propozuara, i cili do ta trajtojë atë si projektligj, apo do t'ia dorëzojmë krejt punën, e këta kanë mundësi ta nisin pastaj këtë diskutim prej fillimit. Sepse, u dëgjuam këtu disa deputetë që thanë - jo vazhdojmë të qëndrojmë prapë idesë për ta ndarë në zona, e kështu me radhë. Domethënë, kjo nënkupton që të nisë edhe një herë diskutimi, prandaj këtë edhe duhet ta qartësojmë.

Pra, ne ia dorëzojmë Komisionit për Legjislacion ligjin me propozimet dhe këta e trajtojnë sikur projektligj, apo jo? Pra, si projektligj sikur që është e paraparë në Rregullore.

SABRI HAMITI: E gjithë puna, e gjithë ajo dosje si e tyre u kalon këtyre. Në formulim e ke atë, brenda është.

VISAR YMERI: Këtë pra desha ta sqaroj unë. Le ta trajtojë si projektligj me propozimet dhe pastaj me afatet e Rregullores.

SABRI HAMITI: Po, ajo është brenda në formulim.

KRYETARI: Mirë, faleminderit! Ne edhe me pikën 50, që është lexuar, kemi të drejtë t'ia kalojmë komisionit.

Atëherë, lus deputetët dhe regjinë të përgatiten për votim. Votojmë tash! Do të thotë, e votojmë vendimin e lexuar nga nënkryetari, ose kryesuesi i seancës.

Me 62 vota për, 1 kundër, miratohet vendimi.

SABRI HAMITI: Vetëm një moment! Ne e kryem, nëse doni të flisni....

KRYETARI: Jo, më s'ka! Mocioni bëhet pa debat. Tash e kemi një propozim, apo njoftim dhe duhet një votim formal.

14. Propozimi i Grupit Parlamentar të Lëvizjes “Vetëvendosje” për zëvendësimin e anëtarit në Komisionin Parlamentar

Grupi Parlamentar i Lëvizjes “Vetëvendosje” e ka propozuar deputetin Faton Topalli për zëvendëskryetar të parë në Komisionin për Bujqësi, Pylltari, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor, si dhe për anëtar të Komisionit për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale, në vend të ish-deputetit Liburn Aliu.

Kërkoj nga ju që, me një ngritje dore, të deklaroheni për propozimin e Grupit.

Kush është për? Faleminderit! A ka kundër? 1 është kundër!

Atëherë, me shumicën e votave, miratohet propozimi i Grupit “Vetëvendosje”.

Me kaq e mbyllim dhe mirupafshim në seancën e ardhshme!

*E përgatiti:
Njësia për Transkriptim dhe Lekturë*